



# **E DREJTA - LAW**

---

**Revistë për Çështje Juridike dhe Shoqërore**  
**Journal for Juridical and Social Issues**  
**Viti XXXV - Nr. 1 - 2012**

**Botues - Publisher**  
**Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës**  
**University of Prishtina School of Law**

**Shtypi i kësaj reviste financohet nga:**  
***Tafilaj Group***



# E drejta - Law

Revistë për Çështje Juridike dhe Shoqërore

Journal for Juridical and Social Issues

Viti XXXV - Nr. 1 - 2012

Botohet çdo tre muaj - Published every three months

---

## Redaksia - Editorial Staff

Anëtarë

Dr. sc. Abdulla Aliu, prof. i rreg., Dr. sc. Haki Demolli, prof. i rreg., Dr. sc. Bedri Peci,  
prof. asoc., Dr. sc. Visar Morina, prof. asoc., Dr. sc. Qerim Qerimi, prof. ass.

Kryeredaktor – Editor-in-chief

Dr. sc. Qerim Qerimi

Sekretar i redaksisë – Secretary

Vigan Qorrolli, MA

Disenji dhe thyerja teknike

Grafobeni - Prishtinë

Shtypi:

Shtypshkronja

**Grafobeni**

Prishtinë

## Përmbajtja – Content

### *Artikuj – Articles*

*(Summaries in English)*

Prof. Dr. Enver Hasani

*Specifikat e trashëgimit të ish Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të*

.....  
Specificities of the Succession of Former Yugoslavia and the Place of Kosovo in It

Dr. Ján Cirák

*Kodifikimi dhe evropianizimi i të drejtës private në Republikën Sllovake*

.....  
Codification and Europeanization of Private Law in the Slovak Republic

Dr. Rustem Qehaja, prof. ass.

*Arbitrazhi - Mënyrë e zgjidhjes së kontesteve nga polica e sigurimit*

.....  
Arbitration – A Way of Resolving Disputes from Insurance Policy

Ela Elezi

*Legjislacioni penal shqiptar dhe efektiviteti i tij në luftën kundër kriminalitetit*

.....  
Albanian Criminal Legislation and Its Effectiveness in the Fight against Criminality

Doc. Dr. Jeton Shasivari

*Statusi i shqiptarëve në sistemin kushtetues, juridik dhe politik të Republikës së Maqedonisë* .....

The Status of Albanians in the Legal, Constitutional and Political System of the Republic of Macedonia

Ma. sc. Hashim Çollaku

*Fillimi, qëllimi dhe zbatimi i hetimit* .....

The Commencement, Purpose and Implementation of Investigation

Mr. sc. Xhevdet Halili

*Legjislacioni dhe metodat e torturës* .....

The Legislation and Methods of Torture

*Kontribute – Contributions*

Mr. sc. Lavdim Krasniqi

*Pavarësi gjyqësore .....*

Judicial Independence

Ma. sc. Arben Agushi

*Marrëdhëniet Juridike Pronësore të Bashkëshortëve, të Bashkëshortëve  
Jashtëmartesorë dhe të Anëtarëve të Bashkësisë Familjare*

.....



# Artikuj

## Articles



Prof. Dr. Enver Hasani

## Specifikat e trashëgimit të ish Jugosllavisë dhe pozita e Kosovës në të

### *Hyrje*

Ky shkrim synon shjellimin e pasojave në kurriz të Kosovës, të cilat dalin si pasojë e mbylljes së procesit të trashëgimit të ish Jugosllavisë, mbyllje që ka ndodhur me nënshkrimin e marrëveshjes mbi trashëgimin në mes të pesë ish republikave jugosllave, të krijuara si shtete sovrane dhe të pavarura pas shkatërrimit të ish Jugosllavisë<sup>1</sup>. Në diskursin politik e publik kosovar kjo çështje ENDE trajtohet si e hapur<sup>2</sup>. Shtjellimet në këtë shkrim merren me

---

<sup>1</sup> Titulli i Marrëveshjes në origjinal është: “Agreement on Succession Issues and Annexes A to G”, nënshkruar më 29 qershor 2001 në mes të Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Sllovenisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë ( “Unioni Serbi dhe Mali i Zi”, i cili formalisht ka përfshirë dhe Kosovën në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të datës 10 qershor 1999). Në tekstin e mëtejshëm: MT ose “Marrëveshja”. Dokumenti, i shoqëruar me komentet e Negociatorit Special për Çështjet e Trashëgimit të Ish Jugosllavisë prej vitit 1996 deri në lidhjen e MT, Sir Arthur Watts është ribotuar si tekst i plotë në 41 *International Legal Materials* (2002) fq. 1-37. Marrëveshja ka hyrë në fuqi më 2 qershor 2004, sipas dispozitave të nenin 12 (1) mbi hyrjen e saj në fuqi dhe është ratifikuar nga pesë shtete trashëgimtare dhe atë: Bosnja dhe Hercegovina, 15 maj 2002; Kroacia, 3 maj 2004; Unioni Serbi dhe Mali i Zi, 10 tetor 2002; Sllovenia, 21 gusht 2002; ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, 6 mars 2002. Këto të dhëna janë siguruar përmes një interviste elektronike me anë të internetit të cilën ky autor e ka kryer me z. Andrej Rode, përgjegjës për marrëdhënie me publikun pranë ministrisë së punëve të Jashtme të Republikës së Sllovenisë, zhvilluar më datën 9 dhjetor 2005. Sipas z. Rode, deri më tani janë zhvilluar një sërë aktivitete në vijim të zbatimit të MT, siç janë takimet e rregullta të përfaqësuesve të shteteve palë në mekanizmat e saj, kryesisht për çështjet financiare nga Aneksi C i MT dhe ato të pronave të përfaqësive diplomatike e konsullore nga Aneksi B i MT. Sipas bashkëbiseduesit, ndonjë mosmarrëveshje serioze në mes të palëve në Marrëveshje deri më tani nuk ka pasur.

<sup>2</sup> Autori i këtyre rreshtave, pas mbarimit të luftës së fundit në Kosovë, disa herë është detyruar të prononcohet me kërkesë të medias vendëse për të njëjtën çështje, ka provuar fare qartë të vë në dukje kotësinë e qasjes kosovare ndaj këtij problemi, hera e fundit duke qenë prononcimi rreth problemit të kufijve me Maqedoninë, i krijuar në bazë të Marrëveshjes së vitit 2001 në mes të Republikës Federative të Jugosllavisë (tash Unioni Serbi dhe Mali i Zi: më tej shkurt: RFJ/USM). Megjithatë, ky autor nuk ka pasur mundësi të bëjë ndonjë hulumtim të thellë rreth kësaj problematike dhe prononcimet e më sipërme kanë qenë të bazuara kryesisht në MT, e cila ka qenë e arritshme për publikun. Shkuarja në

sqarimin e natyrës së MT dhe të pasojave të saj për të drejtat e detyrat e Kosovës kundrejt trashëgimit të ish Jugosllavisë. Në fakt, në këtë shkrim ne sqarojmë për lexuesin shqip se Kosova si shtet Sovran dhe i pavarur nga data 17 shkurt 2008 trashëgon Republikën e Serbisë, jo ish Jugosllavinë siç ka qenë rasti me MT ku vetëm ish republikat jugosllave kanë pasur një të drejtë të tillë.

---

Universitetin “Northwestern” të Chicagos, SHBA, në Institutin për Studime Ndërkombëtare dhe Komparative, në semestrin dimëror 2005, në kuadër të programit “Fulbright”, për mbajtjen e një cikli të ligjëratave në këtë institut dhe në disa universitete të tjera amerikane, ka bërë të mundur hulumtimin e thellë të materialit rreth trashëgimit të ish Jugosllavisë, për çka autori është mirënjohës si ndaj programit “Fulbright” ashtu dhe ndaj të gjithë atyre që ndihmuan në mbledhjen e materialit për këtë shkrim. Detyrim të veçantë falënderimi autori ndien ndaj drejtorit të Institutit, Dr. Andrew Wachtel, si dhe Prof. William Slomanson nga “Thomas Jefferson School of Law” të San Diegos në Kaliforni. Idenë për një strukturë të tillë të punimit, ndërkaq, autori e ka huazuar nga autori Carsten Stahn, i cili me punimin e tij mjaft të detajuar “The Agreement on Succession Issues of the Former Socialist Federal Yugoslavia”, publikuar në *American Journal of International Law*, Vol. 96 No. 2 (April 2002), fq. 379-397, ka ndikuar esencialisht në autorin për marrjen edhe më tutje me rezultatet aktuale doktrinare në lëmin e trashëgimit shtetëror në rastet e shpërbërjes së shteteve.

Versioni i parë i këtij shkrimi është botuar në “Thomas Jefferson Law Journal”, Vol. 29 No. 1 (Fall 2006), me titull “The Evolution of Succession Process in Former Yugoslavia”, fq. 111- 150, i cili më pastaj është reproduktuar me leje në Hungari në “Miskolc Journal of International Law ” Vol. 4 No. 2 (2007), fq. 12-37, me të njejtin titull. Ky version në gjuhën shqipe paraqet një ndryshim esencial të punimit fillestar sa më sipër për faktin se trajton çështjen e trashëgimit të ish Jugosllavisë në dritën e Planit Ahtisari për Kosovën të datës 2 shkurt 2007 dhe krijimit të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur më 17 shkurt 2008, i njohur nga 91 shtete deri më tani (korrik 2012), ndër to nga shtetet më të fuqishme të botës së sotme, nga shtetet të cilat sot interpretojnë ligjin ndërkombëtar.

Termi “Plani Ahtisari” i cili përdoret në këtë shkrim i referohet dokumentit titulli i plotë i të cilit është “Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës” (datë 2 shkurt 2007). Ky dokument u lejua nga Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ai ishte menduar për ta zëvendësuar Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të datës 10 qershor 1999 mbi bazën e të cilës ishte themeluar misioini i Kombeve të Bashkuara në Kosovë i njohur si UNMIK. Vetëm shqiptarët dhe jo serbët e Kosovës e pranuan vlefshmërinë e këtij dokumenti dhe në bazë të tij u shpall Kosova shtet Sovran dhe i pavarur më datën 17 shkurt 2008. Pala serbe e refuzoi atë. Ky dokument u emërtua sipas ish presidentit finlandez Martti Ahtisaari, i cili i udhëhoqi bisedimet paqësore që synonin përfundimin e statusit politik të Kosovës i cili atëbotë ishte akoma i pazgjidhur dhe që duhej të zgjidhej meqë ishte kërkesë shprehimore e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit. Cf. më tepër për këtë në Ray Murphy, *UN Peacekeeping in Lebanon, Somalia and Kosovo* (Cambridge University Press: Cambridge, 2007); Mauro Mazza, *L’ordinamento costituzionale del Kosovo* (Jovene Editore: Napoli, 2008).



Arritja e MT ka mbyllur njëherë e mirë problemin e trashëgimit të ish Jugosllavisë në mes të ish republikave jugosllave (me përjashtim të Kosovës e cila nuk ka pasur statusin e republikës federale jugosllave), i cili ka qenë i hapur që nga viti 1992. E themi që nga vitit 1992 për arsye se si proces ka mundur të hapet vetëm atëherë kur janë krijuar shtetet e reja dhe shteti i vjetër jugosllav është zhdukur nga skena. Konstatimi ndërkombëtar se ish Jugosllavia ka marrë fund si shtet Sovran dhe i pavarur, i shqiptuar në verë të vitit 1992 nga Komisioni Badinter, ka shtruar nevojën që edhe çështja e trashëgimit të të drejtave dhe detyrimeve të atij shteti të nisë e të zbatohet më me shpejtësi se deri atëherë. U bënë shkrime të shumta akademike e politike rreth kësaj çështjeje, aq sa citimi i tyre me këtë rast nuk do të ishte i mundur.

Në mënyrë zyrtare, ky problem ka filluar të trajtohet për herë të parë në kuadër të Grupit Punues për Çështjet e Trashëgimit, i cili ka funksionuar brenda Konferencës për ish Jugosllavinë (Gjenevë dhe Londër respektivisht: 1992 - 1995). Sipas dispozitave të Marrëveshjes mbi Paqen e Dejtonit (nëntor 1995), Grupi për Trashëgiminë e ish Jugosllavisë ka mbetur i vetmi grup që ka vazhduar punën në kushtet e reja të krijuara pas lidhjes së marrëveshjes në fjalë dhe, mbi bazën e një vendimi të njërit prej organeve të themeluara në Dejton, Këshillit për Implementim të Paqes, kompetenca për trajtimin e çështjeve të trashëgimisë së ish Jugosllavisë ka kaluar në duart e Përfaqësuesit të Lartë për Bosnjë dhe Hercegovinë<sup>3</sup>. Qëndrimi serb në kuadër të punës së këtij grupi për vite me radhë ka penguar punën e tij dhe arritjen e një marrëveshjeje të përgjithshme, ashtu siç kërkon e drejta ndërkombëtare në rastet e trashëgimit të shteteve<sup>4</sup>. Ky qëndrim serb ka konsideruar Republikën Federative të Jugosllavisë (në tekstin e mëtejme RFJ/USM, “Unioni Serbi dhe Mali i Zi”) si trashëgimtarin e vetëm juridiko-ndërkombëtar të ish Jugosllavisë. Sikundër do të shihet në vijim, serbët kanë besuar se me këtë fitojnë të drejtën e ndarjes sipas dëshirës së tyre të aseteve të ish Jugosllavisë<sup>5</sup>. Sipas politikës zyrtare serbe, ish Jugosllavia nuk qe

---

<sup>3</sup> Konkluzionet e Këshillit për Implementimin e Paqes (“Peace Implementation Council”), të dala nga takimi i Londrës, mbajtur më 8 dhjetor 1995, mund të shikohen në Internet në këtë veb faqe: [http://www.ohr.int/pic/default.asp?content\\_id=5168](http://www.ohr.int/pic/default.asp?content_id=5168)

<sup>4</sup> E drejta ndërkombëtare e trashëgimit të shteteve njeh si parësor parimin e marrëveshjes në mes të subjekteve që trashëgojnë.

<sup>5</sup> Për komentet e këtij qëndrimi, shih më shumë në Vladimir –Djuro Degan, *Disagreements over the Definition of State Property in the Process of State Succession to*

shpërbërë më 1992. Atëherë, sipas kësaj politike, ka ndodhur vetëm shkëputja e pjesëve të saj, ku RFJ/USM kishte arritur ta ruajë identitetin e ish Jugosllavisë (dhe kontinuitetin me të) sepse, sipas serbëve, republikat tjera janë shkëputur pa dëshirë dhe, si të tilla, nuk kanë të drejtën e trashëgimit të barabartë të pasurisë, të drejtave dhe detyrimeve të atij shteti.

Ky punim ndahet në disa pjesë dhe ndjek strukturën e MT, në po atë mënyrë që ka bërë autori tjetër, punimi i të cilit ka shërbyer si udhërrëfyes mjaft i dobishëm në hartimin e këtij shkrimi<sup>6</sup>. Pjesa e parë flet për shqyrtimet e përgjithshme rreth trashëgimit, për të kaluar në pjesën e dytë të kuadri ligjor i MT. Kjo bëhet me qëllim që lexuesi të jetë në gjendje për t'i ndjekur specifikat e trashëgimit të ish Jugosllavisë kundrejt praktikave tjera në të drejtën ndërkombëtare, të tashme dhe nga historia. Pjesa e tretë flet për problemet konkrete që kanë lindur rreth ndarjes së pronës shtetërore të ish Jugosllavisë, që ne e kemi quajtur hedhja poshtë e kërkesës së RFJ-së për trashëgimtar të vetëm (kontinuitet) të ish Jugosllavisë. Pjesa e katërt paraqet kuadrin e bashkëpunimit institucional në MT. Ndërkohë që në pjesën e pestë është shtjelluar çështja e pronës së tundshme e të patundshme, ku bëjnë pjesë edhe përfqasitë diplomatike dhe konsullore. Në mënyrë të natyrshme, pjesa e gjashtë e këtij shkrimi plotëson mozaikun e trashëgimit si proces dhe flet për trashëgimin e të drejtave dhe detyrimeve financiare. Sado që arkivat janë pronësi shtetërore, ndarja e tyre kryhet sipas rregullave të tjera nga ato që kanë të bëjnë me pronësinë, gjë që ka bërë të jetë pjesë e ndarë edhe në MT, rrugë që edhe ne e kemi ndjekur në këtë shkrim në pjesën e shtatë të tij<sup>7</sup>. Kjo nuk është kështu kur flitet për pronën private dhe të drejtat e

---

*the Former Yugoslavia*, botuar në Mojmir Marak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 1999), fq. 33-60.

<sup>6</sup> Për tekstin e MT, shih fusnotën 1 *supra*, kurse për autorin në fjalë - fusnotën 2 *supra*.

<sup>7</sup> Në planin ndërkombëtar ekzistojnë dy konventa që rregullojnë çështjet e trashëgimit të shteteve: njëra quhet Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin ndaj Traktateve Ndërkombëtare e vitit 1978 (në tekstin e mëtejshëm: KV I), kurse tjetra Konventa e Vjenës mbi Trashëgimin ndaj Pronës, Arkivave dhe Borxhit të Jashtëm e vitit 1983 (më tej shkurt: KV II). ("Vienna Convention on Succession of States in Respect of Treaties", August 23, 1978, *U.N. Doc. A/CONF. 80/31* (1978)) dhe ("Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts", April 8, 1983, *U.N. Doc. A/CONF. 117/14* (1983)).

Sado që besohet që këto dy dokumente të rëndësishme ndërkombëtare, përkundër të metave, reflektojnë të drejtën zakonore ndërkombëtare në lëmin e trashëgimit të shteteve, statusi i tyre aktual është mjaft i dobët: Etiopia, Iraku, Sllovakia dhe ish Jugosllavia kanë ratifikuar KV I, kurse Republika Dominikane, Egjipti, Estonia, Maroku, Schyelles, Tunisia dhe Ukraina kanë hyrë në të, në ndërkohë që Bosnje - Hercegovina, Kroacia dhe Sllovakia

fituara, të cilat sqarohen në pjesën e tetë të këtij shkrimi. Pjesa e fundit rezervohet për mendimet tona përfundimtare.

Çështja e Kosovës ka qenë tërësisht e përjashtuar nga ky proces, për arsye të mosqenies së saj shtet sovran dhe i pavarur. Asnjë dispozitë e MT nuk i referohet Kosovës. Shkrimi synon që të tregojë jo vetëm përjashtimin e Kosovës nga ky proces, tanimë të mbyllur sipas kushteve të parapara në MT, por edhe mundësitë juridike e politike të cilat janë përdorur dhe hapur në Planin Ahtisari për një rikthim të këtij procesi në dobi të Kosovës *vis-à-vis* Serbisë gjatë bisedave të dyta teknike për Kosovën<sup>8</sup>.

Rifutja e Kosovës në këtë process përmes Planit Ahtisari paraqet teknikë të re juridike, në tërësi *sui generis*, e cila si e tillë i përmbahet në tërësi të drejtës ndërkombëtare mbi trashëgimin e shteteve por se sërish mbetet akt i njënashëm juridik ndërkombëtar pa pasur natyrën e një marrëveshjeje të vlefshme ndërkombëtare. Për këtë arsye në këtë shkrim flasim për Kosovën brenda tekstit pas trajtimit të apsketevë të veçanta të trashëgimit dhe atë çdo herë pas shtjellimeve mbi ish republikat jugosllave dhe vendin që ato kanë pasur dhe kanë në MT (sepse ato dhe vetëm ato, pra ish

---

e kanë trashëguar të njëjtën. Asnjë shtet deri më 31 dhjetor 2005 nuk ka ratifikuar KV II, kurse vetëm Kroacia, Estonia, Gjorgjia dhe Ukraina kanë hyrë në të. “Multilateral Treaties Deposited with the Secretary – General” (Status as on December 31, 2005), *U.N. Doc. ST/LEG/SER/E 19* (2005).

<sup>8</sup> Bisedat e para teknike patën filluar nga pranvera e vitit 2004 dhe kanë zgjatur deri në vjeshten e vitit 2005 dhe janë udhëhequr nga autori i këtyre rreshtave, me format afërsisht të njëjta me këto që janë në vijim sipër dhe që filluan në vjeshtën e vitit 2011, me një dallim që implementimi i tyre këtë herë thuhet se garantohet nga Unioni Evropian. Në fakt, këto bisedime janë duke u kryer nën patronatin e Unionit Evropian. Ata të parat në esencë patën nisur menjëherë pas samitit të UE-së në mesin e vitit 2003, përkatësisht në Vjenë më 14 tetor 2003. Në këtë takim u patën formuar katër grupe punuese (personat e zhdukur, kthimet, energjetika, dhe, transporti e komunikacioni), të cilat gajtë tërë dialogut janë udhëhequr nga ky autor, deri në mbylljen e tyre joformale si pasojë e nisjes së dialogut mbi zgjidhjen përfundimtare të statusit të politik të Kosovës. Kjo ka filluar më 23 mars 2005 kur Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi A. Annan emeron Kai Eide, diplomat i njohur norvegjez, si të dërguar të tij të posacëm për të bërë një hulumtim gjithpërfshirës mbi gjendjen në Kosovë dhe hapat e mëtejme. Sipas raportit të prezantuar në Këshilin e Sigurimit të OKB-së në tetor të vitit 2005, pat filluar edhe dialogu politik e mirëfillët mbi zgjidhjen e statusit final të Kosovës, i cili është udhëhequr nga zt. Ahtisari dhe që ka rezultuar me planin e sipërcekur gjithpërfshirë të vitit 2007, i njohur në popull si PLANI AHTISARI, mbi bazën e të cilit Kosova ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008.

republika jugosllave, kanë qenë dhe janë autore të MT).<sup>9</sup> Sado që MT në aspektin formal nuk mund të zbatohet dhe të vlejë ndaj Kosovës, fryma dhe esenca e saj kanë gjetur zbatim, siç do të shihet, në disa segmente të trashëgimit të Kosovës karshi Serbisë (shtetësia, asetet dhe detyrimet financiare, traktatet për kufij, etj).

### ***I. Koncepti i trashëgimit të shteteve dhe parimet bazë të tij***

Trashëgimi i shteteve në të drejtën ndërkombëtare përfshin tërësinë e rregullave dhe parimeve të cilat zbatohen ndaj pasojave legale të ndërrimit të sovraniteteve territoriale<sup>10</sup>, të drejtave dhe detyrimeve të shtetit pararendës. Ato të drejta dhe detyrime kanë të bëjnë me traktatet ndërkombëtare, shtetësinë, pronën shtetërore dhe borxhin e jashtëm, arkivat dhe të drejtat e fituara të personave privat (fizik dhe juridik). Si i tillë, trashëgimi i shteteve paraqet lëminë e cila ka më së shumti vakum juridik dhe fare nuk është e kodifikuar deri me sot<sup>11</sup>. Edhe ajo pak përvojë e shteteve e grumbulluar deri në fillim të procesit të dekolonizimit nuk arriti të transformohet në rregulla të qarta të së drejtës mbi trashëgiminë e shteteve në të drejtën ndërkombëtare. KV I dhe KV II nuk bënë asgjë veçse sanksionuan trashëgiminë e shteteve në kontekstin kolonial. Jashtë atij konteksti rregullat e tyre mbetën të zbatueshme vetëm në nivel parimesh. Kjo gjendje u krijua si pasojë e faktit se KV I dhe KV II privilegjuan deri në fund ish vendet koloniale duke ua njohur atyre doktrinën e “pjetës së pastër”. Nga të gjitha segmentet e trashëgimit të shteteve, ish vendet koloniale trashëguan vetëm rregullat dhe parimet mbi regjimet kufitare si

---

<sup>9</sup> Ankesi VI (Borxhi Ndërkombëtar) dhe VII (Prona dhe Arkivi) në vecanti janë të dizajnuara për zgjidhjen e segmenteve kyce të trashëgimit në mes të Kosovës dhe Serbisë, sic do të vërehet në vijim të këtij shkrimi.

<sup>10</sup> Cf. Librin monumental të Daniel P. O’Connel, *State Succession in Municipal and International Law*, Vol. I. (Cambridge University Press: Cambridge 1967), fq. 3.

<sup>11</sup> Komisioni për të Drejtën Ndërkombëtare ka filluar punën në kodifikimin e kësaj lëmie më 1963, por pas një dekade ka konstatuar se një gjë e tillë është e vështirë, nëse jo e pamundur në tërësi, sepse kodifikimi në fjalë “...ka të bëjë me një fushë ku nuk ekziston një doktrinë e përgjithshme kurse praktika e shteteve dhe zakoni ndërkombëtar ende nuk kanë prodhuar precedente me bazë të qëndrueshme”. Sir Francis Vallat, “First Report on Succession of States in Respect of Treaties”. *The Yearbook of the International Law Commission*, Vol. II, 1974, fq. 22. Për komentet dhe historikun e kodifikimit të trashëgimit të shteteve, shih në Detlev F. Vagts, “State Succession: The Codifiers’ View”. *Virginia Journal of International Law*, Vol. 33 No. 2 (Winter 1993), fq. 275-297, në fq. 279-280 dhe 294-297.

dhe anëtarësimet në organizatat e caktuara ndërkombëtare të cilat qenë krijuar nga ish metropolet e tyre. Vendet ish koloniale pas fitimit të pavarësisë së tyre u mbështeten në doktrinën e “pjatës së pastër” mbi bazën e së cilës patën mundësinë e refuzimit të shumicës së të drejtave dhe detyrimeve të shtetit pararendës, ish metropoleve të tyre, në veçanti kur qe fjala për borxhet e jashtme shtetërore dhe të drejtat e fituara të personave privat (fizik dhe juridik). KV I dhe KV II si dhe praktika e shteteve e bazuar në to mohoi në tërësi doktrinën e trashëgimit universal, të rrënjësor thellë në të drejtën ndërkombëtare tradicionale. E kundërt me doktrinën e “pjatës së pastër”, kjo doktrinë thekson se çdo ndryshim në sovranitetin territorial ka për pasojë aktivizimin e rregullave dhe parimeve mbi trashëgiminë e shteteve.

Sikundër vërehet, rregullat dhe parimet mbi trashëgiminë e shteteve adresojnë pasojat legale të ndryshimeve në sovranitetin territorial të shteteve<sup>12</sup>. Kjo do të thotë se ndryshimet në regjimin politik dhe ndryshimet që janë bërë në mënyrë kundërligjore, jo legale, nuk aktivizojnë zbatimin e rregullave dhe parimeve mbi trashëgiminë e shteteve<sup>13</sup>. Nisur nga fakti se trashëgimia merret me pasojat legale të ndërrimit të sovraniteteve, pa marrë parasysh sa substanciale janë ato ndërrime sovranitetesh territoriale, atëherë del se nuk ka rëndësi nëse shteti pararendës e ruan identitetin dhe kontinuitetin e tij juridik – ndërkombëtar pas ndërrimeve të tilla në sovranitetin territorial. Krejt çfarë mund të ndodhë është se shteti i goditur

---

<sup>12</sup> KV I dhe KV II flasin për trashëgiminë si për “zëvendësim të një shteti me tjetrin për përgjegjësitë ndërkombëtare të territorit” (neni 2.1. b i KV I dhe II). KV I dhe KV II nuk flasin fare për pasojat legale të ndryshimit të tillë në përgjegjësitë ndërkombëtare të shteteve, gjë e cila paraqet vetë esencën e trashëgimit të shteteve. Një mungesë e tillë mbetet të sqarohet nga doktrina dhe praktika e shteteve për secilin rast veç e veç. Për komente, Cf. Eli Nathan, “The Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts”, botuar në Yoram Dinstein (ed.), *International Law in Time of Perplexity* (Martinus Nijhoff Publishers : The Hague, 1989) fq. 489 – 518, në fq. 498-499.

<sup>13</sup> Komisioni për të Drejtën Ndërkombëtare po ashtu thekson se ndryshimet në sovranitetin territorial duhet të jenë bërë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Cf. *The Yearbook of the International Law Commission* (1981), Vol. II, Part 2, fq. 23; Surya P.Sharma, *Territorial Acquisition, Disputes and International Law* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 1997) fq. 2-51; 48-160, si dhe Kapitulli IV. Për qëndrim të kundërt, Cf. Carsten Thomas Ebenroth & Matthew James Kemner, “The Enduring Political Nature of Questions of State Succession and Secession and the Quest for Objective Standards”. *University of Pennsylvania Journal of International Economic Law*, Vol. 17 No. 3 (Fall 1996), fq. 753 – 819, në fq. 759-763.

me ndërrimet në sovranitetin e tij territorial mund të ketë humbur anëtarësimin në disa traktate ndërkombëtare, disa shtetas të tij mund të jenë bërë shtetas të sovraniteteve tjera, borxhet e tij dhe detyrimet mund të kenë kaluar tek të tjerët dhe, së fundi, të drejtat private të fituara më herët sipas ligjit të tij mund të jenë futur nën ligjin e sovranitetit të ri. E, megjithatë, ai shtet e ruan identitetin dhe kontinuitetin e vet shtetëror juridiko-ndërkombëtar sepse çështja e identitetit dhe e kontinuitetit shtetëror është çështje e ndarë nga trashëgimi. Nëse shteti e ka humbur identitetin dhe kontinuitetin e vet shtetëror, kjo gjë përcaktohet nga bashkësia ndërkombëtare në kohën dhe hapësirën e dhënë. Një përcaktim i tillë është punë marrëveshjeje dhe konvencioni më mes të anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare dhe nuk varet nga sasia e territorit të humbur e as forma e transformimit të tij shtetëror juridiko-ndërkombëtar. Mund të ketë shpërbërje të tërësishme të shtetit, e megjithatë, për qëllimet e të drejtës ndërkombëtare, sërisht të konsiderohet se është ruajtur identiteti dhe kontinuiteti i shtetit pararendës të shpërbërë<sup>14</sup>. Kështu ndodhi me Austrinë, e cila u quajt shtet i njëjtë vazhdimësi e ish Austro-Hungarisë, me Turqinë kundrejt Perandorisë Osmane, me Federatën e Rusisë kur është në pyetje ish BRSS.

KV I dhe KV II nuk paraqesin, sikundër u tha, zgjidhje legislative të cilat mund të zbatohen në rastet tjera jashtë kontekstit kolonial me ndonjë siguri të madhe. Dispozitat e tyre më shumë janë në nivel parimesh, të cilat si të tilla janë konfirmuar nga praktika e shteteve nga koha e kaluar. Ndër këto parime, ai i zgjidhjes me marrëveshje të problemeve të trashëgimisë zënë një vend të rëndësishëm. Se kjo është kështu u pa qartë kur filluan të adresohen pasojat legale të shpërbërjes së ish federatave komuniste-Jugosllavisë, BRSS-së dhe Çekosllovakisë. Ky parim u konfirmua që nga

---

<sup>14</sup> Për këtë dallim, shih gjerësisht në Krystina Marek, *Identity and Continuity of States in International Law* (Geneve: Library E. Droz, 1954) fq. 2-4, 14, 68-76; 241-258; Stevan Dordevic, *O Kontinuitetu Drazavas PosebnimOsvrtom na Medjunarodno-Pravni Kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i FNRJ* (Beograd: Naucna Knjiga, 1967) fq. 13-36. Për rastet e ish federatave komuniste, shih në Rein Mullerson, "The Continuity of States by Reference to Former USSR and Yugoslavia". *International and Comparative Law Quartelry*, Vol. 42 Part 3 (Jyly 1993), fq. 473- 493; Matthew C. R. Craven, "The Problem of State Succesion and Identity in Under International Law". *European Journal of International Law* Vol. 9 No. 1 (1998) fq. 142-163; Hanna Bokor – Szego, "Questions of State Identity and State Succesion in Eeastern and Central Europe", botuar në Mojmir Mrak (ed.), *Succesion of States* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 1999), fq. 95-107.

vendimet e BE-së në kuadër të Konferencës së Paqes për Jugosllavinë (1991-1992), të cilat kanë vlejtur për tri ish federatat në fjalë<sup>15</sup>, prononcimet e Komisionit Badinter<sup>16</sup>, vendimet e Konferencës së Paqes për ish Jugosllavinë të vitit 1992-1995<sup>17</sup> dhe, së fundi, vendimet e KS të OKB<sup>18</sup>. Ky parim zë vend të dukshëm edhe në MT e cila ka reflektuar frymën e tij<sup>19</sup>, dhe, *mutatis mutandis*, edhe në dispozitat e Planit Ahtisari.<sup>20</sup>

<sup>15</sup> “... Zotimi për zgjidhjen me marrëveshje, përfshirë këtu edhe procedurën e arbitrazhit kur kjo quhet e nevojshme, të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me trashëgimin dhe mosmarrëveshjet regjionale”. Paragrafi i pestë i “Declaration on the Guidelines on the Recognition of New States in Eastern Europe and in the Soviet Union”, miratuar në mbledhjen e jashtëzakonshme ministrore të Konferencës për Paqen në Jugosllavi, Bruksel 16 dhjetor 1991. 31 *International Legal Materials* (1991) fq. 1486-1487.

<sup>16</sup> “... Shtetet trashëgimtare të ish Jugosllavisë detyrohen për zgjidhjen me marrëveshje të të gjitha aspekteve të trashëgimit”. Paragrafi i katërt i “Conference for Peace in Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 9”, Paris, 4 korrik 1992. 31 *International Legal Materials* (1992).

<sup>17</sup> Deklarata mbi Parimet, miratuar më 26 gusht 1992 nga Konferenca Ndërkombëtare për Ish Jugosllavinë (e njohur si “Konferenca e Londrës”: 1992-1995), ka përkrahur parimin sipas të cilit të gjitha çështjet e trashëgimit të ish Jugosllavisë duhet të zgjidhen me consensus ose përmes arbitrazhit. Cf. “International Conference on the Former Yugoslavia. Statement of Principles (LC/C2/FINAL). Parimi (ix). 31 *International Legal Materials* (1992) fq. 1533-1534.

<sup>18</sup> Pika 6 e Rezolutës 1022 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, miratuar në mbledhjen e 3595 të Këshillit të Sigurimit, datë 22 nëntor 1995. *UN Doc. S/RES/1022 (1995)*.

<sup>19</sup> Kështu, në paragrafin e parafundit të Preambulës së MT thuhet, *inter alia*, se pesë shtetet e dala nga ish Jugosllavia (Bosnjë-Hercegovina, Republika e Kroacisë, Republika e Maqedonisë, Republika e Sllovenisë, dhe Republika Federative e Jugosllavisë), duke qenë të gjitha shtete sovranë dhe të barabarta në procesin e trashëgimit të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, “ kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në zgjidhjen e çështjeve të hapura të trashëgimit në pajtim me të drejtën ndërkombëtare”, kurse në nenin 9 të MT koncepti i bazës juridike të procesit të trashëgimit të ish Jugosllavisë zgjerohet më shumë dhe përfshinë, përveç parimet e vullnetit të mire (*bona fide*), edhe parimet e të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare si dhe ato që dalin nga Karta e Kombeve të Bashkuara, sado që vetë Karta nuk flet për trashëgimin e shteteve.

<sup>20</sup> Plani Ahtisari, *inter alia*, në mesin e parimeve bazë për zgjidhjen e çështjeve të trashëgimit në mes të Kosovës dhe Serbisë parasheh parimin e zgjidhjes me marrëveshje të çështjes së borxheve, parimin e kompenzimit të Serbisë në rast se ajo paguan borxhin në mënyrë të Kosovës pa marrëveshje, pra nëse Serbia njëanëshëm paguan borxhin e Kosovës ajo duhet të kompensohet nga ne, dhe, së fundi, parimin e arbitrit të çdo mosmarrëveshjeje në mes të palëve, Kosovës dhe Serbisë. Cf. Ankesi VI (“borxhi ndërkombëtar”).

Parim tjetër i cili ka gjetur zbatim të gjerë me rastin e trajtimit të pasojave legale të trashëgimit të shteteve është parimi i drejtësisë (“equity”). Zbatimi i këtij parimi paraqet një *condiction sine qua non* në procesin e trashëgimit të shteteve dhe si i tillë ka qenë i pranuar dhe i zbatuar edhe në proceset e trashëgimit në të kaluarën, sado që zbatimi i tij përfshinë fusha të tjera përveç trashëgimit të shteteve<sup>21</sup>. Duke pasur një natyrë mjaft kontekstuale, të vështirë për zbatim praktik, zbatimi i parimit “equity”, sikundër shprehet një autor, do të thotë “gjetje e të vërtetës”<sup>22</sup>. Nevojat e oportunitetit politik, më shumë se normat e ngurta juridike që kërkojnë zbatim të disiplinuar, kanë qenë prapa zgjidhjeve të problemeve të trashëgimit, si në rastet nga e kaluara ashtu dhe kur është fjala me shpërbërjen e ish Jugosllavisë dhe dy federatave të tjera komuniste, ish BRSS-së dhe Çekosllovakisë. Para se të flasim për këto tri raste, vlen të theksohet se me të vërtetë mundësia për zbatim të tij në mënyrë mjaft të lirë e reflekton vetë esencën e pasigurt të materies së trashëgimit të shteteve dhe pamundësinë e rregullimit të saj të detajuar me norma pozitive ndërkombëtare<sup>23</sup>.

Parimi i drejtësisë (“equity”) në KV II shprehet në dispozitat e neneve 37 (1) dhe 40 (2), të cilat kërkojnë që të ekzistojë një ekuilibër në mes të aseteve të ndara dhe borxhit që merret përsipër me rastin e trashëgimit, formulim që te Komisioni Badinter paraqitet si kërkesë që “shpërndarja e

---

<sup>21</sup> “Equity” gjen zbatim të gjerë në të drejtën ndërkombëtare në përgjithësi për arsye të natyrës së tij juridike, përkatësisht për shkak se e drejta ndërkombëtare paraqet një system juridik jo të plotë, jo të sistemuar dhe jo aq të zbatueshëm në praktikë, për dallim nga sistemet e brendshme juridike, gjë që lenë vend për zbrastësira juridike dhe mundësi për zgjidhje të çështjeve ndërkombëtare duke u mbështetur në parime të përgjithshme juridike. Për një elaborim të detajuar të parimit “equity” në të drejtën ndërkombëtare, Cf. Vladimir – Djuro Degan, *L' équité et le droit international* (La Haye: Martinus Nijhoff, 1970); Vladimir – Djuro Degan, “Equity in Matters of State Succession”, botuar në Ronald St. John Macdonald (ed.), *Essays in Honour of Wang Tieya* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 1993), fq. 201-210; Christopher R. Rossi, *Equity and International Law: A Legal Realist Approach to International Decision Making* (Serie de Monografias del Bid - Irvington, N.Y.: Transnational Publishers, 1993); Stefan Oeter, “State Succession and the Struggle Over Equity: Some Observations on the Laws of State Succession with Respect to State Property and Debts in Cases of Separation and Dissolution of States”. *German Yearbook of International Law* (1995), fq. 73-102.

<sup>22</sup> W. Jenks, cituar në Eli Nathan, “The Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts”, botuar në Yoram Dinstein (ed.), *International Law in Time of Perplexity*, fq. 498.

<sup>23</sup> Cf. Eli Nathan, “The Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts”, fq. 496-498.



tërësishme të jetë e drejtë”<sup>24</sup>. Komisioni Badinter ka shkuar më tutje në këtë drejtim, duke ofruar rregulla procedurale për të arritur deri te kjo “shpërndarje e drejtë e përgjithshme”. Shpërbërja e dhunshme e ish Jugosllavisë dhe degjenerimi i procesit politik, megjithatë, kanë pamundësuar zbatimin e prononcimeve sa më sipër të Komisionit Badinter<sup>25</sup>. Procedurat e ofruara të trashëgimit dhe garancionet tjera për vënien në jetë të rregullës “equity” është dashur të presin një kohë bukur të gjatë para se të arrinin rezultatin e një rregulle të “së drejtës së përgjithshme”. Kjo ka ndodhur vetëm me arritjen e MT ku zbatimi i rregullës “equity” ka nënkuptuar marrjen parasysh edhe të qëndrueshmërisë ekonomike të shteteve trashëgimtare, sado që në fillim një rrethanë e tillë ka qenë e paqartë për Komisionin Badinter. Kjo marrje parasysh e qëndrueshmërisë ekonomike të shteteve trashëgimtare reflektohet në MT si kur është fjala për ndarjen e pronës së patundshme, asaj të tundshme, por edhe me rastin e ndarjes së aseteve dhe borxhit të jashtëm<sup>26</sup>. MT, njëjtë si KV II, nuk përmban dispozita mbi kundërmasat dhe garancionet tjera në dobi të trashëgimtarëve dhe kreditorëve për shkak se MT bazohet në premisën se palët do të sillen dhe bashkëpunojnë me mirëbesim, *bona fide*, rrethanë që ka munguar në kohën e marrjes së vendimit të fundit të Komisionit Badinter rreth trashëgimit<sup>27</sup>.

<sup>24</sup> Për më tepër, Badinteri ka parashikuar edhe rregullat procedurale për të arritur deri te kjo “shpërndarje e drejtë e përgjithshme”, duke vënë në dukje detyrimin e bashkëpunimit me mirëbesim në mes të subjekteve të trashëgimisë, si dhe masat ndëshkuese për ata që nuk i përmbahen këtij detyrimi. Cf. Mendimi nr. 13, datë 16 korrik 1993, paragrafi i dytë. 32 *International Legal Materials* (1993), fq. 1591-1592, në fq. 1592.

<sup>25</sup> Robert Badinter, “L’ Europe du droit”. *European Journal of International Law*, Vol. 4 No. 1 (1993), fq. 15-23- në fq. 23.

<sup>26</sup> Neni 5 (2) i Aneksit C dhe Aneksit A dhe C të MT. Krahassimi i dispozitave të këtyre dy anekseve dhe i “çelësit” të përdorur për ndarjen e aseteve dhe detyrimeve nga ana e Fondit Monetar Ndërkombëtar (në tekstin e mëtejshëm: FMN) dhe Bankës Botërore (në tekstin e mëtejshëm: BB), tregon qartë për marrjen parasysh të qëndrueshmërisë ekonomike më rastin e trashëgimit të ish Jugosllavisë nga ana e shteteve të reja trashëgimtare. Cf. Mojmir Mrak, “Apportionment and Succession of External Debts: The Case of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia”. *Research Reports* No. 259 (August 1999) (The Vienna Institute for International Economic Studies), fq. 5-20; Josip Metelko, *Sukcesija država s posebnim osvrtom na raspad bivše SFRJ* (Pravni Fakultet: Zagreb, 1999), fq. 267-288; Ibrahim F. I. Shihata, “Matters of State Succession in the World Bank’s Practice”, botuar në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 1999) fq. 75-93; Mojmir Mrak, “Succession to the Former Yugoslavia’s External Debt: The Case of Slovenia”, botuar në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States*, fq. 159-170.

<sup>27</sup> Komisioni Badinter në fillim e pat bërë të qartë zbatueshmërinë e këtij parimi, mirëpo vetëm më vonë iu është kthyer në mënyrë konkrete mundësisë për ofrimin e

Në rastin e trashëgimit të dy ish federatave të tjera komuniste, BRSS-së dhe Çekosllovakisë, gjërat kanë shkuar më ndryshe për faktin se shpërbërja e tyre nuk ka qenë e shoqëruar me dhunë, konflikt të armatosur dhe kaos derisa për çekosllovakët rregulla “equity” ka nënkuptuar zbatimin me marrëveshje të raportit të ndarjes “dy me një”<sup>28</sup>, në kontekstin e ish BRSS-

---

garancioneve dhe të rregullave tjera procedurale me rastin e zbatimit praktik të tij. Cf. “Conference for Peace in Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 9”. 31 *International Legal Materials* (1992) fq. 1523-1525; International Conference on Former Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 12. 32 *International Legal Materials* (1993), fq. 1589-1591. Për komentet, shih në Hubert Beemelmans, “State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis”. *Boston University International Law Journal*, Vol. 15, No. 1 (Spring 1997) fq. 71-123, në fq. 115-118; Marco Martins, “An Alternative Approach to the International Law of State Succession: Lex Naturae and the Dissolution of Yugoslavia”. *Syracuse Law Review*, Vol. 44 No. 3 (1993), fq. 1019 - 1058, në fq. 1049-58.

Kjo qasje disi e shkapërderdhur lidhet me faktin se trashëgimi i ish Jugosllavisë ka qenë pjesë e një procesi që është shoqëruar me dhunë, luftë të armatosur dhe kaos të përgjithshëm. Kjo ka pasur për pasojë që secila palë të sheh në rregullën “equity” shansin e saj për përfitim në kurrriz të tjerëve, ashtu që vetëm ndërhyrja e faktorit ndërkombëtar, në rend të parë ndërhyrja e botës financiare ndërkombëtare, ka ndikuar në atë që Badinteri të jetë më konkret në mendimet e tij të fundit rreth procedurës dhe masave tjera për vënien në jetë të rregullës “equity”. Cf. Mojmir Mrak, *Succession to the Former Yugoslavia's External Debt*, fq. 159-169; Ana Stanic, “Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia”. *European Journal of International Law* Vol. 12 No. 4 (2001), fq. 751-779, në fq. 754-755; Paul Williams & Jennifer Harris, “State Succession to Debts and Assets : The Modern Law and Policy”. *Harvard International Law Journal* Vol. 42 No. 2 (Summer 2001), fq. 355-417, në fq. 383-400.

Për dallim nga Komisioni Badinter, MT nuk përmban dispozita mbi kundërmasat dhe garancionet tjera në dobi të trashëgimtarëve dhe kreditorëve për shkak se MT bazohet në premisën se palët do të sillen dhe bashkëpunojnë me mirëbesim, *bona fide*.

<sup>28</sup> Në rastin e Çekosllovakisë, zbatimi i të drejtës ndërkombëtare dhe i vetë parimit “equity” ka qenë më i qartë, gjë që ka pasur për pasojë edhe pranimin nga vendet kreditore dhe nga bashkësia ndërkombëtare më lehtë të marrëveshjes së brendshme në mes të dy vendeve, Çekisë dhe Sllovakisë. Çka është edhe më me rëndësi, kjo marrëveshje e brendshme në mes tyre ka pasur karakterin e ligjit kushtetues mbi ndarjen e pasurisë, I miratuar nga Parlamenti Federal i Çekosllovakisë më 13 nëntor 1992, si “Ligji Kushtetues mbi Ndarjen e Pasurisë së Çekosllovakisë në mes të Çekisë dhe Sllovakisë”. Në këtë ligj, dhe në marrëveshjet që janë arritur më pastaj deri në mbylljen e këtij procesi në fillim të vitit 1993, tri parime kanë përbërë esencën e rregullës “equity” ashtu siç është zbatuar në këtë rast: parimi i numrit të popullsisë, i efektshmërisë dhe ai i relevancës. Zbatimi i këtyre tri parimeve në esencë ka gjasuar mjaft me zbatimin e rregullës klasike mbi ndarjen, sipas të cilës duhet pasur parasysh raportin më mes të pasurisë së trashëguar dhe borxhit që merret përsipër. “Equity” në këtë rast ka shërbyer si udhërrëfyes dhe si rregull korrektuese

së një gjë e tillë ka konsistuar në marrjen e tërësishme të borxheve të ish BRSS-së, por edhe të pasurisë së saj, nga ana e Federatës së Rusisë<sup>29</sup>. Në dy rastet, ndërhyrja e jashtme ka konsistuar në respektimin e marrëveshjes së arritur në mes të aktorëve vendës, gjë që ka munguar në rastin e ish Jugosllavisë për një kohë të gjatë deri me arritjen e MT.

E tërë kjo që u tha më sipër vlen edhe për parimin e fundit, po aq të rëndësishëm, parimin *rebus sic stantibus*, i cili shërben si instrument mjaft i dobishëm për interpretimin e dispozitave ekzistuese të KV I dhe II mbi

---

e zbatimit të së drejtës ndërkombëtare, gjë që ka mundësuar që ratio “dy me një” të zbatohet pa ndonjë vështirësi të madhe në mes të dy shteteve të reja trashëgimtare. Cf. Paul Williams & Jannifer Harris, “State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy”, fq. 400-407;. Hubert Beemelmans, “State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis”, fq. 111-113.

<sup>29</sup> Ky opsion është quajtur “zero option agreement” (“marrëveshja pa mundësi zgjidhjeje” apo “marrëveshja pa mundësi për të zgjidhur”) dhe ka dalë si rezultat i përpjekjeve të dështuara, në tri faza, për zgjidhjen e çështjes së aseteve dhe borxhit të ish BRSS dhe trashëgimtarëve të tij. Në fazën e parë, shtetet trashëgimtare patën arritur një memorandum mirëkuptimi në mes tyre, Moskë 28 tetor 1991, ku u pat pranuar përgjegjësia e përbashkët dhe e ndarë e secilit për tërë borxhin e jashtëm të ish BRSS (“joint and several liability”) kurse Banka për Aktivitete të Jashtme Ekonomike u autorizua që të administrojë këtë borxh sovjetik. Kjo rezultoi në shtyrjen e pagesës së borxheve nga ana e kreditorëve të jashtëm të ish BRSS për tërë vitin 1992. Në fazën e dytë, pesëmbëdhjetë vendet trashëgimtare të ish BRSS arritën një marrëveshje, Marrëveshjen e Minsk-ut të datës 4 dhjetor 1991, për ndarjen në përqindje të borxhit dhe të pasurisë së ish Bashkimit Sovjetik, duke përdorur formulimet e ngjashme me ato të MT. Në Marrëveshjen e Minsk-ut, në mes tjerash, theksohet se palët janë koshiente “për faktin se garantimi dhe pagesa e borxhit të jashtëm sovjetik paraqet parakusht për hyrje në tregun botëror” dhe pranojnë marrjen parasysh “të parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe rregullave të Konventës së Vjenës të vitit 1983”. Ky dokument ka shërbyer si bazë e formulimit tërësisht të ngjajshëm të Deklaratës së Alma Ata-s mbi formimin e Komonveltit të Shteteve të Pavarura, datë 21 dhjetor 1991. Këto dy dokumente, megjithatë, nuk hasën në mirëkuptim të të gjitha vendeve trashëgimtare, ashtu që në fazën e fundit, Federata e Rusisë filloi një fushatë të lidhjes së marrëveshjeve bilaterale me kreditorët e jashtëm, duke marrë përsipër pagesën e tërë borxhit të jashtëm sovjetik, por edhe të pasurisë së atij shteti, sipas parimit “zero option agreements”. Për tekstin e Memorandumit të Mirëkuptimit, Deklaratën e Minsk-ut dhe Marrëveshjen e Alma Ata-s, shih në *International Legal Materials* Vol. XXXI No. 1 (January 1992) 138-154; Për komentet e tyre, shih në Lech Antonowicz, “The Disintegration of the USSR from the Point of View of International Law. 19 *Polish Yearbook of International Law* (1991-1992) fq. 7-16; Hubert Beemelmans, “State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis”, fq. 110-111; Paul Williams & Jannifer Harris, “State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy, fq. 366-383; Rein Mullerson, “The Continuity and Succession of States by Reference to the Former USSR and Yugoslavia”, fq. 473-493, në fq. 475-480.

trashëgimin e shteteve, si dhe i dispozitave të tjera të së drejtës ndërkombëtare që janë të zbatueshme ndaj trashëgimit të shteteve<sup>30</sup>. Megjithatë, MT nuk ka dispozita për respektimin e këtij parimi ngaqë të drejtat dhe detyrimet e trashëgimtarëve të ish Jugosllavisë që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare nuk kanë qenë objekt kontestimi reciprok dhe çështje problematike. Kjo është arsyeja pse as ne nuk shtjellojmë më tepër cilësitë karakteristike të këtij parimi të rëndësishëm.

## ***II. Struktura e MT: pjesa kryesore dhe anekset***

MT ka dy pjesë të ndara, të cilat megjithatë përbëjnë një tërësi unike. Pjesa e parë përbëhet prej pjesës kryesore, “Marrëveshjes mbi Çështjet e Trashëgimit”, e cila paraqet “ombrellën” ose kuadrin e MT, kurse e dyta përbëhet prej anekseve (shtatë sosh). MT, në pjesën e vet kryesore adreson çështjet kyçe të trashëgimit të ish Jugosllavisë, ato më kontestueset që nga fillimi i procesit më 1992, të cilat kanë të bëjnë me: problemin e statusit juridik të republikave jugosllave kundrejt ish Jugosllavisë, vendin dhe rolin e KV II, rolin dhe vendin e parimit të drejtësisë (“equity”), nivelin dhe natyrën e detyrimeve të ndërsjella të shteteve trashëgimtare dhe, fare në fund, çështjet e bashkëpunimit institucional në mes të subjekteve të barabartë të trashëgimit të ish Jugosllavisë.

Pjesa e dytë, anekset e MT, mbulojnë këto segmente të trashëgimit si dhe të drejtat e detyrat që dalin nga to: Aneksi “A” - pronën e tundshme dhe të patundshme të ish Jugosllavisë; Aneksi “B” - pronën e përfaqësive diplomatike e konsullore të ish Jugosllavisë; Aneksi “C” – asetet dhe detyrimet financiare të ish Jugosllavisë; Aneksi “D” – Arkivat e ish Jugosllavisë; Aneksi “E” – pensionet e ish shtetasve të Jugosllavisë; Ankesi “F” – interesat, të drejtat dhe detyrimet tjera që nuk përfshihen me anekset e mëparshëm dhe që mund të dalin më vonë në syprinë; dhe, në fund, Aneksi “G” – prona private dhe të drejtat e fituara të personave privat, fizik dhe juridik, në kohën e ish Jugosllavisë.

Sikundër mund të vërehet, MT nuk përmban të gjitha njësitë e trashëgimit dhe të drejtat e detyrimet që dalin nga trashëgimi ndaj tyre. E kemi fjalën në

---

<sup>30</sup> Guido Acquaviva, “The Dissolution of Yugoslavia and the Fate of Its Financial Obligations”. *Denver Journal of International Law and Policy*, Vol. 30 No. 2 (Spring 2002), fq. 173-216, në fq. 185-194 dhe 206, 211-215.

rend të parë për trashëgimin ndaj çështjes së shtetësisë dhe anëtarësisë në organizatat ndërkombëtare. Po ashtu, as KV I dhe KV II nuk rregullojnë këto dy çështje. Meqë MT nuk flet për këto dy njësi, ngaqë nuk ka pasur probleme serioze rreth trashëgimit të tyre, as ne në këtë shkrim nuk jemi ndalur në to<sup>31</sup>.

### ***III. Hedhja poshtë e kërkesës së RFJ-së për trashëgimtar të vetëm (kontinuitet) të ish Jugosllavisë***

Ka qenë prononcimi i parë i Komisionit Badinter, më 29 nëntor 1991,<sup>32</sup> ai i cili ka hapur rrugën për zgjidhjen përfundimtare të statusit juridik

---

<sup>31</sup> Kjo gjendje është pasojë e faktit se lëmia e shtetësisë është kompetencë mjaft ekskluzive e shteteve, me disa kufizime për sa i përket detyrimit të shteteve për uljen e numërit të personave pashtetësi. Shteti i vendit përcakton kushtet e tjera, përveç vendbanimit (domicilit) për fitim të shtetësisë së re, çka do të thotë se në të drejtën ndërkombëtare nuk njihet fitimi automatik i shtetësisë. Rregulla tradicionale ka qenë që vendbanimi (domicili) të jetë pikë referimi për fitim të shtetësisë së re në rastet e trashëgimit dhe si i tillë ka figuruar në marrëveshjet e paqes të lidhura pas dy luftërave botërore. Në rastin e ish Jugosllavisë, vendbanimi (domicili) sikur ka mbetur ende pikë referimi por i kombinuar me kërkesën për shtetësinë dytësore të ish republikës jugosllave. Kjo do të thotë se në të drejtën ndërkombëtare nuk ka fitim automatik të shtetësië. Një gjë e tillë është reflektuar jo vetëm në ligjet mbi shtetësinë të ish republikave jugosllave, të nxjerra pas vitit 1991, por edhe në dokumentet e propozuara mbi trashëgimin në këtë lëmi nga ana e Grupit Punues për Trashëgim të Konferencës për Ish Jugosllavinë gjatë periudhës 1993– 1996. Cf. Todor Djunov, “Succession of States in Respect of Citizenship: The Case of Former SFRY”. *Development and Cooperation*, Vol. XII No. 23 (December 1996), fq. 149-166.

Kosova nuk bën përjashtim aspak nga qasja sa më sipër e ish republikave jugosllave. Kjo qasje është reflektuar në Ligjin Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës i datës 20 shkurt 2008. Cf. në veçanti Kapitullin II (nënt 5-15) dhe Kapitullin V (nenet 28-29).

<sup>32</sup> Conference on Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 1. 31 *International Legal Materials* (1992), fq. 1494-1497. Në opinionin tjetër, datë 4 korrik 1992, Badinter konstatoi se procesi i filluar në nëntor të vitit 1991 ka arritur fundin ashtu që, në mes tjerash, “RSFJ më nuk ekziston”. Conference on Yugoslavia. Arbitration Commission.

Opinion No. 1. 31 *International Legal Materials* (1992), fq. 1521-1523. Për komentet shih: Vladimir – Djuro Degan, “Yugoslavia in Dissolution - Opinion No.1 of the Arbitration Commission of 7 December, 1991”. *Croatian Political Science Review* (Zagreb) Vol. I No. 1(1992) fq. 20-32; Alain Pellet, “The Opinions of the Badinter Committee: A Second Breath for the Self-Determination of Peoples”. *European Journal of International Law*, Vol.3 No. 1 (1992), fq. 178-182; Roland Rich, “Recognition of States: The Collapse of Yugoslavia and the Soviet Union”. *European Journal of International Law* Vol. Vol. 4 No. 1 (1993), fq. 36-65; Danilo Turk, “Recognition of States: A Comment”.

ndërkombëtar të ish Jugosllavisë<sup>33</sup>. Në këtë prononcim, Komisioni pat theksuar, *inter alia*, se “Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë gjendet në procesin e shpërbërjes”. Ky prononcim, përkundër kundërshtimit të hapur serb<sup>34</sup>, ka gjetur përkrahje të pa rezervë në forumet ndërkombëtare, në rend të parë në Këshillin e Sigurimit dhe Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara<sup>35</sup>, e më pastaj edhe në organizmat e tjerë ndërkombëtar<sup>36</sup>. Për më tepër, edhe vendimet e gjykatave nacionale kur janë

---

*European Journal of International Law*, Vol. 4 No. 1 (1993), fq. 66-72; Marc Weller, “The International Response to the Dissolution of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia”. *American Journal of International Law* Vol. 86 No. 3 (July 1992), fq. 569-607; Vladislav Jovanovic, “The Status of the Federal Republic of Yugoslavia in the United Nations”. *Fortham International Law Journal* Vol 21 No. 5 (June 1998) fq. 1719-1736; Për qëndrim neutral ndaj punës së Komisionit Badinter, Cf. Michael C. Wood, “Participation of Former Yugoslav States in the United Nations and in multilateral Treaties”. *Max Planck Yearbook of United Nations Law* Vol. I (1997), fq. 231-257.

<sup>33</sup> Për laikët kanë ekzistuar tri shtete jugosllave, njëra e quajtur “Mbretëria e Jugosllavisë” (me rastin e themelimit e quajtur si “Mbretëria Serbo – Kroato – Sllovene”), tjetra Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë” dhe, së fundi, “Republika Federative e Jugosllavisë”, e krijuar nga Milosheviq më 1992, e cila pas rrëzimit të tij nga pushteti ndërroj emrin në “Unioni Serbi dhe Mali i Zi” (USM). Ndërrimi i emrit, në kohën sa ka qenë Milosheviq në pushtet, nuk ka qenë i mundur sepse ruajtja e atij emëri, sipas Milosheviqit, ka qenë simbolikë dhe identitet i njëjtësisë, përkatësisht i kontinuitetit shtetëror juridik – ndërkombëtar me ish Jugosllavinë. Në pikëpamje shkencore dhe nga vetë praktika e të drejtës ndërkombëtare, ndërkaq, ka pasur vetëm një shtet jugosllav: ai që krijua pas Luftës së Parë Botërore dhe që u rrënua më 1992. Për këtë do të flitet akoma më shumë në vijim.

<sup>34</sup> Cf. “Position of SFR Yugoslavia on the Question of Internal Borders of Yugoslavia” (Belgrade, December 30, 1991). Text reprinted in Review of International Affairs Vol. XLIII, February 5, 1992 (Belgrade), fq. 23. Për komentet zyrtare serbe, Cf. Vladislav Jovanovic, “The Status of the Federal Republic of Yugoslavia in the United Nations”, fq. 1719-1736; Për qëndrim neutral ndaj kësaj çështje, Cf. Michael C. Wood, “Participation of Former Yugoslav States in the United Nations and in multilateral Treaties”, fq. 231-257; Për komentet tjera rreth refuzimit serb dhe historikun e këtij refuzimi, Cf. Josip Metelko, *Sukcesija država s posebnim osvrtom na raspad bivše SFRJ*, fq. 262-289.

<sup>35</sup> Rezolutat 752, datë 15 maj 1992 dhe 757, datë 30 maj 1992, miratuar në takimet 3075 dhe 3082 respektivisht të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Për qëndrimet e njëjta të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Cf. Rezoluta nr. 47/1 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, datë 22 qershor. Tekstet në origjinal te autori, ofruar nga Ministria e Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

<sup>36</sup> Vlen të theksohet se “Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim” (EBRD) ka qenë organizata e parë ndërkombëtare e cila ka deklaruar se RSFJ është shpërbërë si shtet. Cf. EBRD, Rezoluta e Bordit të Guvernatorëve nr. 30 mbi Anëtarësimin e Vendeve të cilat më parë kanë qenë pjesë e Jugosllavisë, 9 tetor 1992. Pas kësaj vijnë prononcimet e FMN, datë 14 dhjetor 1992, dhe BB, datë 25 shkurt 1993. Cf. IMF Press Release, 15 December

ndeshur më një çështje të tillë kanë pasur parasysh prononcimet e sipër cekura të Komisionit dhe vendimet autoritative të forumeve ndërkombëtare<sup>37</sup>. Pasojat praktike të këtyre qëndrimeve kanë qenë se RFJ mund të jetë vetëm njëri ndër trashëgimtarët e barabartë të ish Jugosllavisë, pa pasur një trashëgimtar të vetëm të identitetit dhe kontinuitetit të saj shtetëror juridik – ndërkombëtar. Këtë fakt e ka sanksionuar MT në pjesën hyrëse të saj ku theksohet se, inter alia, pesë republikat jugosllave (Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Sllovenia dhe RFJ, janë titullarë të barabartë në procesin e ndarjes së pasurisë, marrjen e detyrimeve si dhe në çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me trashëgimin e ish Jugosllavisë<sup>38</sup>.

Kërkesa serbe për kontinuitet me ish Jugosllavinë është e vjetër dhe ka ekzistuar në diskursin politik zyrtar dhe akademik serb që nga vitet e para të krijimit të atij shteti më 1918. Pas viti 1918, serbët me këmbëngulje kanë insistuar se shteti i ri, Mbretëria Serbo-Kroato – Sllovene (i riemërtuar si “Mbretëria Jugosllave” pas viti 1929) paraqet shtet të njëjtë dhe kontinuitet të Mbretërisë Serbe të para vitit 1918<sup>39</sup>. Aktivizimi i kërkesës së njëjtë pas

---

1992 dhe WB Press Release No. 93/543, 26 February 1993. Për komentet akademike, Cf. Paul R. Williams, “State Succession and the International Financial Institutions: Political Criteria v. Protection of Outstanding Financial Obligations”. *The International and Comparative Law Quarterly*, Vol. 43 No. 4 (October 1994), fq. 776-808 në fq. 779-782, 794-804; Ibrahim F. I. Shihata, “Matters of States Succession in World Bank’s Practice”, fq. 75-93, në fq. 81-85.

<sup>37</sup> 34 Gjykata Supreme e Austrisë në rastin “Republic of Croatia et al. v Girocredit Bank A.G. Der Sparkassen”, 17 dhjetor 1996. 36 International Legal Materials (1997) fq. 1522-1530. Në këtë vendim të Gjykatës Supreme të Austrisë gjenden elaborimet më të detajuara dhe me bazë të thellë shkencore në lidhje me kontinuitetin shtetëror të ish Jugosllavisë, si dhe kundërshtimet e argumentuara dhe shkencore të pozicioneve serbe rreth kontinuitetit shtetëror jugosllav.

<sup>38</sup> Ka fare pak rëndësi rrethana që në MT nuk përdoret terminologjia standarde që është përdorur ndaj ish Jugosllavisë, pra se fjala ka qenë për shpërbërje. Tani në MT figuron fjala “prishje” (“break up”) në vend të saj. Cf. Preambula e MT, paragrafi i dytë. Pra, deri atëherë, serbët kanë insistuar që nuk flitet për shpërbërje (“dissolution”) apo për prishje (“break up”) por për shkëputje (“secession”) të pjesëve të caktuara të ish Jugosllavisë ku RFJ (Serbia dhe Mali i Zi), e krijuar nga Millosheviqi më 1992, paraqet shtetin e njëjtë (dhe vetë vazhdimsinë) me ish Jugosllavinë.

<sup>39</sup> Për qëndrimin serb, zyrtar dhe akademik, shih në Krystina Marek, *Identity and Continuity of States in International Law*, fq. 237- 262; Mark Almond, *Europe's Backyard War. The War in the Balkans*. (Heinemann: London, 1994), fq. 116-117; S. Jovanovic, *Ustavno Pravo Kraljevine Srba, Hrvata i Slovenaca* (Narodna Knjiga: Beograd 1914) fq. 12-21; Stevan Dordevic, *O Kontinuitetu Drazava s Posebnim Osvrtom na Medjunarodno-Pravni Kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i FNRI*, fq. 162-163. Për kundërshtimet kroate e

vitit 1991 është vetëm vazhdim i këtij diskursi, në ndërkohë që në periudhën komuniste ka pasur një ngrirje të kësaj problematike<sup>40</sup>. Në literaturën serbe me të drejtë është vërejtur se kjo kërkesë serbe ka paraqitur thelbin e projektit mbi Serbinë e Madhe, të mbështjellur me petkun e ligjit ndërkombëtar<sup>41</sup>.

Milosheviq këtë kërkesë e ka çuar përpara por pa sukses. Në fillim ai ka ngelur vetëm në nivel të prononcimeve dhe këmbënguljes së zakonshme, duke shpresuar se një insistim i tillë do t'i sjellë më shumë të drejta në procesin e trashëgimit të ish Jugosllavisë<sup>42</sup>. Më vonë ka ndërmarrë dhe hapa praktik, sado që deri në fund janë treguar pa rezultat dhe naiv. Në këtë kontekst, ai ka lidhur marrëveshje<sup>43</sup> dhe ka bërë deklaratat<sup>44</sup> me republikat tjera jugosllave pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit (nëntor 1995), duke

---

sllovene, qëndrimet negative të të cilëve, njëjtë si pas vitit 1991, qenë përkrahur nga bashkësia ndërkombëtare, Cf. O Robarz, 'Da li je Nasa Kraljevina Nova ili Stara Drzava'. *Arhiv za Pravne i Društvene Nauke* Knjiga XXIII (Beograd: 1933) fq. 241-261.

<sup>40</sup> Stevan Dordevic, *O Kontinuitetu Drazava s Posebnim Osvrtom na Medjunarodno-Pravni Kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i FNRJ*, fq. 97-114.

<sup>41</sup> Cf. Milan Bartos, "Krystyna Marek: Identity and Continuity of States in Public International Law (Geneve 1954)". *Jugoslovenska Revija za MedjunarodnoPravo* Vol. I Nr. 1 (Beograd: 1954) fq. 290-293, në fq. 292. Milan Bartos ka qenë jurist i njohur serb i viteve '60 dhe '70 të shekullit të kaluar; Për arsytim të njëjtë nga autori tjetër serb, Cf. Stevan Dordevic, *O Kontinuitetu Drazava s Posebnim Osvrtom na Medjunarodno-Pravni Kontinuitet Kraljevine Jugoslavije i FNRJ*, fq. 97-114.

<sup>42</sup> Në të drejtën ndërkombëtare nuk ekziston një rregull e cila privilegjon shtetet trashëgimtare gjatë ndarjes së pronës shtetërore, pa marrë parasysh nëse ato shtete janë vazhdim i shtetit pararendës. Cf. Vladimir - Djuro Degan, "Disagreements over the Definition of State Property in the Process of State Succession to the Former Yugoslavia", botuar në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States*, fq. 33-60; Rein Mullerson, "The Continuity and Succession of States by Reference to the Former USSR and Yugoslavia", fq. 473-493; Hanna Bokor-Szego, "Questions of State Identity and State Succession in Eastern Europe and Central Europe", fq. 95-107.

<sup>43</sup> "The Agreement on Normalization of Relations and Promotion of Cooperation between Macedonia and the Federal Republic of Yugoslavia", 8 prill, 1996. Teksti integral botuar në "Flaka e Vllazërimit" (Shkup), 9 prill 1996; dhe "The Agreement on Normalization of Relations between the Federal Republic of Yugoslavia and Croatia", 23 gusht 1996. Teksti integral i botuar në *Review of International Affairs* Vol. XLVII nr. 1048 (Beograd 1996). Për komentet e tyre, Cf. Saskia Hille, "Mutual Recognition of Croatia and Serbia (+ Montenegro)". *European Journal of International Law* Vol. 6 No. 4 (1995), fq. 598-612.

<sup>44</sup> "Joint Statement", 3 tetor 1996 (Paris). Për komentet, Cf. Charles Truchart, "Bosnia-Yugoslavia to Swap Embassies". *Washington Post Foreign Service* (4 October 1996).



shpresuar se ato do t'i mjaftojnë për të bindur bashkësinë ndërkombëtare në kërkesën e tij për njohje të kontinuitetit me ish Jugosllavinë. Në të gjitha këto dokumente të bëra me republikat tjera ish jugosllave figuron klauzola sipas së cilës behët njohja e kontinuitetit shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi me ish Mbretërinë Serbe, në njërën anë, dhe e kontinuitetit shtetëror të Maqedonisë, Kroacisë dhe Bosnje-Hercegovinës respektivisht me format shtetërore të këtyre vendeve në të kaluarën sa ka ekzistuar ish Jugosllavia dhe para saj kur është në pyetje Kroacia (dhe format e saja para shtetërore nga e kaluara). U mor vesh, këto përpjekje serbe ranë në ujë dhe dështuan sepse askush nga bashkësia ndërkombëtare nuk njohu kontinuitetin e RFJ me ish Jugosllavinë<sup>45</sup>. Tani, shtrohet pyetja, pse serbët nën Milosheviqin shumë insistuan në kontinuitet shtetëror me ish Jugosllavinë? Studiuesit të cilët janë marrë me trashëgimin e ish Jugosllavisë me të drejtë kanë vërejtur se insistimi i tillë serb shpjegohet me iluzionet rreth ndarjes së borxhit të jashtëm dhe aseteve të ish Jugosllavisë. Milosheviq ka besuar se, krejt në mënyrë naive, nëse arrin që RFJ të konsiderohet kontinuitet (trashëgimtar i vetëm) i ish Jugosllavisë, sipas definicionit, republikat tjera do të quheshin secesioniste dhe nuk do t'u takonte asnjë aset kurse borxhi i jashtëm ish jugosllav do të ndahej sipas dëshirës dhe rregullave të cilat vetë serbët do t'i diktonin si shtet vazhdues i ish Jugosllavisë. Kjo, sikundër u tha, nuk ka qenë e suksesshme dhe MT ka mbyllur këtë çështje njëherë e mirë, problematikë të cilën e trajtojmë në vijim të këtyre rreshtave.

#### ***IV. Kuadri për bashkëpunim institucional në MT***

Puna rreth trashëgimit të ish Jugosllavisë nën drejtimin e Arthur Watts që ndërprerë në prag të luftës në Kosovë<sup>46</sup>, për të vazhduar menjëherë pas

---

<sup>45</sup> Për argumentim të ngjashëm, Cf. Mirjam Skrk, "Recognition of States and Its (Non-) Implications on State Succession: The Case of Successor States to the Former Yugoslavia", botuar në Mojmir Mrak (ed.), *Succession of States*, fq. 1-31, në fq. 23-30.

<sup>46</sup> Mbledhja e fundit për çështjet e trashëgimit të ish Jugosllavisë nën kryesinë e Arthur Watts-it është mbajtur më 6 dhe 7 nëntor 1997. Cf. B92 OPEN SERBIA, 6-7 nëntor 1997 (Beograd); ODRAZ B92 VESTI, 11 nëntor 1997 (Beograd). Për komentet rreth ndërprerjes dhe vazhimit të bisedimeve për trashëgimin e ish Jugosllavisë, Cf. Ana Stanic, "Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia", fq. 753; Sir Arthur Watts, "Introductory Note to the Agreement on Succession Issues Between the Five Successor States of the Former State of Yugoslavia". 41 *International Legal Materials* (2002), fq. 1-2, në fq. 2.

Kosova nuk ka mundur të jetë palë trashëgimtare sepse nuk ka qenë shtet sovran dhe i pavarur. Siç e tham më heret, trashëgimi i shteteve vjen në shprehje vetëm atëherë kur

rrëzimit të Milosheviqit nga pushteti në tetor të vitit 2000. Para arritjes së MT janë mbajtur dy takime në mes të palëve, një në Bruksel (dhjetor 2000) dhe tjetra në Lubjanë (shkurt 2001)<sup>47</sup>. Megjithatë, më herët nuk ka pasur ndonjë rrjet bashkëpunimi institucional, i cili u krijua vetëm me arritjen e MT. Tani ekzistojnë jo vetëm institucionet permanente për bashkëpunim gjatë fazës së implementimit të MT, por edhe mekanizma tjerë për zgjidhjen e kontesteve lidhur me vetë zbatimin dhe interpretimin e MT.

Institucioni kryesor sipas MT është Komitetit i Përbashkët i Përhershëm (“Joint Standing Committee”) (në tekstin e mëtejme: KPP), të cilin e përbëjnë përfaqësuesit e lartë të secilit shtet trashëgimtar<sup>48</sup>. Detyrë e KPP është mbikëqyrja e zbatimit efektiv të MT. Përveç kësaj, KPP shërben edhe si vend ku zgjidhen mosmarrëveshjet në mes të palëve<sup>49</sup>. Vendimet e tij nuk janë të detyrueshme për palët dhe kjo paraqet një të metë të madhe të këtij organi<sup>50</sup>. Në njëfarë mënyre, KPP paraqitet si një lloj bashkëpronari nisur nga fakti se të drejtat dhe detyrat e shteteve trashëgimtare janë e mirë e përbashkët e tyre të cilat qeverisen nga shtetet trashëgimtare nën drejtimin e KPP<sup>51</sup>.

---

ndodhë zëvendësimi i një sovraniteti shtetëror me tjetërin, gjë që në Kosovë ka ndodhur vetëm më datën 17 shkurt 2008 e tutje. Më 10 qershor 1999 ka ndodhur vetëm suspendimi (pezullimi) i sovranitetit të Beogradit mbi Kosovën dhe ndalimi i Republikës së Kosovës që të ushtroj çfarëdo juridiksioni nëpër territorin e Kosovës. Këtë pozicion tejet të sakët nga pikëpamja e të drejtës ndërkombëtare e ka konfirmuar Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (më tej shkurt: GJND) me vendimin e saj Këshilldhënës të datës 22 korrik 2010. Cf. “Accordance With International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo”. INTERNATIONAL COURT OF JUSTICE. Advisory Opinion. Date: 22 July 2010, në veçanti paragrafët 52-56; 74-84; 96-109; dhe 114-121.

<sup>47</sup> Ana Stanic, “Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia”, fq. 778.

<sup>48</sup> Cf. neni 4 i MT.

<sup>49</sup> Ibid., neni 5 (2) (b).

<sup>50</sup> KPP mund të bëjë vetëm “rekomandime për qeveritë e shteteve trashëgimtare”. Ibid. Neni 5 (2).

<sup>51</sup> Këto të drejta dhe detyrime përfshijnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet të cilat i kanë takuar ish Jugosllavisë dhe që nuk janë të përmendura në MT (përfshirë, pa u kufizuar në, të drejtat e patentit, vulës, të drejtat e autorit, honoraret, si dhe kërkesat e detyrimet tjera të ish Jugosllavisë). Cf. Ibid. Për sa i përket detyrimeve të ish Jugosllavisë, Cf. neni 1, Aneksi F i MT. Neni 2 i Aneksit F të MT përcakton se “të gjitha kërkesat kundër RSFJ, të cilat nuk përfshihen me këtë marrëveshje duhet të shqyrtohen nga KPP, i themeluar në bazë të nenit 4 të MT.

Me qëllim të mbikëqyrjes së implementimit të pjesëve të caktuara të MT, të cilat janë dëshmuar si më kontestueset gjatë viteve të mëhershme, është paraparë themelimi i disa mekanizmave tjerë, të cilët kanë të bëjnë me shpërndarjen e sendeve të tundshme dhe të patundshme, ndarjen e pasurisë së përfaqësive diplomatike dhe konsullore, si dhe të aseteve dhe borxheve. Karakteristikë e këtyre komiteteve është se puna e tyre fillon ende pa hyrë në fuqi MT për shkak të rolit të madh që kanë në zgjidhjen e problemeve të hapura të trashëgimit të ish Jugosllavisë e të cilat janë provuar si të vështira për zgjidhje në mes të palëve që nga dita e parë<sup>52</sup>. Në vijim të kësaj, shtetet trashëgimtare të ish Jugosllavisë krijuan Komitetin e Përbashkët mbi Trashëgimin e Sendeve të Tundshme dhe të Patundshme (“Joint Committee on Succession to Movable and Immovable Property”: në tekstin e mëtejme KPTSTP). Ky mekanizëm ka për qëllim që të përkujdeset për “zbatimin e drejtë të dispozitave ... të cilat zbatohen ndaj sendeve të prekshme të tundshme dhe të patundshme (përveç pasurisë ushtarake), si dhe zgjidhjen e problemeve që mund të lindin gjatë procesit të zbatimit të tyre”<sup>53</sup>. Përveç tij, MT parasheh themelimin edhe të komiteteve tjera të përbashkëta. Këto komitete kanë për qëllim përcaktimin e vlerës së aseteve dhe të borxheve të pasurisë së përfaqësive diplomatike e konsullore të ish Jugosllavisë, si shpërndarjen e aseteve dhe borxheve sipas çelësit të përcaktuar në MT<sup>54</sup>.

Dallimet që lindin në lidhje me interpretimin ose implementimin e MT i nënshtrohen, në rend të parë, zgjidhjes “mbi bazën e diskutimeve në mes të shteteve të interesuara”<sup>55</sup>. Vetëm në rast se diskutimi i tillë nuk sjell rezultate, palët mund t’i drejtohen një personi të pavarur sipas zgjedhjes së

---

<sup>52</sup> Ibid., Aneksi A, neni 5 (2): (“Komiteti i Përbashkët do të fillojë punën brenda tre muajve nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje”); Aneksi B, neni 6 (“Komiteti i Përbashkët do të fillojë punën përkohësisht brenda tre muajve nga dita e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje”); Aneksi C, neni 6 (“Secili shtet trashëgimtar do të caktojë një përfaqësues të Bankës Qendrore, ose ndonjë përfaqësues tjetër, me qëllim të formimit të një komiteti i cili do të takohet brenda tridhjetë ditëve nga nënshkrimi i Marrëveshjes, me qëllim të përcaktimit të modaliteteve për shpërndarjen fillestare të identifikuar në nenin 5 të këtij aneksi”). Cf. po ashtu edhe nenin 12 (2) të MT i cili thekson se këto dispozita “do të jenë përkohësisht të zbatueshme pas datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, në pajtim me kushtet e përcaktuara këtu”.

<sup>53</sup> Ibid., Aneksi A, neni 5 (10).

<sup>54</sup> Ibid., Aneksi B (neni 5) dhe Aneksi C (neni 6).

<sup>55</sup> Neni 5 (3) i MT.

tyre, të cilit i japin të drejtën për marrjen e vendimit të detyrueshëm<sup>56</sup>. Palët, në mënyrë alternative, mund ta dërgojnë çështjen në KPP, i cili ka të drejtën e marrjes së vendimit këshillues (jo të detyrueshëm për palët). Në raste të caktuara, sipas nismës së cilësdo palë, mosmarrëveshjet që dalin lidhur me interpretimin e MT mund t'i dërgohen për vendosje të detyrueshme një eksperti të vetëm, i cili caktohet me marrëveshje në mes palëve apo, në mungesë të marrëveshjes, ai mund të caktohet nga Kryetari i Gjykatës së Pajtimit dhe Arbitrazhit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë<sup>57</sup>. Kjo dispozitë synon që të pengojë ngecjet dhe bllokimet e mundshme të procesit të zgjidhjes së trashëgimisë së ish Jugosllavisë. OSBE është zgjedhur nga palët për një rol të tillë sepse kjo organizatë regjionale ka pasur një involvim të madh në krizën dhe tragjedinë ish jugosllave ashtu që palët e kanë parë atë si një aktor neutral në gjykimin edhe të çështjeve të tilla, siç është trashëgimi ndërkombëtar i ish Jugosllavisë<sup>58</sup>. Për dallim nga KV II, MT nuk përmend fare mundësinë e involvimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Kjo nuk do të thotë se MT ka përjashtuar në tërësi mundësinë e involvimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në këtë proces, gjë që shihet nga formulimi sipas të cilit “kushtet nga neni 5 nuk i prekin të drejtat dhe detyrimet e palëve të cilat dalin nga dispozitat në fuqi për sa i përket zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”. Ofrimi i zgjidhjeve origjinale në lëminë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në MT, një e detyrueshme kurse tjetra jo, paraqet risinë dhe precedentin më të rëndësishëm të trashëgimit jugosllav, i cili mund të hyjë në punë në rastet e ardhshme të trashëgimit të shteteve

#### ***V. Prona e tundshme, prona e patundshme dhe prona e përfaqësive diplomatike e konsullore***

Lidhur me ndarjen e patundshmërive të ish Jugosllavisë, MT ka dispozita të cilat janë krejtësisht të ndryshme nga standardet ndërkombëtare të përcaktuara në KV II. Këto dispozita të reja dhe origjinale janë parashikuar për këto kategori: definimin e pronës së patundshme shtetërore; përcaktimin

---

<sup>56</sup> Neni 5 (2) i MT flet për “vendosjen e shpejtë dhe me efekt detyrues të çështjes e cila duhet të respektohet nga palët dhe, sipas rastit, vendimi mund përcaktojë edhe afatet për veprimet që duhet të ndërmerren”.

<sup>57</sup> Idem., neni 5 (3).

<sup>58</sup> Në fakt, vetë ideja e formimit të kësaj gjykate të OSBE-së ka lindur nga Robert Badinter, kryetari i Komisionit të Arbitrazhit për ish Jugosllavinë. Cf. Robert Badinter, “L’Europe du droit”, fq. 15-23.

e momentit të trashëgimit të kësaj prone; kompensimin eventual për kalimin e pronës së tillë të trashëgimtarët; dhe, së fundi, dispozitat që caktojnë ligjin i cili zbatohet për definimin e pronës së patundshme të ish Jugosllavisë.

Si moment të trashëgimit, MT ka përcaktuar në marrëveshje momentin e “deklarimit të pavarësisë” ashtu siç e kanë dëshiruar vetë palët e jo si thotë KV II <sup>59</sup>. Kjo do të thotë, sipas MT, se “prona e patundshme e RSFJ, e cila ka qenë në territorin e RSFJ, do të kalojë në shtetet trashëgimtare në territorin e të cilave ajo pronë gjendet”<sup>60</sup>, kurse të drejtat pronësore “konsiderohet se kanë lindur që nga data e shpalljes së pavarësisë së shteteve të reja” <sup>61</sup>.

KV II parashikon se prona e patundshme u takon atyre shteteve në territorin e të cilëve gjendet prona e tillë dhe parashikon mundësinë e kompensimit në rast se një kalim i tillë i patundshmërisë prodhon efekte të padrejta për trashëgimtarët e ndryshëm. Kompensimi i tillë është kërkuar nga të gjitha ish republikat jugosllave, përveç serbëve të cilët kanë mbajtur në posedim pronën e tillë në pjesën më të madhe. E njëjta ka ndodhur edhe me ish republikat sovjetike, si dhe me Çekinë dhe Sllovakinë<sup>62</sup>, por pa sukses. MT nuk përjashton një mundësi të tillë por vetëm në rast të pajtimit të plotë për kompensim në mes të pesë ish republikave jugosllave dhe atë pasi të jetë rekomanduar me konsensus nga trupat përkatës të themeluar sipas MT<sup>63</sup>. Në praktikë, kjo do të thotë se vështirë që mund të vijë deri te një kompensim i tillë konsensual.

Përveç kësaj risie, palët kanë futur edhe një qasje tjetër për identifikimin e pronës së ish Jugosllavisë, e cila dallon nga modaliteti i KV II. Derisa KV II thotë se “ligji i brendshëm” përcakton se çka ka qenë pronë e shtetit

---

<sup>59</sup> KV II pranon si moment të trashëgimit “datën kur shteti trashëgimtar ka zëvendësuar shtetin pararendës në përgjegjësitë e tij për marrëdhëniet ndërkombëtare të territorit”. Cf. neni 2 (d) i KV II.

<sup>60</sup> Neni 2 (1), Aneksi A.

<sup>61</sup> Neni 7, Aneksi A.

<sup>62</sup> Cf. Paul Williams & Jennifer Harris, “State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy”, fq. 366-383 dhe 400-407; Hubert Beemelmans, “State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis”, fq. 110-113.

<sup>63</sup> Cf. neni 5 dhe neni 8 (Aneksi A) i MT.

pararendës<sup>64</sup>, MT e bënë të kundërtën e kësaj. MT thotë se shteti trashëgues, pra jo shteti pararendës, “në territorin e të cilit gjendet pasuria e patundshme ... e përcakton vetë ... nëse prona e tillë ka qenë pasuri shtetërore e RSFJ-së në pajtim me të drejtën ndërkombëtare”<sup>65</sup>. Në ndërkohë që si pronë e RSFJ-së “konsiderohet tërë prona e tundshme dhe e patundshme e federatës së definuar si Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë”<sup>66</sup>. Kjo ka një kundërthënie logjike në shikim të parë, por del e kuptueshme nëse merret parasysh fakti se serbët gjatë tërë kohës kanë kundërshtuar zbatimin e prononcimeve të Badinterit dhe të KV I dhe II në çështjet e ndarjes së pronës, duke pasur në posedim të tyre shumicën e pronës së ish Jugosllavisë. Ndarja e pronës së tundshme të ish Jugosllavisë sërish është bërë në një mënyrë të ndryshme nga ajo që përcakton KV II<sup>67</sup>. Në KV II ndiqet parimi funksional, sipas të cilit prona e tundshme i takon shtetit aktiviteti i të cilit lidhet me pronën e tillë të tundshme që trashëgohet<sup>68</sup>. MT, ndërkaq, ka vepruar ndryshe duke e pranuar qasjen territoriale edhe ndaj pronës së tundshme. Kjo është bërë për arsye të faktit se serbët kanë mbajtur në posedim pjesën më të madhe të asaj prone. Qeveria Serbe ka përdorur këtë pronë për ndjekjen e qëllimeve të saja ushtarake. MT, me një fjalë, i është nënshtruar politikës *fait accompli* të Serbisë duke përjashtuar nga trashëgimi pasurinë e tundshme ushtarake të ish Armatës Jugosllave,<sup>69</sup> kurse dëmet e luftës u përjashtuan nga procesi i trashëgimit të ish Jugosllavisë, ashtu siç pat propozuar më heret vetë Komisioni Badinter<sup>70</sup>.

---

<sup>64</sup> Kjo do të thotë se në përcaktimin e asaj se çka paraqet pronë shtetërore të trashëgueshme duhet bazuar në definimet e asaj prone sipas ligjeve në fuqi të shtetit pararendës në momentin e trashëgimit. Cf. neni 8 i KV II.

<sup>65</sup> Neni 6, Aneksi A.

<sup>66</sup> Neni 1 (1), Aneksi A i MT.

<sup>67</sup> Edhe në rastin e pronës së tundshme vlejnë rregullat e më sipërme për identifikimin e saj, pra atë e bënë shteti trashëgimtar në territorin e të cilit gjendet prona e tillë duke u mbështetur në të drejtën ndërkombëtare, jo në ligjin e brendshëm të shtetit pararendës siç thotë KV II. Cf. neni 6 i Aneksit A të MT.

<sup>68</sup> Cf. nenet 14 (b), 15 (d), 17 (b), 18 (c) të KV II.

<sup>69</sup> Prona ushtarake përbëhej prej 75 për qind të pasurisë së ish Jugosllavisë. Cf. Vladimir – Djuro Degan, “Dissagreements over the Definition of State Property in the Process of State Succession to Former Yugoslavia”, fq. 50; Ana Stanic, “Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia”, fq. 755. Prona e ish ushtrisë jugosllave përjashtohet nga trashëgimi. Ndarja e pronës së ish ushtrisë jugosllave mund të bëhet vetëm nëse ekzistojnë marrëveshje të veçanta në mes të shteteve trashëgimtare për një ndarje të tillë. Cf. neni 4 (2) i Aneksit A të MT.

<sup>70</sup> International Conference on Former Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 13. 32 *International Legal Materials* (1993), fq. 1591-1592.

Sipas nenit 3 (1) të Aneksit A të MT, “pasuria e tundshme shtetërore e RSFJ e cila është gjetur brenda territorit të RSFJ-së kalon në shtetin trashëgimtar në territorin e të cilit ajo pronë ka qenë e vendosur në ditën e shpalljes së pavarësisë”. Paragrafi në vijim i nenit të njëjtë përjashton nga kjo kategori pronën me rëndësi kulturore e historike për popujt e ish Jugosllavisë. Kjo dispozitë është vënë, nisur nga fakti se luftërat në ish Jugosllavi kanë shkatërruar në masë të konsiderueshme pasurinë kulturore e historike të popujve jugosllav. Ky përjashtim nuk shtrihet vetëm ndaj pronës së tundshme me rëndësi historike e kulturore që ka qenë e vendosur brenda territorit të ish Jugosllavisë në ditën e pavarësimit të shteteve trashëgimtare, por edhe në atë pronë të tundshme e cila, sipas nenit 4 (5) të Aneksit B, ka qenë e mbajtur jashtë vendit si pjesë e përfaqësive diplomatike e konsullore. Kjo dispozitë është një risi e madhe krahasuar me KV II e cila një mbrojtje të tillë u ofron vetëm materialeve arkivore pra, jo dhe pronës shtetërore të tundshme të pararendësit <sup>71</sup>.

MT praktikisht ka ndjekur prononcimin e Komisionit Badinter mbi ndarjen e dëmeve të luftës nga trashëgimi i shtetit ish jugosllav. MT nuk flet fare për dëmet e luftës, mirëpo formulimi i dispozitës së nenit 3 (3) i Aneksit A adreson mundësinë e kthimit të pronës së tundshme e cila është marrë pa autorizim nga shtetet trashëgimtare, nëse ajo pronë ka qenë e vendosur në territorin e tyre në ditën e shpalljes së pavarësisë. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë shteti trashëgimtar që ka marrë pronën e tillë pa të drejtë detyrohet të bëjë kompensim të tërësishëm për pronën e tillë të marrë, u mor vesh përveç pronës ushtarake <sup>72</sup>. Nga kjo shihet qartë se kthimi ka përparësi ndaj kompensimit të këtij lloji të pronës shtetërore të ish Jugosllavisë.

Në ndarjen e pronës së përfaqësive diplomatike dhe konsullore, e cila përbëhet vetëm prej një për qind të tërë pasurisë <sup>73</sup>, trashëgimtarët e ish Jugosllavisë kanë qenë më afër respektimit të dispozitave të KV II dhe të

---

<sup>71</sup> Cf. neni 30 (3) i KV II.

<sup>72</sup> Në të vërtetë, prona e ish ushtrisë jugosllave që ka shërbyer për qëllime civile ka një tretman të njëjtë me pronën e tundshme nga neni 3 (1) i Aneksit A të MT, pra, kalon në shtetin trashëgimtar në territorin e të cilit ka qenë ditën e shpalljes së pavarësisë.

<sup>73</sup> Cf. Vladimir – Djuro Degan, “Disagreements over the Definition of State Property in the Process of State Succession to Former Yugoslavia”, fq. 50.

praktikës ndërkombëtare<sup>74</sup>. Me qëllim të arritjes së një ndarjeje të drejtë (“equity”), MT ka paraparë tri mënyra. Sipas mënyrës së parë, MT parashikon ndarjen sipas përzgjedhjes së vetë shteteve trashëgimtare të përfaqësive diplomatike e konsullore të ish Jugosllavisë (neni 1 i Aneksit B). Mirëpo, kjo përzgjedhje është e natyrës së përkohshme dhe e pjesshme sepse MT në nenin e dytë flet për mënyrën e dytë të ndarjes e cila duhet të respektoj përqindjet e caktuara kur të ketë përfunduar në tërësi ndarja e pronës së tillë (neni 3 i Aneksit B). Ato përqindje ndryshojnë nga përqindjet e zbatuara nga FMN dhe synojnë të jenë më të favorshme për Bosnjë Hercegovinën dhe Maqedoninë (neni 2, para 2 i Aneksit B), ashtu që tani duken për sa vijon: Bosnje dhe Hercegovina 15 për qind; Kroaci 23.5 për qind; Maqedonia 8 për qind; Sllovenia 14 për qind; dhe RFJ 39.5 për qind. Këtë përqindje e përfshijnë edhe pronat e përfaqësive diplomatike e konsullore nga neni 1 i Aneksit B ku palët kanë bërë këtë përzgjedhje: Bosnjë dhe Hercegovina ka marrë ambasadën e ish Jugosllavisë në Londër; Kroacia ka marrë ambasadën e ish Jugosllavisë në Paris; Maqedonia ka marrë konsullatën e përgjithshme të ish Jugosllavisë në Paris; Sllovenia ka marrë ambasadën e ish Jugosllavisë në Washington; dhe RFJ ka marrë rezidencën e ish Jugosllavisë në Paris.

Në fund, si mënyrë të tretë, MT ka parashikuar se prona e luajtshme i takon shtetit trashëgimtar që ka marrë përfaqësinë diplomatike sipas dy mënyrave të sipër cekura, me përjashtim të pronës e cila paraqet rëndësi kulturore ose historike për ndonjërin prej shteteve trashëgimtare (neni 4, paragrafi 5 i Aneksit B). Kjo do të thotë se prona tjetër ndahet në mënyrë proporcionale duke synuar arritjen e përqindjeve si më sipër. Kjo mund të arrihet ose me marrëveshje në mes të pesë trashëgimtarëve vetë ose duke parashikuar

---

<sup>74</sup> “... Prona e patundshme shtetërore e shtetit pararendës e cila gjendet jashtë vendit u jipet shteteve trashëgimtare në proporcion të drejtë”. Neni 18 (1) b i KV II. Për komentet, Cf. P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives and Debts* (The Edwin Mellen Press, Lewiston: N.Y., 1991) fq. 111. Insistimi serb në kontinuitetin shtetëror me ish Jugosllavinë më së miri është reflektuar në sjelljet e serbeve karshi pronës së përfaqësive diplomatike dhe konsullore të atij shteti. RFJ tërë kohën është sjellë sikur ato të ishin pronat e saj kurse tjerët, secesionistët, sipas praktikës ndërkombëtare, zakonisht nuk kanë gëzuar të drejtën e trashëgimit të pronës së përfaqësive diplomatike e konsullore të shtetit pararendës i cili ka vazhduar të jetojë edhe pas shkëputjes së një pjesë të territorit të tij. Cf. Malcolm Shaw, *International Law* (Cambridge University Press: Cambridge, 1995), fq. 613-614. Për dyshimet rreth këtij qëndrimi, Cf. Ana Stanic, “Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia”, fq. 769, fusnota nr. 91.



procedura të veçanta në mes tyre për ndarjen e tillë, gjithnjë duke pasur parasysh përqindjet e më sipërme. Në nenin 4 (1-5) MT parashikon se në kuadër të regjionit ku janë të vendosura pronat e tilla diplomatike e konsullore shtetet trashëgimtare kanë proporcionet e tyre në pronat e tilla deri sa të arrihet përqindja e parashikuar nga neni 3 i Aneksit B.

Në fund fare, vlen të theksohet se MT ka paraparë sjelljen me nikoqirllëk dhe me mirëbesim të palëve në duar te të cilës gjendet prona e tillë, deri në momentin e kalimit të saj në trashëgimtarin të cilit i takon sipas kriterëve dhe mënyrave si më sipër, si dhe kompensimin në dobi të palës së dëmtuar në rast se në ndërkohë ka ndodhur humbja ose dëmtimi i pronës së tillë <sup>75</sup>.

## **VI. Asetet dhe detyrimet financiare**

Asetet dhe detyrimet financiare janë pjesa më e parregulluar me KV II, kurse praktika e bazuar në to deri më 1991 ka qenë kryesisht në kontekstin kolonial<sup>76</sup>. Si KV II, ashtu dhe praktika shtetërore e kësaj kohe kanë mangësi në definimin e borxhit shtetëror dhe në parimin sipas të cilit duhen ndarë asetet dhe borxhet e shtetit pararendës. Në pikëpamje të borxhit, KV II pranon si borxh shtetëror vetëm nëse kreditori është “shtet, organizatë ndërkombëtare ose subjekt i së drejtës ndërkombëtare”, kurse për mënyrë të ndarjes ofron “ekuilibrin në mes të borxhit që merret dhe aseteve që trashëgohen”<sup>77</sup>. Sikundër mund të vërehet, këtu merret parasysh vetëm interesi i vendeve trashëgimtare të cilat marrin përsipër borxhin (personi i debitorit), jo interesi i atyre të cilëve u duhet paguar borxhi (personi i

<sup>75</sup> Cf. neni 7 i Aneksit B të MT.

<sup>76</sup> Mampuya Tashiabo, *Emergence des Etats nouveaux et droit international* (Presses universitaires du Zaïre: Kinshasa, 1984), fq. 155-189; Annie Gruber. *Le Droit international et la succession d' Etats* (Faculte de Droit – Paris V: Paris 1986), fq. 13-22; Guido Acquaviva, “The Dissolution of Yugoslavia and the Fate of Its Financial Obligations”, fq. 178-184; Paul Williams & Jennifer Harris, “State Succession to Debts and Assets : The Modern Law and Policy”, fq. 355-417, në fq. 356-366; Pierre Michel Eisemann, “Rapport du directeur d'etudes de la section de langue française du Centre”, botuar në Pierre Michel Eisemann et Martti Koskenniemi (eds), *La succession d' Etats : la codification a l'epreuve des faits/State Succession : Codification Tested Against the Facts* (Martinus Nijhoff Publishers: The Hague, 2000), fq. 3-64 në fq. 10-20, 47-62; Martti Koskenniemi, “Report of the Director of the Studies of the English – Speaking Section of the Centre”, botuar në Pierre Michel Eisemann et Martti Koskenniemi (eds), *La succession d' Etats : la codification a l'epreuve des faits/State Succession : Codification Tested Against the Facts*, fq. 65-132 në fq. 65-69, 90-96.

<sup>77</sup> Neni 41 i KV II.

kreditorit)<sup>78</sup>. Interesat e kreditorëve privat të cilët nuk janë “subjekte të së drejtës ndërkombëtare” do të ishin dëmtuar rëndë nëse do të ishte ndjekur kjo praktikë. Për të evituar zbatimin praktik të këtij definicioni dhe të kësaj praktike të mëparshme, organizatat ndërkombëtare qeveritare<sup>79</sup>, por edhe vendet kreditore (“Klubi i Parisit”) dhe kreditorët komercial (“Klubi i Londrës”) kanë ndërhyrë fuqishëm në procesin e ndarjes së aseteve dhe të borxhit të jashtëm, si në ish Jugosllavi ashtu dhe në rastet e ish BRSS-së dhe Çekosllovakisë<sup>80</sup>. Kjo ndërhyrje ka qenë interes jo vetëm i faktorëve të sipër cekur ndërkombëtar por edhe i vendeve trashëgimtare për shkak të nevojës së tyre për integrim në tregun e kapitalit ndërkombëtar dhe zhvillimit të tyre ekonomik, një gjendje kjo e ndryshme nga koha e trashëgimit kolonial. Në këtë pikëpamje duhen shikuar hapat e Sllovenisë dhe të ish republikave tjera jugosllave, përjashtim RFJ/USM, të cilat në periudhën prej viti 1993 deri më 1996 kanë bërë marrëveshje dypalëshe me vendet e “Klubit të Parisit” dhe kreditorët e “Klubit të Londrës” për pagesën e pjesës së borxhit të tyre sipas proporcioneve të FMN<sup>81</sup>, duke ia lënë RFJ/USM pjesën e borxhit të

<sup>78</sup> Cf. Stefan Oeter, “State Succession and the Struggle Over Equity: Some Observations on the Laws of State Succession with Respect to State Property and Debts in Cases of Separation and Dissolution of States”, fq. 83-84; August Reinisch, *State Responsibility For Debts: International Law Aspects of External Debt Restructuring* (BOHLAU: Vienna 1995), fq. 4-6 dhe 23.

<sup>79</sup> Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka për Zhvillim e Afrikës, Banka Ndëramerikane për Zhvillim, si dhe Banka për Zgjidhjet Ndërkombëtare. Nga këto organizma, Banka për Zgjidhjet Ndërkombëtare ka status të veçantë sepse marrëveshja e saj me trashëgimtarët e ish Jugosllavisë paraqet aneks të MT. Cf. Shtojcën e MT, “BIS Assets”, të datës 10 prill 2001.

<sup>80</sup> Për historikun e këtij involvimi shih në Mojmir Mrak, “Apportionment and Succession of External Debts: The Case of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia”, fq. 11-20.

<sup>81</sup> Proporcionet e FMN kanë qenë për sa vijon: Bosnjë – Hercegovina 13.20 për qind, Kroacia: 28.49 për qind, Maqedonia: 5.40 për qind; Sllovenia: 16.39 për qind; dhe RFJ: 36:52 për qind. Çelësin e FMN-së e kanë pranuar edhe institucionet tjera qeveritare, ndërkombëtare dhe komerciale, përfshirë dhe Bankën Botërore, kurse vetë MT në mënyrë shprehimore thotë, në nenin 3 të Aneksit C, se “ndarjet e tilla të bëra më herët janë definitive dhe nuk mund të rihapen dhe të diskutohen nga asnjëri prej vendeve trashëgimtare në kontekstin e trashëgimit”. Për komentet akademike, Cf. Paul R. Williams, “State Succession and the International Financial Institutions: Political Criteria v. Protection of Outstanding Financial Obligations”. *The International and Comparative Law Quarterly*, Vol. 43 No. 4 (October 1994), fq. 776-808, në fq. 779 (fusnota 14), 793-795; Ibrahim F. Shihata, “Matters of State Succession in the World Bank’s Practice”, fq. 75 dhe 87 ; Mojmir Mrak, “Succession to the Former Yugoslavia’s External Debt: The Case of Slovenia”, fq. 159-170; Mojmir Mrak, “Apportionment and Succession of External Debts:

saj të paalokuar dhe asetet që i takojnë sipas përqindjes së njëjtë sikur trashëgimtarëve të tjerë<sup>82</sup>. MT pranon çelësin e institucioneve financiare ndërkombëtare si kriter për ndarjen e aseteve dhe borxhit të jashtëm të ish RSFJsë, duke lënë të paprekur marrëveshjet individuale të cilat trashëgimtarët e ish Jugosllavisë i kanë lidhur gjatë periudhës 1993 – 1996 me vendet kreditore, bankat komerciale dhe organizatat tjera ndërkombëtare financiare. Vetëm në këtë mënyrë ka mundur të arrihet deri te realizimi i parimit të drejtësisë në kontekstin e ish Jugosllavisë, jo duke zbatuar KV II dhe praktikën e kontekstit kolonial. Ndërhyrja e institucioneve financiare ndërkombëtare ka qenë vendimtare në arrijten e marrëveshjes në mes të palëve trashëgimtare si në ish Jugosllavi ashtu dhe në Ish BRSS dhe Çekosllovakia, sepse ka përcaktuar qartë kriteret e ndarjes së drejtë dhe ka imponuar disiplinë në këtë proces. Në rastin e ish Jugosllavisë, kjo reflektohet fare qartë në Aneksin A (me dy shtojcat e tij) të MT.

MT ka pranuar në parim çelësin e FMN me rastin e ndarjes së aseteve të ish Jugosllavisë. Kjo nuk do të thotë se palët në tërësi kanë zbatuar çelësin e përcaktuar nga FMN, i cili qe bazuar në disa faktorë, siç janë kontributi i ish republikave jugosllave në prodhimin e përgjithshëm shoqëror, në eksportin e ish Jugosllavisë, si dhe fuqia e tyre ekonomike karshi njëra tjetrës<sup>83</sup>.

---

The Case of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia”, fq. 165-170; Ana Stanic, “Financial Aspects of State Succession: The Case of Yugoslavia”, fq. 758-763.

<sup>82</sup> Shenjat e para se do të ndiqet një rrugë e tillë e ndarë për zgjidhjen e problemeve të aseteve dhe të borxheve financiare të ish Jugosllavisë i ka dhënë Komisioni Badinter, i cili pat thënë, në mes tjerash, se mosbindja ndaj zgjidhjes me marrëveshje të problemeve të trashëgimit nga ana e ndonjërit prej shteteve trashëgimtare nuk është pengesë që tjerët të fillojnë një process të tillë me ato vendet trashëgimtare që janë kooperativ në këtë proces. Cf. “International Conference on the Former Yugoslavia. Arbitration Commission. Opinion No. 12”. 32 *International Legal Materials* (1993) fq. 1589-1591. Kjo qasje e Komisionit dhe praktika e ndjekur nga vendet trashëgimtare të ish Jugosllavisë ka shërbyer si një lloj mjeti për presion ndaj RFJ/USM, e cila më në fund është detyruar të pranojë tërë atë që është arritur në baza bilaterale në mes të vendeve trashëgimtare të ish Jugosllavisë me institucionet financiare ndërkombëtare, kreditorët privat dhe vendet kreditore. Për analizën e detajuar të historikut të marrëveshjeve bilaterale si dhe presionin ndërkombëtar ndaj vendeve trashëgimtare të ish Jugosllavisë, Cf. Paul R. Williams, “State Succession and the International Financial Institutions: Political Criteria v. Protection of Outstanding Financial Obligations”, fq. 793-804.

<sup>83</sup> Cf. fusnota nr. 24 *infra*. Një zbatim të shumë faktorëve e kanë aplikuar edhe vendet e ish Bashkimit Sovjetik, kurse praktika e ish Çekosllovakisë e ndarjes së aseteve dhe borxheve financiare bazohet vetëm në një faktor: madhësia e popullsisë së vendeve trashëgimtare. Për rastet e ish BRSS-së dhe Çekosllovakisë, Cf. Paul Williams & Jennifer Harris, “State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy”, fq. 372, 383,

Modifikimet e çelësit të ndjekur nga FMN-ja janë sanksionuar në nenin 5 (2) të MT<sup>84</sup>. Ato tani duken kështu: Bosnja dhe Hercegovina, 15.5 për qind; Kroacia, 23 për qind; Maqedonia, 7.5 për qind; Sllovenia, 16 për qind; dhe RFJ/USM 38 për qind. Kjo ndarje vlen në veçanti për këto asete: për 27 për qind të kapitalit të ish Bankës së RSFJ-së për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar<sup>85</sup>; për shumën neto të kërkesave të Bankës Nacionale të ish RSFJ-së ndaj vendeve tjera<sup>86</sup>; për asetet e huaja financiare, siç janë paratë e gatshme, ari dhe metalet tjera të çmueshme; llogaritë e depozituara dhe sigurimet e drejtpërdrejta ose bashkërisht me bankat e huaja të mbajtura nga ish RSFJ ose Banka Nacionale e ish RSFJ-së<sup>87</sup>; dhe, në fund, për asetet financiare të jashtme aktualisht të panjohura për palët<sup>88</sup>.

Mënyra si është bërë ndarja e borxhit të jashtëm të ish Jugosllavisë paraqet risi në disa drejtime. Në rend të parë, vlen të theksohet se palët në MT kanë pranuar çelësin e FMN edhe për ndarjen e borxheve<sup>89</sup>. Në rend të dytë, ndarja e borxhit të jashtëm në MT nuk ndjekë rrugën e KV II sipas së cilës duhet të ketë një ekuilibër në mes të aseteve që trashëgohen dhe borxhit që merret përsipër nga trashëgimtari. Zbatimi i kësaj formule është provuar në kontekstin e ish BRSS-së dhe Çekosllovakisë<sup>90</sup> por pa sukses. Kreditorët e jashtëm nuk kanë pranuar një gjë të tillë dhe kanë insistuar në përgjegjësinë e ndarë dhe të përbashkët ("joint and several liability"). Mënjanimi i kësaj klauzole është bërë i mundur vetëm kur kreditorët e jashtëm kanë vërejtur se vendet trashëgimtare ish federative socialiste janë serioze në marrjen përsipër të borxhit të tyre të paalokuar (borxhin federal)<sup>91</sup>. Ky ka qenë një

---

402-403, dhe 406; Hubert Beemelmans, "State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis", 110-113.

<sup>84</sup> Per çelësin e eprdorur nga FMN, Cf. fusnota nr. 78 *supra*.

<sup>85</sup> Aneksi C, neni 4 (a) i MT.

<sup>86</sup> Aneksi C, neni 4 (b) i MT.

<sup>87</sup> Aneksi C, neni 5 (1) i MT.

<sup>88</sup> Aneksi C, neni 5 (3) i MT.

<sup>89</sup> Neni 3, para. 1-3 i Ankesit C të MT.

<sup>90</sup> Cf. fusnota nr. 25 *infra*.

<sup>91</sup> Për rastin e ish Jugosllavisë, Cf. neni 2 para. 1-2 i Ankesit C të MT. Për komentet rreth përgjegjësisë së ndarë dhe të përbashkët ("joint and several liability"), si dhe për marrjen përsipër të borxhit të paalokuar në tri rastet e ish federatave komuniste, shih më shumë në: Stefan Oeter, "State Succession and Struggle Over Equity: Some Observations on the Law of State Succession With Respect to State Property and Debts in Cases of Separation and Dissolution of States", fq. 76-83; Andrea Gioia, "State Succession and International Financial Institutions", botuar në Pierre Michel Eismann & Martti

proces i vështirë, i komplikuar dhe i gjatë. Ky borxh, në praktikën standarde të së drejtës ndërkombëtare nuk përfshin as borxhin lokal (të kontraktuar nga autoritetet regjionale, ish republikat dhe krahinat autonome) e as borxhin e lokalizuar (të kontraktuar nga ish federatat komuniste në dobi të autoriteteve regjionale, ish republikave dhe krahinave autonome)<sup>92</sup>. Këto dy lloje të borxhit kalojnë në mënyrë automatike në barrë të shteteve të reja trashëgimtare sipas rregullës së “përfituesit të fundit”, pra, kush ka qenë përfitues nga borxhi i tillë<sup>93</sup>.

Kjo mënyrë e ndarjes së borxhit të paalokuar të ish Jugosllavisë ka nënkuptuar se ndarja e kryer borxhit të paalokuar të ish Jugosllavisë, sipas celësit të FMN, si dhe veprimet e kryera dypalëshe në mes të FMN, BB, vendeve të “Klubit të Parisit”, si dhe bankave komerciale të “Klubit të Londrës”, paraqesin një zgjidhje të përhershme dhe të mbyllur. Këtë e thotë

---

Koskeniemi (eds), *La succession d' Etats : la codification a l' epreuve des faits/ State Succession: Codification Tested Against the Facts*, fq.327- 383 në fq 355-383; Mojmir Mrak, “Apportionment and Succession of External Debts: The Case of the Socialist Federal Republic of Yugoslavia”, fq. 12-20; Vladimir – Djuro Degan, “State Succession , Especially in Respect of State Property and Debts”. *The Finnish Yearbook of International Law*. 4 (1993) fq. 130-193, në fq. 143-146; Hubert Beemelmans, “State Succession in International Law: Remarks on Recent Theory and State Praxis”, fq. 110-118; Paul Williams & Jennifer Harris, *State Succession to Debts and Assets: The Modern Law and Policy*, fq. 368-383, 396-407.

<sup>92</sup> Borxhi i jashtëm publik në të drejtën ndërkombëtare ndahet në borxhin nacional, borxhin lokal dhe në borxhin e lokalizuar. Borxhi nacional është borxhi për të cilin përgjigjet në mënyrë ekskluzive shteti. Në rastin e ish federatave socialiste, ai quhet borxh federal. Cf. Stefan Oeter, “State Succession and the Struggle Over Quity: Some Observations on the Laws of State Succession with Respect to State Property and Debts in Cases of Separation and Dissolution of States”, fq. 87. Ndarjen si kjo e ka bërë për herë të pare Asociacioni për të Drejtën Ndërkombëtare më 1970. Cf. International Law Association. *Report of the Fifty – Fourth Conference held at the Hague*, 23rd – 20th Agust , 1970 (London: 1971) fq. 108; Shih poashtu edhe M. Bedjaoui, *Ninth Report on Succession of States in Respect of Matters Other Than Treaties* (Doc.A/CN.4/301 and Add. 1 of 13 and 20 April 1977, paras. 2, 3, 6, 14, 16, 18-19, 22-24, 29, 32-33, 40, 63, and 118 ; 1418th Meeting of 13 May 1977, para. 38; and M.Bedjaoui, *Thirteenth Report on Succession Of States in Respect of Matters Other Than Treaties* (Doc. A/CN.4/345/Add. 1 of 29 May 1977), paras. 127, 129, 132, and 157; Përveç kësaj ndarje, borxhet nganjëherë ndahen edhe në borxhe të a.q. odioze (borxhet e marra për qëllim të zhvillimit të operacioneve luftarake dhe për shuarjen e kryengritjes), të cilat nuk mund të jenë objekt trashëgimi, dhe borxhet e ndërmarrjeve publike, trashëgimi i të cilave është mjaft i diskutueshëm në praktikën e shteteve. Cf. P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives, and Debts* , fq. 157-170).

<sup>93</sup> Neni 2 (b) i Aneksit C të MT.

në mënyrë shprehimore MT në neni 3 parag. 3, Aneksi C, kurse në paragrafin e dytë të po këtij neni theksohet se palët nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim ligjor kundër njëri - tjetrit ose të hapin ndonjë procedurë karshi njëri - tjetrit për kërkesat që kanë të bëjnë me kërkesat financiare të cilat lidhen me detyrimet ndaj “Klubit të Parisit” ose “Klubit të Londrës”. Kjo është bërë për të siguruar vendet e Klubit të Parisit dhe kreditorët komercialë të “Klubit të Londrës” se mosmarrëveshjet eventuale në mes të palëve nuk do të reflektohen në asnjë mënyrë në marrëveshjet e arritura bilaterale në mes të kreditorëve të sipër cekur dhe ish republikave jugosllave. Mungesa e kësaj klauzole sigurisht që do ta kishte vënë në lëvizje rikthimin e sistemit të “përgjegjësisë së ndarë dhe të përbashkët” (“joint and several liability”) të ish republikave jugosllave.

Kosova nuk përbën përjashtim nga kjo qasje, pra nga qasja e zbatuar ndaj ish Jugosllavisë për sa i takon aseteve dhe detyrimeve financiare. Nuk pranohet si mënyrë ndarje ndjekja e “ekuilibrit në mes të borxhit që merret dhe aseteve që trashëgohen” nga neni 41 i KV II e as zbatimi i parimit të “përgjegjësisë së ndarë dhe të përbashkët” (“joint and several liability”) për arsye se Kosova është e fundit si shtet sovran dhe i pavarur që del nga territory ish jugosllav më 17 shkurt 2008. Kjo don të thotë se karshi Kosovës qëndron një process i mbyllur i trashëgimit shtetëror të ish Jugosllavisë i bazuar në MT, kurse Kosova si shtet nuk mund të trashëgojë më ish Jugosllavinë por vetëm Republikën e Serbisë. Kjo më tutje nënkupton se formalisht nuk mund të zbatohet MT por që në esencë, sa i takon aseteve dhe detyrimeve financiare, por edhe kufijve dhe disa segmenteve tjera, në tërësi është ndjekur rruga dhe fryma e njëjtë me atë të ndjekur me rastin e zbatimit të MT.

Se gjendja është si më sipër, shihet qartë nga qarkullimi i dokumentacionit tejet sekret të FMN, BB, që ngërthen edhe detyrimet ndaj “Klubit të Parisit” dhe “Klubit të Londrës”.<sup>94</sup> Në këtë dokumentacion me saktësi përcaktohet

---

<sup>94</sup> Borxhi i alokuar i Kosovës nuk është kontestues. Kosova në mënyrë automatike ka trashëguar borxhin e tillë si “përfitues i fundit” dhe kryesisht ka të bëjë me dy-tri kredi të marra nga Banka Botërore në mesin e viteve '70-ta të shekullit XX-të. Këtu e kam fjalën për borxhin regjional të cilin Kosova vet sipas Kushtetutës së vitit 1974 ka pasur të drejtë ta kontrakttoj. Mirëpo, në sasinë e borxhit të lokalizuar, të cilin ish federate jugosllave e ka kontraktuar në emër të Kosovës hyjnë edhe shumë kontrakte tjera të kryera për ose në emër të Kosovës me qëllim të zhvillimit të bujqësisë dhe promovimit të ndryshimeve strukturore në ekonominë e atëhershme të Kosovës. Tekstet e këtyre marrëveshjeve duhet

shuma e borxhit aktual të paalokuar të Kosovës, i cili kap shumë afro 689 milion euro.<sup>95</sup>

## VII. Arkivat

Në ndarjen e arkivave të ish Jugosllavisë më së shumti është respektuar KV II. Kjo nuk do të thotë se MT nuk ka futur zgjidhje të reja në këtë drejtim<sup>96</sup>. Ato kanë të bëjnë me zbatimin e parimit territorial, funksional (organik)<sup>97</sup>, si dhe me parimin e integritetit të koleksionit arkivor me rastin e ndarjes së tij<sup>98</sup>.

KV II niset nga parimi se dokumentet dhe materiali arkivor i “çfarëdo lloji dhe date” që është i nevojshëm për funksionimin normal të administratës në territorin e trashëguar përfshihet në trashëgim<sup>99</sup>. Kjo ka të bëjë si me arkivat administrative ashtu dhe me ato që nuk kanë natyrë të tillë por që janë të rëndësishme nga pikëpamja historike e kulturore. Arkivat politike nuk

---

të gjenden në arkivat e Beogradit dhe të ish republikave jugosllave (kopjet e tyre), sepse ato kanë shërbyer si bazë për përcaktimin e borxhit (automatikisht) të alokuar të Serbisë të marrë në emër të (territorit) të Kosovës sipas dispozitave të MT.

<sup>95</sup> Cf. “Establishment of the Kosovo Debt Management Support Program (KDMSP), dated June 9, 2008. CONFIDENTIAL: R 2008-0135. IDA/R 2008-0218. June 12, 2008

<sup>96</sup> Arkivat shtetërore të ish Jugosllavisë kanë qenë objekt diskutimi në mes të shteteve trashëgimtare që nga vitit 1992, por pa ndonjë rezultat të prekshëm. Problemet kanë lindur qysh në fillim dhe kanë pasur të bëjnë me vetë definimin e termit “arkivë shtetërore”. Cf. Vladimir – Djuro Degan, “State Succession, Especially in Respect of State Property and Debts”, fq. 130-193, në fq. 149; Për historikun e këtyre bisedimeve dhe ofertat e ndërmjetësuesve ndërkombëtar, sikundër dhe për qëndrimet e kundërta të palëve vendore, shih më shumë në Marija Oblak – Carni & Born Bohte, “Succession to the Archives of the Former SFR Yugoslavia”, botuar në Mojmir Mrak, *Succession of States*, fq. 171- 185, në fq. 178-185.

<sup>97</sup> Termin “lidhje organike” të arkivave me territorin e ka përdorur për herë të parë P. K. Menon. Cf. P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives and Debts*, 136.

<sup>98</sup> Për komentet e parimeve të territorialitetit, funksionalitetit dhe të integritetit arkivor, Cf. P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives and Debts*, fq. 119-149.

<sup>99</sup> Neni 31 (1) (a) i KV II. Në nenin 3 të Aneksit D të MT, në vijim të zbatimit të parimit territorial, thuhet se: “ajo pjesë e arkivave shtetërore të RSFJ (që ka natyrë administrative, aktuale ose që paraqet shënime arkivore) e cila është e domosdoshme për funksionimin normal të administratës së territorit të njëres prej shteteve trashëgimtare, në pajtim me parimin e përkatësisë funksionale, kalon në ato shtete, pa marrë parasysh vendndodhjen e tyre momentale”.

trashëgohen<sup>100</sup>. KV II, sikundër vërehet, nuk flet për njësitë të cilat përbëjnë dokumentet dhe materialin tjetër arkivor<sup>101</sup>. Këtë paqartësi e ka evituar MT, e cila në nenin 1 (a) të Aneksit D i konsideron si arkiv: “të gjitha dokumentet, të çfarëdo lloji e date, të vendosura kudo, të cilat janë prodhuar ose pranuar nga RSFJ .... në vijim të ushtrimit të funksioneve të saj si shtet dhe të cilat, më 30 qershor 1991, i kanë takuar RSFJ-së sipas ligjit në fuqi dhe që janë ruajtur si arkiv qoftë nga vetë ajo ose nën kontrollin e saj, pa marrë parasysh qëllimin e tyre”, kurse në po atë nen, nën pikën (b), flet për dokumentet që përbëjnë materialin arkivor i cili është objekt trashëgimi në mes të pesë shteteve të reja. Kjo nuk do të thotë se ka mundur të përpilohet një listë shterrëse e gjithë dokumenteve dhe materialit arkivor që trashëgohet. Ky formulim lë hapësirë për mosmarrje të përgjegjësisë për arkivat që trashëgohen për një periudhë disa muajshe (qershor 1991 – korrik 1992) për shkak se mungon shteti pararendës i cili është zhdukur pikërisht në këtë periudhë.

KV II lidhur me parimin organik jep formulimin sipas të cilit “lidhja e drejtpërdrejtë e arkivave të shtetit pararendës me territorin e shtetit trashëgimtar” paraqet kusht të mjaftueshëm për trashëgimin e tyre, pa dhënë ndonjë kriter për të gjykuar se cila është kjo lidhje direkte. MT në këtë drejtim është më specifike dhe përmban, përveç formulimit mbi “lidhjen e drejtpërdrejtë të territorit me arkivën që trashëgohet” edhe formulimin që lidhet me faktin se ato janë prodhuar si të tilla nga shteti trashëgimtar ose janë marrë në emër të tij në të kaluarën<sup>102</sup>.

Sipas parimit të integritetit arkivor, trashëgimtarët me rastin e ndarjes së arkivave shtetërore duhet të kenë kujdes që të mos e dëmtojnë tërësinë e të dhënave dhe informacionin arkivor si tërësi. Në MT kjo shprehet me kujdesin që duhet pasur në mënyrë që “sa më shumë që të jetë e mundur të respektohet integriteti i grupeve të arkivave të RSFJ-së pa marrë parasysh se ku do të ruhen grupet e tilla të arkivave”. Zbatimit të këtij parimi i shërben edhe neni 6 i Aneksit D i cili parashikon mundësinë e lënies në “trashëgim të përbashkët” të arkivave shtetërore të ish Jugosllavisë, përveç atyre nga neni 3 dhe 4, të cilat nuk mund të ndahen në mënyrë të drejtë (“equitable”)

---

<sup>100</sup> Cf. P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives and Debts*, fq. 142-144.

<sup>101</sup> Kjo mangësi është kritikuar nga doktrina. Cf. P.K. Menon, *The Succession of States in Respect to Treaties, State Property, Archives and Debts*, fq. 123.

<sup>102</sup> Neni 4 (a) (ii) i Aneksit D të MT.



në mes të shteteve trashëgimtare të ish Jugosllavisë. Me qëllim të lehtësimit të këtij procesi parashikohet formulimi i listës së veçantë nga ana e shteteve trashëgimtare për arkivat të cilat mbesin “trashëgimi e përbashkët”<sup>103</sup>. Funksion të njëjtë të ruajtjes së integritetit arkivor, përveç arkivave që mbesin “trashëgimi e përbashkët”, ka edhe neni 5 i Aneksit D të MT. Ky nen lejon, parasheh, se palët mund të merren vesh se cila nga to do ta mbajë origjinalin, kurse të tjerëve t’i bëjnë kopjet në rastet kur “arkivat u takojnë një ose më shumë shteteve trashëgimtare”<sup>104</sup>. Vlen të theksohet, megjithatë, se parimi i integritetit arkivor, ose i ruajtjes së koleksionit arkivor siç e thonë disa autorë, nuk guxon të shkojë në dëm të nevojave të realizimit të dy parimeve të sipër cekura<sup>105</sup>.

Sa i përket Kosovës, në çështjet e arkivave nuk ka pasur ndonjë lëvizje konkrete në praktikë. Në Planin Ahtisari nuk ka dispozita mbi këtë çështje. I vetmi hap që është ndërmarrë në këtë drejtim ka të bëjë me Konkluzionet e Brukselit të arritura në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë Serbe më datën 2 shtator 2001<sup>106</sup>. Në këtë dokument parashihet që të bëhet dorëzimi i kopjeve të regjistrave kadastral palës kosovare. Dorëzimi i kopjeve në fjalë në këtë rast bëhet për të dhënë mesazh të qartë në publik se origjinali do të mbetet në duart serbe e kjo don të thotë se Serbia i konsideron ato origjinale si pjesë organike të “territorit serb” në Kosovë dhe se vetëm ajo si shtet ka të drejtën ekskluzive të ruajtjes së integritetit arkivor të regjistrave të tillë kadastral.

### ***VIII. Prona private dhe të drejtat e fituara***

Tërësia e rregullave dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare mbi të drejtat e fituara ka për qëllim kufizimin e arbitraritetit shtetëror me rastin e ndërrimit të sovraniteteve territoriale. Si të tilla, ato nuk janë kufizime të

<sup>103</sup> Cf. Neni 6 (b) i Aneksit D të MT.

<sup>104</sup> Për mënyrën e bartejs së shpenzimeve të transporti dhe të fotokopjimit të materialit arkivor, Cf. zgjidhjen standarde në nenin 7 të Aneksit D të MT.

<sup>105</sup> Cf. Eli Nathan, “The Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts”, fq. 504.

<sup>106</sup> Cf. Agreed Conclusions of 2 September 2011 (Cadastral Record). Përveç këtyre, më 2 korrik është arritur edhe nënshkrimi i një dokumenti tjetër, në formë konkluzioni, në Bruksel, më datën 2 korrik 2011, me të cilin rregullohet çështja e librave të regjistrave civil të cilat Serbia i ka marrë me vete pas mbarimit të luftës më 10 qershor 1999. Edhe këtu është zbatuar parimi i njëjtë, pra Kosova mere kopjet e certifikuara kurse origjinali mbetet në Serbi. Cf. Agreed Conclusions of 2 September 2011 (Civil Registry Books).

sovrانيتetit, por kanë për qëllim mbrojtjen e marrëdhënieve private të individëve dhe personave të tjerë juridikë, privatë me rastin e ndërrimit në sovranitetin territorial<sup>107</sup>. Zbatimi i këtyre normave dhe parimeve me rastin e trashëgimit, pas mbarimit të Luftës së Ftohët, ka dëshmuar fuqishëm se ato paraqesin një pjesë të së drejtës ndërkombëtare zakone<sup>108</sup>. Një dëshmi të tillë paraqet edhe historiku i këtyre rregullave dhe parimeve në të kaluarën, me përjashtim të periudhës së dekolonizimit kur sovranitetet e reja territoriale, të bazuar në doktrinën e njohur të “pjtës së pastër”, seriozisht cenuan rregullat dhe parimet mbi të drejtat e fituara<sup>109</sup>. Në kohën para dekolonizimit, të drejtat e fituara kanë gjetur përkrahjen si të gjykatave

---

<sup>107</sup> August Reisch, *State Responsibility For Debts: International Law Aspects of External Debt Restructuring*, fq. 86, 88-89; Georges Kaeckenbeeck, *The Protection of Vested Rights in International Law* (Oxford University Press: Oxford, 1936) fq. 8.

<sup>108</sup> Cf. Carsten Stahn, “The Agreement on Succession Issues of the Former Socialist Federal Republic of Yugoslavia”, fq. 395.

<sup>109</sup> Kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur dokumente ndërkombëtare të kohës të cilat kanë synuar zbutjen e kësaj ndërhyrjeje brutale të sovraniteteve të reja territoriale, por që zbatimi ka qenë fare i papërfillshëm. Për praktikën e shteteve në këtë periudhë, Cf. “ILC Report on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts”. *The Yearbook of the International Law Commission* (1981), Vol. II, Part 2, p.79-80; Për komentet doktrinare që arsyetojnë politikat e nacionalizimit, Cf. Yao Kunale EKLO, *Le Principe de Droit Acquis, La Nationalisation et Les “Nouveaux Etats”*. (Cahier Libre de Institut de la Recherche Scientifique: Vol. 1 Octobre 1974, LOME), fq. 7-11, 15-25; Hanna Bokor-Szego, *New States and International Law*. (Akademiai Kiado: Budapest, 1970) fq. 52-72. Për komentet që mbrojnë të drejtat e fituara, përfshirë edhe normat mbi të drejtat e njeriut si ndërhyrëse në procesin e mbrojtjes të të drejtave të fituara, shih më shumë në: Thomas Ebenroth & Matthew James Kemner, “The Enduring Political Nature of Questions of State Succession and Succession and the Quest for Objective Standards”. *University of Pennsylvania Journal of International Economic Law*, Vol. 17 No. 3 (Fall 1996), fq. 753 – 819; Pierre-Michel Eisemann, “Raport du Director d’ etudes de la section de langue Française du Centre”, fq. 60-61; 106-108; Sandrine Maljean – Dubois, “La role de l’equite dans le droit de la succession d’Etats”, botuar në Pierre – Michel Eisemann & Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d’ Etats: la codification a l’epruvedes facts/ State Succession: Codification Tested Against the Facts*, 137-184 në fq. 151; Isabele Poupart, “Succession aux traite et droit de l’home: vers la reconnaissance d’une protection ininterrompe des individus”, botuar në Pierre – Michel Eisemann & Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d’ Etats: la codification a l’epruve des facts/ State Succession: Codification Tested Against the Facts*, fq. 465-490 në fq. 467-468, 475; Maria Isabel Torras Cazorla, “Rights of Privat Persons on State Succession: An Approach to the Mos Recent Cases”, botuar në Pierre – Michel Eisemann & Martti Koskenniemi (eds.), *La succession d’ Etats: la codification a l’epruve des facts/ State Succession : Codification Tested Against the Facts*, fq. 663-717, në fq. 663, 667-679 dhe 686-712.

nacionale<sup>110</sup>, ashtu dhe të atyre ndërkombëtare<sup>111</sup>, por edhe kanë qenë objekt i rregullimit normativ shumëpalësh<sup>112</sup> dhe dypalësh<sup>113</sup>. Edhe në rastet kur janë cenuar ato, kjo ka ndodhur kundrejt një kompensimi të drejtë dhe të menjëhershëm” të palës së dëmtuar<sup>114</sup>.

Të drejtat e fituara përfshijnë “çdo të drejtë, materiale dhe jo materiale, e cila u takon subjekteve private të së drejtës, fizike dhe juridike, sipas të ligjit të brendshëm, vlera e të cilës mund të konvertohet në para”<sup>115</sup>. Ato kanë lindur në kontekstin e mbrojtjes së koncesioneve të huaja kundër nacionalizimit nga ana e sovranitetit të ri territorial dhe kanë qenë në lidhmëri të ngushtë me të ashtuquajturen mbrojtjen diplomatike. Në fakt, rastet e para të gjykatave bëjnë fjalë për këtë lloj mbrojtjeje të të drejtave të fituara<sup>116</sup>.

---

<sup>110</sup> Parimi sipas të cilit të drejtat private të fituara sipas ligjeve të vjetra duhet të ruhet është pranuar mjaft në praktikë. Në rastin *United States v Percheman* (1819), Chief Justice Marshall pat dhënë në mënyre elokuede esencën e këtij parimi: “zakoni modern i kombeve, i cili është bërë ligj, do të cënohej, kuptimi i drejtësisë dhe i të drejtës së njohur nga bota e civilizuar do të ofendoheshin, sikur prona të konfiskohej, kurse të drejtat private të anuloheshin”. Cf. *United States v Percheman* (32 U.S. 51, 1833). Për komentet akademike, shih në Sir Herch Lauterpacht, *The Development of International Law by the International Court* (Stevens & Sons: London, 1958) fq. 319-320.

<sup>111</sup> Cf. “Colons allemands au Pologne”, 1923 *CPJI*, série B no. 6, fq. 36.

<sup>112</sup> Neni 35 i Aktit Final të Berlinit mbi Kongon. “The General Act of the Berlin Congo Conference (1845)”, ribotuar në Arthur Berriedale Keith, *The Belgian Congo and the Berlin Act* (Clarendon Press: Oxford, 1919). Për komentet, Cf. Daniel de Leon, “The Conference at Berlin on the West-African Question”. *Political Science Review* Vol. 1 No. 1 (March 1886), fq. 103-139.

<sup>113</sup> Këtu mendohet në doktrinën Drago-Porter, të mishëruar në “Konventën e Hagës të vitit 1907 mbi Kufizimin e Përdorimit të Forcës për Nxjerrjen e Borxheve Kontraktuale”. Për komentet Cf. Georg Winfield Scott, “Hague Convention Restricting the Use of Force to Recover on Contract Claims. 2 *American Journal of International Law* (January 1908), pp. 78- 94; August Reinisch, *State Responsibility for Debts: International Law Aspects of External Debt and Debt Restructuring*, fq. 13-14.

<sup>114</sup> Eli Nathan, “The Vienna Convention on Succession of States in Respect of State Property, Archives and Debts”, fq. 513; J.E.S. Fawcett, “Some Foreign Effects of Nationalization of Property”. 27 *British Yearbook of International Law* (1950), fq. 355-375; N. R. Doman, “Post War Nationalization of Foreign Property in Europe”. *Colombia Law Review* Vol. 48 No. 8 (December 1948), fq. 1125-1161; Patric Daillier & Alain Pellet, *Droit International Public* (L.G.D.J.: Paris, 1994) fq. 518.

<sup>115</sup> Daniel P. O’Connell, *International Law*. Botimi i II-të (Stevens: London, 1979), fq. 763.

<sup>116</sup> Cf. August Reinisch, *State Responsibility for Debts: International Law Aspects of External Debt and Debt Restructuring*, fq. 12-17. Të drejtat e fituara përfshijnë edhe

Në rastin e shpërbërjes së tri ish federatave komuniste këto të drejta janë respektuar në mënyrën më të duhur dhe nuk ka pasur asnjë hezitim nga ana e sovraniteteve të reja territoriale për sa i përket respektimit të tyre në praktikë. Kjo shpjegohet me mungesën e konfliktit ideologjik rreth formave të pronës dhe orientimit të tërë botës ish komuniste kah ekonomia e lirë dhe respektimi i pronës private dhe konkurrencës së lirë. Për më tepër respektimi i tyre është ndërlidhur me konceptet universale mbi të drejtat e njeriut, të cilat janë inkorporuar nëpër legjislacionet nacionale të ish vendeve komuniste<sup>117</sup>. Dispozitat e MT reflektojnë këtë frymë universale dhe përmbajnë dispozita konkrete kundër diskriminimit dhe për kompensim material në rastet kur nuk mund të bëhet rikthimi në gjendjen e mëparshme i të drejtave të fituara.

Përveç të drejtave të fituara të natyrës administrative, siç janë pensionet<sup>118</sup> dhe të drejtat tjera që mund të lindin në të ardhmen<sup>119</sup>, Aneksi G i MT flet për “të drejtat e fituara dhe pronën private” (nenet 1 - 8). Këto të drejta në MT ndahen në të drejtat materiale (neni 2: “të drejtat mbi sendet e luajtshme dhe të paluajtshme”) dhe në ato që nuk janë materiale (neni 3: “të drejtat

---

kërkesat e pastërta financiare, ndryshe nga që është menduar deri vonë, dhe si të tilla mbrohen nga e drejta zakonore ndërkombëtare sikur të drejtat tjera që kanë natyrë materiale. Koncesionet, përkatësisht mbrojtja e tyre si të drejta të pastërta financiare të personave privatë (fizikë dhe juridikë) kanë lindur konceptin e mbrojtjes diplomatike në kontekstin e të drejtave të fituara. Cf. Daniel P. O’Connell, “Economic Concessions in the Law of States Succession”. 27 *British Yearbook of International Law* (1950) fq. 93-124.

<sup>117</sup> Cf. Carsten Stahn, “The Agreement on Succession Issues of the Former Socialist Federal Republic of Yugoslavia”, fq 396; Martti Koskenniemi, “Report of the Director of Studies of the English – Speaking Section of the Centre”, fq. 106-112; Maria Isabel Torres Cazorla, “Rights of Privat Persons on State Succession: An Approach to the Most Recent Cases”, fq. 671-677 dhe 714-717.

<sup>118</sup> Aneksi E i MT ka të bëjë me pensionet dhe ka tri nene. Neni i parë rregullon të drejtën e gëzimit pa asnjë diskriminim të pensioneve të cilat janë gëzuar nga shfrytëzuesit e tyre gjatë kohës së ish Jugosllavisë por që janë paguar nga ish republikat jugosllave; Neni 2 flet për pensionet federale, të personave ushtarakë dhe atyre civilë; Neni i fundit parashikon lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe në mes të shteteve trashëgimtare me qëllim të bartjes së fondeve për realizimin e pagesave për pensionet nga nenet 1 dhe 2.

<sup>119</sup> Në nenin 2 të Aneksit F të MT parashikohet mundësia e daljes së kërkesave të reja kundër ishJugosllavisë. Në rast se lindin kërkesa të tilla të reja, qofshin të natyrës së të drejtave të fituara të personave privatë, fizikë dhe juridikë, ose të natyrës tjetër publike ose shtetërore, atëherë ato shqyrtohen nga Komiteti i Përhershëm i Përbashkët, i themeluar në pajtim me nenin 4 të Marrëveshjes për Trashëgim. Për këtë qëllim, palët kanë detyrë ta informojnë njëra tjetrën në rast të ekzistimit të kërkesave të tilla (neni 2, fjalja e fundit).

mbi pronësinë intelektuale, përfshirë patentet, shenjë e dallimit, të drejtat e autorit, honoraret dhe të ngjashme”). Parimi i mosdiskriminimit figuron fuqishëm në nenin 2, pika (a), ku thuhet për sa vijon:

“... të drejtat ndaj pronës së tundshme dhe të patundshme të vendosura në shtetin trashëgimtar dhe të cilat u kanë takuar personave fizikë ose juridikë të RSFJ-së më 31 dhjetor 1990, gëzojnë mbrojtje dhe u kthehen titullarëve sipas standardeve dhe normave të së drejtës ndërkombëtare, pa marrë parasysh nacionalitetin, shtetësinë, vendbanimin ose vendndodhjen e tyre. Kjo përfshin personat të cilët pas datës 31 dhjetor 1990 kanë fituar shtetësinë, vendbanimin ose vendndodhjen në shtetin tjetër përveç shtetit trashëgimtar...”

Dispozitë të ngjashme mbrojtëse përmban edhe neni 6 i Aneksit G të MT mbi mbrojtjen e të drejtës banesore, pa prekur këtu në garancionet shtesë ekzistuese të shteteve nacionale lidhur me mosdiskriminimin<sup>120</sup>. Kjo do të thotë se çdo kontratë e lidhur nën shtrëngim konsiderohet si e pavlefshme<sup>121</sup>. Dispozitat mbi pavlefshmërinë e kontratave të tilla synojnë t’i evitojnë, sa të jetë e mundur, veprimet joligjore kundër të drejtave të fituara, ngjashëm siç ka bërë Marrëveshja e Dejtonit më 1995<sup>122</sup>. Në frymën e ndalimit të diskriminimit është edhe formulimi i nenit 7, i cili synon që personave privatë, fizikë dhe juridikë, t’ua lehtësojë qasjen pa asnjë diskriminim në gjykatat vendore të shteteve trashëgimtare në rast se do të kenë nevojë për realizimin e të drejtave të fituara sipas ligjit të vjetër.

Rregulla mbi kompensimin parashikohet për rastet kur nuk mund të realizohen të drejtat mbi sendet e patundshme dhe të tundshme të

---

<sup>120</sup> Cf. neni 8 i Aneksit G.

<sup>121</sup> Neni 2 (b), Aneksi “G” i MT.

<sup>122</sup> Në nenin 1 (1) të Aneksit 7 të Marrëveshjes së Dejtonit parashihet kthimi i pronës së marrë pa të drejtë, ose kompenzimi nëse nuk ka mundësi të bëhet një kthim i tillë, dhe i referohet kohës së armiqësisë të filluara pas vitit 1991. Cf. “General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina” (December 14, 1995). 35 *International Legal Materials* (1996), fq. 89-169 në fq. 137. Vlen të theksohet se, në praktikë, megjithatë nuk ka pasur ndonjë zbatim të suksesshëm të kësaj dispozite, sikundër as të dispozitave të tjera mbi të drejtat themelore të njeriut. Procesi i zbatimit të të drejtave të njeriut në Bosnjë-Hercegovinë pas arritjes së Marrëveshjes së Dejtonit më 1995 ka ecur mjaft ngadalë dhe më shumë vështirësi. Shih më shumë në: Christopher Harland, “Making Effective the Use of Human Rights and Freedoms in Bosnia-Herzegovina”, botuar në Jasna Baksic – Muftic & Liljana Mijovic (eds.), *Citanka ljudskih prava* (Centar za ljudska prava Univerziteta u Sarajevu: Sarajevo, 2001) fq. 259-280.

përshtetësi si më sipër. Në një rast të tillë sigurohet se personat, fizikë dhe juridikë, të cilët nuk mund t'i realizojnë të drejtat e tyre "...e gëzojnë të drejtën e kompensimit në pajtim me të drejtën civile dhe ndërkombëtare".

Për fund, vlen të thuhet se dispozitat e Aneksit G të MT ofrojnë zgjidhje në nivel parimi, mjaft të përgjithësuara. Për këtë arsye në nenin 4 të Aneksit G shprehimisht parashikohet detyrimi i palëve "për të lidhur marrëveshje dypalëshe dhe për të njoftuar gjykatat e autoritetet tjera kompetente" me qëllim që të mundësohet "zbatimi efektiv i parimeve të këtij aneksi" në pajtim me "parimet e përgjithshme të drejtësisë dhe ashtu siç e kërkon nevoja".

Çështja e pronës private dhe e të drejtave të fituara në Kosovë duhet të jetë më problematike. Kjo është e tillë, siç u pa më sipër, edhe në rastet e vendeve që kanë të lidhur një marrëveshje ndërkombëtare. Mbrojtja e këtyre të drejtave varet kryekput nga raporti i forcave në mes të palëve. Në rastet e trashëgimit të tyre gjatë dhe pas mbarimit të Luftës së Ftohtë, sovranitetet e reja territoriale nuk kanë qenë në pozitë për të zbatuar logjikën e "pjetës së pastër", përkatësisht të mohojnë në mënyrë përfundimtare të drejtat pronësore dhe të drejtat tjera të fituara, sipas ligjeve të shtetit pararendës. Në këtë drejtim, Kosova ka pak gjasa të realizoj ndonjëherë nga këto të drejta të qytetarëve të vet, në veçanti lidhur me pensionet. Ka tepër pak gjasa që Serbia ndonjëherë të pranojë lidhjen e një marrëveshjeje dypalëshe me Kosovën lidhur me këto çështje. Mundësia e vetme është që bashkësia ndërkombëtare në mënyrë të njëanëshme të bëjë bartjen e një shume paushalle të borxhit të jashtëm të Kosovës, si formë kompenzimi, në barrë të Serbisë. Ky lehtësim financiar karshi Kosovës më pas do të shërbente si bazë për kompenzim të të drejtave pronësore dhe të drejtave tjera të qytetarëve të Kosovës. Edhe ky option, megjithatë, ka pak gjasë të realizohet nisur nga fakti se asnjëherë nuk është biseduar seriozisht me Serbinë për caktimin e arbitrit ndërkombëtar ashtu siç thuhet në nenin 3.1 dhe 3.2 të Aneksit VI të Planit Ahtisari<sup>123</sup>. Pra, Kosova duhet të insistojë në

---

<sup>123</sup> Aneksi VI, Neni 3.1 i Planit Ahtisari: "Nëse, brenda një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Kosova dhe Republika e Serbisë nuk janë pajtuar për barazimin dhe alokimin e borgjeve, pas konsultimit me palët, Grupi Drejtues Ndërkombëtar, do të emëroj një arbitër ndërkombëtar për ndarjen e borxhit ndërkombëtar të Republikës së Serbisë në mes të Republikës së Serbisë dhe Kosovës, në atë pjesë të borxhit ndërkombëtar për të cilin nuk është arritur ujd nga palët, në marrëveshje me kreditorët relevant."

zbatimin deri në fund të Planit Ahtisari. Kjo, megjithatë, në asnjë mënyrë nuk nënkupton që autori i këtyre rreshtave mbron tezen krejt naive dhe joprofesionale të qarqeve të caktuara në Kosovë që besojnë akoma se kuptimi i dispozitave sa më sipër të Planit Ahtisari për caktimin e këtij arbitri do të thotë se ka vend akoma që Kosova të bëjë rinegociimin me ish republikat jugosllave të borxhit të jashtëm dhe të çështjeve tjera që lidhen me asetet dhe pasurinë e ish Jugosllavisë. Kosova nuk ka asnjë mundësi që ti diskutojë këto punë me ish republikat jugosllave, përveç se me Sërbinë të cilën e trashëgon. Trashëgimi i ish Jugosllavisë është punë e kryer dhe çdo përpjekje publike për ushqim të një iluzioni të tillë nuk është veçse një iluzion naiv.<sup>124</sup>

Mënyrë tjetër për zgjidhjen e këtij problemi është që të bëhet imponimi Serbisë për kompenzim të këtyre të drjetave si pjesë e dëmit të luftës të shkaktuar nga Shteti serb në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Edhe ky opsion mund të realizohet vetëm nëse kreditorët e jashtëm të Serbisë dhe të Kosovës e imponojnë në mënyrë të njëanshme një gjë të tillë. Kjo, po ashtu duhet thënë këtu me këtë rast, ka fare pak gjasa për të ndodhur sepse deri tani bashkësia ndërkombëtare nuk ka pranuar fare që dëmet e luftës të diksutohen apo që të merren parasysh si ndonjë prej bazave të kompenzimeve reciproke për dëmet e shkaktuara në luftërat e ish Jugosllavisë. Në fakt, ky ka qenë pozicion fillestar i Komisionit Badinter dhe nuk ka pasur asnjë shmangje nga ky parim, pra nga parimi që dëmet e luftës nuk mund të jenë objekt diskutimi dhe as të shërbejnë si bazë për

---

Aneksi VI, Neni 3.2 i Planit Ahtisari: “Caktimi i arbitrit nga arbitri do të jetë i parevokueshëm dhe do të vendosë se cilat borxhe do t’i transferohen Kosovës”.

<sup>124</sup> Në kohën e shkrimit të këtyre rreshtave, u publikua një raport në gusht 2012 nga FORUMI 2015, i cili vepron në kuadër të “Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur” (KFOS), në të cilin raport thuhet se Kosova duhet të rregulloj raportet e trashëgimit të pasurisë dhe çështjet tjera me ish republikat jugosllave pasi që kjo çështje, sipas këtij raporti, ka mbetur e hapur akoma me Planin Ahtisari. Ky raport, ishte shkruar si analizë për përmbylljen e pavarësisë së mbikqyrur të Kosovës sipas Planit Ahtisari, gjë e cila ndodhi më 12 shtator 2012. Pra, sipas këtyre ekspertëve del sikur Kosova akoma ka shans për të diksutuar me ish republikat jugosllave restaurimin e pronës publike, borxhin e jashtëm dhe çështjet tjera të trashëgimit të ish Jugosllavisë dhe se arbitri i paraparë me Planin Ahtisari ka për mandat edhe trashëgimin e ish Jugosllavisë, përkatësisht zgjidhjen e çështjeve të trashëgimit të borxhit për kohën 1989-1999 dhe segmenteve tjera që lidhen me këtë. Kjo fare nuk ka asnjë bazë logjike, lëre më profesionale. Cf. *MËNGJESI NJË DITË PAS: JETA PA MBIKËQYRJE* (Prishtinë: Gusht 2012). *Për komente, cf* më shumë në artikullin “Forumi 2015: Veriu do të jetë çështje tensionesh e problemesh” të Besnik Krasniqi, botuar në të përditshmen *Koha Ditore*, Prishtinë, e mërkurë, 5 shtator 2012, fq. 2.

kompenzim të ndërsjellë të ish republikave jugosllave. Këtë mosshmangie e ka respektuar edhe MT, siç u diskutua më herët në këtë punim.

### *Në vend të përfundimit*

Procesi i trashëgimit të ish Jugosllavisë, i filluar më 1991, është mbyllur me sukses në mes të shteteve sovraane më 2001 me lidhjen e MT. MT ka ndjekur rrugën e prononcimeve të Komisionit Badinter duke dëshmuar fuqishëm se trashëgimi i shteteve është proces mjaft kontekstual dhe se rregullat juridike, kryesisht, luajnë rol në nivel parimesh të përgjithshme. Me fjalë të tjera, sërish u vërtetua se parimi i bashkëpunimit, i marrëveshjes në mes të palëve dhe ai *rebus sic stantibus* janë kyç në zgjidhjen e çështjeve që dalin nga trashëgimi i shteteve. Përkundër kritikave të argumentuara e racionale<sup>125</sup>, miratimit të prononcimeve të tij *en bloc*<sup>126</sup>, por edhe akuzave ndaj tij për konspiracion gjatë prononcimeve<sup>127</sup>, puna e Komisionit Badinter në përgjithësi mund të thuhet se ka qenë me vend dhe i ka dhënë kahje modelimit të krizës ish jugosllave, si në formë e përmbajtje, ashtu dhe në aspektin politik e juridik.

Kjo nuk do të thotë se trashëgimi i ish Jugosllavisë nuk ka sjellë rezultate të reja dhe precedente të cilat mund të përdoren në të ardhmen. Risitë kryesore mund të përmbledhen për sa vijon: për herë të parë u tregua se trashëgimi universal, jo ai i “pjatës së pastër”, duhet të jetë rregull zakonore ndërkombëtare, pra, se shtetet, në parim, trashëgojnë të gjitha llojet e të

<sup>125</sup> Michla Pomerance, The Badinter Commission: The Use and Misuse of the International Court of Justice's Jurisprudence. *Michigan Journal of International Law* Vol. 20 No. 1 (Fall 1998) fq. 31-58; Matthew C. R. Craven, The European Community Arbitration Commission on Yugoslavia. 66 *British Yearbook of International Law* (1995) fq. 333-413.

<sup>126</sup> Alain Pellet, “The Opinions of the Badinter Committee: A Second Breath for the Self-Determination of Peoples”, fq. 178-181; Alain Pellet, “Note sur la Conférence Européenne pour la Paix en Yougoslavie”, botuar në *Annuaire Française de Droit International* Vol. XXXVIII (1992) fq. 223-238; Vladimir-Djuro Degan, “Samoopredeljenje naroda i teritorijalna celovitost drzava u uvjetima raspada Jugoslavije”. *Nasa Zakonitost* Vol. 46 No. 4 (Zagreb: prill 1992) fq. 543-569; Vladimir – Djuro Degan, “L’arbitrage juridique ignore la jurisprudence de la Commission Badinter”, botuar në Marie François Allain et al. (eds.), *E'ex Yougoslavie en Europe: de la fallite des democraties au processus de paix* (Editions L' Harmattan: Paris, 1997) fq. 31-43.

<sup>127</sup> Gregory H. Fox, “Self-Determination in the Post-Cold War Era: A New Internal Focus? *Michigan Journal of International Law* Vol. 16 No. 3 (Spring 1995) fq. 733-781 në fq. 750.



drejtave dhe detyrimeve në rastet kur ndodhin ndërrimet në sovranitetin territorial të pararendësit. Këtu nuk përjashtohet as lëmia e pronës private dhe të drejtave të fituara. Risi tjetër, që lidhet me këtë, është se roli i bashkësisë ndërkombëtare, në rend të parë i kreditorëve të jashtëm u dëshmuar si crucial në përcaktimin e modaliteteve të trashëgimit të pronës, aseteve dhe detyrimeve të shtetit pararendës, diçka që më parë nuk ka pasur mundësi të imagjinohet. Në vaçanti ndërhyrja dhe ndihma e institucioneve ekonomike ndërkombëtare, BB dhe FMN, por edhe i vendeve kreditore dhe i bankave komerciale u tregua si e domosdoshme në zgjidhjen e problemeve të trashëgimit të shteteve.

Kosova nuk u përfshi nga tërë ky proces. Fare me të drejtë sepse nuk ishte shtet sovran e i pavarur, që është parakusht për të trashëguar dikë në të drejtën ndërkombëtare. Përderisa për çështjet sovraane, siç janë shtetësia, borxhi i jashtëm, traktatet ndërkombëtare (në veçanti ato që lidhen me regjimin ndërkombëtar të kufijve të Kosovës) dhe anëtarësimin nëpër disa organizata ndërkombëtare<sup>128</sup>, Kosova nuk mund të thuhet se u përjashtua në tërësi pas fitimit të pavarësisë më 17 shkurt 2008, në njësitë tjera të trashëgimit mund të bëhet precedent dhe të përmirësohen padrejtësitë e bëra ndaj Kosovës. Këtu e kemi fjalën në rend të parë për pronën shtetërore dhe asetet e ish Jugosllavisë, të cilat RFJ/USM i ka trashëguar pa të drejtë në emër të Kosovës, duke bërë kështu pasurim të pa bazë ligjore në kurriz të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Kosova ka kontribuar esencialisht në rritjen e pronës dhe të aseteve të atij shteti, pikërisht, gjykuar sipas kriterëve të miratuara nga BB dhe FMN dhe palët në MT (pjesëmarrja në buxhetin federal jugosllav, në prodhimin shoqëror jugosllav, në eksportin jugosllav,

---

<sup>128</sup> Kuvendi i Kosovës ka ratifikuar Traktatin për anëtarësimin e Kosovës në FMN dhe në Grupimin e Organizatave të Bankës Botërore më datën 24 korrik 2009, me vendimin e saj o3-V-159. Sa i përket organizatave tjera, Kosova mund të thuhet se ka bërë një progress të vogël vetëm sa i përket qasjes në organizata të ndryshme regjionale, por jo edhe anëtarësimin. Kjo është bërë meajonal dhe Bashkëpunim, në mes të Qeverisë së Serbisë dhe Qeverisë së Kosovës. Në këtë Marrëveshje u përcaktua se Kosova do të përdorë vetëm emerin e saj, pa cilësuar fromën aktuale shtetërore të një shteti Sovran dhe të pavarur. Kjo qasje në këtë Marrëveshje u kritikua shumë sepse, siç u tha, Kosovës ia humb identitetin e saj aktual shtetëror. Në Marrëveshje thuhet se ky lloj emërtimi vetëm si “Kosovë” nuk prejjudikon statusin e saj e as pozitën dhe është në harmoni me Rezolutën 1244 të Këshilit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me Deklarimin e pavarësisë” (Cf. paragrafi 3 i Marrëveshjes). Sado që kjo marrëveshje është arritur, Kosova nuk ka pasur ndonjë dobi të prekshme për sa i takon bashkëpunimit dhe aktiviteteve tjera rajonale.

numri i popullsisë, i njëjtë nëse jo më i madh se disa shtete trashëgimtare të ish Jugosllavisë, territori i njëjtë, nëse jo më i madh se i disa shteteve trashëgimtare të ish Jugosllavisë dhe, në fund fare, fuqia ekonomike e Kosovës, afërsisht e njëjtë me atë të disa prej vendeve trashëgimtare të ish Jugosllavisë). E njëjta gjë vlen edhe për arkivat shtetërore të ish Jugosllavisë: Kosovës duhet t'i kthehen arkivat sipas parimit funksional, organik dhe integral, siç ka ndodhur me shtetet tjera. Kthimi i statujave, i objekteve të ngjashme dhe dokumenteve të tjera të cilat serbët i kanë tërhequr nga Kosova pas humbjes së luftës më 1999 nuk paraqet trashëgim por rikthim i gjërave të rëndësisë kulturore për një region të caktuar, të marra nga ai si pasojë e konfliktit të brendshëm. Për pasojë, kjo do të thotë se edhe kthimi i tyre bëhet sipas ligjit të brendshëm dhe jo ndërkombëtar. Për të ndërruar këtë, kosovarët përmes institucioneve të tyre duhet të kërkojnë që këto gjëra të futen në bisedat teknike për zgjidhjen e veriut të Kosovës që pritet të zhvillohen gjatë këtij viti, pra gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012. Ato që filluan në vjeshtë 2004 dhe që zgjatën përgjatë vitit 2005, si dhe ato të vitit që e lamë pas, nuk dhanë ndonjë rezultat të prekshëm. Ajo që u sanksionua me Planin Ahtisari për sa i takon trashëgimit të shteteve paraqet dokumentin më kompetent nga pikëpamja e të drejtës ndërkombëtare. Dhe, për Kosovën, ai paraqet dokumentin më të favorshëm. Por, siç dihet, ai u refuzua nga serbët dhe mbeti vetëm në letër kur është fjala për trashëgimin e të drejtave dhe detyrimeve të subjektit pararendës, pra për sa i përket trashëgimit të Serbisë nga ana e Kosovës. Por, për t'u bërë kjo, kosovarët më parë duhet ta braktisin diskursin naiv mbi "Kosovën si element konstituiv i federatës jugosllave". Ajo federatë dhe ai shtet janë shpërbërë dhe pasuria e saj ka kaluar tashmë në trashëgimtarët e rinj. Serbia ka trashëguar në emër të Kosovës dhe MT është fakt i pandryshueshëm. Kosova ka punë me Serbinë, jo me trashëgimtarët tjerë të ish Jugosllavisë. Pasurinë e Kosovës e ka marrë Serbia dhe ajo duhet ta kthejë atë. Kjo bëhet jo duke vajtuar për diçka që ka shkuar, për "Kosovën si element konstituiv", por duke kërkuar gjatë bisedave në vijim për veriun e Kosovës që pasuria e Kosovës të kthehet siç është marrë. Shkenca juridike ndërkombëtare mund të luajë këtu një rol, mjaft pozitiv e konstruktiv, duke gjetur modalitete të reja të ritrashëgimit të pjesëve të caktuara të të drejtave dhe detyrimeve të shtetit pararendës, i cili kundrejt Kosovës është RFJ/USM, pra, jo ish Jugosllavia. Kjo nënkupton edhe atë, se regjimet kufitare të Kosovës, të cilat janë krijuar pas vitit 1991, siç është rasti me Marrëveshjen për Kufij në mes

të RFJ-së dhe Republikës së Maqedonisë<sup>129</sup>, mbetin në fuqi dhe nuk mund të ndryshohen. Ngjashëm do të ndodhë edhe me kufirin me Malin e Zi, me të cilin shumë shpejt duhet të lidhet marrëveshja e demarkacionit si me Maqedoninë. Thënë shkurt: duhet të krijohet një precedent i ri, një lloj trashëgimi *sui generis*, ashtu që edhe ndaj Kosovës të krijohen mundësitë për zbatim të parimeve të njëjta të trashëgimit, të proklamuar nga Komisioni Badinter një dekadë më herët<sup>130</sup>. Po nuk u bë kjo, vështirë mund të thuhet se Kosova dhe qytetarët e saj kanë fituar diçka pas tërë atyre vuajtjeve e persekutimeve deri në shkallë gjenocidi. Kjo zgjidhje *sui generis* duhet të insistoje në një involvim më të paktë të faktorit ndërkombëtar në qeverisjen e Kosovës, në një integrim më të madh evropian e ndërkombëtar të Kosovës, si dhe në krijimin e mundësive që Kosova të jetë trashëgimtare e menjëhershme e atyre dimensioneve të trashëgimit të ish Jugosllavisë të cilat nuk prekin interesat e shteteve të treta, por vetëm ato të Republikës së Serbisë, entitetit që ka folur e trashëguar në emër të Kosovës pas vitit 1992 deri me lidhjen e MT më 2001.

Qasja e Kosovarëve në dialogun e viteve para arritjes së Planit Ahtisari, por edhe pas tij që u zhvillua në vitin 2011, ka qenë naëve për një arsye të thjeshtë: asnjëri nga ata që patën mandat politik për dialogim nuk qenë të vetëdijshëm për ekzistimin e MT dhe faktit se trashëgimi i ish Jugosllavisë pat qenë i mbyllur në atë kohë. Këtë rrethanë, autori i këtyre rreshtave e pat vërejtur meqë ka udhëhequr dialogun e parë teknik me serbët para arritjes së Planit Ahtisari që u zhvillua në Vjenë gjatë viteve 2004-2005, dhe që u pasua pastaj me dialog politik nga nëntori i vitit 2005 e tutje. Çdo tentim i këtij autori për të futur në përdorim diskursin dhe forcën e parimeve e

---

<sup>129</sup> “Treaty between the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Macedonia Concerning the Delineation and Description of the State Border”, nënshkruar më 23 shkurt 2001 (ratifikuar më 9 maj 2001), kurse ka hyrë në fuqi më 16 qershor 2001. *Official Gazette of the FRY – Annex “Medjunarodni Ugovori”* (Beograd: 16.1/01). Kosova më pastaj, pas fitimit të pavarësisë, ka nënshkruar një marrëveshje tjetër për demarkacion sepse çdo marrëveshje për kufi ka dy faza, delimitimin dhe demarkacionin. Kuvendi i Kosovës me vendimin e vet nr. 03-V-203 të datës 17 tetor 2009 ka bërë ratifikimin e Marrëveshjes për Demarkacionin Fizik të Kufirit Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë. Për historikun e kësaj Marrëveshje, cf. Studimin elokuent dhe të gjatë të Dr. Jove Dimitrija Talevski, *The Borders of the Republic of Macedonia, With Supplements* (Kiro Dandaro: Bitola, 1998), në veçanti faqet 141-188; dhe 331-343.

<sup>130</sup> Për qëndrim të ngjashëm, Cf. Guido Acquaviva, “The Dissolution of Yugoslavia and the Fate of Its Financial Obligations”, fq. 213-214.

normave të së drejtës ndërkombëtare mbi trashëgimin e shteteve, përfshirë këtu edhe precedentin e krijuar me MT, shurdhohej nga zërat e akademikëve e kuazi intelektualëve të edukuar në frymën e diskursit “shkencor” të vitit 1974 dhe iluzionet për “Kosovën si element konstitutiv i federatës jugosllave”.

**Prof. Dr. Enver Hasani**

## **Specificities of the Succession of Former Yugoslavia and the Place of Kosovo in It**

### *Summary*

The succession of Former Yugoslavia that started in 1992 ended with the signing of the Vienna Agreement on Succession Issues in June 2001 by the five successor states to the Former Yugoslavia: Bosnia-Herzegovina, Croatia, Macedonia, Slovenia and the Federal Republic of Yugoslavia (also known as the “Union of Serbia and Montenegro”). The fall of the Serbian dictator S. Milosevic from power in October 2000 stands for the speedy conclusion of the process of succession to the former Yugoslavia. In this paper, the author tries to elaborate general trends on the succession of states and the issue of an eventual precedent that might have been established following the conclusion of the process of succession to the former Yugoslavia. In an indirect manner the author deals with cases of the former USSR and Czechoslovakia, taken into account the fact that both successions were based on the same principles of state succession established after the end of the Cold War. General trends on state succession, the role of international financial institutions, private creditors and creditor states, the place of “equity” and the agreement among successor states have been widely discussed in this paper. In addition to these issues, the paper deals, towards the end, with the consequences for Kosovo of the conclusion of the succession process to former Yugoslavia. In this context, the author tries to see as to whether there is any possibility for an eventual reopening of the succession *vis-à-vis* Kosovo and in its relations with Serbia. This is a very important issue now that the talks over the definition of the status of the north of Kosovo are about to commence in the second half of 2012. This eventual reopening should be seen as against Serbia only due to the fact that Serbia had spoken in the name of Kosovo and its citizens in the succession process since 1992 until its conclusion in 2001. This reopening would be a kind of satisfaction for Kosovo and its citizens for their sufferings at the hands of Serbia, and would contribute to stability and security for all living in Kosovo and around it. If this were not the case, the author says that then

the consequences of it shall be very serious and have their implications wider than Kosovo itself. The Ahtisari Plan of 2007 is a good and a very solid basis on which to rely in making succession of Serbia by Kosovo work in practice and Serbia should accept this. The Ahtisari Plan, at the end of the day, served as the basis for the declaration of independence of Kosovo on 17 February 2008, a fact recognized by over 90 states of the world. The declared independence by Kosovo did not go against any norm of any part of international law, a fact recognized as well by the International Court of Justice in its Advisory Opinion on Kosovo of July 2010.

Ján Cirák<sup>1</sup>

## Kodifikimi dhe evropianizimi i të drejtës private në Republikën Sllovake

### *Përmbledhje:*

Artikulli trajton problemet e kodifikimit dhe evropianizimit të së drejtës private në kuadër të zhvillimeve të fundit në legjislacionin e Republikës Sllovake. Të dyja proceset e së drejtës private, kodifikimi dhe evropianizimi, janë të ndërlidhura reciprokisht në mes veti. Në lidhje me veçantinë e zhvillimit të procesit të rregullimit të së drejtës private, veçanërisht analizohen kërkesat dhe rolet kryesore gjatë përpilimit të kodit të ri civil. Më tej, artikulli shtjellon kërkesën për përfundimin e legjislacionit të përkohshëm që ka të bëjë me të drejtën private, kërkesën për të arritur një shkallë më të lartë të përafrimit të së drejtës private të Republikës Sllovake me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe në fund analizohen aspektet themelore të krijimit të një koncepti të ri, modern dhe mundësisht të një koncepti sa më optimal të rregullimit të marrëdhënieve themelore dhe të instituteve të së drejtës private .

### *Fjalët kyç:*

*Kodifikimi, evropianizimi, e drejta private, kodi civil, direktivat juridike të BE-së, ligji për mbrojtjen e konsumatorit, modelet e së drejtës civile evropiane, përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit kombëtar.*

Artikulli trajton problemet e kodifikimit dhe evropianizimit të së drejtës private në kuadër të zhvillimeve të fundit në legjislacionin e Republikës Sllovake. Që në fillim, duhet theksuar se të dy proceset e së drejtës private në Republikën Sllovake, ai i kodifikimit dhe evropianizimit, janë ngushtë të ndërlidhura reciprokisht. Në lidhje me veçantinë e zhvillimit të procesit të rregullimit të së drejtës private në Republikën Sllovake, që të dy proceset e përmendura gjejnë kuptimin e tyre në ligjet e veçanta të së drejtës private.

---

<sup>1</sup> Dr. Ján Cirák, jurist i diplomuar, profesor i asociuar, Csc, Fakulteti juridik i Kolegjit Panevropian në Bratislavë, e-mail: jimmy.cirak@gmail.com.

Në krye të interesit të së drejtës civile sllovae, për disa vite me radhë, qëndron krijimi i një kodi të ri civil. Detyra e krijimit të një kodi të ri civil ishte dhe mbetet nevojë urgjente. Për këtë arsye, pothuajse të gjitha qeveritë që nga viti 1990 i kanë kushtuar vëmendje të veçantë. Në fillim bëhej fjalë për qeverinë e Çekosllovakisë, kurse prej 1.1.1993 për qeverinë e Republikës Sllovae, respektivisht të Republikës Çeke, të cilat i kanë kushtuar vëmendje të veçantë këtij problemi. Pas disa përpjekjeve të pasuksesshme, procesi aktual i përgatitjes së kodifikimit, mund të thuhet se ka kaluar në një fazë të avancuar të hartimit të një kodi të ri civil. Me 14.1.2009, qeveria miratoi "Synimin e legjislativit për kodifikimin e së drejtës private" dhe ky veprim hapi një fazë të re të punës në formulimin e neneve. Sipas orarit të punëve legjislative të komisionit të ri-kodifikimit, versioni përfundimtar i draft kodit të ri pritet të nxirret në vitin 2014.

Nevoja për një kodifikim të ri të së drejtës private në Republikën Sllovae (edhe në Republikën Çeke) ishte shumë e madhe që nga fillimi. Si rezultat i ndryshimeve sociale dhe politike në vitin 1991, nën një presion të madh kohor, janë miratuar amendamente të shumta të Kodit Civil të vitit 1964 dhe është miratuar një Kod i ri Tregtar (Ligj për tregtinë). Një legjislacion i tillë, i krijuar për një kohë shumë të shpejtë, është konsideruar afatshkurtër dhe i përkohshëm që nga fillimi. Duhet të potencoj veçanërisht pamundësinë e aplikimit të Kodit Civil paraprak dhe të ligjeve tjera në marrëdhëniet e reja.

1. Legjislacioni i përkohshëm ka lindur në ish Çekosllovakë, për shkak se çështja e diskontinuitetit në rregullimin e së drejtës private themelore, ka lindur si pasojë e zhvillimeve të mëparshme përgjatë dyzet viteve dhe nuk është zgjidhur në mënyrë të vazhdueshme në fillim të viteve nëntëdhjeta të shekullit të kaluar.

Praktika e ndryshimeve të pjesshme të Kodit Civil të vitit 1964 dhe miratimi Ligjit të ri për tregtinë në vitin 1991, në këtë fazë të zhvillimit, ka hequr mungesat themelore të drejtës private, por në një periudhë afatgjate, ka krijuar një gjendje të paekuilibruar dhe vështirë të krahasueshme me standardet e përgjithshme të aplikimit të principeve të kodifikimit të së drejtës pronësore në Evropën kontinentale të përparuar.

Nga standardet e përgjithshme moderne, largohet veçanërisht raporti ndërmjet të drejtës së përgjithshme private të modifikuar në Kodin Civil



të vitit 1964 dhe të drejtës private të veçantë, e cila është modifikuar posaçërisht në Ligjin e ri për tregtinë. Ligji për tregtinë në Republikën Çeke dhe në Republikën Sllovaqe, përfshin jo vetëm dispozitat mbi ndërmarrjet tregtare dhe kooperativat, të ashtuquajtura “raporte të ndërmarrjeve” apo “konkurrenca ekonomike”, por në pjesën e saj të tretë me titullin “Marrëdhëniet kontraktuale”, gjendet e hartuar në detaje çështja e detyrimeve të përgjithshme dhe të veçanta. Pjesa e përgjithshme e së drejtës së detyrimeve në Ligjin për tregtinë, trajton rregullimin e instituteve të cilat gjithmonë kanë qenë pjesë e të drejtës së përgjithshme private, gjithashtu bëhet fjalë për institutet dhe veprimet juridike, siç janë: mekanizmat e krijimit të kontratave, solidariteti në marrëdhëniet ligjore mbi detyrimet, çështja e garantimit të kontratave, të përfundimit të tyre, apo pasojat ligjore si pasojë e vonesës së pagesës së huamarrësit ose huadhënësit, ruajtja e sekretit afarist, të përgjegjësisë ndaj detyrimeve (kompensimi i dëmit) etj. Përveç 21 llojeve të kontratave të modifikuara në Kodin Civil të amendamentuar, në pjesën e veçantë të Ligjit për tregtinë, hasim në modifikimin e një vargu kontratash, të ashtuquajtura “kontrata tregtare” (bëhet fjalë për 23 llojet e kontratave). Në disa raste, për shembull te kontratat për shitjen e ndërmarrjes, respektivisht për shitjen e një pjese të ndërmarrjes dhe te kontratat bankare ose te kontratat për kredi, ky modifikim është pjesërisht i pranueshëm, veçanërisht për shkak se bëhet fjalë për plotësimin e boshllëqeve në ligjet e veçanta të së drejtës private, pasi që ligji i përgjithshëm, gjegjësisht Kodi Civil nuk e rregullon fare këtë çështje. Argumentimi i ekzistimit të dyfishtë të pjesës së veçantë të së drejtës detyrimore, bazohet në gjetjet se shumë lloje të kontratave, për shembull: kontratat për shitblerje, kontratat mbi vepër, kontratat mandatore dhe të ngjashme, bëhet fjalë për lloje të kontratave të cilat përdoren në mënyrë tipike në të gjitha marrëdhëniet e së drejtës private. Për këtë shkak, nuk ka arsye që dispozitat e tyre për çështje të përgjithshme siç janë: ruajtja e sekretit afarist, prekluzioni (precludo), përgjegjësia për të meta dhe përgjegjësia për dëme, të kenë dallim diametral në Kodin Civil në njërën anë dhe në Ligjin për tregtinë në anën tjetër.

Dispozitat e përkohshme mbi marrëdhëniet pronësore, dëshmojnë shumë mangësi. Mund të thuhet në mënyrë të përgjithësuar se në përmbajtjen e paqartë dhe të dyfishtë të dy kodeve, me vështirësi mund të gjejmë, respektivisht vetëm duke u bazuar në intuitë, mund të modelojmë një

sistem të plotë, të qëndrueshëm dhe të ndërlidhur reciprokisht të kontratave, të cilin mund ta hasim në dispozitat e avancuara juridike të së drejtës pronësore me karakter të së drejtës private. Mangësia tjetër konceptuale e një sistemi të tillë të copëtuar të kontratave, qëndron në dispozitat në fuqi të mjeteve të veçanta të cilat sigurojnë të drejtën private, të cilat gjenden në Kodin Civil, në Ligjin për tregtinë dhe në Ligjin e punës. Në rast të veçantë, nuk është aspak e lehtë të bëjmë zgjedhje optimale se cili kod/ligj do të aplikohet. Në teorinë e së drejtës civile, legjislacionit si dhe në praktikën ligjore, në Sllovaki mbizotërojnë mendime se një numër i problemeve konceptuale, veçanërisht në sistemin juridik dhe në dispozitat themelore të së drejtës private, mund të eliminohet vetëm përmes konsolidimit të së drejtës private në formën e kodifikimit.

Kodi Civil nr. 40/1964 i cili është në fuqi, gjatë historisë së tij deri më tani është amendamentuar mbi 40 herë. Shumica dërmuese e modifikimeve janë aprovuar në dy dekadat e fundit, në mënyrë që Kodi Civil t'i përshtatet më së miri nevojave të ekonomisë së tregut. Sistemi juridik *de lege lata* si pasojë e një qasjeje të tillë, vuan nga fragmentimi, paqartësia dhe mos kompletimi, kurse nuk është e mundur të arrihet zgjidhja përmes ndryshimeve të pjesshme dhe plotësimeve të kodeve/ligjeve. Përpyekjet e ligjvënësve në lidhje me modifikimin e çështjeve themelore të së drejtës private, gjithnjë e më shumë ballafaqohen me limitet e një sistemi dhe të koncepteve të harxhuara. Kjo nuk zgjidh asgjë, por vetëm sa e thellon gjendjen e pakënaqshme, siç dëshmohet nga shumë probleme të vazhdueshme të interpretimit apo aplikimit në praktikë. Kjo veçanërisht ka të bëjë me vlerësimin e Kodit Civil të vitit 1964, i cili është në fuqi. Edhe përkundër përpjekjeve të shumta për "përmirësim" dhe "modernizim" të tij, ky kod nga ana e përmbajtjes, sidomos në aspektin sistematike dhe teknik, paraqet një sistem juridik jo të përsosur dhe jo të plotë, që nuk është në gjendje që plotësisht të kryej detyrat e një ligji me një rëndësi themelore. Për këtë arsye, në Kodin Civil i cili aktualisht është në fuqi, edhe sot e kësaj dite mungojnë psh: dispozitat të cilat kanë të bëjnë me trajtimin e "superficies solo cedit", instituti i së drejtës për të ndërtuar dhe relativisht i rreptë është rregullimi i të drejtave të veçanta. Ende aplikohen dispozitat me theks të veçantë në pavlefshmërinë relative të veprimeve ligjore, mungon masa e gjerë e mbrojtjes së palëve të dëmtuara nga kompensimi i dëmeve, nuk jemi përballur me institutet e

humbura apo të harruara të së drejtës trashëgimore, siç janë; legu, kontrata mbi trashëgiminë, testamenti i përbashkët bashkëshortor, testamentet e privileguara si dhe shumë çështje të tjera të rëndësishme.

2. Paralelisht me punët përgatitore për ri-kodifikimin e së drejtës private në Republikën Sllovake, ka vazhduar dhe vazhdon procesi i evropianizimit të së drejtës private. Në kuadër të marrëveshjes për Asocijim të nënshkruar ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës Sllovake, është krijuar një kornizë obligative për përafrimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian<sup>2</sup>. Në kuadër të së drejtës private, para së gjithash bëhet fjalë për ligjin për mbrojtjen e konsumatorit, ligjin për mbrojtjen e pronës intelektuale, ligjin për ndërmarrjet tregtare dhe ligji mbi konkurrencën ekonomike. Kursi i përafrimit dhe harmonizimit të së drejtës evropiane me kushtet specifike kombëtare të Sllovakisë karakterizohet nga veçoritë dhe modalitetet e shumta. Siç u përmend më herët, në Republikën Sllovake nuk është vendosur plotësisht për formën definitive të së drejtës private nga perspektiva e përgatitjeve të vazhdueshme për kodifikimin e ri kombëtar të kësaj të drejte. Përveç punëve në tejkalimin e legjislacionit të përkohshëm, në mënyrë intensive kërkohen zgjidhje të qëndrueshme dhe konkrete për një model optimal të integritetit të normave juridike të BE-së, të theksuara veçanërisht në direktivat e Bashkimit Evropian, në konceptin e një Kodi të ri Civil të Sllovakisë.

Zgjerimi i Bashkimit Evropian me 1 maj 2004 me 10 shtete të reja, përfshirë edhe Sllovakinë, ka krijuar një situatë të re ligjore në lidhje me evropianizimin. Në sfond të projekteve shkencore dhe juridike për të drejtën kontraktore, siç janë *Principles of European Contract Law (PECL)*, *Principles of European Tort Law (PETL)*, apo të modeleve në formim e sipër të së drejtës civile evropiane, për shembull *Draft Common Frame of Reference (DCFR)*<sup>3</sup>, apo edhe më gjerë, nismat që synojnë krijimin e një të drejte kontraktore të vetme, apo unifikimin e të

<sup>2</sup> Marrëveshja e Asociimit e mbyllur në mes të Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij në njërën anë dhe Republikës Sllovake në anën tjetër, është publikuar në Përmbledhjen e Ligjeve me numër 158/1997 sipas plotësive të fundit dhe Marrëveshja për aderim në Unionin Evropian është publikuar me numër 185/2004 PL.

<sup>3</sup> Për DCFR duhet të theksohet që paraqet rezultat të punës të gjithë rrjetës ndërkombëtare të akademikëve dhe si i tillë nuk paraqet dokument zyrtar, i cili do të mund të ishte ligj *da lege lata*.

drejtës detyrimore, apo projektet e reja për kodin e ri civil evropian, apo iniciativat për shembull: *Unidroit Principles of International Commercial Contracts (PICC)*, pastaj *Parimet e Acquis (Acquis Principles, ACQP<sup>4</sup>)* dhe të tjera të ngjashme. Lind pyetja; A është ky veprim i përgjegjshëm ndaj Evropës, që edhe më tej të vazhdojmë të përgatisim kodifikimin kombëtar të Kodit Civil të Republikës Sllovaqe? Me fjalë të tjera, a do të duhej të vazhdohej me aplikimin e mënyrës evolucionare të realizimit të ndryshimeve të pjesshme në legjislacionin themelor civil, duke përfshirë pranimin e direktivave të reja të Bashkimit Evropian? Kjo do të rezultonte në një situatë, ku në fund të një procedure të tillë, gradualisht do të krijohet një formë themelore e të drejtës civile sllovaqe e në kuadër të saj edhe versioni i ri i kodit të ri civil të Sllovakisë.

Duke komentuar këtë çështje, duhet të theksoj dy ide themelore: Së pari, korniza kohore për realizimin e kodifikimit në formatin e Kodit Civil Evropian, respektivisht të pjesëve të veçanta të tij (përfshirë të drejtën kontraktore), edhe përkundër përpjekjeve më të mira të mundshme, nga perspektiva e sotme, duket si vrapim në një shteg shumë të gjatë. Bëhet fjalë për një proces të gjatë dhe jashtëzakonisht të vështirë në aspektin konceptual dhe organizativ. Së dyti, edhe nëse ky proces do të përfundonte në një afat relativisht të shkurtër dhe me sukses dhe e drejta civile evropiane kontinentale do të unifikohej çdoherë e më shumë, nuk mund të ndërtojmë gjëra në atë mënyrë që kodet civile kombëtare do të pushojnë së aplikuar përnjëherë. Me ekzistencën e tyre llogaritet edhe në të ardhmen. Me më shumë gjasa do të ndodhë vetëm zëvendësimi gradual dhe i pjesshme i instituteve të së drejtës civile kombëtare me legjislacionin e unifikuar evropian.

Në Republikën Sllovaqe, si një anëtare relativisht e re e Bashkimit Evropian, kodifikimi i ri kombëtar i së drejtës private nuk është qëllim i tejkaluar apo i vjetruar. Përkundrazi kodifikimi është një mundësi e mirëpritur për të krijuar një kod të ri e modern të drejtës private i cili do të jetë në gjendje për të reflektuar dinamikën e ndryshimeve në komunitetin ekonomik dhe socio-politik të Evropës, duke përfshirë një kodifikim evropian të parashikuar dhe të përgatitur. Kjo nuk ka të bëjë asgjë më shumë dhe asgjë më pak se sa me krijimin e një kodi civil të

---

<sup>4</sup> Parimet *Acquis* nga *Aquis Group* janë aktualisht në fazën përfundimtare të shqyrtimit.

plotë, të qartë dhe në përputhje me standardet e Evropës Qendrore, të themeluar mbi bazat shkencore të një sistemi të përgjithshëm të së drejtës private. Një bazë e tillë edhe në të ardhmen do të pasqyronte një ndryshim të ardhshëm të sistemit në drejtim të integritetit të mëtejshëm të standardeve evropiane në ligjin e ri të konsoliduar të së drejtës private sllovaqe në krye me kodin e ri civil. Në këtë kontekst, kodifikimi i ri i së drejtës private, është pasuruar nga një tjetër rol i rëndësishëm, një dimension tjetër i pazëvendësueshëm.

Është e vërtetë se qasja e ligjvënësve sllovak për zbatimin e direktivave evropiane për mbrojtjen e konsumatorit dhe të pronës intelektuale, nuk ishte e unifikuar. Direktivat evropiane për të drejtat e konsumatorit janë zhvendosur ose në ligjin për mbrojtjen e konsumatorit, ose në Kodin Civil (Direktiva 93/13/EEC, nr. 94/47/EU, nr. 1999/44/EU dhe nr. 2004/48 /EU), ose në ligje të veçanta (p.sh. udhëzimi administrativ mbi përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga një produkt me të meta, nr. 85/374/EEC, është implementuar në ligjin nr. 294/1999). Një qasje e tillë jo e unifikuar e ligjvënësve, ka krijuar një sistem mjaft konfuz të normave të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, duke bërë që përfituesit nga këto norma, të orientohen më vështirë dhe duke e zvogëluar efikasitetin e veprimit të këtyre normave dhe aplikimin e tyre në praktikë.

Qëllimi i ligjvënësve për kodifikimin e së drejtës private paraqet një ndryshim fundamental në qasjen aktuale të ligjvënësve sllovak në zbatimin e direktivave evropiane në sistemin kombëtar juridik. Bazuar në përvojën e shteteve që kanë pasur të bëjnë me këtë çështje, të gjithë materien nga Ligji për mbrojtjen e konsumatorit e kanë përfshirë drejtpërsëdrejti në kodin e tyre civil (Gjermania, Holanda, Hungaria), edhe ligjvënësit sllovak do të veprojnë ashtu që në kodin themelor të së drejtës private, të zbatojnë materien e zgjeruar nga direktivat evropiane të së drejtës private, veçanërisht nga ligji për mbrojtjen e konsumatorit si palë më e dobët kontraktore. Me fjalë të tjera, standardet evropiane të cilat në direktivat për konsumatorin kanë natyrë të normave ligjore-publike, edhe më tej do të mbesin jashtë kornizës ligjore të kodit të ri civil. Gjithashtu dispozitat dedikuar çështjeve më pak të dalluara dhe në përgjithësi të çështjeve teknike, të cilat edhe pse përmbajnë karakteristika të së drejtës private, edhe më tej do të vazhdojnë të mbeten në si ligje të veçanta. I gjithë zbatimi i direktivave për të drejtat

e konsumatorit do të përfshihet në kodin e ri civil, në atë mënyrë që të reflektojë sa më shumë të jetë e mundur dinamikën e harmonizimit të ndryshimeve në këtë fushë, veçanërisht korniza referuese e cila paraqet draftin e direktivës së Parlamentit European dhe direktivës së Këshillit për të drejtat e konsumatorit, i cili sipas parimit të harmonizimit total, propozon unifikimin e të drejtave dhe përgjegjësiive të konsumatorit në kuadër të një tregu të vetëm të brendshëm të BE-së<sup>5</sup>.

Propozimi i ashtuquajtur horizontal i direktivave për konsumatorin, mbetet ende temë e diskutimit. Edhe pse fati i tij është mjaft i diskutueshëm, profesionistët i japin atij një rëndësi të veçantë, sepse bëhet fjalë për një hap tjetër të ndërmjetëm të krijimit të së drejtës kontraktore evropiane. Në këtë kontekst është e nevojshme të monitorohet edhe aktiviteti i organeve të Bashkimit Evropian në lidhje me krijimin e zgjidhjeve të harmonizuara në fushën e së drejtës kontraktore. Kështu për shembull, Këshilli i Bashkimit Evropian në kuadër të ashtuquajturit *Program i Stokholmit*, për periudhën funksionale 2010 – 2014, ka thirrur komisionin për të filluar punën në kornizën e përbashkët referuese. Raporti i Komisionit "Evropa 2020", KOM (2010) i datës 3 mars 2010, në përgjigje ndaj sfidës, përcakton qartë jo vetëm domosdoshmërinë për të krijuar zgjidhje të tilla, të harmonizuara në lidhje me kontratat e konsumatorëve, por edhe modele të dispozitave kontraktore të Bashkimit Evropian, gjithashtu edhe nevojën për të krijuar një të drejtë kontraktore, tani për tani të jo detyruese, me referencë të veçantë në hapësirën *on-line*. Me vendimin e Komisionit Evropian 2010/233/EU, të datës 26 prill 2010, është ngritur komisioni i ekspertëve në fushën e së drejtës kontraktore evropiane, i cili ka për detyrë krijimin e kornizës zyrtare referuese, qëllimi i së cilës është krijimi i një propozimi për të drejtën detyrimore evropiane (të drejtën kontraktore), i cili mund të ketë ambicie për t'u bërë ligj *de lege lata*. Grupi i ekspertëve ka prezantuar rezultatet e para të punës së tyre në maj të vitit 2011. Ajo konsiston në një studim që përfshin 189 nene mbi çështjen e së drejtës kontraktore, si dhe mundësinë e zbatimit të së drejtës detyrimore evropiane<sup>6</sup>.

---

<sup>5</sup> Shih KOM (2008) 614

<sup>6</sup> Shih; European Contract Law for consumers and businesses: Publication of the results of the feasibility study carried out by the Expert Group on European Contract Law for stakeholders and 'legal practitioners' Feedback, mund të gjindet në

Siç i kemi përmendur modelet e së drejtës civile evropiane të cilat janë duke u krijuar, të cilat specifikohen në burimet e shumta formale, ato krijojnë domosdoshmërinë objektive për të reflektuar mbi krijimin e dispozitave të veçanta dhe instituteve të Kodit të ri Civil të Republikës Sllovaqe, me përvoja dhe njohuri të një konteksti evropian. Shumë zgjidhje të përfshira në model projektet e unifikimit të së drejtës private (kompenzimi i dëmit, përfaqësimi, instituti i së drejtës kontraktore), do të gjejë shpjegimin e tyre juridik në dispozitat përkatëse të kodit të ri. Një qasje e tillë e ligjvënësve është në përputhje të plotë me Librin e Gjelbër të Komisionit Evropian i cili është publikuar në verën e vitit 2010, dhe i cili përcakton mundësitë e politikave të BE-së, të cilat kanë për qëllim krijimin e rregullave të së drejtës kontraktore të Bashkimi Evropian në lidhje me konsumatorët dhe ndërmarrjet *KOM (2010)*, 348<sup>7</sup>. Në këtë kontekst merret në konsideratë realizimi i një analize serioze krahasuese të modeleve të ligjeve në formë të DFCR, rregullave Acquis, apo studimit të zbatimit të së drejtës detyrimore evropiane, me propozim të pjesëve përkatëse të kodit të ri i cili do të siguronte një material të vlefshëm për veprimet e mëtutjeshme ri-kodifikuese.

3. Një nga rolet themelore të kodifikimit të së drejtës private është miratimin i zgjidhjeve të tilla konceptuale, të cilat në një perspektivë më të gjatë kohore do të bëheshin bazë e një sistemi optimal dhe stabil në raportet e së drejtës private, të cilat do të krijojnë një kornizë me perspektivë sistematike dhe të rregulluar të funksionimit të raporteve pronësore, personale, në kushtet e tanishme të tregut ekonomik dhe pluralizmit politik. Arsytimi dhe diskutimi profesional në këtë drejtim, mjaft dhe qartë anon kah trendët aktuale zhvillimore të vendeve evropiane dhe në konceptin e një kodi të së drejtës private, i cili integron jo vetëm marrëdhëniet themelore tradicionale, por gjithashtu rregullon edhe materien e marrëdhënieve të së drejtës kontraktore dhe të marrëdhënieve të cilat paraqiten në mes të ndërmarrësve (tregtarëve) dhe konsumatorëve. Bëhet fjalë për një koncept modern monistik, i cili është plotësisht i zbatueshëm jo vetëm në vendet fqinje në tranzicion (Republika Çeke, Hungaria, Polonia), por edhe në rastet e kodeve civile

<http://ec.europa.eu/justice/policies/consumer/docs/explanatory-note-results-feasibility-study-0-5-2011-en.pdf>

<sup>7</sup> Mund të gjindet në <http://eur-lex.europa.eu/lexuriserv/lexuriserv.do?uri=COM:2010:0348:FIN:CS:PDF>

të konceptuara në mënyrë të gjera dhe të integruar, sikur të Holandës, Rusisë, Italisë, Zvicrës dhe Kodi Civil i Kvebekut (Quebec). Është e vërtetë, që në kushtet sllovaqe, kemi të bëjmë me një qasje monistike e cila përfshin detyrimet e së drejtës civile dhe të ligjit për tregtinë në formën e një sistemit të unifikuar të kontratave, por modifikimi i përgatitur nuk përfshinë problematikën e ndërmarrjeve tregtare, ligjin për konkurrencën, ligjin për pronën intelektuale dhe të drejtën ndërkombëtare private.

Siç u përmend tashmë, Kodi Civil i Republikës Sllovaqe do të integroj, jo vetëm kontratat tregtare, por edhe të ashtuquajturat kontrata të lidhura me konsumatorët, të cilat në të vërtetë tregojnë natyrën e marrëveshjeve të njëanshme tregtare. Gjatë formulimit të sistemit të gjerë dhe të integruar të kontratave, do të jetë e domosdoshme të merret parasysh parimi i lirisë dhe autonomisë kontraktore dhe të aplikohet në marrëdhëniet juridike të modifikuara, në atë mënyrë, që në këto marrëdhënie nuk do të krijoj disbalanc të pakëndshëm mbi shkallën e lejuar të drejtave dhe detyrimeve të palëve kontraktuese, në formë të ekzistencës apo pranimit të dispozitave të padrejta në kontratat e konsumatorëve. Në të kundërtën, në fushën e marrëdhënieve kontraktore midis tregtarëve (ndërmarrësve), do të bëhet fjalë për një raport profesional, duke i njohur kushtet e tregut dhe konkurrencën, ku ndërhyrja në formën e integritetit të legjislacionit do të kishin karakter të zgjidhjes, kurse aspekti social në parim do të tërhiqet gradualisht nga parimet klasike të së drejtës private, ku është autonomia e lirë e subjekteve dhe në kuadër të saj aplikohet liria kontraktore.

Në përmbyllje, vlen të potencohet, që katalogu i detyrave të evropianizimit dhe kodifikimit të së drejtës private është i gjerë. Kërkesat kryesore nga Republika Sllovaqe në bazë të kushteve të këtij shteti si shtet anëtar i BE-së, në veçanti janë:

- a) kërkesa për heqjen e legjislacionit të përkohshëm të sistemit themelor të së drejtës private, në atë mënyrë që pas kodifikimit, e drejta civile të marrë pozitën e të drejtës së përgjithshme private në sistemin legjislativ të Republikës Sllovaqe. Do të thotë pozitën të cilën aktualisht nuk e disponon për shkak të legjislacionit të përkohshëm në fuqi.



- b) kërkesa për krijimin e një marrëveshjeje të përshtatshme sistematike të kodit i cili është në përgatitje e sipër, i cili në perspektivë kohore do të mundësonte integrim sa më të gjerë të mundshëm të së drejtës civile evropiane, sidomos integrimin e direktivave evropiane që synojnë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të drejtën kontraktore evropiane.
- c) kërkesa për krijimin e një sistemi plotësisht të ri të integruar të rregullimit të raporteve themelore dhe instituteve të cilat bëjnë pjesë brenda fushës së drejtës private.

Përfundimi i suksesshëm i punëve në hartimin e kodit të ri civil, i cili pritet t'i dorëzohet qeverisë dhe pastaj të diskutohet në parlament në vitin 2014, do të kërkojë përpjekje edhe më të mëdha. Qëllimi është ambicioz, sepse kodi i ri i së drejtës private do të duhej të ishte kombëtar, por me dimensione sociale të qarta evropiane. Prandaj, ky kod duhet të ketë një shkallë të lartë të pajtueshmërisë me kodin tradicional civil të ashtuquajturave shtetet të vjetra anëtare të BE-së, si dhe me traditat e vendeve fqinje të Evropës Qendrore, gjegjësisht të vendeve me një nivel të krahasueshëm të kulturës juridike, ekonomike apo orientimit socio-politik.



Ján Cirák<sup>8</sup>

## Codification and Europeanization of Private Law in the Slovak Republic

### *Summary*

The article deals with the codification and Europeanization of private law in the context of recent developments in legislation of the Slovak Republic. Both processes of private law, codification and Europeanization are closely interrelated. In connection with the development of private law, special requirements have been analyzed in order to draft a new Civil Code. Further, the article treats the need for termination of temporary legislation related to private law and the needs to achieve a higher level of harmonization of private law of the Slovak Republic with the legislation of European Union and finally analyzes basic concepts of creating a new, modern and possibly an optimal concept for regulation of basic relations and institutions of private law.

For several years it has been a top interest of Slovak civil law, to create a new civil code. The task of creating a new civil code was and remains an urgent need. For this reason, almost all governments since 1990 have paid attention to this issue. At the beginning this was a task for the government of Czechoslovakia, and from 1.1.1993 it is a task for the government of the Slovak Republic, respectively Czech Republic. After several unsuccessful attempts, it can be said that the actual process of codification has entered in an advanced stage. On 14.1.2009, the Government approved the "Intention of the legislature to codify private law" and this step opened a new phase of work on drafting the articles. According to the schedule of legislative commission for re-codification, the final version of the new draft code is expected to be done in 2014.

The need for a new codification of private law in Slovak Republic (in Czech Republic) existed for many years. As a result of social and political changes in 1991, numerous amendments to the 1964 Civil Code were adopted under the pressure of time and a new Commercial Code has been adopted. Such

---

<sup>8</sup> Dr. Ján Cirák, graduated lawyer and Associate Professor, Faculty of Law of the Paneuropean College in Bratislava, e-mail: jimmy.cirak@gmail.com.

legislation, created in a time pressure and very short period of time, was considered to be temporary since its beginning.

Civil Code no. 40/1964 which is actually in force, during its history so far has been amended over 40 times. The majority of modifications were approved in the past two decades, so the Civil Code would best fit the needs of the market economy. The legislation *De lege lata* as a result of such an approach suffers from fragmentation, uncertainty and incompleteness, but it is not possible to reach a solution through making partial changes and amendments to the code. This does not solve anything, but it only deepens the dissatisfaction, as evidenced by the many ongoing problems of interpretation or application of law in practice. Despite numerous attempts to "upgrade" and "modernize" the code, in terms of content, especially in systematic and technical terms, is not a perfect and complete legal system and is not able to fully perform the duties of a law with a fundamental importance.

In parallel with re-codification of private law in the Slovak Republic, continues the process of Europeanization of private law. The Agreement for Association signed between the European Community and the Slovak Republic, created a binding framework for aligning national legislation with EU legislation. The process of approximation and harmonization of European law with specific national conditions of Slovakia is characterized by multiple modalities. Beside the works to overcome the temporary legislation, long lasting solutions required for an optimal model of integration of the legal EU norms, particularly stated in the directives of European Union, are being intensively searched to be incorporated into the concept of a new Civil Code of Slovak Republic.

A question arises: Is it a responsible action towards Europe, if we continue to prepare national codification of the Civil Code of the Slovak Republic? In other words, shall we continue with the application of evolutionary mode of realization of partial changes in the civil legislation, including new directives of the European Union?

Commenting on this issue, I should emphasize two fundamental questions: First, the timeframe for implementation of the encoding format of the European Civil Code, respectively of its individual parts (including contractual rights), despite the best possible efforts and viewed from today's

perspective, looks like running in a very long path. Process will result as a long and extremely difficult. Second, even if this process would be successfully completed in a relatively short term, we cannot build things in a way that national civil codes will disappear at once. More likely, only gradual and partial substitution of institutes of national civil rights with European legislation will happen.

The purpose of the lawmakers to codify private law represents a fundamental change in the current approach of the Slovak lawmakers in implementing European directives into national legal system.

In conclusion, it should be pointed out that a list of tasks for Europeanization and codification of private law is quite long. The main requirements demanded from Slovak Republic as a member of the EU, in particular are:

- a) The request for removal of temporary legislation underlying system of private law, so that after codification, civil law would take the position of the general private law in the legislative system of the Slovak Republic. The position that currently is not available due to temporary legislation in force.
- b) requirements for making a proper systematic arrangement of code that is being drafted, which in time perspective will enable broader integration of European civil law, especially the integration of European directives aimed to protect consumers and European contractual law.
- c) requirements for establishment of a new fully integrated system for regulation of basic relations and institutions which belong to private law.

The successful completion of works on designing the new civil code, that will be submitted to the government and then will be discussed in the parliament in 2014, will require a lot of efforts. The goal is ambitious, because the new code of private law should be national, but with clear European social dimensions. Therefore, this code must have a high degree

of compatibility with traditional civil code of the so-called old member states of the EU, and the traditions of neighboring Central European countries, therefore the countries with a comparable level of legal culture, economic or socio-political orientation.

Dr. sc. Rrustem QEHAJA, prof. ass.<sup>1</sup>

## **Arbitrazhi - mënyrë e zgjidhjes së kontesteve nga polica e sigurimit**

### **1. Shqyrtime hyrëse**

Industria e sigurimeve në Republikën e Kosovës aktualisht është e mbuluar me 10 sigures, përkatësisht kompani të sigurimeve të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe ofrojnë shërbimet e tyre policmbajtësve për të cilën janë të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (tani e tutje BQK) në pajtim me dispozitat ligjore.

Veprimtaria parësore e siguresve është shitja e policave, përkatësisht ofrimi i shërbimeve të sigurimit për produktet e ndryshme të sigurimit, të cilat sipas një ndarje në “*vija të trasha*” mund të klasifikohen në sigurime të detyruara dhe në sigurime vullnetare ose në:

1. Sigurimi i personave;
2. Sigurimi i garancive;
3. Sigurimi i pasurisë;
4. Sigurimi i përgjegjësisë; dhe
5. Sigurimi i automjeteve.

Krahas këtyre ndarjeve, për secilën klasë të sigurimit ekzistojnë produkte të sigurimit të veçantë, kështu p.sh. në kuadër të sigurimit të automjeteve përfshihen:

1. Sigurimi i detyrueshëm nga autopërgjegjësia për dëmin e shkaktuar palës së tretë<sup>2</sup> – TPL<sup>3</sup>;

---

<sup>1</sup> Autori është mësimdhënës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës për lëndët mësimore: Arbitrazhi, E Drejta Procedurale Civile dhe E Drejta e Sigurimeve.

<sup>2</sup> Sipas Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ( LSDAP) të datës 23.06.2011 me pale të tretë nënkuptohet “personi me të drejtë kompensimi sipas

2. Sigurimi TPL Plus që mbulon poseduesin e mjetit motorik<sup>4</sup> kur ai/ajo gjendet jashtë Kosovës për shtetet me të cilat ekziston marrëveshja e ndërsjellë; dhe
3. Sigurimi Kasko i cili mund të jetë i plotë dhe i pjesshëm.

Kompanitë e sigurimeve të cilat janë të licencuara si degë në Kosovë apo që veprojnë vetëm në Kosovë krahas licencës së përgjithshme të cilën duhet të marrin nga BQK-ja janë të detyruara që për çdo produkt të cilin e ofrojnë paraprakisht të aplikojnë në BQK për t'u pajisur me licencë përkatëse nëse i plotësojnë kushtet e parashikuara me dispozita ligjore.<sup>5</sup>

Gama e produkteve për të cilat kompanitë e sigurimeve në Kosovë mund të pajisen me licencë përkatëse është e gjerë dhe ajo përcaktohet me Rregullin 2 të BQK-së.<sup>6</sup>

Kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që veprimtarinë e tyre të sigurimeve të ushtrojnë në pajtim me Rregullat e BQK-së të cilat i dedikohen sigurimeve, si dhe me ligjet e tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Ushtrimi i veprimtarisë së sigurimeve është i ndërlidhur me lidhjen e marrëdhënies kontraktuese në mes të siguruesit dhe të siguruarit përmes shitjes së polices së sigurimit për produktin e caktuar të sigurimit.

---

dispozitave të këtij ligji, të cilit i është shkaktuar dëmi apo lëndimi nga mjeti motorik”, për më shumë shih: Neni 2 pika 1.8 të LSDAP.

<sup>3</sup> TPL ka kuptimin e Third Persons Liability.

<sup>4</sup> Shih: LSDAP neni 2 pika 1.7 I cili përmban: “Posedues I mjetit motorik konsiderohet personi fizik apo juridik I cili, me autorizimin e pronarit, e ka në posedim apo përdorim mjetin motorik”.

<sup>5</sup> Çështja e licencimit të Kompanive të sigurimeve në Republikën e Kosovës është e rregulluar me Rregulloren nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit e të Ndërmjetësuesve të Sigurimit të datës 05.10.2001 dhe Rregullin 4 mbi Ndryshimin e Rregullës për Licencimin e Kompanive të Sigurimit të Përgjithshëm dhe të Sigurimit të Jetës miratuar nga Këshilli Drejtues i ish AQBK (Autoriteti Qendror Bankar I Kosovës) tani BQK (Banka Qendrore e Kosovës) në mbledhjen e mbajtur më datë 23.06.2005.

<sup>6</sup> Shih: Rregullin 2 të ABPK në ndryshimin e Rregullit mbi Klasët e Sigurimit të Përgjithshëm të Njohura nga BPK-ja të miratuar nga Bordi Udhëheqës I Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2002 që ka hyr në fuqi më 01.04.2002.



Shitja e policave të sigurimit aktualisht realizohet në mënyrë fizike në mes të siguruesit dhe të siguruarit, ndonëse BQK-ja për produktin e sigurimit TPL është paraparë edhe shitja “on-line” përmes internetit,<sup>7</sup> por deri më tani të paktën Rregullorja e tillë ende nuk është zbatuar në praktikë.

Shitja e policave të sigurimit nga siguruesit në vete ngërthen blerjen e rrezikut që nënkupton përgjegjësinë e këtyre të fundit për shpërblimin e dëmit nëse ndodhë “*rasti i siguruar*”<sup>8</sup> që paraqet një ngjarje të ardhshme dhe të pasigurt, e që në të shumtën e rasteve nuk varet nga palët kontraktuese përkatësisht nga siguruesi dhe i siguruari.

Pikërisht paraqitja e “*rastit të siguruar*” hap një “*kapitull*” të ri dhe jo rrallë herë të vështirë në mes të palëve, përkatësisht në mes të dëmtuarit dhe siguruesit në cilësi të dëmtuesit i cili është përgjegjës për shpërblimin e dëmit.

Lidhja e situatave të tilla krijon “*Kontest*”<sup>9</sup> përkatësisht “*Proces kontestimor*” në mes të palëve, i cili kërkon trajtim të veçantë dhe në praktikë mund të zgjidhet në rrugë jashtëgjyqësore ose në rrugë gjyqësore.

Lidhur me këtë, dispozitat ligjore të ligjit në fuqi<sup>10</sup> kanë paraparë afate dhe atë për dëmet në persona siguruesi është i detyruar që më së largu në afat prej gjashtëdhjetë ditësh, ndërsa për dëme në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse ose me vendimin dhe arsyet

<sup>7</sup> Shih: Rregullin 29 të ABPK mbi Shitjen e Sigurimeve Përmes Internetit të miratuar nga Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2002 që ka hyr në fuqi më 01.04.2002.

<sup>8</sup> Shih: LSDAP Neni 2 pika 1.10 I cili lidhur me përkufizimin e rastit të siguruar përmban: “Rasti i siguruar ka kuptimin e një ngjarje e cila kur të ndodhë, rezulton me të drejtën për kompensim për dëmin e shkaktuar nga mjete motorik”

Apo sipas disa autorëve “Rasti i siguruar është ngjarje e paparaparë e ardhshme, e pasigurt dhe e pavarur nga vullneti i kontraktuesve” Nërzhivane Dauti “E drejta e detyrimeve pjesa e përgjithshme dhe veçantë” Prishtinë 2004 fq. 425 etj.

<sup>9</sup> Kontesti dhe procesi kontestimor janë dy nocione të ndryshme, i pari ka të bëjë me gjendjen e krijuar në raportin material juridik, kurse nocioni i dytë ka të bëjë me procedurën gjyqësore me të cilën gjendja e tillë zgjidhet. Për më shumë shih: Faik Brestovci “E drejta procedurale civile” Prishtinë 2004.

<sup>10</sup> Mendohet në LSDAP nr.04/L-018

ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmit.<sup>11</sup>

Palët e dëmtuara zakonisht në fillim preferojnë të zgjedhin rrugën jashtëgjyqësore për realizimin e të drejtës në dëmshpërblim, por nuk janë të rralla as rastet kur palët e zhgënjyera nga pritja e gjatë dhe ofertat joserioze të disa siguruesve i drejtohen gjykatës për realizimin e të drejtës së tyre në rrugë gjyqësore.

Lidhur me këtë në praktikën e përgjithshme me qëllim të realizimit sa më efikas të së drejtës së dëmshpërblimit preferohet edhe arbitrazhi si formë e zgjidhjes së kontesteve nga polica e sigurimit në drejtim të realizimit të së drejtës së shpërblimit të dëmit të cilit do i referohemi në vazhdim.

## 2. Kuptimi dhe funksionimi i arbitrazhit

Lidhur me kuptimin e arbitrazhit, në teori mund të gjenden përkufizime të ndryshme, varësisht nga këndvështrimi dhe qasja që i bëhet këtij nocioni.<sup>12</sup>

Kështu, me arbitrazh nënkuptohet një “trup” i përberë nga një e më shumë persona – arbitër me përzgjedhjen e te cilëve palët paraprakisht kanë rënë në ujdi që të njëjtit të vendosin në mënyrë meritore dhe vendimi i tillë të këtë karakter përmbarimor.<sup>13</sup>

Në përgjithësi, rregullimi juridik i arbitrazhit mund të gjendet në burimet e brendshme dhe të jashtme.<sup>14</sup>

---

<sup>11</sup> LSDAP Neni 26.1.

<sup>12</sup> Kështu me Ligjin e Procedurës Kontestimore GZ e RSFJ-së nr. 4/77 nuk ka përdorur shprehjen “arbitrazh”, por “gjykatë e zgjedhur” e cila shprehje është ndikuar nga e drejta gjermane. Arbitrazha apo “gjykata e zgjedhur” është konsideruar si një gjykatë që palët japin besimin që në vend të gjykatës shtetërore në mënyrë autoritative të zgjidhin një apo më shumë mosmarrëveshje. Lidhur me këtë për më shumë shih: Poznic.B. “Gradjansko procesno pravo” Bgd. 1986 fq. 402-403.

Shprehjen “gjykatë e zgjedhur” në vend të shprehjes “arbitrazh” e ka ruajtur edhe Ligji i procedurës kontestimore të IRJ të Maqedonisë shih: “Sluzbeni vesnik na RM”, nr. 33/98, 22/2002, Kreu XXX Nenet 438-459.

<sup>13</sup> F. Brestovci vep. e cit. fq. 146

<sup>14</sup> Shih: Protokolli i Gjenevës për klauzolat e arbitrazhit 1923, Konventa e Gjenevës për përmbarimin e vendimeve të arbitrazhit 1927, Konventa e New Yorkut për njohjen dhe përmbarimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit 1958, Konventa evropiane për arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare 1961, Konventa e Washington-it për zgjidhjen e

Te ne, kuptimin e arbitrazhit mund ta gjejmë në disa burime, përfshirë:

1. Rregullin 28 të BPK-së tani BQK-së mbi Themelimin e një Forumi të Arbitrazhit për t'i Zgjidhur Kundërshtimet mbi dëmet të datës 01.04.2002;
2. Ligjin për arbitrazhin nr. 02/L-75 të datës 26.01.2007;
3. Rregullin 10 i BQK-së mbi Ndryshimin e Rregullës Mbi Themelimin e Forumit të Arbitrazhit i cili ka hyr në fuqi me datë 29.07.2008;
4. Rregullat e arbitrazhit të OEK<sup>15</sup>;
5. Rregullat e arbitrazhit të OEA<sup>16</sup>.

Me këtë rast është me rëndësi të theksohet se asnjëri nga burimet e lartpërmendura nuk përmban një përkufizim identik lidhur me përkufizimin e nocionit të arbitrazhit.

Sipas Rregullit 28, arbitrazhi përkufizohet kështu: *”Arbitrazhi është proces i zgjidhjes së kundërshtimeve, jashtë procesit juridik, që është dizajnuar të sigurojë rezolutë të shpejtë dhe të lirë të çështjeve që janë të kundërshtueshme në mes të dy apo më shumë palëve”*.

Nga përmbajtja e këtij përkufizimi rezultojnë paqartësi dhe kundërthënie lidhur me shprehjet e përdorura, por duke pasur parasysh se e njëjta Rregull tani më nuk është e zbatuar për më shumë nuk do të ndalemi lidhur me këtë gjë.

Sipas Ligjit për Arbitrazhin, arbitrazhi nuk definohet, por në përmbajtje të tij gjejmë shprehjen “Marrëveshja e Arbitrazhit” e cila përkufizohet kështu: *“Marrëveshja e Arbitrazhit nënkupton marrëveshjen e arritur ndërmjet dy ose më shumë personave, që disa ose të gjitha kontestet juridike, të cilat kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet tyre, do t'i nënshtrohen arbitrazhit”*.

---

mosmarrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me investimet në mes të shteteve dhe qytetarëve të shteteve tjera 1965 etj.

<sup>15</sup> Kjo Rregull ka hyr në fuqi më 24.06.2011

<sup>16</sup> Kjo Rregull ka hyr në fuqi më 01.07.2011

Nga përmbajta e këtij përkufizimi vërejmë një përkufizim të përgjithësuar të arbitrazhit si një nga format e zgjidhjes së kontesteve në mes të palëve në rrugë jashtëgjyqësore, por edhe mundësin që palët kontraktuese me rastin e lidhjes së marrëdhënieve të tyre kontraktuese të parashikojnë në të ardhmen zgjidhjen e kontesteve eventuale përmes arbitrazhit.

Sipas Rregullit 10 mbi Ndryshimin e Rregullës Mbi Themelimin e Forumit të Arbitrazhit, shprehja arbitrazh definohet kështu: *“Arbitrazhi nënkupton procedurën e zgjidhjes së kontesteve në të cilin një palë e tretë neutrale (arbitri) nxjerrë një vendim pas shqyrtimit, në të cilën të dyja palët e kanë mundësinë të dëgjohen”*.

Vështuar përmbajtjen e këtij përkufizimi rezulton se i njëjti është domethënës dhe problemi i vetëm qëndron në jetësimin e tij në praktikë duke pasur parasysh se edhe sot e kësaj dite kjo Rregull fatkeqësisht ka mbetur vetëm në letër.

Krahasuar numrin e kërkesave për dëme të shkaktuara nga mbulesa e sigurimit, numrin e tyre të paraqitur në rrugë jashtëgjyqësore dhe numrin e padive të kësaj natyre të paraqitura në rrugë gjyqësore, rezulton në nevojën imediate të fillimit sa më parë të zbatimit të këtij Rregulli.<sup>17</sup>

### 3. Procedura e trajtimit të dëmit

Kompetenca dhe juridiksioni i Tribunalit (Panel, Forum etj.) të arbitrazhit shtrihet edhe për rastet e shkaktimit të dëmeve të cilat mbulohen me police të sigurimit.

Përmes arbitrazhit mund të zgjidhen të gjitha çështjet të cilat janë të lidhura me detyrimin nga një police, shtrirja e një humbje apo dëmi dhe çështjeve tjera të lidhura me kushtet e kontratës së sigurimit (polices).

Me qëllim të zbatimit të këtij Rregulli, është e nevojshme që sa më parë të përgatitet lista e arbitrave në pajtim me nenin 5 të Rregullit 10 që bie në

---

<sup>17</sup> Sipas disa të dhënave statistikore të BQK-së për periudhën janar-tetor 2011 primet e shkruara bruto kanë qenë 61.970.219 € ndërsa krahasuar këtë me periudhën e njëjtë të vitit 2010 primet e shkruara bruto kanë qenë 66.517.664 € përderisa dëmet e paguara për periudhën janar – tetor 2010 kanë qenë në shumën 22.430.656 € ndërsa për periudhën e njëjtë të vitit 2011 kanë qenë në shumën 21.239.838 €

barrë të Siguruesve të licencuar, degëve të siguruesve të jashtëm dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve të cilët duhet të themelojnë Forumin e arbitrazhit.

Është në kompetencë të Forumit të arbitrazhit t'i dorëzoj listën e personave BQK-së, përkatësisht listën e kandidatëve potencial të cilët mund të zgjidhen arbitër numri i të cilëve parashihet të jetë deri në pesëmbëdhjetë.

Vështruar preferencat të cilat duhet t'i këtë një arbitër rezulton se personat e tillë duhet të jenë individ me integritet të lartë, të ndershëm dhe të kenë njohuri adekuate dhe të jenë kompetent të gjykojnë çështjet të cilat lidhen me sigurime.

Nga kjo rezulton se duhet menduar në kategorinë e personave të cilët i plotësojnë kushtet për ushtrimin e profesionit të avokatit apo gjyqtarit madje nga praktika e shikimit të listës së arbitrave të Odës ekonomike ndërkombëtare në Paris e cila në përbërje të saj ka 25 emra rezulton se nga ta 6 veta janë profesor të fakulteteve juridike. Ndonëse kjo praktikë është ndjekur për arbitrazhet që vendosin lidhur me çështjet e natyrës ekonomike-tregtare konsiderojmë se kjo praktikë e përbërjes së listës së arbitrave edhe për lëmin e sigurimeve do të ishte e pranuar të zbatohet në praktikë pa anashkaluar edhe profesionistët e tjerë me përvojë të gjatë në industrinë e sigurimeve.

Me Rregullin 10 të lartpërmendur parashihet që pala e dëmtuar e cila ka mbulesë të sigurimit, realizimin e të drejtës në dëmshpërblim mund të realizoj përmes rrugës së arbitrazhit dhe atë duke zgjedhur një nga pesëmbëdhjetë anëtarët që parashihet të gjenden në listën e arbitrave, ndërsa një mundësi e tillë i është lënë edhe siguruesit përgjegjës për dëmshpërblim mbi bazën e sigurimit nga polica e sigurimit dhe në fund parashihet që dy arbitrit e zgjedhur të zgjedhin arbitrin e tretë nga po ajo listë e të pesëmbëdhjetëve i cili njëkohësisht është edhe kryetar dhe kështu të formohet paneli i arbitrazhit për të vendosur për çështjen konkrete.

Nga kjo rregull ka përjashtime kur është në pyetje vlera e dëmit deri në 1.000 €sepse në raste të tilla vendos një arbitër i vetëm dhe përzgjedhja e tij bëhet nga BQK-ja.

Lidhur me mundësinë e përjashtimit të arbitrit të caktuar nga paneli i arbitrazhit vlejné rregullat e njëjta të cilat vlejné për përjashtimin e gjyqtarit në procedurën kontestimore.<sup>18</sup>

Me rëndësi të veçantë është momenti se kur pala e dëmtuar ka të drejtë t'i drejtohet BQK-së përkatësisht arbitrit apo Panelit të arbitrazhit për të kërkuar zgjidhjen e kontestit për shpërblim të dëmit nga mbulesa siguruese.

Këtë gjë ligdhënësi e ka rregulluar në atë mënyrë duke konsideruar të parakohshme çdo kërkesë-padi para se e njëjta të jetë shqyrtuar nga Kompania e sigurimeve përgjegjëse për shpërblimin e dëmit.<sup>19</sup> Kjo nënkupton se çdo kërkesë-padi drejtuar BQK-së përkatësisht panelit të arbitrazhit për vendosje pa u shteruar të gjitha mjetet juridike brenda një Kompanie të sigurimit nga Arbitrazhi do të konsiderohet e parakohshme dhe si e tillë do të hedhet poshtë si e parakohshme pa hyrë fare në shqyrtimin e saj.

Mbajtja e seancave të arbitrazhit kërkojnë së paku dhjetë ditë njoftim paraprak, për palët përveç nëse për një njoftim të tillë është hequr dorë sipas nënshkrimit të palës së cilës i është dedikuar njoftimi.

Konsiderojmë se lidhur me dërgimin e shkresave palëve përfshirë edhe mënyrën e tyre do të duhej të gjejné zbatim dispozitat e LPK-së të cilat e rregullojnë këtë çështje në Kreun VII të tij.

Fryti i mbajtjes së një apo më shumë seancave është marrja e vendimit në periudhën e caktuar me ligj që nënkupton se Vendimi i marrë nga arbitrat është detyrues, ka fuqinë e titullit përmbarues dhe as kompania e sigurimit e as pala pretenduese (paditësi) nuk mund të ankohen në gjykatë ose në ndonjë panel tjetër të arbitrazhit apo të inicioj kontest për të njëjtën çështje dhe për përmbarimin e tij është kompetent gjykata.

Mirëpo, nga kjo rregull është paraparë një përjashtim që ka të bëjë me mundësinë që palët e pakënaqura përfshirë siguruesin dhe përfituesin e

---

<sup>18</sup> Shih: Ligji i procedurës kontestimore (LPK) Ligji Nr. 03/L-006 datë 30 qershor 2008 I cili është në zbatim prej datës 06.10.2008, Kreu III Neni 67-72.

<sup>19</sup> Kjo çështje është e rregulluar edhe me dispozitat e LSDAP Neni 25 i cili përmban "I dëmtuari ka të drejtë që kërkesën për dëmshpërblim nga baza e sigurimit të autopërgjegjësisë t'ia parashtrijë drejtpërdrejt siguruesit përgjegjës..."

polices së sigurimit që kanë të drejtë të ushtrojnë padi në gjykatën kompetente për anulimin e vendimit të arbitrazhit jo më vonë se 90 ditë pas pranimit të vendimit të tribunalit të arbitrazhit dhe atë nëse:

a. Paditësi dëshmon se:

- njëra nga palët në marrëveshjen e arbitrazhit nuk ka pasur zotësinë për të vepruar;
- marrëveshja e arbitrazhit nuk është e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët ose nga tribunali i arbitrazhit ose, në mungesë të një caktimi të tillë, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë;
- paditësi nuk është njoftuar me rregull në lidhje me emërimin e një arbitri ose mbi procedurën e arbitrazhit, ose për arsye tjera nuk ka qenë në gjendje të paraqes rastin e tij;
- vendimi nuk ka të bëjë me çështjen e shqyrtuar nga tribunali i arbitrazhit ose ka të bëjë me një çështje për të cilën nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit, ose vendimi përfshinë çështje për të cilat nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit. Në këto raste, nëse vendimi mbi çështjet për të cilat është kompetent tribunali i arbitrazhit mund të ndahet nga çështjet tjera, atëherë kjo pjesë e vendimit mund të ekzekutohet.
- përbërja e tribunalit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose me marrëveshjen e arbitrazhit, me kusht që mangësia e tillë të këtë pasur ndikim në vendimin e tribunalit ose

b. Gjykata konstaton se:

- arbitrazhi në fjalë është i ndaluar me ligj ose
- ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do ishte në kundërshtim me rendin publik.

Është rregull e përgjithshme që kur kërkohet anulimi i vendimit të tribunalit të arbitrazhit, Gjykata mundet, nëse kjo është e arsyeshme, të anuloj

vendimin dhe t'ia kthej lëndën tribunalit të arbitrazhit që ta iniciojë serish procedurën e arbitrazhit ose që t'i merr ato veprime, të cilat sipas vlerësimit të tribunalit të arbitrazhit do të mënjanojnë arsyet për anulimin e vendimit.

Është shumë e logjikshme që çdo procedurë në vete përcillet me shpenzime të caktuara të cilat shpenzime duhet të mbulohen nga dikush.

Kjo çështje është e rregulluar me Rregullin 10, ku theksohet se:

- Shpenzimet rreth funksionimit të zyrës së arbitrazhit duke përfshirë, shpenzimet administrative, shpenzimet për vendin, furnizimet dhe materialet si dhe shpenzimet tjera të arsyeshme dhe të nevojshme për arbitrazhin do të paguhen nga kompanitë e sigurimit.

- Kurse shpenzimet rreth procedurës së zhvilluar në kontestin konkret duke përfshirë mëditjet e arbitrave, shpenzimet për ekspert, si dhe shpenzimet tjera të nevojshme për arbitrazh dhe rreth procedurës së arbitrit do t'i bartë pala që humb kontestin.<sup>20</sup>

- Me qëllim të kryerjes sa më të suksesshme të procedurës së gjithëmbarshme dhe varësisht nga ajo sa e ndërlikuar është çështja kontestuese, nga palët duhet të kërkohej të bëjnë deponimin e një shume parash në emër të shpenzimeve siç e përcakton Rregullorja e punës së Arbitrazhit.

- Po qe se pala nuk e deponon shumën e parave nga pika paraprake në afatin prej 15 ditësh, atëherë konsiderohet se ka tërhequr kërkesën për arbitrim.

---

<sup>20</sup> Nga praktika e vendeve të rajonit rezulton e drejta e arbitrave në kompensimin e shpenzimeve si dhe shpërblimin për punën e bërë shih: dispozitat ligjore lidhur me këtë të Kroacisë dhe Malit të Zi derisa disa vende të tjera këtë çështje nuk e rregullojnë në mënyrë të veçantë. Derisa sipas dispozitave gjegjëse të Malit të Zi dhe Kroacisë parashihet që palët në mënyrë solidare përgjigjen për pagesën e shpenzimeve dhe shpërblimit të arbitrave, për derisa ligji kroat lejon edhe mundësin që arbitri vetë të cakton shumën e shpërblimit për punën e bërë me kusht që vendimi I tillë nuk detyron palët nëse ato nuk pajtohen me të. Kur ndodhë një rast I ngjashëm kontestin lidhur me lartësinë e shpërblimit e përcakton organi I cili ka emëruar arbitrit nëse një gjë të tillë e kanë përcaktuar palët në marrëveshjen e tyre të arbitrazhit, përkatësisht gjykata kompetente sipas propozimit të arbitrit apo palëve nëse paraprakisht nuk ka pasur marrëveshje lidhur me këtë çështje. Për më shumë shih: Jovic. K. Arbitrazno pravo drzava u region zapadnog balkana Institut za uporedno pravo Bgd.



Lidhur me përmbajtjen e kësaj pjese të lartpërmendur konsiderojmë se është e padrejtë t'i vendoset një barrë e barabartë të gjitha kompanive të sigurimit lidhur me mbulimi e shpenzimeve për faktin se aktualisht nga 10 kompani të sigurimeve të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në Kosovë përqindja e tyre në blerjen e rrezikut përkatësisht pjesëmarrja në tregun e sigurimeve është e ndryshme,<sup>21</sup> andaj do të ishte e rrugës që varësisht nga pjesëmarrja në treg të detyrohen Kompanitë e sigurimit të marrin pjesë edhe në shpenzimet administrative e të tjera të arbitrazhit.

Lidhur me shpenzimet procedurale është çështje parimore që pala e cila humb kontestin të mbuloj shpenzimet, por konsiderojmë se duhet pasur parasysh edhe situatat e tilla kur pala pjesërisht ka sukses në realizimin e të drejtës të cilën pretendon se i takon, andaj në raste të tilla konsiderojmë se duhet të gjejnë zbatim dispozitat e Kreut të XXV të LPK-së lidhur me shpenzimet procedurale.

Një çështje mjaftë e ndjeshme është edhe përmbarimi - ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit sepse fundja e gjithë *“lufta”* bëhet me qëllim të jetësimit të vendimit përkatës. Kompetente për përmbarimin - ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit lidhur me policat e sigurimit është BQK-ja dhe gjykata pasi që i njëjti të shpallet i ekzekutueshëm, deri në themelimin dhe funksionalizim e një Agjensionit të specializuar që do të merret me përmbarime - ekzekutime.

#### 4. Përfundim

Bazuar në atë se aktualisht në tregun e sigurimeve në Republikën e Kosovës afarizmin e tyre e ushtrojnë dhjetë (10) kompani të sigurimeve të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) në njërën anë, dhe në anën tjetër duke pasur parasysh numrin në rritje gjithnjë e më shumë të kërkesave për shpërblim të dëmit material dhe jo material nga palët e dëmtuara në cilësi të *“palës së tretë”*, lind nevojën e gjetjes së një mënyre apo rruge për zgjidhjen e kontesteve për shpërblimin e dëmit që buron nga mbulesa siguroese në mënyrë sa më efikase.

---

<sup>21</sup> Sipas disa të dhënave statistikore të BQK-së deri në tetor 2011 pjesëmarrja e Kompanive të sigurimeve në tregun e sigurimeve sipas përqindjes radhitet kështu: KS “Illyria” 22.94 %, KS “Sigal Uniqa” 12.88%, KS “Sigma” 10.71%, KS “Elsig” 10.50%, KS “Siguria” 9.89%, KS “Insig” 9.75 %, KS “Kosova e Re” 7.91%, KS “Dardania” 7.66%, KS “Croatia” 4.31% dhe KS “Sigkos” 3.45%.

Një nga rrugët e tilla padyshim që përbën edhe arbitrazhi si një nga mënyrat e zgjidhjes së kontesteve përkitazi me shpërblimin e dëmit që buron nga kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të polices së sigurimit.

Veprimtaria e siguriesve është e lidhur me blerjen e rrezikut përkundrejt pagesës së caktuar në emër të “*primit*” për policen e sigurimit për produktet e sigurimit të detyruar dhe vullnetar bazuar në kushtet e kontratës së sigurimit që bëjnë që kjo e fundit pra, kontrata e sigurimit të marrë natyrën e kontratave formulare.

Ndodhja e “*rastit të siguruar*” paraqet hapjen e një kapitulli të ri në mes të palëve kontraktuese siguriesit dhe të siguruarit përkatësisht palës së tretë e cila në cilësi të palës së dëmtuar ka të drejtë në shpërblimin e dëmit dhe pikërisht përshkrimi i rrugës drejtë realizimit të kërkesës për dëmshpërblim-zhdëmtim në disa raste mund të jetë e gjatë dhe e vështirë.

Prandaj, BQK-ja në cilësi të autoritetit mbikëqyrës të Kompanive të sigurimeve dhe me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurieseve dhe palëve të treta si palë të dëmtuara me të drejtë në zhdëmtim nga mbulesa e polices së sigurimit, ka paraparë me Rregullin 10 themelimin dhe funksionimin e forumit-tribunalit të arbitrazhit si një mënyrë dhe rrugë më e shpejtë për realizimin e kërkesave nga ana e palëve të dëmtuara përkitazi me trajtimin e rasteve të sigurimit me qëllim të shpërblimit të dëmit.

Ndonëse duhet përgëzuar BQK-në për një hap të tillë në rregullimin ligjor të arbitrazhit në aspektin teorik që përbën vetëm njërën anë të medaljes derisa ana tjetër e medaljes ajo e zbatimit praktikë ka ngecur dhe mbase është koha e fundit në fillimin e zbatimit praktikë të Rregullit 10 sepse si çdo rregull tjetër sado e mirë që të jetë në aspektin teorik ajo mbetet ashtu vetëm në letër përderisa nuk fillon zbatimi në praktikë. Andaj, të shpresojmë së bashku në zbatimin sa më të shpejtë në praktikë të arbitrazhit për zgjidhjen e kontesteve nga polica e sigurimit me çka në mënyrë indirekte do të ndikonte edhe në zvogëlimin e lëndëve gjyqësore të kësaj natyre nga gjykatat tona.

**Dr. sc. Rrustem QEHAJA, prof. ass.**

## **Arbitration - A Way of Resolving Disputes from Insurance Policy**

### *Summary*

Based on the actual situation of the insurance market, in the Republic of Kosovo their business exercise 10 insurance companies licensed by the Central Bank of Republic of Kosovo (CBK) on the one hand, and on the other hand considering the ever increasing number of more claims for compensation for material and immaterial damage from injured parties in the capacity of “third party” there arises a need to find a way or ways to resolve disputes over compensation for damage stemming from insurance coverage in the most efficient way.

One of such ways, no doubt, is also that arbitration as a means of resolving disputes relating to compensation of damage that stems from the general and special insurance policy. The activity of insurers is related with buying the risk against certain payment in the name of “premium” for the insurance policy for mandatory and voluntary insurance products based on insurance contract terms that make the latter, i.e. the insurance contract take the nature of the contract forms. Occurrence of the “insured case” represents the opening of a new chapter between the contracting parties namely the insurer and the insured third party who in the capacity of the injured party is entitled to indemnification and the very description of the way to realizing claim for damages in some cases can be too long and difficult.

Therefore, the CBK in the capacity of the supervisory authority of insurance companies in order to protect the interests of insurer and third parties as injured parties entitled to compensation from the insurance policy coverage, with the Rule 10 has provided the foundation and operation of the forum / tribunal of the arbitration as a faster way to realize the claims of injured parties with respect to handling of cases for the purpose of providing compensation for damage. Although CBK should be congratulated for such a step in the legal regulation of arbitration in theoretical terms that constitutes only one side of the coin whereas the other side of the coin, the

practical implementation is stalled and probably it is the right time to start with the practical implementation of the Rule 10, because like any other rule, however good the theoretical aspect is it remains only on paper until its implementation in practice. So, let us hope together that practical implementation of the arbitration for resolving disputes from the insurance policy shall start as soon as possible which would indirectly affect in reducing of court cases of this nature in our courts.

Ela Elezi<sup>1</sup>

## Legjislacioni penal shqiptar dhe efektiviteti i tij në luftën kundër kriminalitetit

### Hyrje

Shpallja e pavarësisë kombëtare 100 vjet më parë dhe krijimi i shtetit shqiptar shënon arritje të mëdha edhe në zhvillimin historik të legjislacionit penal. Nga normat penale fragmentare të pashkruara në të drejtën zakonore kemi kalimin në Statutet e qyteteve – komune (fillimet e shek. XIV), aktet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kanuni i Zhurisë i shtetit të sapokrijuar (10 maj 1913) deri te Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (1995). Ky kod, i bazuar në parime demokratike bashkëkohore, si dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës (2012)<sup>2</sup> janë armë efektive në luftën kundër kriminalitetit dhe shërbejnë në mbrojtjen e demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Kodi Penal shqiptar që nga hyrja në fuqi e deri tani është ndryshuar me një varg reformash të rëndësishme.

Reforma në legjislacionin penal është një proces intensiv, i gjerë dhe që kërkon përfshirjen e shumë ekspertëve, institucioneve por edhe vullnet politik. Shpesh herë reforma ligjore përqëndrohet te rezultati dhe jo te mënyra e hartimit të ligjeve.

Në dallim nga filozofia e ligjit, nëse marrim parasysh se realizimi i një të drejte bëhet në praktikë dhe jo në teori, atëherë edhe ligji në mënyrë që të vlerësohet drejt duhet të përballlet me faktet dhe ndryshimet sociale.<sup>3</sup>

*Me ligj penal kuptohet një normë ose tërësia e normave penale – juridike që përcaktojnë veprat penale, bazat e përgjegjësisë penale, institutet, dhe dënimet e sanksionet e tjera me karakter penal, që zbatohen kundër personave fajtorë.*<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Specialiste në Drejtorinë e Kërkimeve, Studimeve dhe Botimeve, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Në proces doktorature.

<sup>2</sup> Meqënëse Kodi Penal i ri i Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 1 janar 2013, e pashë të arsyeshme që në këtë shkrim të mos bëhet referim në Kodin Penal të tanishëm të Kosovës.

<sup>3</sup> Lascoumes, P., Serverin, E. Théories et pratiques de l'effectivité du Droit.

<sup>4</sup> Elezi, I. Kaçupi, S. Haxhia, M. Komentari i Kodit Penal (pjesa e përgjithshme), Tiranë 2012.

Autorë të ndryshëm japin përkufizime të ndryshme të ligjit penal.<sup>5</sup>

## 1. Kuptimi i efektivitetit të legjislacionit penal

1. Sqarimi i kuptimit të efektivitetit të legjislacionit penal ka lidhje të ngushtë me marrëdhëniet e politikës penale (kriminale) dhe me të drejtën penale.

Në literaturën bashkëkohore mjaft autorë i përmbahen pikëpamjes se politika penale ka përparësi ndaj së drejtës penale. Kjo përparësi shprehet në faktin se politika penale i përcakton detyrat që qëndrojnë para saj dhe, nëpërmjet legjislacionit penal mishërohet në të.

Ndërkohë, e drejta penale gjer në një farë mase ruan pavarësinë e saj ndaj politikës penale, është më konservative, kurse politika penale, vepron më me shpejtësi ndaj ndryshimeve të reja.

Ky fakt duket qartë në periudhën e tranzicionit në Shqipëri, ku pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal (1995), politika penale, si pjesë përbërëse e politikës shtetërore, u shfaq me reforma të thella ligjore për shtesa e ndryshime në Kodin Penal, për ta bërë atë një armë sa më efektive në luftimin e kriminalitetit dhe parandalimin e tij.

Reforma ligjore në fushën penale u diktua nga dy faktorë kryesorë: shfaqia e formave të reja të kriminalitetit në Shqipëri, të pandeshura më parë (si veprat penale kompjuterike etj) dhe nevoja e përqasjes së legjislacionit me rekomandimet dhe konventat europiane të ratifikuara (si pastrimi i parave, terrorizmi etj.).

2. Përmbajtja konkrete e të drejtës penale përcaktohet nga rendi shoqëror – ekonomik në një vend të caktuar, nga periudha në të cilën kalon shteti, nga gjendja, dinamika dhe struktura e kriminalitetit në një kohë të caktuar. Kur rezulton se një ose disa norma penale nuk u përgjigjen kërkesave të luftës kundër kriminalitetit, politika penale ndikon menjëherë në legjislacionin penal për zëvendësimin, bërjen e shtesave ose ndryshimin e tyre me një normë të re.

<sup>5</sup> Prof. Ismet Salihu nëpërmjet përkufizimit të së drejtës penale, jep edhe nocionin e ligjit penal: “E drejta ligjore është nga se kjo degë e drejtësisë që i rregullon çështjet në lëmin e saj vetëm me ligj, por jo me ndonjë akt tjetër”. (E drejta penale pjesa e përgjithshme), Prishtinë 1995, f. 4.

V. Kambovski e përkufizon ligjin penal si vijon: “Me ligj penal nënkuptohet dispozita ligjore me të cilën një sjellje njerëzore shpallet veprë penale, përcaktohen prezumimet për përgjegjësinë e veprës penale dhe përcaktohet dënimi, sanksion tjetër penal – juridik apo pasojë tjetër juridike e veprës penale”. (E drejta penale pjesa e përgjithshme), Shkup 2007, fq. 105.

*Pikërisht për këto arsye me efektivitet të legjislacionit penal kuptohet zhvillimi i tij për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave në luftimin e kriminalitetit në dinamikën dhe strukturën e tij në mënyrë që të sundojë ligji dhe të realizohet drejtësia.*

Efektiviteti i legjislacionit penal, i ndikimit të tij pozitiv duket para së gjithash në luftimin e kriminalitetit.

Meqënëse kjo temë nuk është trajtuar më parë në literaturën tonë, po shpreh opinionin tim, pa pretenduar për zgjidhje të plota e të padiskutueshme.

Efektiviteti i legjislacionit penal të shtetit duket në këto drejtime kryesore:

1. Në kriminalizimin e veprave të cilat janë me të vërtetë shoqërisht të rrezikshme, që prekin vlera të rëndësishme shoqërore, individuale a shtetërore;

2. Të përmbajë vetëm ato masa kundërvepruese ndaj veprës penale, të cilat janë efektive në planin e parandalimit të posaçëm e të përgjithshëm, që t'u përgjigjen njëkohësisht parimeve të drejtësisë e të humanizmit;

3. Të parashikohet mundësia e diferencimit të sanksioneve penale ndaj kategorive të ndryshme të personave që kryejnë vepra penale.

Efektiviteti i legjislacionit penal përmban tre elemente kryesore të domosdoshme:

a. Norma juridike penale të pasqyrojë politikën penale e të bazohet në të dhënat e analizave kriminologjike të gjendjes, dinamikës e strukturës së kriminalitetit;

b. Formulimi cilësor i normës juridike penale;

c. Realizimi i saj në praktikë.

Kriminologu gjerman Heinz Zipf thotë se: “Fusha e së drejtës penale nuk toleron ndërhyrje të shpejtuara, të pakonsultuara e të vlefshme vetëm për një kohë të shkurtër. Politika penale kërkon perspektiva afatmesme e afatgjata”.<sup>6</sup>

Edhe autorja italiane Desiree Fondaroli, pasi bën një varg kritikash për pjesën e përgjithshme të Kodit tonë Penal, arrin në përfundimin “për nevojën e një reforme të qetë e të studiuar në të ardhmen, duke saktësuar terminologjinë juridike dhe eliminuar kontradiktat, reflektim për disa

---

<sup>6</sup> Zipf, H. Criminologia. Politica criminale, diritto penale, introduzione in italiano da Adriano Bazoni, Giuffrè, Editore Milano 1989, p. 320.

zgjidhje të politikës penale (kriminale) që kanë inspiruar në parashikimin e dënimeve të rënda”.<sup>7</sup>

Autorët italianë Gianluigi Ponti dhe Isabella Merzagora Betsoi theksojnë se: “Nëpërmjet instrumenteve të kontrollit shoqëror më kryesori është ndërtuar nga ligjet dhe sanksionet penale”.<sup>8</sup>

Por, në çdo rast, thotë F. Mantovani, nëpërmjet sistemit penal dhe sistemit ekstrapenal të kontrollit shoqëror ekziston një raport i zhdrejtë, sa më shumë ulen mekanizmat e kontrollit shoqëror, aq më tepër shtrëngohet kontrolli kundër krimit duke forcuar sistemin penal”.<sup>9</sup>

## 2. Legjislacioni penal shqiptar

Aktualisht para së drejtës penale të Republikës së Shqipërisë qëndrojnë ato detyra që përcaktohen në Kodin Penal: “Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre.”<sup>10</sup> (neni 1/b KP) Këto detyra burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 3 e 4, 15, 18, 20, 21 e në vijim).

Duke i sistemuar, detyrat e Kodit Penal mund të ndahen në tri kategori kryesore:

1. Mbrojtja e vlerave të rëndësishme e të padiskutueshme të njeriut (jeta, shëndeti, dinjiteti, të drejtat, liritë), të shoqërisë e të shtetit;
2. Bashkëjetesa e mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat kombëtare dhe bashkëjetesa fetare;
3. Parandalimi i veprave penale.

Fakti që në Kodin Penal janë përcaktuar detyrat, është pozitiv, sepse tregon për orientimet kryesore në legjislacionin penal të shtetit të së drejtës, që po ndërtohet e forcohet në Shqipëri.

Faktor tjetër me rëndësi është se, ashtu sikurse Kodi Penal në tërësi edhe reformat ligjore për shtesat e ndryshimet e tij gjatë viteve 2001 – 2012,

<sup>7</sup> Fondaroli, D. Shënime për konfiskimin në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, a cura di Sergio Vinciguerra, Codice penale della Repubblica d’Albania, CEDAM Padova 2008.

<sup>8</sup> Ponti, G. dhe Merzagora Betsoi, I. Compendio di criminologia, quinta edizione, Raffaello Cortina Editore, Milano 2008, f. 451.

<sup>9</sup> Mantovani, F. Il problema della criminalità, CEDAM, Padova, 1984, f. 85.

<sup>10</sup> Neni 1/b i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.



janë bazuar në Kushtetutë, në aktet juridike ndërkombëtare, në rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për çështjet penale dhe shënojnë hapa pozitive drejt integritimit të legjislacionit tonë penal në standartet europiane.<sup>11</sup>

Efektiviteti i legjislacionit penal për luftimin e kriminalitetit është në proces të zhvillimit e forcimit të tij, që realizohet nëpërmjet reformave ligjore për përsosjen e legjislacionit dhe sistemit të drejtësisë penale për zbatimin e tij në praktikë.

Vlefshmëria e një sistemi ligjor nuk qëndron vetëm në efektet sociale, por në kombinimin e përshtatshëm të tre elementëve: legjislacioni, jurisprudenca dhe zakoni. Nëse ligji është i pari, atëherë zbatimi i tij duhet të udhëhiqet nga jurisprudenca, e cila do e përshtasë atë sipas ndryshimeve sociale. Në momentin e kodifikimi, Portalis<sup>12</sup> ka thënë se “ligji nuk mund të parashikojë gjithçka, dhe nuk duhet ta bëjë këtë, pasi do të pengonte evolucionin e normave”. Geny<sup>13</sup> do ta mbështeste më vonë këtë ide, duke deklaruar se legjislatori duhet të lërë disa “boshllëqe”, në mënyrë që të mundësojë gjykatat t’i zbatojnë ligjet edhe në situata të reja të paparashikuara. Me këtë nënkuptohet zgjerimi i interpretimit gjyqësor, por kjo nuk është gjithnjë efektive, pasi nëse norma juridike nuk është e qartë, le shteg për abuzime dhe subjektivizëm.

Efektiviteti në legjislacionin penal përfshin pjesën e përgjithshme dhe pjesën e posaçme të Kodit Penal. Pjesa e përgjithshme përmban parimet dhe institutet kryesore dhe është baza ku mbështetet pjesa e posaçme, e cila konkretizon kriminalizimin e veprave penale dhe penalizimin e tyre.

Duhet të pranojmë se megjithë rezultatet pozitive që janë arritur me reformat ligjore gjatë viteve 2001 – 2012, përsëri janë vërejtur veprime të pastudiuara mirë, nxitime për ndryshime të shpeshta të të njëjtave dispozita penale etj., duke arritur që më tepër se gjysma e Kodit Penal ka ndryshuar, gjë që ka shtruar për diskutim përgatitjen e një Kodi Penal të ri.

Në literaturën juridike bashkëkohore mbështetet pikëpamja se realizimi i reformave ligjore bëhet në këto forma kryesore: 1. ligjbërja e ligjit penal, ndryshimet e plotësimet e tij, 2. respektimi dhe zbatimi i drejtë i

---

<sup>11</sup> Rekomandimi R(87)18 i Komitetit të Ministrave drejtuar vendeve anëtare në lidhje me thjeshtimin e drejtësisë penale, botuar në një paketë rekomandimesh të Këshillit të Europës në lidhje me administrimin e drejtësisë restauruese, botim i Fondacionit “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë 2007, f. 13.

<sup>12</sup> Portalis, Discourses préliminaire au Code civil.

<sup>13</sup> Geny, F. *Méthodes d'interprétation et sources en droit privé positif*, 2<sup>e</sup> éd, Paris.

tij nga sistemi i drejtësisë penale, 3. interpretimi ligjor, doktrinor e gjyqësor, 4. rritja e vetëdijes juridike të komunitetit në respektimin e ligjit penal.

Sipas pikëpamjes së autorëve të tjerë, zbatimi i formave të politikës penale bëhet në dy drejtime kryesore: në bërjen e ligjit penal dhe në zbatimin e tij.

## 2.1. Ligjbërja

Në literaturën juridike penale pranohet se politika penale gjen shprehjen e vet në radhë të parë në bërjen e ligjit penal. Kjo pikëpamje mbështetet fuqishëm. Natyrisht, këtu mbahet parasysh pikësëpari Kodi Penal, pa mohuar edhe ligje penale të tjera ose ligje të veçanta që përmbajnë norma juridike – penale.<sup>14</sup>

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në një vendim të saj shprehej se: “Gjykata, në vijim të arsyetimeve të saj, e sheh me vend të theksojë se shpërndarja e normave juridiko penale në ligje të ndryshme, si dhe ndryshimet e shpeshta në legjislacionin penal, nuk i shërbejnë stabilitetit juridik të vendit, si një kusht i rëndësishëm për funksionimin e shtetit të së drejtës”.<sup>15</sup>

Në rast të ndryshimeve të shpeshta në legjislacion, pavarësisht kërkesës për unifikimin me të drejtën ndërkombëtare, mund të ndeshim në atë që quhet “pasiguria juridike”, pra kur autoritetet kompetente nuk kanë pushtetin apo aftësinë për të siguruar në çdo rast zbatimin e ligjeve.

Në bërjen e ligjeve ndërthuren në mënyrë të qartë elementët përbërës të politikës penale, të kriminologjisë dhe të së drejtës penale, duke dhënë si rezultat bërjen e një ligji (kodi) penal me cilësi të lartë.

Në këtë drejtim kanë kontribuar në mënyrë të veçantë tekstet universitare të së drejtës penale e botimet e veçanta në fushën penale të autorëve në Shqipëri e në Kosovë, si dhe botime të autorëve të huaj.

Gjithashtu studimet kriminologjike të kryera nga studiuesit Ragip Halili, Vasilika Hysi, si dhe ato të politikës penale nga Vesel Latifi etj.<sup>16</sup>

Bërja e ligjit penal nënkupton që më parë të respektohen e zbatohen disa standarte kryesore: së pari të bëhen studime e analiza kriminologjike

<sup>14</sup> Guiding principles for the Criminal Law Reform Process  
<http://www.usip.org/files/MC1/MC1-Chapter4.pdf>

<sup>15</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr. 1 datë 20.1.2011.

<sup>16</sup> Halili, R. Kriminologjia, Prishtinë 2002; Hysi, V. Kriminologjia, Tiranë 2010; Latifi, V. Elezi, I. Hysi, V. Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë 2012.

për gjendjen e kriminalitetit, strukturën, dinamikën e tij, shkaqet dhe faktorët kriminogjenë.

Pa analiza kriminologjike, ligji penal do të ketë karakter abstrakt, nuk do të mund të pasqyrojë realisht parimet e kriminalizimit, dekriminalizimit, penalizimit e depenalizimit, në zhvillimin e tyre historik.

Metodat kriminologjike të studimit të kriminalitetit japin rezultate të cilat i shërbejnë politikës penale për të përcaktuar orientimet që do t'i japë legjislatorit për bërjen e ligjit penal ose për shtesat e ndryshimet e tij, për çdo reformë ligjore në fushën penale. Legjislacioni penal shpreh në mënyrë të koncentruar parimet dhe përmbajtjen e politikës penale.

Së dyti, ligji penal (kodi) të udhëhiqet nga parimet demokratike, duke vënë në mbrojtje të gjithanshme të drejtat dhe liritë e njeriut, të sanksionuara me Kushtetutë.

Së treti, ligji penal të bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

Së katërti, ligji penal të bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit si dhe të humanizmit. (Zbatimi i ligjit me analogji nuk lejohet (neni 1/c).

Së pesti, ligji penal të bazohet në parimin e ligjshmërisë të sanksionuar në Kushtetutë (neni 29) dhe të pasqyruar në Kodin Penal: “Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj.”<sup>17</sup>

Në këtë nen shprehet qartë e saktë parimi i njohur i shkollës klasike: “Nullum crimen, nulla poena, sine lege”.

Së gjashti, në ligjin penal të gjejnë pasqyrim edhe parimet e tjera të rëndësishme si veprimi në kohë i ligjit penal, mosnjohja e ligjit, parimi i shtetësisë, juridiksioni universal etj.<sup>18</sup>

Së shtati, standard i domosdoshëm është që ligji penal të afrohet sa më shumë, siç thekson filozofi gjerman Emanuel Kant, me konceptin universal të drejtësisë, dmth. të bëhen ligje të drejta që të sigurojnë sa të jetë e mundur e më shumë dhënien e drejtësisë.<sup>19</sup>

<sup>17</sup> Neni 3 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë 1995 me ndryshime.

<sup>18</sup> Elezi, I. Kaçupi, S. Haxhia, M. Komentari i Kodit Penal (pjesa e përgjithshme), Tiranë 2012.

<sup>19</sup> Zipf, H. vep. cit f. 320.

Së teti, cilësia e ligjit penal të jetë kërkesë themelore.

## 2.2. Cilësia e ligjit penal

Cilësia e ligjit penal, nënkupton një nivel të kënaqshëm të teknikës ligjore, harmonizimin e neneve të ndryshme të ligjit penal, harmonizimin e ligjit penal me akte të tjera ligjore të degëve të ndryshme të së drejtës, për të siguruar baza të forta për kriminalizimin/dekriminalizimin apo penalizimin/depenalizimin e veprës.

Sa më i përsosur të jetë teksti i ligjit, aq më pak sjell vështirësi në zbatimin e tij në praktikë.

Duke vlerësuar cilësinë e Kodit Penal në fuqi, pa mohuar parimet demokratike, janë bërë plotësimet në luftën kundër kriminalitetit, megjithatë mbetet ende për të punuar sepse ai paraqet mjaft të meta.

## 2.3. Metoda e bërjes së ligjit

Qëllimi kryesor i reformës ligjore në fushën penale është që të përgatitet një ligj penal me cilësi të lartë, mbi bazën e studimeve e duke përzgjedhur modele të përshtatshme të shteteve demokratike europiane. Këto kanë të bëjnë me teknikën ligjore, gjuhën e stilit, me harmonizimin e neneve brenda të njëjtit kre apo seksion etj. dhe që ndikojnë negativisht në kuptimin si dhe zbatimin e tyre në praktikë.

Realizimi i këtij qëllimi është në varësi nga metoda e ndjekur për bërjen e ligjit penal. Siç dihet me këtë detyrë është ngarkuar me ligj Ministria e Drejtësisë nëpërmjet departamentit të kodifikimit. Rol të veçantë luan edhe Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë, si organ i specializuar për të siguruar cilësinë e ligjeve, por edhe vetë Kuvendi i Shqipërisë gjatë diskutimit të projektligjeve.

Garancia kryesore për një metodë efektive në bërjen e ligjeve të drejta, të qarta e të sakta, është angazhimi i specialistëve më të kualifikuar, e me përvojë, diskutimi i gjerë i projekteve, debati shkencor, debati në shtyp e në televizion, reflektimi i rekomandimeve që bëhen në seminare e konferenca shkencore të fakulteteve të drejtësisë, në tekstet universitare dhe në artikujt shkencorë nga autorë të vendit e të huaj.

Veç këtyre, përmirësimi i metodës së punës për të bërë ligje penale sa më efektive, është e nevojshme të merret edhe opinioni i organizmave ndërkombëtare në Tiranë, si OSBE, Projekti Euralius etj.

Të gjitha këto kanë rëndësi të madhe, sepse në teknikën ligjore shprehet konkretisht efektiviteti i legjislacionit penal. Manipulimi me teknikën ligjore mund të shpjerë në kundërshtim me atë çka është dashur të thuhet në fillim. Prandaj, problemet e teknikës ligjore janë shpesh probleme politike.

#### **2.4. Disa nga të metat e teknikës ligjore në Kodin Penal në fuqi**

Teknika ligjore e Kodit Penal në fuqi (1995) është larg përsosmërisë në disa parametra. Fakti që në Kodin Penal të vitit 1995 deri në vitin 2012 janë bërë mbi 250 shtesa e ndryshime, jo vetëm për të plotësuar e përafuar me ligjet e Bashkimit Europian dhe konventat e aktet e tjera juridike ndërkombëtare, por duke ndryshuar disa herë të njëjtën dispozitë, flet qartë se sa vuan teknika ligjore. Kështu me shtesat e ndryshimet e bëra në vitin 2004, u ndryshuan në formulime 21 nene të rinj, të vendosur me reformën ligjore të vitit 2001.

Synimi për të marrë në mënyrë mekanike nenet nga kodet e huaja ose aktet juridike ndërkombëtare ka bërë që disa nene të mos harmonizohen me strukturën e Kodit Penal dhe as me kushtet konkrete të vendit tonë, e për pasojë të mos gjejnë zbatim në praktikë.

Kjo teknikë ligjore e përdorur gjerësisht vitet e fundit ka krijuar probleme për kuptimin dhe zbatimin e rregullt të dispozitave të Kodit Penal.

Sipas kritikës së disa profesorëve italianë:

“Pjesa e përgjithshme nuk është ndërtuar fort mirë, është jo e plotë, struktura jo e përkryer, ka mangësi nga ana formale, një gjuhë juridike jo të qartë, që kërkon më shumë reflektim e vëmendje.”<sup>20</sup>

Më poshtë bëhen vërejtje për teknikën ligjore.

Kritika më të forta bëhen për pjesën e posaçme të Kodit Penal, sidomos për krimet politike, ku vihen mbi të gjitha interesat e shtetit.

Pedagogu tjetër i Universitetit të Torinos, Adelmo Manna, duke folur për përgjegjësinë penale sipas Kodit Penal të Shqipërisë shkruan se:

“Lënda për përgjegjësinë penale në Kodin Penal shqiptar paraqet dritë e hije, në kuptimin se paraqet aspekte të modernizimit – për format e fajësisë e të riedukimit dhe nga ana tjetër prevalojnë masa të hekurta të mbrojtjes shoqërore për ata që veprojnë nën ndikimn e lëndëve narkotike, pa u kujtuar për parimin themelor të fajësisë”.<sup>21</sup>

<sup>20</sup> Pittaro, P. Codice penale della Republica d’Albania, 2008.

<sup>21</sup> Manna, A. L’imputabilita nel codice penale albanese. Alcune considerazioni. 2008.

Ndërsa autorë të tjerë vërejnë se:

- Në mjaft nene ka formulime të hollësishme të panevojshme, shpjegime të tejzgjatura.
- Ka strukturime të neneve krejtësisht të paarsyeshme
- Ka mungesë logjike në përmbajtjen e disa neneve, përse i përket dispozitivit ashtu dhe strukturës së sanksioneve penale.
- Mosharmonizim të dispozitave e të sanksioneve brenda Kodit Penal.<sup>22</sup>

Opinionet, analizat dhe kritikët e autorëve italianë në hyrjen e Kodit Penal, janë objektive dhe me vlera teorike si dhe ndikojnë në përmirësimin e legjislacionit tonë penal, që të jetë sa më efektiv në luftimin e kriminalitetit.

Terminologjia e përdorur në Kodin Penal jo kudo është e njësuar, por lë shkak për interpretime të ndryshme nga zbatuesit e ligjit. Të tilla janë psh: termat: “dëmtim”, “dëmtime të tjera”, “pasoja”, “pasoja të rënda”.

Për të mënjeluar subjektivizmin në interpretimin e këtyre termave, që mund të shpien në shkeljen e parimit të ligjshmërisë apo parimet e dhënies së drejtësisë, individualizimit e të diferencimit të dënimit etj., është e nevojshme që Kodi Penal të shoqërohet me një fjalor të posaçëm terminologjik, ku të sqarohet përmbajtja e çdo termi.

Përdorimi i tepruar i formulimeve të vështira të neneve, është krejtësisht i panevojshëm.

Shembuj të tillë në Kodin Penal janë të shumtë, psh. nenet për trafiket e paligjshme (nenet 110/a, 114/b, 128/a), nenet për korrupsionin aktiv e pasiv (nenet 164/a, 164/b, 245/1), nenet 221 (kryengritja), nenet për terrorizmin (230 – 230/c), neni 245/1 (ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike), pastrimi i produkteve të veprës penale (neni 287) etj. janë formuluar në formën e komentarit dhe jo të neneve konçize, të qarta e të sakta.

Gjithashtu në Kodin Penal vërehet një copëzim i panevojshëm i neneve për vepra penale me objekt të përbashkët si psh. për llojet e kontrabandës, për llojet e falsifikimit, terrorizmit etj.

---

<sup>22</sup> Pittaro, P. Codice penale della Republica d’Albania, 2008.

## 2.5. Zbatimi i drejtë, i paanshëm, i rregullt i ligjit penal

Ligji penal, si çdo ligj tjetër, sado i drejtë dhe me cilësi të lartë të jetë, nëqoftëse nuk gjen zbatim të rregullt në praktikë, do të cenojë rëndë dhënien e drejtësisë.

Pikërisht për këto arsye, zbatimi i drejtë, i rregullt e i paanshëm, me ndershmëri, i ligjit penal merr rëndësi të jashtëzakonshme, sepse lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen juridike penale të të drejtave e lirive të njeriut, të të gjitha vlerave të rëndësishme shoqërore e shtetërore.

Thënia latine “Lex dura, sed lex” ka vlera aktuale, sepse sado i ashpër që është Kodi Penal, ai duhet zbatuar me përpikmëri e korrektësi.

Praktika tregon se moszbatimi i rregullt i ligjit penal mbetet problemi më shqetësues. Kështu psh. sipas raportit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga rreth 7000 çështje të gjykuara janë dënuar vetëm 40 për korrupsion (nga të cilat 2 gjyqtarë për korrupsion aktiv).

Për zbatimin e Kodit Penal janë ngarkuar me ligj organet e prokurorisë, të gjykatës e të policisë gjyqësore.

Moszbatimi i rregullt i Kodit Penal e ka burimin në disa faktorë objektivë e subjektivë. Ndër këta mund të përmendim presionet e ndërhyrjet e politikës në prokurori e në pushtetin gjyqësor, ndërhyrjet miqësore e shoqërore, paaftësia profesionale dhe veçanërisht korrupsioni etj. Të dhënat e sondazhit të fundit tregojnë se 25% e gjyqësorit në Shqipëri pranon se është i korruptuar dhe 7% mendon se gjyqësori është i varur nga politika.

Për kapërcimin e këtyre faktorëve kërkohet në radhë të parë e mbi të gjitha integriteti moral i prokurorëve e gjyqtarëve, qëndrim i vendosur në respektimin e drejtë e të rregullt të ligjit, mosnënshtrimi ndaj presioneve e ndërhyrjeve dhe luftim i korrupsionit brenda sistemit të drejtësisë penale e jashtë tij.

Kërkesë tjetër e kohës së sotme është rritja e kualifikimit profesional në forma të ndryshme, sepse nuk mund të vazhdohet gjatë me njohuritë e Fakultetit të Drejtësisë apo të Shkollës së Magjistraturës, por është e domosdoshme studimi i literaturës juridike bashkëkohore, legjislacionit të BE, jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Misioni i gjyqtarëve për dhënien e drejtësisë kapërcen kufijtë juridiko – penale e proceduralë dhe është në radhë të parë mision që realizohet duke ruajtur e mbrojtur vlerat etike – morale.

Vetëm duke ruajtur dinjitetin personal mbrohet sistemi i drejtësisë dhe fitohet besimi i popullit ndaj drejtësisë, si koncept universal.

## Përfundime

Parimi i efektivitetit të së drejtës penale është ai parim që parashikon zbatimin konkret të drejtësisë dhe normave që përbëjnë sistemin e drejtësisë. Pikërisht aftësia për të garantuar efikasitetin e normave të së drejtës në një sistem të caktuar mund të konsiderohet si parametri për të përcaktuar vlefshmërinë e një sistemi ligjor. Normat ligjore sado të plota e të gjithanshme të jenë, nëse nuk do të gjejnë zbatim në praktikë, atëherë nuk do të mund të flasim për një të drejtë substanciale.

Studimet e shumta që nevojiten shërbejnë për të përcaktuar mënyrën e hartimit të reformës ligjore, nëse është e nevojshme nxjerrja e ligjeve të reja apo modifikimi i regjimit të sanksioneve.

Kriminaliteti është fenomen shoqëror dhe nuk mund të mendohet se legjislacioni penal, sado efektiv që të jetë do e zhdukë atë. Po të pranohej një tezë e tillë kjo do të sillte paqartësi në politikën penale si dhe në vetë shtetin e organet e tij. Mbrojtja e vlerave të rëndësishme shoqërore nuk mund të realizohet plotësisht vetëm nëpërmjet legjislacionit penal, por është çështje e të gjithë shoqërisë.

Megjithatë legjislacioni penal sa më shumë të luftohet kriminaliteti aq më efektiv bëhet. Sa më tepër ulet kriminaliteti aq më tepër rritet efektiviteti i legjislacionit penal kundër tij.

Për rritjen e efektivitetit të legjislacionit penal në luftimin e kriminalitetit është i domosdoshëm rekomandimi që jepet për organet shtetërore të drejtësisë, të cilat në bërjen e ligjeve apo përgatitjen e reformave ligjore a të sistemit të drejtësisë, të orientohen nga shkencat e së drejtës penale dhe shkencat e reja të politikës penale, kriminologjisë, penologjisë, të forcojnë bashkëpunimin me fakultetet e drejtësisë brenda vendit e me ato të Kosovës dhe të shfrytëzojnë edhe ndihmën e institucioneve shkencore e të drejtësisë të vendeve demokratike.

Por duke marrë për bazë se në Kodin në fuqi janë bërë shumë shtesa e ndryshime, që krijojnë jo pak vështirësi në praktikë, mbështesim opinionet e shprehura në literaturën juridike për të përgatitur një Kod Penal të ri, me efektivitet të plotë, në luftimin e kriminalitetit në kushtet e integritetit e të ndërkombëtarizimit të tij në forma të sofistikuar e të organizuara.

Efektiviteti i ligjit penal për luftimin e kriminalitetit mbron të drejtat e liritë themelore të njeriut, forcon shtetin e së drejtës, rrit besimin e popullit në pushtetin gjyqësor për dhënien e drejtësisë dhe vepron për integritetin e Shqipërisë në Bashkimin European.



Ela Elezi

## **Albanian Criminal Legislation and its Effectiveness in the Fight against Criminality**

### *Summary*

The history of Albanian criminal legislation begins with the customary law, Statutes of cities – commune (early fourteenth century), Canon of Jury of the newly established state (10 May 1913) up to the Criminal Code of the Republic of Albania (1995). This code, based on modern democratic principles and the Criminal Code of the Republic of Kosovo (2012) are effective weapons in the fight against criminality and serve the defense of democracy and human rights.

The Albanian Criminal Code since the entry into force has gone through a series of important reforms.

The content of criminal law is determined by social and economic order in a certain country, the history, dynamics and structure of crime in a given time. When it turns out that one or more criminal provisions do not respond to the fight against criminality, criminal policy immediately affects criminal legislation in order to replace it, making additions or changing them with a new provisions.

Precisely for these reasons, the effectiveness of criminal legislation means the development of criminal legislation in order to fight criminality in its dynamics and structure, so that law and justice can prevail.

Some authors are of the view that the implementation of criminal policy is done in two main directions: in drafting the criminal law and its enforcement.

Criminality is a social phenomenon, and we cannot realistically pretend that criminal legislation can dissolve it no matter how effective it is. Protection of important social values cannot be fully realized only through criminal law, as it is a matter of the whole society.

To increase the effectiveness of criminal law in the fight against criminality it is imperative to implement the recommendation given to justice authorities, which in law-making or preparing a legal reform of the justice system, they should be guided by the science of criminal law, criminal policy, criminology, and should strengthen cooperation with law faculties in Albania and Kosovo, as well as utilize the help of scientific institutions and academic communities of democratic states.

---

Ultimately, the effectiveness of criminal law protects the fundamental human rights and increases the trust of people in judicial system.

Doc. Dr. Jeton SHASIVARI<sup>1</sup>

## STATUSI I SHQIPTARËVE NË SISTEMIN KUSHTETUES, JURIDIK DHE POLITIK TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

*Simplex sigillum veri - Vula e së vërtetës është e thjeshtë - The seal of  
the truth is simple*

### Hyrje

*Në këtë punim analizohet statusi i popullit shqiptar në Republikën e Maqedonisë, në kuadër të dy fazave të zhvillimit kushtetues të vendit, përkatësisht faza e parë që përfshin periudhën kohore prej miratimit të Kushtetutës së RM-së të vitit 1991 deri në nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në vitin 2001, dhe faza e dytë që përfshin periudhën kohore nga viti 2001 e deri në ditët e sotme. Në këtë drejtim, autori nënvizon faktin se statusi kushtetues juridik dhe politik i shqiptarëve nuk ka shënuar ndonjë përparim që nga momenti i shfuqizimit (fshirjes) të kombësisë shqiptare si subjekt konstitutiv të RM-së me Amendamentin LVI të vitit 1989 për Kushtetutën e RM-së të vitit 1974 dhe inaugurimit të popullit maqedonas si subjekt të vetëm konstitutiv, gjë që ishte pasojë e ndikimit të drejtpërdrejtë të diktatorit serb Millosheviq paralelisht me shfuqizimin e autonomisë kosovare.*

*Autori analizon edhe zgjidhjet kushtetuese lidhur me gjuhën shqipe dhe simbolin kombëtar të shqiptarëve, sidomos vendimet dhe qëndrimet e Gjykatës kushtetuese për këto dy çështje, që ricikluan konceptin e kombit shtet që ishte një veçori dalluese e fazës së parë të zhvillimit kushtetues të vendit. Në këtë punim, trajtohet edhe trajta unitare e rregullimit shtetëror të vendit e cila nuk përkon me realitetin e raporteve midis dy popujve më të mëdhenj në vend, sepse këtë trajtë, klasa politike maqedonase e percepton nën frymën e konceptit të kombit shtet, që ka qenë i pa pranueshëm për shqiptarët që nga pavarësimi i vendit në vitin 1991. Autori analizon edhe*

---

<sup>1</sup> Autori është Docent për grupin e lëndëve kushtetuese - administrative dhe Prodekan i Fakultetit Juridik të Universitetit të Evropës Jug-Lindore në Tetovë.

*mangësitë e funksionimit të modelit të ndarjes horizontale të pushtetit “power sharing” i cili tashmë mbi 20 vite nuk ka sjellë ndryshime cilësore dhe përmbajtësore për sa i përket statusit të shqiptarëve si popull konstitutiv në sistemin kushtetues juridik dhe politik të vendit sepse ky model nuk është funksional për rrethanat e RM-së meqenëse nuk i plotëson parakushtet kryesore teorike dhe praktike për funksionimin efikas të tij në zgjidhjen e çështjeve dhe raporteve ndëretnike, andaj, autori meret me shqyrtimin teorik të modelit tjetër të organizimit të pushtetit shtetëror, atë të ndarjes vertikale të pushtetit shtetëror në qendër (trajtën federative të rregullimit shtetëror) si një model i cili jo vetëm që përkon me rrethanat në RM, por paraqet edhe modelin e vetëm që siguron statusin e shqiptarëve si popull konstitutiv në sistemin kushtetues juridik dhe politik të vendit.*

### **1. Veçoritë qenësore të zhvillimit kushtetues të RM-së**

Zhvillimi kushtetues i RM-së shënon dy faza, edhe atë: faza e parë që përfshin periudhën kohore nga miratimi i Kushtetutës së RM-së më 17.11.1991 deri në nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit më 13.08.2001 dhe, faza e dytë, e cila përfshin periudhën kohore pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit deri në ditët e sotme.

Faza e parë e zhvillimit kushtetues, karakterizohet me miratimin e Kushtetutës së vendit që kaloi pa konsensusin e duhur ndëretnik, përkatësisht vetë themelimi i RM-së si shtet sovran dhe i pavarur u veçua me ekskluzivitetin nacionalist të politikanëve të atëhershëm maqedonas përballë kërkesave të politikanëve shqiptarë për shqiptarët si popull konstitutiv në sistemin kushtetues dhe politik të vendit, përkatësisht për konstituimin e RM-së si një shtet dynacional i maqedonasve dhe i shqiptarëve. Si pasojë e kësaj, Kushtetuta e RM-së nuk mori përkrahjen e deputetëve të atëhershëm shqiptarë nga radhët e PPD-së dhe PDP-së, të cilët nuk u pajtuan me konceptin e imponuar të kombit shtet përkatësisht me statusin e pakicës nacionale për shqiptarët. Krejt kjo ishte një refleksion i qëndrimit mbizotërues të asaj kohe se kushtetuta medoemos duhet miratuar (imponuar) me cilindo çmim, madje edhe përkundër pakënaqësisë së politikanëve shqiptarë gjë që përbënte një zgjidhje jo demokratike dhe të padrejtë sepse nënkuptonte imponimin e vullnetit përmes të drejtës së votës përkatësisht përmes tiranisë së shumicës sepse pas tij nuk qëndronte edhe vullneti i shqiptarëve si populli i dytë në vend.

Një veçori e tillë, është më se e qartë, kur sot 20 vite pas këtij akti, protagonistët kryesorë të asaj kohe, pranojnë se atëherë nuk ekzistonin

botëkuptimet vizionare për të drejtat e shqiptarëve në vend<sup>2</sup>, përkatësisht se Kushtetuta ishte një gabim i madh<sup>3</sup> ose se nuk u tha qartë se çfarë Maqedonie do të ndërtohej në të ardhmen<sup>4</sup>. Për këto arsye Kushtetuta e RM-së e vitit 1991 nuk e dha provimin e pjekurisë si çdo kushtetutë e mirë, përkatësisht secila kushtetutë e mirë i përshtatet realitetit dhe njerëzve për të cilët edhe shkruhet. Prandaj, këtë kushtetutë mund ta numërojmë në grupin e kushtetutave nominale sepse u shkrua për një realitet tjetër që nuk përputhej me realitetin në të cilin duhej të zbatohet sepse nuk ishte kushtetutë që i përshtatej popullit shqiptar, por kushtetutë të cilës populli

<sup>2</sup> “Kur përkujtojmë atë kohë, duhet thënë se VMRO-DPMNE dhe personalisht unë, vërtetë kishim një koncept të shprehur nacional për vendin, të mos e quaj koncept nationalist, që nuk kishte të bënte vetëm me pavarësimin e vendit, por edhe me rregullimin e brendshëm. Atë periudhë e vlerësoj si një koncept jo vizionar. Kur bëj analizën e asaj periudhe, absolutisht nuk e paskam kuptuar nevojën e shqiptarëve që të kenë më tepër të drejta. Ky nuk ishte vetëm gabimi im, por ishte një atmosferë e përgjithshme në Maqedoni, ndoshta ishte një ndikim i tërthortë i Millosheviqit në vendin tonë. Partitë politike maqedonase, të proveniencës së majtë dhe të djathtë, (përfshi këtu edhe Kiro Gligorovin) nuk arritën që në një mënyrë vizionare t'i shikojnë shqiptarët dhe qysh në start t'u jepen më tepër të drejta që të parandalohen disa ngjarje të mëvonshme”. Intervistë e Ljubčo Georgievskit, ish-lider i VMRO-DPMNE-së për gazetën ditore: “УТРИНСКИ ВЕШНИК”, me titull: “Бевме многу наивни”-“Ishim shumë naivë”, numër 3668, të datës: 29.08.2011.

<sup>3</sup> “Gabimi i tretë ishte Kushtetuta. Unë isha udhëheqës i Komisionit për çështje kushtetuese dhe nuk kishim sukses që të shqiptarët të ruajmë të drejtën e fituar për përdorimin e gjuhës. Neve madje i privuam ata edhe nga të drejtat e fituara, dhe prapsepapë Kushtetuta u mbiquajtë si një akt tradhtie. Kishim një marrëveshje që më 14.11.1991 të votojmë, mirëpo VMRO-DPMNE bëri të ditur se u ka ndaluar deputetëve të votojnë për një kushtetutë të tillë, që e mbiquajtën si tradhtarë dhe organizuan demonstrata të mëdha. Por, neve nuk lëshuam pe përballë demonstratave, mirëpo megjithatë ndërhyëm në të drejtat e fituara të shqiptarëve me Kushtetutën paraprake të vitit 1974 dhe i zvogëluam ato. Ky ishte një gabim i madh dhe një prej atuve kryesore që faktori i huaj, më pas vazhdimisht t'na thoshte se neve e degradojmë pozitën e shqiptarëve”. Intervistë e Stojan Andovit, Kryetarit të parë të Kuvendit shumëpartiak të RM-së për gazetën ditore: УТРИНСКИ ВЕШНИК”, me titull: “Македонија доцна го фати чекорот”-“Maqedonia vonë e kapi hapin”, numër 3656, të datës: 15.08.2011.

<sup>4</sup> “Gabimi i parë brenda Kushtetutës ishte se nuk u pranua ideja për përkufizimin e shtetit si një shtet qytetar ose, meqë kishte nevojë që të përmenden kolektivitetet, atëherë duhej përmendur edhe shqiptarët. Aty ishin edhe zgjidhjet rigjide për gjuhën, për arsimimin e lartë, për mënyrën e vendimmarjes në Kuvend. Mosbesimi ishte evident sepse as neve nuk u besonim partive politike maqedonase e as ato nuk u besonin partive politike shqiptare”. Intervista e Abdurahman Alitit për revistën javore: “ПУБЛИКА” me titull: “Nuk thamë qartë se çfarë Maqedonie do të ndërtojmë”, numër 4, të datës: 04.01.2011.

shqiptar duhej t'i përshtatet<sup>5</sup>, andaj kjo kushtetutë nuk bashkëjetoj me realitetin, por vetëm në letër ku ishte e shtypur dhe e shkruar.

Faza e parë e zhvillimit kushtetues, u veçua me modelin e etnokracisë në vend të demokracisë, përkatësisht regjimin e privilegjuar kushtetues të rezervuar për maqedonasit etnik, me ç'rast çfarëdo orvatje për marrëveshje politike dhe dialog për të drejtat legjitime të shqiptarëve përfundonte me mbivotim (majorizim) si në Kuvend ashtu edhe në institucionet e tjera. Kërkesat legjitime konsistojnë në: statusin autonom për shqiptarët, arsimimin sipëror në gjuhën shqipe, zyrtarizimin e gjuhës shqipe dhe të simbolit kombëtar, përfaqësimin e plotë në jetën publike, barazinë ndëretnike, etj. Në këtë drejtim, do të veçojmë disa shembuj konkret që të ilustrojmë modelin e imponuar etnokratik, përkatësisht nacionalizmin kushtetues të kësaj periudhe.

Në vitin 1992 u organizua referendumi i shqiptarëve për autonomi politike dhe territoriale, i realizuar nga partitë politike shqiptare PPD dhe PDP, rezultatet e të cilit nuk u pranuan nga shteti. Në vitin 1994, tri komunat me shumicë shqiptare, Tetova, Gostivari dhe Dibra si dhe partitë politike shqiptare PPD dhe PDSH me vetë inisiativë vendosën që të themelohet Universiteti i Tetovës me mësim në gjuhën shqipe, që përndryshe ishte një nismë ligjore meqë komunat ligjërisht njiheshin si themeluese të institucioneve të arsimit të lartë. Mirëpo, shteti u përgjigj me mospranim dhe intervenim me forcë me ç'rast kishte një shqiptarë të vrarë. Më 9 korrik 1997, policia shtetërore intervenoi me forcë në komunat e Tetovës dhe të Gostivarit për të hequr simbolin kombëtar të shqiptarëve që ishte vendosur para komunave me vendime të këshillave komunalë, me ç'rast kishte 4 shqiptarë të vrarë dhe mijëra të plagosur në Gostivar. Në vitin 1999 diskriminimi në punësim në sektorin publik ishte marramendës, përkatësisht 85% të punësuar maqedonas dhe vetëm 7% të punësuar shqiptarë. Diskriminimi ekonomik kishte të bëjë me procesin e privatizimit të vitit 1993, me ç'rast një pjesë e pa përfillshme e kapitalit shoqëror kaloi në duar të shqiptarëve për shkaqe politike dhe etnokratike<sup>6</sup>.

---

<sup>5</sup> Loewenstein, Karl, *Political Power and the Governmental Process*, Chicago, 1957, p. 203-205.

<sup>6</sup> “Bëmë një privatizim të keq. Tek ekspertët mbizotëronte mendimi për modelin e vauçerëve si më të pranueshëm për RM-në. Unë nuk kam qenë i pranishëm kur është marë qëndrimi përfundimtar për modelin e privatizimit, mirëpo, shumë mirë e di dhe absolutisht është e vërtetë se në momentin e fundit, motivi vendimtar ka qenë ai politik, e jo ekonomik. Të gjithë i ka heshtur formulimi i dhënë nga Kryetari Gligorov: “Po, ndoshta është ashtu, mirëpo a jeni të vetëdijshëm se nëse e pranojmë modelin e vauçerëve, mbi 40% e kapitalit shoqëror do të kalojë në duar të jo maqedonasve, kurse me këtë që propozoj unë, neve do të

Edhe përkundër faktit se në kuadër të fazës së parë të zhvillimit të sistemit kushtetues dhe politik (1991-2001), në suaza të pesë qeverive të RM-së mernin pjesë edhe partitë politike të shqiptarëve, edhe atë: në qeverinë e parë (21.03.1991-07.07.1992) e njohur si: “qeveri ekspertësh” participoi PPD me tri poste ministrore; në qeverinë e dytë (04.09.1992-20.12.1994) sërish participoi PPD me pesë poste ministrore; në qeverinë e tretë (20.12.1994-01.12.1998) sërish participoi PPD me katër poste ministrore; në qeverinë e katërt (01.12.1998-16.05.2001) participoi PDSH me pesë poste ministrore dhe në qeverinë e pestë e njohur si: “qeveri e unitetit politik” (16.05.2001-01.11.2002) e formuar nën presionin ndërkombëtar përgjatë konfliktit të vitit 2001, sërish mernin pjesë të dyja partitë politike shqiptare, PPD dhe PDSH me nga tri poste ministrore (gjithsej gjashtë ministri) prapsepapë duhet nënvizuar konstatimin e studiuesit të sistemeve politike Florian Biber se: “Sistemi në fjalë nuk mund të konsiderohet si një formë e ndarjes së pushtetit, por më tepër si një orvatje për kyçjen e elitave politike shqiptare në pushtet”<sup>7</sup>, konstatim ky që siç do të shihet në vazhden e punimit, në masë të madhe vlen edhe për fazën e dytë të zhvillimit të sistemit kushtetues dhe politik të vendit.

Siç u përmend më sipër, faza e dytë përfshin periudhën nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit e deri në ditët e sotme. Qëllimi kyç i kësaj Marrëveshje konsistonte në ndërprerjen e veprimeve të armatosura shtatëmuajore në vitin 2001, por jo edhe zgjidhja përfundimtare e statusit juridik dhe politik të shqiptarëve si popull konstitutiv në sistemin shtetëror të vendit. Në këtë drejtim, RM ka dy preambula të ndryshme, edhe atë: e para, preambula e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, dhe e dyta, Amendamenti i IV-të kushtetues i vitit 2001 për Kushtetutën e RM-së që zëvendësoi preambulën paraprake të vitit 1991.

Dallimi ndërmjet këtyre dy preambulave konsiston në karakterin e shtetit, përkatësisht, preambula e parë bazohet në karakterin qytetar të shtetit pa “kokteje etnike”, ndërkaq, preambula e dytë bën një përzierje të karakterit qytetar dhe atij etnik, duke i ndarë qytetarët në Popull Maqedonas (termi maqedonas është i shkruar me germë të madhe) si dhe në qytetarë që jetojnë brenda kufijve të shtetit, të cilët janë pjesë e popullit shqiptarë,

---

arrijmë që kapitali shoqëror të kalojë në duart e maqedonasve me mbi 90%, dhe tani ju zgjedhni modelin më të mirë””. Intervista e Abdurahman Alitit për revistën javore: “PUBLIKA” me titull: “Nuk thamë qartë se çfarë Maqedonie do të ndërtojmë”, numër 4, të datës: 04.01.2011.

<sup>7</sup> Biber, Florian, “Ndarja e pushtetit dhe realizimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit”, Friedrich Ebert Stiftung, Shkup, 2008, fq. 20.

popullit turk, popullit serb, popullit vllah, popullit romë, popullit boshnjak dhe të tjerët. Është evidentë fakti se termi: “pjesë e popullit shqiptarë” paraqet një përkufizim modern të pakicave emigrante kombëtare që duhet integruar në kuadër të sistemit dominues juridik, politik dhe kulturor të vendit, përkatësisht edhe pse preambula e dytë i vendosë qytetarët si element konstitutiv të shtetit, prapëseprapë popullin maqedonas e përkufizon si etnos (komb), ndërkaq, shqiptarët si pakicë nacionale<sup>8</sup>, gjë që paraqet një diskriminim të hapur të qytetarëve qysh në hyrje të kushtetutës. Konsideroj se një zhvendosje e tillë e karakterit të shtetit krijoi shtegun e riciklimit të konceptit të kombit shtet që ishte veçori e fazës së parë 1991-2001.

## **2. Statusi kushtetues i gjuhës shqipe dhe i simbolit kombëtar**

Kur shqyrtohet çështja e statusit të gjuhës shqipe dhe i simbolit kombëtar të shqiptarëve në RM, krahas rregullimit kushtetues jo preciz dhe të paqartë të kësaj lëme, duhet veçuar edhe dy shembuj praktik të vendimeve dhe qëndrimeve të Gjykatës kushtetuese si autoriteti më i lartë i interpretimit kushtetues dhe i kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë në vend, e cila në dy raste cenoi frymën shumetnike të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit duke ricikluar konceptin e kombit shtet.

Rasti i parë është ai i vitit 2007 që kishte të bënte me vendimin e saj për simbolin kombëtar të shqiptarëve, dhe rasti i dytë është ai i vitit 2008 që kishte të bënte me gjuhën shqipe. Në vitin 2007, Gjykata kushtetuese duke shqyrtuar kushtetutshmërinë e Ligjit për përdorimin e simboleve të komuniteteve në RM të vitit 2005, i cili bazohej në pikën 7.1. të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit e cila garanton lirinë e pushteteve lokale që në objektet lokale publike të vendosin simbolet që shprehin identitetin e komunitetit që është shumicë në komunë, vendimin e saj (me të cilin shfuqizoi disa dispozita ligjore të ligjit në fjalë) e bazoi në parimin e mos diskriminimit të komuniteteve etnike në vend, me ç'rast konstatoi se censusi shumicë që parashihte ligji në fjalë nuk është në pajtim me Amendamentin e VIII-të kushtetues i cili nuk parasheh asnjë census, andaj, sipas saj, komuniteti etnik shqiptar me këtë ligj vihet në një pozitë privilegjuese ndaj komuniteteve të tjera etnike në vend. Pra, kjo gjykatë duke dashur që të promovojë parimin shumetnik dhe atë të mos diskriminimit, ra në grackën e nacionalizmit kushtetues sepse këto dy parime i peshoi vetëm në raportet e shqiptarëve me komunitetet e tjera jo maqedonase, duke i veçuar

---

<sup>8</sup> Шкарик, Светомир, Давкова, Гордана, Уставно право, второ издание, Скопје, 2009, стр. 176.



maqedonasit etnik si më të barabartit prej të tjerëve, meqenëse po të kishte peshuar edhe maqedonasit etnik atëherë do të konstatonte se nuk është në pajtim me dy parimet e mësipërme që maqedonasit etnik të (keq)përdorin simbolin shtetëror si simbol të vetin etnik! Pra, vendimi i tillë i kësaj gjykatë rihapi së paku dy dilema, edhe atë, e para, censusi shumicë parashihet në pikën 7.1. të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe shërbeu si bazë për ligjin e mësipërm, kurse për gjykatën në fjalë, kjo Marrëveshje u injorua skajshmërisht si burim primar formal i së drejtës kushtetuese në vend, madje, burim me fuqi më të lartë juridike dhe politike se vetë kushtetuta e vendit (meqë në vete përmban edhe nënshkrimet e përfaqësuesve ndërkombëtarë të SHBA-ve dhe të BE-së), dhe duhet të shërbejë si bazë për interpretimin e 14-të amendamenteve kushtetuese të vitit 2001 që burojnë prej saj; dhe e dyta, në kushte kur pas vitit 2001, RM nuk përkufizohet më si shtet nacional i popullit maqedonas, por shtet shumetnik, shtrohet pyetja se: A është në pajtim me konceptin shumetnik praktika e (keq) përdorimit të simbolit shtetëror (i cili me asgjë nuk shpreh karakterin shumetnik të shtetit) nga ana e maqedonasve si simbol të vetin etnik (kombëtar), një praktikë që përndryshe riciklon konceptin e kombit shtet?!

Nga ana tjetër, në vitin 2008, Gjykata kushtetuese refuzoi parashtrësën dygjuhësore të ish-Kryetarit të Komunës së Tetovës drejtuar kësaj gjykate, me arsyetimin se komunikimi me këtë gjykatë realizohet vetëm në gjuhën maqedonase dhe në shkrimin e saj qirilik gjë që paraqet një shembull praktik për atë se gjuha shqipe dhe shkrimi i saj nuk e gëzojnë statusin e gjuhës dhe shkrimit zyrtar në vend. Çuditërisht, ky refuzim ndodhi vetëm disa muaj pas miratimit të Ligjit për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% të qytetarëve të RM-së dhe të njësive të vetadministrimit lokal të miratuar në gusht të vitit 2008, me çka praktikisht u demaskuan të gjitha premtimet dhe garancat politike se me këtë ligj përfundimisht u zyrtarizua gjuha shqipe dhe shkrimi i saj. Duhet theksuar faktin se ligji në fjalë u miratua një ditë para zgjedhjes së qeverisë së re pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2008 edhe atë për pesë minuta, pa asnjë debat parlamentar dhe një diskutim më të gjerë publik. Është interesante se ligji në fjalë nuk ka lëndë të veten, por paraqet një përshtypje të stilit “copy-paste” të dispozitave të mbi 30-të ligjeve paraprake të miratuar në periudhën e viteve 2002-2008 e që shquhen për nga degradimi dhe segmentimi i gjuhës shqipe.

Sipas përkufizimit, gjuhë zyrtare është gjuha me të cilën komunikojnë organet shtetërore, andaj, argumentet se ligji në fjalë nuk e zyrtarizon gjuhën shqipe dhe shkrimin e saj janë si vijon: seancat plenare të

Kuvendit nuk mund të udhëhiqen edhe në gjuhën shqipe aq më tepër kur njëri nga nënkryetarët e tij është shqiptar (përveç mundësisë që puna e komisioneve parlamentare të udhëhiqet edhe në gjuhën shqipe), ministrat shqiptarë në Qeveri nuk mund të flasin e as të shkruajnë në gjuhën shqipe dhe në shkrimin e saj, gjuha shqipe fare nuk përdoret në Presidencën e shtetit, gjuha shqipe nuk mund të përdoret në armatë dhe në polici, procedurat gjyqësore penale dhe civile si dhe procedurat administrative nuk mund të udhëhiqen edhe në gjuhën shqipe dhe në shkrimin e saj (madje as edhe në gjykatat që veprojnë në njësitë e vetadministrimit lokal ku gjuha shqipe është gjuhë zyrtare në nivelin lokal, si: Qyteti i Shkupit, Tetova, Gostivari, Dibra, Kumanova, Kërçova, Struga, etj.<sup>9</sup>), procedurat tatimore nuk mund të udhëhiqen edhe në gjuhën shqipe, procedurat para Gjykatës kushtetuese, Gjykatës supreme, Avokatit të Popullit, Komisionit Shtetëror Zgjedhor, Drejtorive të ndryshme shtetërore, etj., nuk mund të udhëhiqen edhe në gjuhën shqipe, etj. Pra, shihet qartë se gjuha shqipe nuk trajtohet si gjuhë zyrtare dhe si një e drejtë kolektive, por si një e drejtë individuale, si gjuhë e palës, si gjuhë e individit, si një gjuhë e qasjes, e jo si gjuhë e shtetit përkatësisht si gjuhë e organit shtetëror ose e personit zyrtar në ushtrimin e veprimeve dhe procedurave shtetërore juridike dhe zyrtare.

Kur flitet për statusin e gjuhës shqipe dhe të shkrimit të saj, konstatohen së paku tri paradokse, edhe atë: i pari, paradoksi historik që ka të bëjë me sistemin e shkuar socialist (me të drejtat e fituara të shqiptarëve nga ai sistem) ku, për shembull, e drejta e udhëheqjes së procedurave gjyqësore edhe në gjuhën shqipe dhe në shkrimin e saj ka qenë e garantuar me dispozitën e nenit 17-të të Ligjit për gjykatat e rregullta të vitit 1976, ku thuhej se: “Në territoret e komunave ku jetojnë pjesëtarët e kombësive, nëse me statutin e komunës parashihet përdorimi i gjuhës së kombësisë së caktuar, (atëherë) procedura para gjykatës komunale të themeluar për atë

---

<sup>9</sup> Sipas të dhënave statistikore, nga gjithsej 84 njësi (komuna) të vetadministrimit lokal në RM, në 32 sish (përfshi edhe Qytetin e Shkupit), duhet të ketë dy gjuhë zyrtare mbi bazën e dispozitave kushtetuese (censusi 20%), edhe atë: në 27-të njësi gjuhë zyrtare duhet të jenë maqedonishtja dhe shqipja, në 4 njësi maqedonishtja dhe turqishtja, dhe në një njësi maqedonishtja dhe gjuha rome. Kurse, nga ana tjetër, në një komunë, gjuhë zyrtare duhet të jenë: maqedonishtja, shqipja dhe serbishtja, ndërkaq, në disa komuna, këshillat e tyre komunalë kanë vendosur që si gjuhë zyrtare të jetë edhe gjuha e qytetarëve që nuk përbëjnë 20%-in e popullatës, si p.sh gjuha vllehe në Krushevë, gjuha turke në Dibër dhe Gostivar, etj.

territor udhëhiqet edhe në gjuhën e asaj kombësie”<sup>10</sup>, (pra, paradoksi ka të bëjë me faktin se shqiptarët kanë gëzuar më tepër të drejta gjuhësore në socializëm se sa në demokraci). I dyti, paradoksi praktik përkatësisht në kuadër të mësimi klinik dhe praktik shpesh herë me studentët e Fakultetit tonë marim pjesë në seanca gjyqësore në Gjykatën themelore të Tetovës, ku jemi dëshmitarë të situatave tragji-komike, me ç'rast të gjithë pjesëmarrësit në një procedurë gjyqësore penale ose civile, si: gjyqtari, prokurori publik, avokati, eksperti, dëshmitari, i pandehuri, paditësi, i padituri, paditësi privat, procembajtësi, etj., janë shqiptarë, mirëpo, megjithatë procedurën gjyqësore e zhvillojnë vetëm në gjuhën maqedonase duke komunikuar njëri me tjetrin vetëm në këtë gjuhë?! Dhe, i treti, paradoksi statusor që ka të bëjë me statusin e pakicave kombëtare, përkatësisht Konventa Evropiane për gjuhët regjionale dhe të pakicave e Këshillit të Evropës të 05.11.1992, në dispozitën e nenit 9 (Autorizimet gjyqësore) i detyron shtetet anëtare të KE-së (ku bën pjesë edhe RM) që: “të sigurojnë se gjykatat në procedurat penale, civile dhe administrative, me kërkesë të njëres palë të realizojnë procedurën edhe në gjuhën regjionale ose të pakicës kombëtare”<sup>11</sup>, paradoksi ka të bëjë me faktin se shqiptarët nuk i gëzojnë as edhe të drejtat gjuhësore që kjo Konventë u garanton pakicave kombëtare.

Në këtë drejtim, kur flitet për censusët për gjuhën dhe simbolin kombëtar, është tërësisht e pakuptueshme që për këto dy çështje me bazë të njëjtë meqë i përkasin identitetit dhe kulturës shqiptare e që duhet zgjidhur me analogji, të parashihen dy censuse të ndryshme, edhe atë, censusi prej 20% për gjuhën dhe censusi shumicë në komuna përkatësisht mbi 50% për simbolin kombëtar. Konsideroj se, qëllimi i censusëve të ndryshëm për gjuhën dhe simbolin kombëtar është marginalizimi dhe degradimi i shqiptarëve në RM, kurse nga ana tjetër, që sa më tepër të zhduken tiparet dhe gjurmët dynacionale të realitetit shoqëror dhe etnik në vend. Kështu, gjuha dhe simboli i shqiptarëve, edhe sot e kësaj dite, nuk kanë zgjidhje parimore dhe demokratike meqë, nga njëra anë, ligji në fuqi për gjuhën që flitet nga 20%-i i qytetarëve, lëre që nuk e zyrtarizon gjuhën shqipe, por vazhdon me segmentimin dhe degradimin e mëtutjeshëm të saj gjë që shihet edhe nga ndryshimet dhe plotësimet e fundit të ligjit në fjalë të 25.07.2011 e që parashohin se deputetët dhe funksionarët e zgjedhur ose të emëruar nga

<sup>10</sup> Јаневски, Арсен, “Употребата на јазикот пред судот во парничната постапка во РМ”, Зборник на трудови со наслов: Евроинтеграција-идеи, состојби, реализација, УКИМ, Правен факултет, Скопје, 2002, стр. 55-56.

<sup>11</sup> European Charter for Regional and Minority Languages, Council of Europe, Strasbourg, [www.conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/148.htm](http://www.conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/148.htm).

Kuvendi që flasin gjuhë tjetër nga maqedonishtja, në seancat plenare të Kuvendit ose të komisionit parlamentar mund të flasin në gjuhën e tyre. Segmentimi dhe degradimi konsiston në pamundësinë që gjuha shqipe edhe të shkruhet në Kuvend ose seancat plenare të udhëhiqen edhe në gjuhën shqipe, si dhe nga ana tjetër, pamundësia e ministrave shqiptarë që të flasin e të shkruajnë shqip në Qeverinë e RM-së si dhe të gjitha argumentet e mësipërme lidhur me mos zyrtarizimin e gjuhës shqipe dhe të shkrimit të saj, si gjuhë e shtetit ose e organit shtetëror. Ndërkaq, nga ana tjetër, poashtu edhe ndryshimet dhe plotësimet e fundit të 25.07.2011 të Ligjit për përdorimin e simboleve të komuniteteve në RM vazhdojnë me segmentimin dhe degradimin e tij meqë zmadhojnë censusin shumicë të pikës 7.1. të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në census më tepër se 50%, kurse, nga ana tjetër, neni 8-a përcakton se: “Simboli i RM-së (që siç u nënvizua më sipër maqedonasit e keqpërdorin si simbol të vetin etnik) vendoset me simbolet e tjera dhe është me dimensione për një të tretën më i madh se simbolet e tjerë”<sup>12</sup>, kështu që nuk do koment, se kush është superior e kush inferior në RM. E keqja bëhet më e madhe kur këto zbritje të të drejtave kombëtare edhe ashtu gjysmake, bëhen me votat e përfaqësuesve legjitim politik të shqiptarëve si pasojë e pazarllëqeve të ndryshme për kyçjen e elitave politike shqiptare në pushtetin ekzekutiv.

### **3. Modeli i ndarjes horizontale “power sharing” vs. modelit të ndarjes vertikale (federative) të pushtetit shtetëror**

Modeli i ndarjes horizontale të pushtetit shtetëror i njohur si: “power sharing” ose si: demokraci konsensuale (federalizimi funksional ose jo territorial) nuk paraqet një risi të inkorporuar me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, meqë praktikisht ka filluar të zbatohet qysh nga qeveria e parë e vitit 1991 me kyçjen në të, të partisë politike shqiptare PPD e deri në ditët e sotme, dhe gjatë gjithë kësaj periudhe mbi 20-të vjeçare ka manifestuar më tepër mangësi se sa përparësi në zgjidhjen efikase dhe të drejtë të çështjeve të ndryshme në frymën e barazisë ndëretnike, dhe në këtë drejtim, Marrëveshja Kornizë e Ohrit vetëm se legalizoi një model të zbatuar qysh më herët nga viti 1991.

Në këtë drejtim, në teorinë kushtetuese dhe politike theksohet se, për të qenë ky model efikas dhe i zbatueshëm, duhet plotësuar mbi 12 parakushte, me ç'rast do të veçohen tri kushtet kryesore, edhe atë: së pari,

---

<sup>12</sup> Закон за изменување и дополнување на Законот за употреба на знамињата на заедниците во РМ, “Службен весник на РМ”, број 100, 25.07.2011, член 6.

duhet të ketë ndarje (dallime) brenda komuniteteve që kryqëzojnë, e jo që ndajnë, kështu që në rastin e RM-së, midis dy popujve më të mëdhenj, atij maqedonas dhe atij shqiptar, ka ndarje që nuk kryqëzojnë, por ndajnë njëri-tjetrin, meqë populli maqedonas ka etnitet tjetër, gjuhë tjetër dhe besim fetar tjetër, ndërkaq, populli shqiptar, ka etnitet tjetër, gjuhë tjetër si dhe besim fetar tjetër, kështu që ndarjet që kryqëzojnë konsistojnë tek maqedonasit me besim fetar islam dhe shqiptarët me besim fetar orthodoks ose katolik, të cilët nuk kanë kapacitetin e duhur për të kryqëzuar ndarjet (dallimet); së dyti, mos ekzistimi i partive politike shumë nacionale, por një nacionale (një etnike), me ç'rast partitë politike shqiptare nuk garojnë në tërë territorin e vendit, për dallim prej atyre maqedonase, dhe së treti, nuk duhet të ketë bipolarizim, por një ndarje shumë dimensionale të fuqisë me së paku tri deri në pesë segmente homogjene shoqërore për nga fuqia dhe madhësia, gjë që nuk plotësohet në rastin e RM-së, meqë ka dy segmente më të mëdha, ai maqedonas dhe ai shqiptar, ku gjithë të tjerët (jo maqedonasit dhe jo shqiptarët) së bashku përbëjnë 7%-in e popullatës, si dhe nuk ka homogjenitet zhvillimor midis tyre si për nga fuqia ashtu edhe për nga madhësia, pra segmentet nuk janë homogjene, por heterogjene. Pra, modeli i demokracisë konsensuale nuk arrinë që të balancojë dallimet brenda një tërësie, sidomos në një shoqëri heterogjene siç është RM, dhe nuk mundëson që popujt e ndryshëm të punojnë secili në mënyrën e vetë. Për të mbështetur këtë konstatim, do të veçohen disa shembuj praktik të katërvjeçarit të fundit të qeverisjes politike me vendin: enciklopedia fyese dhe shtre mbëruese historike për shqiptarët e financuar dhe promovuar nga Kryeministri i vendit; ligji diskriminues që financonte fëmijun e tretë dhe të katërt vetëm në komunat e pjesës lindore të RM-së; imponimi i gjuhës maqedonase për fëmijët jo maqedonas që nga mosha gjashtëvjeçare; evidenca pedagogjike vetëm në gjuhën maqedonase; ndryshimi i shtetësisë në pasaportat biometrike ku në grafën e shtetësisë shkruan: “maqedonas” në vend të “i RM-së”; asnjëri nga tri funksionet kyçe të sistemit kushtetues dhe politik të vendit, pra, ai i Kryetarit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe i Kryeministrit, asnjëherë nuk kanë qenë të ushtruar nga shqiptarët; diskriminimi buxhetor në të gjitha sferat e jetës shoqërore shqiptare, si: arsim, kulturë, shkencë, art, bursa studentore, investime, etj.; ministrat shqiptarë menaxhojnë me një përqindje simbolike të mjeteve buxhetore si dhe niveli i ulët i posteve udhëheqëse për shqiptarët në institucione të ndryshme shtetërore dhe publike.

Prandaj, duke u nisur nga fakti se shqiptarët në RM janë popull autokton që jeton në një hapësirë kontinuele gjeografike dhe posedon të

drejtën e pashteruar të vetëvendosjes, shtrohet pyetja nëse duhet ndryshuar trajta e rregullimit shtetëror nga ajo unitare në atë federative ose kantonale?

Në këtë drejtim, njëri nga arkitektët e Kushtetutës së RM-së të vitit 1991 dhe i Amendamenteve kushtetuese të vitit 2001, profesori i të drejtës ndërkombëtare publike në Fakultetin juridik të Shkupit, Ljubomir Fërçkoski, në shkrimin me titull: “Njujork konfidenshënell” të publikuar në të përditshmen maqedonase: ”Dnevnik”, të datës 26.10.2010, flet për konferencën ndërkombëtare të organizuar nga Instituti Amerikan “Hariman” të Universitetit të Kolumbias (Njujork) së bashku me Fakultetin juridik të Shkupit, me ç’rast, siç nënvizon vetë autori, gjatë debatit dhe diskutimeve, kolegët amerikanë kanë filluar të shtrojnë dilemën nëse federalizimi ose kantonizimi i RM-së do të ishte modeli më i mirë për vendin, duke pasur parasysh faktin se modeli i përcaktuar me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, dita-ditës po shndërrohet në një model jo funksional që nuk po jep rezultatet e pritura. Sidomos, nëse vendi nuk gjen rrugëdalje nga kriza lidhur me kontestin për emrin me Greqinë dhe mbetet jashtë strukturave euro-atlantike për një periudhë të gjatë kohore<sup>13</sup>.

Debati lidhur me federalizimin e RM-së, zakonisht, nga klasa politike maqedonase përmbillet qysh në start si një e keqe që do sjell ndarjen e shtetit, pastrime etnike dhe shkëmbime territoresh, dhe ajo që është më absurde, kjo klasë secilës kërkesë më të gjerë politike të subjektit politik shqiptar, si për shembull, kërkesës për autonomi politike, kulturore dhe territoriale të shqiptarëve; kërkesës për zyrtarizimin e gjuhës shqipe dhe të simbolit kombëtar; kërkesës për regjionalizimin e pushtetit lokal përkatësisht inkorporimin e regjionit si shkallë të dytë të vetadministrimit lokal si dhe kërkesës për decentralizimin real të pushtetit shtetëror, i përgjigjet negativisht me arsyetimin se të gjitha këto kërkesa shpiejnë në federalizimin ose kantonizimin e vendit. Edhe pse, kërkesat politike për autonomi ose regjionalizim nuk duhet të jenë fjala e fundit e shqiptarëve meqë, duhet pasur parasysh përvojën kosovare me autonominë e saj në ish-RSFJ, kurse, regjionet janë trupa administrativ, e jo qeveri, dhe kryekëput varen nga pushteti qendror i cili mund t'i shfuqizojë në çdo moment, dhe nga ana tjetër, procesi i decentralizimit në RM, duke filluar nga viti 2005 e këndej mori përmasa triviale të një decentralizimi fiskal me të vetmin efekt që komunat i shndërroi në “postierë” të pushtetit qendror ose “arkëtues” të tatimeve në emër të qeverisë, ndërkaq, RM vazhdoi të mbetet edhe më tej, njëri nga shtetet më të centralizuar në Evropë dhe më gjerë me një vetadministrim lokal tipik njëshkallësh që paraqet një rrallësi në Evropë dhe

---

<sup>13</sup> Фрчкоски, Љубомир, “Њујорк конфиденшл”, Дневник, 26.10.2010, стр. 15.

më gjerë, megjithatë, vendi vazhdon të mbetet jashtë të gjitha trendeve evropiane dhe botërore të organizimit të pushtetit qendror dhe lokal, që do të siguronin qeverisje efikase me diversitetet etnike, fetare, kulturore dhe politike në RM. Nga ana tjetër, shkëmbimi i territoreve dhe i popullatës si pasojë e mundshme e federalizimit, daton nga viti 2001 kur Akademia maqedonase e shkencave dhe e arteve doli me këtë ide, e cila u përkrah edhe nga kryeministri i atëhershëm Ljubčo Georgievski, që përndryshe nuk ka asgjë të përbashkët me realitetin dhe me të vërtetat shkencore, sepse federalizimi nuk nënkupton ndarjen e shtetit, por ndarjen territoriale (vertikale) të pushtetit shtetëror në qendër, në mënyrë që të sigurohet qeverisja efikase me diversitetet etnike, fetare, kulturore dhe politike në RM, që siç u mor vesh, janë diversitete që i ndajnë e nuk i kryqëzojnë maqedonasit dhe shqiptarët.

Në fund, duhet përfunduar me konstatimin e studiuesit të njohur të dy modeleve në fjalë, profesorit të shkencave politike në Universitetin e Aberdinit (Skoci) Majkëll Kiting i cili thekson se, edhe pse këto dy modele në praktikë janë të përzier në forma të ndryshme, megjithatë në Evropën Perëndimore trendet aktuale më tepër janë të orientuar kah organizimi territorial, për arsytet si vijon: së pari, dita-ditës, territori po bëhet një parim që është më inkluziv se sa parimi i identitetit grupor; së dyti, tendencat kah identiteti i grupeve me gjuhën dhe territorin, poashtu janë në rritje, dhe së treti, botëkuptimi i ri ndaj territorit, që është më pak i lidhur me kufijtë, në suaza të të cilit sistemet e ndryshme funksionale mund të kenë kufij të ndryshëm, mirëpo që të jetë ironia më e madhe, në vendet ku federalizmi është më se i nevojshëm pra, vendet ku mungon mirëbesimi dhe vullneti i mirë, pikërisht në këto vende është shumë vështirë të funksionojë ky koncept<sup>14</sup>.

### Shqyrtimet përfundimtare

- Romakët kanë thënë: “Mortus exitus non est exitus” - “Suksesi i dobët nuk është sukses” dhe “Quod initio vitiosum est, non potest tractu temporis convalescere” - “Çka është e shtrembër që nga fillimi, nuk mund të korigjohet me kalimin e kohës”, që vlen për 20 vjetorin e miratimit të Kushtetutës së RM-së (e miratuar pa votën e deputetëve shqiptarë) si dhe 10 vjetorin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, të cilat nuk rikthyen statusin e popullit konstitutiv për shqiptarët, status ky që u shfuqizua (u fshi) me

<sup>14</sup> Keating, Michael, “Federalism and the Balance of Power in European States”, SIGMA, OECD, Paris, 2007, p. 38;

Amendamentin LVI të vitit 1989 për Kushtetutën e RM-së të vitit 1974 nën ndikimin e drejtpërdrejtë të diktatorit serb Millosheviq ngjashëm siç veproi me shfuqizimin e autonomisë së Kosovës. Madje, edhe preambula kushtetuese në fuqi e vitit 2001, edhe pse i vendosë qytetarët si konstituensë të shtetit, prapsepapë popullin maqedonas e përkufizon si etnos (komb), ndërkaq, shqiptarët si pjesë të popullit, përkatësisht pakicë kombëtare, gjë që paraqet një diskriminim të hapur të qytetarëve qysh në hyrje të Kushtetutës.

- Lidhur me statusin e gjuhës shqipe dhe të simbolit kombëtar, u konstatua se aktet kushtetuese dhe ligjore në fuqi nuk i zyrtarizojnë këto dy vlera, por ende më tepër i degradojnë dhe i segmentojnë në drejtim të marginalizimit të tyre me qëllim të zhdukjes së tipareve dhe gjurmëve dynacionale të realitetit shoqëror dhe etnik në vend meqë siç u mor vesh, aktet kushtetuese dhe ligjore nuk e trajtojnë gjuhën shqipe dhe shkrimin e saj si gjuhë zyrtare dhe si një e drejtë kolektive, por si një e drejtë individuale, si gjuhë e palës, si gjuhë e individit, si një gjuhë e qasjes, e jo si gjuhë e shtetit përkatësisht si gjuhë e organit shtetëror ose e personit zyrtar në ushtrimin e veprimeve dhe procedurave të ndryshme gjyqësore dhe zyrtare;

- Në punim u konstatua se RM-ja nuk i plotëson tri parakushtet kryesore për funksionimin efikas të modelit të demokracisë konsensuale (federalizimit jo territorial) e njohur edhe si: “power sharing”, me ç’rast disa elemente të tij funksionojnë që nga viti 1991, përkatësisht që nga qeveria e parë shumëpartiake e deri sot duke manifestuar më tepër mangësi se sa përparësi në qeverisjen 20-të vjeçare me diversitetet etnike, fetare, kulturore, sociale dhe politike në vend. Pra, edhe pse në të gjitha përbërjet e qeverive në vend nga e para e vitit 1991 e deri tek ajo e fundit e vitit 2011 kanë marrë pjesë parti të ndryshme politike shqiptare, megjithatë, sistemi në fjalë nuk paraqet një formë të ndarjes së pushtetit, por një orvatje për kyçjen e elitave politike shqiptare në qeveri;

- Duke pasur parasysh konstatimet e mësipërme, sugjerohet që në të ardhmen në rrugë shkencore, politike dhe demokratike të promovohet federalizimi si një model i ndarjes territoriale (vertikale) të pushtetit shtetëror në qendër përmes një procesi të zëvendësimit të akteve ekzistuese kushtetuese me akte të reja kushtetuese, sepse kjo trajtë e rregullimit shtetëror siguron një qeverisje efikase me diversitetet etnike, fetare, kulturore, historike, sociale dhe politike në vendet ku funksionon si për shembull: Zvicra dhe Belgjika, dhe si e tillë u përgjigjet në tërësi edhe rrethanave shumë-dimensionale të RM-së.



**Doc. Dr. Jeton SHASIVARI**

## **The Status of Albanians in the Legal, Constitutional and Political System of the Republic of Macedonia**

### *Summary*

Romans said: “Mortus exitus non est exitus”-“Weak success is not success” and “Quod initio vitiosum est, non potest tractu temporis convalescere”-“What is crooked from the beginning, cannot be corrected over time”, that goes for 20 anniversary of the adoption of the Constitution of the Republic of Macedonia (adopted without a vote of the Albanian MPs) and 10'th anniversary of the Ohrid Framework Agreement, which didn't return to the constitutive status of the Albanians, a status that was abolished (was deleted) with Amendment LVI of 1989 on the RM Constitution of 1974 under the direct influence of the Serbian dictator Milosevic acted similarly to the abolition of Kosovo's autonomy. Even the Constitutional preamble in force in 2001 although sets the citizens as constitutive elements, however defines the Macedonian people as a nation (ethnos) and Albanians as a part of people (national minority), which represents an open discrimination of citizens.

Regarding to the status of the Albanian Language and Albanian national symbol, it was concluded that the Constitutional and legal acts in force in RM did not formalize this two values, but still more marginalize and degrade them, in order to eliminate the traits and traces of two national (two ethnic) reality of the country.

The paper concludes that RM does not meet the three main prerequisites for effective functioning of Consensual democracy model (non-territorial federalization) also known as "Power sharing", where some elements of this model works since 1991, respectively, since the first multi-party and multi-ethnic government until today, manifesting more

disadvantages than advantages in the 20-year political governance with the ethnic, religious, cultural, social and political diversity. Although in all governments, in the first place by the 1991's up to it last year 2011, participated various Albanian political parties, however, the system does not represent a form of power sharing, but an attempt to involve Albanian political elites in Government of Republic of Macedonia;

Considering the above findings, author suggests the promotion of Federalism in scientific, political and democratic way as a model of territorial (vertical) split of state power in the center through a process of replacing the existing Constitutional acts with new one, because the Federalism provides an efficient governance with ethnic, religious, cultural, historical, social and political diversity in countries where it functions as for example, Switzerland and Belgium, and fully respond to the main circumstances in Republic of Macedonia.

Ma. Sc. Hashim Çollaku

## Fillimi, qëllimi dhe zbatimi i hetimit

### Hyrja

Në punim, kam trajtuar temën fillimi i hetimeve, qëllimi dhe zbatimi i hetimit, duke pasur parasysh që sipas dispozitave ligjore gjatë punës, hetimet janë çështje me rëndësi për përfundimin e punës rreth çështjes penale të filluar. I autorizuar për zbatimin e hetimeve, sipas Kodit të procedurës penale të Kosovës është prokurori<sup>1</sup> (në vazhdim KPPK), i cili përfaqëson organin ndjekës.

Me hyrjen në fuqi të KPPK, nga 6 prilli 2004, prokurori publik ka kompetenca më të mëdha, në krahasim me rolin e prokurorit publik, sipas ligjit të aplikuar që ishte në fuqi në Kosovë (Ligji i procedurës penale) sipas rregullores së UNMIK-ut<sup>2</sup>.

Sipas dispozitave ligjore, konkludohet me të drejtë se hetimet kanë kaluar në kompetencë të prokurorit, që jep të kuptojmë se ngadalë po braktiset tipi inkuizitor i procedurës penale dhe po kalohet në tipin akuzator.

Kalimi në hetimin e çështjeve penale në kompetencë të prokurorit, paraqet domosdoshmërinë për ngritjen dhe shtimin e profesionalizimit të kapaciteteve njerëzore, përkundër asaj se stafi ekzistues shquhet me profesionalizëm. Shtimi i numrit të prokurorëve, jep të kuptojmë se qasja në këtë drejtim është më se serioze sa i përket zbulimit të rasteve dhe ndjekjes së kryerësve të veprave penale. Me KPPK, procedura penale zhvillohet ndaj kryerësve madhorë të veprave penale, por edhe ndaj kryerësve të mitur të veprave penale është menduar nga se është nxjerrë Kodi i Drejtësisë për të Mitur i Kosovës (në vazhdim KDM)<sup>3</sup>.

Sa i përket nxjerrjes së provave dhe barra e provës ka kaluar në kompetencë të prokurorit, i cili ka obligim që nga fillimi i hetimit në çështjen penale të përkujdeset për nxjerrjen e provave në kuptim të dispozitave ligjore. KPPK ka paraparë që prokurori publik përkujdeset për fillimin e hetimit që nga procedura parapenale, duke qenë aktiv në

<sup>1</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2004/26, 25 korrik 2004, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

<sup>2</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 1999/01, 25 qershor 1999, Për autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë.

<sup>3</sup> Kodi Penal i Drejtësisë për të Mitur nr 03/L-193 08 korrik 2010.

mbledhjen e provave të kërkuara me të vetmin qëllim që të jetë sa më i suksesshëm në fitimin e rastit.

## 1. Fillimi dhe zbatimi i hetimeve

Për të hetuar një çështje penal, duhet pasur parasysh të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, që janë të garantuara me aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare si dhe kushtetutën e vendit dhe ligjet e tjera pozitive. Duke u nisur nga Deklarata e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat dhe Liritë të Njeriut<sup>4</sup>, Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut<sup>5</sup>, Paktin Fakultativ për të drejtat civile dhe politike<sup>6</sup>, Konventën mbi të Drejtat e Fëmiut<sup>7</sup>, etj, si dhe kornizën ligjore vendore.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Kapitullin e dytë parasheh të drejtat dhe liritë themelore të garantuara<sup>8</sup>, të cilat respektohen gjatë punës, të parapara dhe me KPPK, KPDM, që kujdes i posaçëm i kushtohet gjatë hetimit të çështjes penale.

Sipas nenit 46 të KPPK: *“zyra e prokurorisë publike është organ i pavarur përgjegjës, për hetimin e veprave penale, për ushtrimin e ndjekjes penale, ndaj personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e të dëmtuarit, për mbikëqyrjen e punës së policisë gjyqësore gjatë hetimit të personave të dyshuar, për kryerjen e veprave penale dhe përmbledhjen e të dhënave dhe informacioneve për fillimin e procedurës penale. Prokuroria publike kryen edhe punë të tjera të parapara me ligj”*.

Në vijim të këtij neni janë të parapara edhe dy paragrafë, në të cilët si dhe në nenet tjera flitet për autorizimet e prokurorit publik. Vlerësuar dispozita ligjore përkatëse, vërehet se prokurori publik punën e mbështet në kuadër të autorizimeve që i takojnë sipas ligjit.

Shikuar dispozitat ligjore të Kodeve të procedurës penale të disa shteteve nga rajoni, rolit i prokurorit publik gjatë hetimeve, për ndjekjen e kryerësve të veprave penale:

- sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë: *“prokurori publik ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet*

<sup>4</sup> Neni 9 dhe 10, i Deklaratë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat dhe Liritë të Njeriut, 10 dhjetor 1948.

<sup>5</sup> Neni 5 i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, 1950.

<sup>6</sup> Neni 9 dhe 14 i Paktit Fakultativ për të drejtat civile dhe politike, 1966.

<sup>7</sup> Neni 2 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmiut, 1989.

<sup>8</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës në fuqi nga 15 qershori 2008, Kapitulli i dytë neni 24 dhe 29.

*paraprake ngritë akuzë në gjykatën kompetente, dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara me këtë kod”, etj<sup>9</sup>.*

-sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Malit të Zi, prokurori publik ka autorizim të udhëheq me procedurën parapenale, të bënë kërkesë për fillimin e hetimeve dhe të drejtojë rrjedhën e procedurës parapenale në përputhje me dispozitat ligjore, etj<sup>10</sup>.

- sipas Kodit të Procedurës Penale të Kroacisë, prokurori publik ndërmerr ndjekjen kundër kryerësit të veprës penale dhe nxjerr aktvendimin për fillimin e hetimeve, për të filluar me grumbullimin e provave të duhura, dhe ndërmerr veprimet e tjera në kuadër të dispozitave ligjore<sup>11</sup>.

- sipas Kodit të Procedurës Penale të Serbisë, autorizimet e prokurorit publik janë që të udhëheqë me procedurën paraprake, të bëjë kërkesë për fillimin e hetimeve në gjykatën kompetente, etj<sup>12</sup>.

- sipas Kodit të Procedurës Penale të Bosnjës dhe Hercegovinës, prokurori publik ka autorizime të mbikëqyr hetimet dhe të ndërmerr ndjekjen penale, të udhëheq me hetimet pasi ta nxjerr aktvendimin për fillimin e hetimeve , etj<sup>13</sup>.

Duke vlerësuar dispozitat ligjore të KPPK, sa i përket zhvillimit të procedurës penalo- juridike, dallojmë tri faza:

- fazën e hetimit, që identifikohet me tri nën faza , nën fazën e ndërmarrjes së veprimeve para penale, nën fazën e fillimit të hetimeve si dhe nën fazën e mbledhjes së provave deri në ngritjen e aktit akuzues përkatës,

- fazën e shqyrtimit gjyqësor, që identifikohet me prezencën aktive të prokurorit publik , nga prezenca në konfirmimin e akt akuzës, në

<sup>9</sup> Neni 24 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë( i azhurnuar) Tiranë 2004.

<sup>10</sup> Neni 44 i Kodit të Procedurës Penale të Malit të Zi, ku flitet për autorizimet e prokurorit publik, mbështetur dhe në Kushtetutën e Malit të Zi, neni 105 dhe neni 106, (Grubac, Momcilo, Vuckovic, Branko, Komentar Zakonika i Krivicnom Postupku, Cetinje, Obod 2006).

<sup>11</sup> Neni 38 i Kodit të Procedurës Penale të Kroacisë, (Ranko Mrijan, Zakon o Kaznenom Postupku NN 152/08, 76/09, Narodne Novine d.d , Zagreb, srpanj 2009).

<sup>12</sup> Neni 45 i Komentarit të Kodit të Procedurës Penale të Serbisë, (Skulic, Milan,Komentar Zakonika o Krivicnom Postupku, Beograd 2007).

<sup>13</sup> Neni 35 i Kodit të Procedurës penale të Bosnjës dhe Hercegovinës,( Komentar Zakona o Krivicnom Postupku, od 26 januara 2005, Sarajevo

pjesë marrjen në shqyrtimin gjyqësor deri në marrjen e aktgjykimit ose aktvendimit,

- fazën e veprimit sipas mjeteve juridike (mjeteve të rregullta dhe mjeteve të jashtëzakonshme).

Me të pranuar të kallëzimit penal, prokurori publik ka obligim ta vlerësojë dhe pastaj të vendosë për fillimin ose mos fillimin e hetimeve. Kallëzimi penal i pranuar shikohet a i përmbush kriteret e kërkuara sipas dispozitave ligjore: a ofron prova të mjaftueshme për fillimin e hetimeve, a është i njohur i dyshuari i mundshëm, pastaj vendoset për fillimin e hetimeve<sup>14</sup>.

Nga kallëzimi penal në bazë të provave të mbledhura, prokurori publik vjen në përfundim për ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm, për të filluar hetimet. Hetimet fillojnë kundër personit për të cilin dyshohet se ka kryer veprën penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare<sup>15</sup>. Hetimet fillojnë me aktvendim për fillimin e hetimeve<sup>16</sup>, nga i cili dihet personi i dyshuar kundër të cilit fillohen hetimet, koha e fillimit të hetimit, përshkrimi i veprës penale<sup>17</sup>, etj.

Nëse nga kallëzimi penal, i dyshuari për veprën penale të kryer është i panjohur dhe paraqiten vështirësi të tjera për punë, prokurori publik urdhëron që kallëzimi penal të plotësohet<sup>18</sup>. Me kërkesën për plotësim e kallëzimit penal, kërkohet nga parashtruesi i kallëzimit penal të mbledh prova të tjera shtesë, që kanë të bëjnë me dëgjimin e dëshmitarëve, të dëmtuarit, sigurimin e informacioneve të tjera, provave të duhura të ndërlydhura me çështjen penale për tu hetuar.

---

<sup>14</sup> Hp nr 01/2009, rasti penal i 08 01 2009, janë filluar hetimet me aktvendimin për fillimin e hetimeve 08 01 2009 për veprën penale vrasje nga neni 146 KPK dhe veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll dhe në posedim në mënyrë të paautorizuar e armëve nga neni 328 par 2 KPK të pandehurit Gj P, gjatë grumbullimit të provave dhe vlerësimit të tyre, është nxjerrë aktvendimi për zgjerimin e hetimeve, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 147 par 1 nën par 9, dhe aktakuza është ngritur për këto vepra penale.

<sup>15</sup> Neni 220 I KPPK

<sup>16</sup> Neni 221 i KPPK

<sup>17</sup> Hp nr 249/09, rasti penal, në të cilin janë filluar hetimet, për shkak të veprës penale kontrabandimi me migrant si bashkëkryerës, nga neni 138 par 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, vërehet që gjatë punës janë respektuar drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara nga Kushtetuta si dhe Ligjet tjera pozitive.

<sup>18</sup> Neni 209 i KPPK

Udhëzimet e prokurori publik, për parashtruesin e kallëzimit penal duhet të jenë të qarta dhe precize që lehtësojnë punën e mëtejme. Bashkëpunimi në mes të prokurorit dhe parashtruesit të kallëzimit penal, është i vazhdueshëm, me qëllim që çështja penale të merr rrjedhën e duhu gjatë hetimit<sup>19</sup>.

Gjatë hetimeve, prokurori publik mbledh provat e duhura, dëgjon të pandehurin, të dëmtuarin, dëshmitarët, ekspertët, si dhe ndërmerr të gjitha veprimet sipas autorizimeve ligjore deri në përfundim të hetimit. Gjatë fazës së hetimit palët tjera të parapara sipas dispozitave ligjore, si dhe gjykata, mund të bëjnë kërkesa për nxjerrjen e provave të reja, për të cilat mendohet se i kontribuojnë zbardhjes së rastit.

Respektimit të dispozitave ligjore, i kushtohet kujdes i shtuar gjatë nxjerrjes së provave të duhura si ato me të cilat pretendohet të vërtetohet fajësia, pa i lënë anash edhe provat shfajësuese që shkojnë në favor të pandehurit.

## 2. Qëllimi i zbatimit të hetimeve

Pas pranimit të kallëzimit penal, prokurori publik bën vlerësimin e të njëjtit, për të vërtetuar, se kallëzimi penal a e përmbushë anën juridike për të filluar hetimin në çështjen penale të caktuar. Obligim i prokurorit është, që të shikoj, që provat të cilat e mbështesin kallëzimin penal a paraqesin bazë juridike për të filluar me punë rreth hetimit penal.

Në këtë mënyrë, prokurorit publik i krijohet mundësia, që pas vlerësimit të kallëzimit penal, ka disa mundësi:

- mund të kërkoj plotësimin e tij me kërkesën përkatëse,
- të vendosë për hedhjen e kallëzimit penal nga bazat e parapara ligjore,
- të nxjerr aktvendimin për fillimin e hetimeve, ose
- të vendos për ngritjen e aktit akuzues po që se ka prova të mjaftueshme.

---

<sup>19</sup> Hp nr 288/ 07 rasti penal i dt 11 01 2008, nga ana e prokurorit publik është bërë kërkesa për plotësimin e kallëzimit penal, pasi që informacioni nga kallëzimi penal nuk ka qenë i mjaftueshëm për nxjerrjen e aktvendimit për fillimin e hetimeve. Në këtë rast është kërkuar që të bëhet edhe një here dëgjimi i të dëmtuarit, të bëhet sigurimi i adresës së të pandehurit, e më pastaj të fillohet me hetimin penal.

Me të pranuar të kallëzimit penal prokurori publik e lexon kallëzimin penal, vlerëson provat dhe vendos për fillimin e hetimeve. Përcaktohet për kualifikimin juridik, për të fituar bazën për fillimin e punës, që nënkupton se fillon hetimet, përcakton ritmin e punës për procedimin e provave të duhura që kanë të bëjnë me çështjen penale. Vazhdimisht provat e nxjerra vlerësohen dhe pas përfundimit dhe vlerësimit vendos për ngritjen e aktit akuzues, në të kundërtën me aktvendim i pushon hetimet. Pushimi i hetimeve është veprim procedural që ndërlihet me atë se mungon baza e mjaftueshme për të vazhduar ndjekjen penale.

Për hedhjen e kallëzimit penal prokurori vendos, kur i vlerëson provat nga kallëzimi penal, andaj, bazuar në dispozitat ligjore vendos për hedhjen

Kushtet ligjore për hedhjen e kallëzimit penal janë:

- vepra penale a është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare,
- a është vlerësuar afati i parashkrimit për ndjekjen penale,
- vepra penale a është përfshirë me amnisti ose falje,
- personi ndaj të cilit është filluar ndjekja penale gëzon imunitet, si dhe
- cilat janë rrethanat tjera të duhura që e përjashtojnë ndjekjen penale<sup>20</sup>.

Kallëzimin penal të pranuar, prokurori publik ka mundësinë që ta hedhë<sup>21</sup>, por duhet ta dijë që është i obliguar ta njoftojë palën e dëmtuar në kuptim të dispozitës përkatëse ligjore. Ky veprim ndërmerret me qëllim që i dëmtuari, mos të privohet nga e drejta ligjore për vazhdimin e ndërmarrjes së ndjekjes penale<sup>22</sup>.

---

<sup>20</sup> Neni 208, KPPK.

<sup>21</sup> PP nr 15/2009 rasti penal, i pranuar në prokurori si kallëzim penal 581/01-28 01 2009 ndaj të dyshuarve B Z, ShP, për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale të grabitjes nga neni 255 të KPK, veprën penale mundësimi në prostitucion nga neni 201 të KPK, dhe veprën penale kontrabandimi me migrant nga neni 138 të KPK, kallëzimi penal nuk ka dhënë bazë të mjaftuar për të filluar hetimet, është kërkuar që të bëhet plotësimi, rreth mbledhjes së informatave shtesë, , kurse me datën 05 06 2009 është hedhë ne kuptim të nenit 208 të KPPK.

<sup>22</sup> Neni 62, KPPK.



### 3. Nxjerrja e provave nga ana e prokurorit publik

Duke pasur parasysh që çështjen penale e cila hetohet e karakterizojnë provat e ndryshme, si personale ashtu edhe materiale, prokurori publik e saj e mbështetë në dispozita e KPPK- së. Provat e mbështetura në dispozitat ligjore, janë të pranueshme për punë të mëtutjeshme, lehtësojnë punën e prokurorit publik, që pas vlerësimit të vendos për të ngritë aktin akuzues, apo të pushoj hetimet. Provat e nxjerra duke respektuar dispozitat ligjore dhe procedurën përkatëse paraqesin lehtësi për gjykatën kompetente.

Provat e nxjerra dhe të bazuara në ligj shërbejnë për punë të mëtejme, kurse ato që nuk nxirren në kuptim të dispozitave ligjore mund të hedhen si të papranueshme.

Ndërmarrja e veprimeve të kërkuar të bazuara në dispozitat ligjore, në çështjet penale janë me rëndësi, sidomos te hetimet para se të nxirret aktvendimi për fillimin e hetimeve. Për nxjerrja e provave që karakterizon çështjen penale të caktuar, prokurori publik duhet ti kushton kujdes sidomos gjatë punës me masat e fshehta dhe teknike të hetimit dhe të vëzhgimit<sup>23</sup>, si institute të reja të parapara në KPPK.

Kur jemi te teknikat e veprimit me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit, duhet pasur parasysh aktivitetin e prokurorit me këto masa, si dhe zbatimin e procedurës së paraparë me ligj.

Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit për herë të parë janë paraparë sipas Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2002/6 të 18 mars 2002, ashtu që me të drejtë konstatohet se këto janë institute të reja në procedurën penale. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 26/2003 të 6 korrik 2003, Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës, në fuqi nga 06 prill 2004, si dhe Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës. Nga 20 prill 2004, iu bashkëngjitet Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 8/2004, Ligji Penal për të Mitur i Kosovës, që paraqet të arritje të mëdha në lëmin penale dhe shkëputjen e kontinuitetit të ligjeve të aplikuara sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 24/99 të 12 dhjetor 1999.

KPPK ka paraparë shumë risi në krahasim me LPP<sup>24</sup>, ndër të tjera si institute të reja ka paraparë masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të

---

<sup>23</sup> Kapitulli XXIX, neni 256-267, KPPK.

<sup>24</sup> Ligji i Procedurës Penale të RSFJ-së, gazeta zyrtare, e RSFJ nr 4/77, 01 korrik 1977, i cili ka shfuqizuar Ligjin e Procedurës Penale, gazeta zyrtare e RSFJ nr 50/67, 54/70 dhe

hetimit. Sipas KPPK-së në kuadër të autorizimeve, prokurori publik përkujdeset dhe udhëheq me hetimin e çështjes penale, prej momentit kur informohet nga ana e policisë se ka ndodhur rasti dhe duhet filluar punën për ndriçimin e tij. Fillohet me grumbullimin e provave të kërkuara për ta identifikuar rastin dhe krijim e kushteve për fillimin e hetimit.

Gjatë punës me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit duhet pasur kujdes të posaçëm, sepse me të njëjtat cenohet e drejta e privatësisë e garantuar me aktet dhe instrumentet tjera ndërkombëtare si dhe ligjet vendore<sup>25</sup>. Përndryshe, këto masa janë të parapara në një kapitull të posaçëm të KPPK-së, duke u shpjeguar procedura dhe puna me to.

#### 4. Marrja në pyetje e të pandehurit

Pasi nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve nga ana e prokurorit, menjëherë fillohet me procedim dhe hartimin e planit të punës. Palët, të cilat është vlerësuar se duhet thirrur, prokurori i fton me thirrje, që është paraparë si masë për sigurimin e prezencës së të pandehurit sipas nenit 268 të KPPK-së. Thirrja<sup>26</sup> është masa e parë për sigurimin e prezencës së të pandehurit, përkundër asaj që janë të parapara edhe 7 masa të tjera në KPPK<sup>27</sup>.

Në thirrje shënohet, logo e prokurorisë kompetente, numri i lëndës, emri dhe mbiemri i të pandehurit, vendbanimi dhe adresa e saktë, vepra penale për të cilën janë filluar hetimet, data e paraqitjes në prokurori, si dhe zyra ku duhet paraqitur. Në ftesë është vërejtja se si duhet vepruar dhe të paraqitet, në të kundërtën do të veprohet sipas ligjit, për t'u sjellë me forcë<sup>28</sup>.

---

6/73, ashtu që rregullat që janë nxjerrë në bazë të këtij Ligji dhe dispozitat e tjera që janë në kundërshtim me Ligjin e Procedurës Penale të theksuar, me gazetën zyrtare të RSFJ nr 26 të 16 maj 1986, hynë në fuqi Ligji mbi Procedurën Penale.

<sup>25</sup> Neni 12 i Deklaratës së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Neni 17 Paktit Fakultativ për të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 36 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, etj

<sup>26</sup> Neni 269 i KPPK.

<sup>27</sup> Neni 268, KPPK, Kapitulli XXX, Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, pengimin e rikrjerjes së veprës penale dhe sigurimin e suksesshëm të zhvillimit të procedurës penale, thirrja, urdhërarresti, premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin, ndalimin për t'u ofruar vendit ose personit të caktuar, paraqitja në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpia dhe paraburgimi.

<sup>28</sup> Neni 269 par 2 KPPK.

Në thirrje i bëhet me dije të pandehurit, se mund të angazhojë mbrojtës, i cili mund të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje. Varësisht prej natyrës së lëndës, nëse i pandehuri nuk ka angazhuar mbrojtës, këtë të drejtë e ka të garantuar sipas KPPK-së dhe ligjeve të tjera varësisht prej natyrës së lëndës

Nëse i pandehuri gjendet në paraburgim, është obligim i prokurorisë që të respektojë të gjitha dispozitat ligjore rreth garantimit të drejtave, por këto të drejta duhet gëzuar prej momentit kur gjendet në ndalim policor. Nëse nuk respektohen, i dyshuari, ka të drejtë ankese te gjykatësi i procedurës paraprake në gjykatën kompetente.

Personi për të cilin dyshohet se ka krye veprën penale, nga ana e subjektit përkatës mund të ndalohej, por është obligim që menjëherë të vihet kontakti me prokurorin kujdestar, për veprim të mëtejshëm. Obligim i policisë për ta njoftuar prokurorin për veprim të mëtejshëm sepse brenda gjashtë orëve duhet ta merr urdhrin për veprim të mëtejshëm në të kundërtën, personin e ndaluar duhet liruar.

Gjatë kohës derisa gjendet në polici, prokurori duhet të ndërmerr të gjitha masat në kuadër të autorizimeve që për të dyshuarin të respektohen afatet ligjore për veprim brenda 48 orëve, për kryerjen e punëve nga prokurori dhe dërgimin para gjykatësit të gjykatës kompetente<sup>29</sup>. Kjo është paraparë edhe KRK në nenin 29 para 2 -***“çdo kush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit në gjuhën që ai – ajo e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdo kush që privohet nga liria pa urdhrin të gjykatës brenda 48 orësh duhet të dërgohet përpara gjykatësit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se 48 orë nga momenti kur personi i privuar është sjell para gjykatës. Çdo kush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/ tij para gjykimit.”***

Në shikim të parë, dispozita si e tillë krijon hapësirë të përshtatshme, sa i përket respektimit të Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, konkretisht

---

<sup>29</sup> Neni 212 par. 4, KPPK, si dhe Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e KPPK-së, nr 03/L-003, neni 4 (i cili fletë për ndryshimin e bërë në KPPK-së dhe zëvendësimi i fjalës shtatëdhjetë 72 me fjalën katër dhjetë e tetë 48).

privimit prej lirisë, që janë harmonizuar me aktet dhe marrëveshjet ndërkombëtare<sup>30</sup>.

Në aktvendimin mbi ndalimin e personit të arrestuar, oficeri i autorizuar i policisë, merre shënimet, njofton të ndaluarin për arsyen e arrestimit, për veprën penale për të cilën dyshohet se e ka kryer, si dhe për të drejtën që mundet për ta kundërshtuar aktvendimin. Kundërshtimi, i paraqitet gjyqtarit të procedurës paraprake të gjykatës kompetente, për të cilën çështje është i obliguar gjyqtari të vendosë brenda afatit prej 48 orëve

#### **4.1. Marrja në pyetje e të pandehurit në polici**

Sipas KPPK i dyshuari për veprë penale, kur të arrestohet vendoset në lokalitetin e posaçëm, i cili është i ndarë për kategorinë e personave të privuar nga liria. Me vendosjen, atëherë fillohet me punë për rastin konkret, duke filluar nga marrja në pyetje.

Para se të merret në pyetje nga ana e policisë, personi i ndaluar duhet të njoftohet për të drejtat që i takojnë në kuptim të dispozitave ligjore<sup>31</sup>. Të drejtat që i takojnë personit të arrestuar dhe duhet të informohet për to janë:

- e drejta për tu njoftuar për arsyet e arrestimit,
- e drejta për tu intervistuar në gjuhën amtare ose në gjuhën të cilën ai e kupton zhvillimin e procedurës,
- e drejta për të pasur mbrojtës,
- e drejta për të heshtur, për mos dhënë deklaratë, përpos shënimeve personale, për të vërtetuar identitetin,
- e drejta në përkthim falas,
- e drejta për të njoftuar dikë prej familjes se është arrestuar,

<sup>30</sup> Deklaratën Universale për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut neni 11, Paktit Ndërkombëtar fakultativ për të drejtat civile dhe politike të vitit 1966 dhe protokollet e saj, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut të vitit 1950, në nenin 2/b që fletë për të drejtën për jetë, në mes të tjerash: **“për të kryer një arrestim të rregullt, ose për të penguar arratisjen e një personit ligjërisht të burgosur”**, neni 5 që fletë për të drejtat për liri dhe siguri, që ekskluzivisht i referohet çështjes së privimit prej lirisë.

<sup>31</sup> Neni 214, KPPK.

- e drejta për vizitë mjekësore për t'u konstatuar se mos ka ndonjë ngarkesë që e pengon në zhvillimin e mëtutjeshëm të procedurës, dhe duhet ofruar edhe trajtimi mjekësor psikiatrik.

Me theks të posaçëm duhet theksuar se personi i arrestuar po që se është shtetas i vendit të huaj, pra i vendit të tjetër, atëherë duhet bërë përpjekje që të vihet kontakti me misionin diplomatik të shtetit shtetas i të cilit është. Nëse vendi nuk ka të vendosura marrëdhënie diplomatike me atë shtet, shtetas i të cilit është kryesi i veprës penale, duhet mundësuar shfrytëzimin e kanaleve diplomatike, në mënyrë që t'i sigurohet komunikimi me vendin shtetas nga është.

Të drejtat e garantuara duhet respektuar, prej momentit kur personi i dyshuar si kryes i mundshëm i veprës penale, është ndaluar nga ana e policisë, si dhe gjatë të gjitha fazave të procedurës.

Sa i përket marrjes në pyetje të pandehurit, me ligj është e ndaluar që të ushtrohet dhunë, torturë etj. Përndryshe, personat që kanë kaluar nëpër dyer të policisë në ish regjimin Jugosllav, janë torturuar nga dhuna e ushtruar. Torturat dhe poshtërimet kanë qenë të llojit më të ulët, duke u munduar që ta shkatërrojnë mendjen dhe ta dëmtojnë trupin e personit i cili është marrë në pyetje.

Është ushtruar dhunë sistematike, rrahje me mjete prej më të ndryshmeve, me përdorimin e mjeteve të ngurta, mjeteve elektrike, djegien e pjesëve të trupit, dëmtimin e dhëmbëve, dhunë seksuale deri te marrja e jetës.

Kjo formë e dhunës është ushtruar te popullsia shqiptare e cila nuk është pajtuar me regjimin serbo sllav. Është arritur deri te ajo formë që nga dhuna e ushtruar, viktimat nuk kanë mundur që ta marrin veten me muaj të tërë, ka pasur raste që kanë vdekur nëpër burgje të cilat raste fare mirë njihen. Gjithashtu, torturimi, dhuna është ushtruar edhe ndaj personave të dënuar që kanë qenë në vuajtje të dënimit Metodot e torturimit të përdorur, karakterizohet me ushtrimin e dhunës ndaj të burgosurve, siç është i njohur rasti në burgun famëkeq të Goli Otokut, si dhe burgjet e tjera.

Nxjerrja e deklaratës në këtë formë, ka pasur për qëllim që ta thyejë shpirtërisht të paraburgosurin, të burgosurin, të dënuarin që t'ia ulin dinjitetin njerëzor, ta poshtërojë, etj<sup>32</sup>.

---

<sup>32</sup> Shkrimi i Dr. Sabile Keçmezi - Basha në gazetën ditore "Epoka e Re", 2 dhjetor 2009, vazhdimi i dytë, fq. 15. "Të burgosurit nuk janë si njerëzit që shohin diellin, yjet. Kanë

#### ***4.2. Marrja në pyetje e të pandehurit në prokurori***

Me të pranuar kallëzimin penal në prokurorin kompetente, prokurori në kuadër të autorizimeve të veta, e nxjerr aktvendimin për fillimin e hetimeve. Është me rëndësi që prokurori publik pasi që ta shikojë kallëzimin penal, vëren se është lëndë paraburgimi, vepron me urgjence, nga se është i lidhur me afatin kohor prej 48 orëve. Në të kundërtën nëse është lëndë për procedurë të rregullt, vepron sipas ritmit të punës që e përcakton.

Nëse i pandehuri nuk gjendet në paraburgim, me anë të thirrjes, njoftohet për datën kur duhet të paraqitet në prokurori për t'u dëgjuar. Thirrja duhet dorëzuar personalisht të pandehurit, e po që se nuk mund të dorëzohet e njëjta, atëherë, i dorëzohet anëtarit të afërm të familjes. Nëse i pandehuri nuk i përgjigjet thirrjes, atëherë prokurori publik bën kërkesë për sjelljen me dhunë, të cilën kërkesë ia dërgon gjykatësit të procedurës paraprake, duke kërkuar që në urdhëresë të shënohet data e paraqitjes së të pandehurit, koha e paraqitjes si dhe zyra e prokurorisë.

Pas pranimi të kërkesës për urdhër arrest gjyqtari i procedurës paraprake, e lëshon urdhëresën, një kopje ia dërgon prokurorit të çështjes për tu njoftuar për punën e kryer. Mënyra e ekzekutimit të urdhër arrestit, parashihet në përmbajtje të saj që është e kartë për të gjitha palët.

Prokurori i çështjes, pas nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve, vendos për dëgjimin ose mosdëgjimin e të pandehurit. Në aktvendim për fillimin e hetimeve, duhet të përmbushet ana formale - juridike, përpos që i pandehuri nuk ka të drejtë ankese.

Me plotësimin e kushteve të parapara sipas dispozitës ligjore<sup>33</sup>, njoftohet i pandehuri për të drejtat:

- se ka të drejtë që të heshtë, mos të japë deklaratë, mos të përgjigjet në pyetje të cilat i parashirohen, por është e preferuar që të japë informacione për shënimet personale të cilat e karakterizojnë, dhe të njëjtat duhet të jenë të sakta.

---

gjuhën e tyre, kanë nervat e tyre. Edhe në shtëpinë tënde të jesh po të mbyllin derën nga jashtë të duket sikur s'ngopesh me frymë.... pale në burg, në qeli! Dhe ngaqë trupi mbetet në vend brenda katër mureve, dhe shpirti arratiset duke kërkuar gjurmët e djeshme të këmbëve, formohet në trup një mjegull e dendur si era e qelisë si forma e korridoreve të burgut”.

<sup>33</sup> Neni 231, KPPK.

- se ka të drejtën që të ketë përkthyes nëse nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura penale, dhe vazhdimisht t'i përkthehen dhe t'i sqarohen pyetjet që i parashtrohen deri në momentin kur konsiderohet se e ka kuptuar pyetjen.

- se e drejta në mbrojtës është e garantuar, dhe prej momentit të vënies së kontaktit me të pandehurin, mbrojtësi i tij kujdeset për garantimin e të drejtave të cilat i takojnë, në të kundërtën, mosrespektimi paraqet shkelje dhe cenim i të drejtës së garantuar. Me mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare, ose të angazhuar, i pandehuri konsultohet para dhënies së deklaratës, me qëllim që çështjen penale ta kuptojë dhe deklarata e tij të jetë në kontekst të veprës penale e cila i vihet në barrë.

- se deklaratën të cilën e jep i pandehuri, është e rëndësishme, nga se e njëjta do të përdoret si provë para gjykatës, por paraprakisht deklarata e dhënë në prokurori duhet të jetë e bazuar në ligj, me qëllim që në fazat e tjera të procedurës të administrohet.

- se i pandehuri ka të drejtë të kërkojë nxjerrjen e provave të nevojshme, të cilat e përcjellin çështjen penale, obligim i prokurorit i cili duhet të nxjerrë provat fajësuese për të vërtetuar gjendjen faktike, por duhet nxjerrë edhe provat shfajësuese që shkojnë në favor të pandehurit.

Deklarata e të pandehurit duhet të shënohet në procesverbal, në formë të shkruar, nëse ekziston teknika, është mirë që regjistrimi të bëhet në mënyrë auditive dhe vizuale<sup>34</sup>, dhe të paraqitet versioni i deklaratës së tij.

Marrja në pyetje e të pandehurit duhet të përqendrohet në çështjen penale për të cilën janë filluar hetimet, që nënkupton se do të merret në pyetje kur të konsiderohet më e rëndësishme, gjithnjë duke vepruar në kuadër të KPPK-së.

Gjatë marrjes në pyetje, duhet ruajtur identiteti i të pandehurit, që i njëjti mos të provokohet me pyetje të cilat nuk ndërlidhen me çështjen penale apo të shkaktohet nervozë. Duhet pasur parasysh që pyetjet të cilat nuk i kupton i pandehuri t'i sqarohen dhe mundësisht t'i jepet kohë e mjaftueshme për paraqitjen e deklaratës.

Marrja në pyetje të pandehurit nga ana e prokurorit publik është e drejtpërdrejtë (direct examination), por mund të parashtrohen edhe pyetje kryqësore nga ana e palëve të tjerë të cilët janë prezentë gjatë marrjes në pyetje të pandehurit (cross examination), që do të thotë se pyetjet e

---

<sup>34</sup> Neni 90, KPPK.

parashtruara nga ana e mbrojtësit kanë për qëllim që ta ulin besueshmërinë e provës së nxjerrë nga ana e prokurorit.

Ndodh që prokurori publik t'ia ketë besuar ndërmarrjen e hetimeve policisë, mirëpo paraprakisht duhet ta pajisë me autorizim, duke ua bërë të ditur ndërmarrjen e veprimeve të kërkuara.

**4.2.1. Marrja në pyetje e të pandehurit në mënyrë të drejtpërdrejtë**  
(*direct examination*)

Subjekt me rëndësi në procedurën penale i cili ndërmerr ndjekjen penale është prokurori publik. Fillimi i hetimeve është i ndërlidhur me punën e prokurorit publik i cili zhvillon hetime, por prej momentit kur e nxjerrë aktvendimin për fillimin e hetimeve, ndërmerr të gjitha veprimet në kuadër të kompetencave ligjore.

I pandehuri, statusin e të pandehurit e fiton, me nxjerrjen e aktvendimi për fillimin e hetimeve. Me tu paraqitur i pandehuri në prokurori, prokurori publik, e udhëzon për të drejtat të cilat i takojnë në kuptim të nenit 231 të KPPK-së. Këto të drejta duhet t'i garantohen të pandehurit, gjatë të gjitha fazave të procedurës së mëtejme.

Marrja në pyetje e të pandehurit mund të jetë e drejtpërdrejtë, që nënkupton se të pandehurit, duhet t'i bëhet e ditur që çështja penale për të cilën zhvillohen hetimet, ka të bëjë me rastin e paraqitur, që ndërlidhet me mbledhjen e informatave, tregimin e rastit, marrjen e informatave për dëshmitë e mundshme të cilat ndërlidhen me çështjen që do të hetohet.

Qëllimi i marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë duhet ta mbështes teorinë dhe temën e rastit, si dhe procedimin e fakteve, që ndërlidhen me të pandehurin, të dëmtuarin, dëshmitarë si dhe me provat e tjera lidhur me rastin.

Marrja në pyetje e drejtpërdrejtë karakterizohet me parashtrimin e pyetjeve karakteristike të parapara në kriminalistikë dhe shkencat e tjera<sup>35</sup>.

Pyetjet e drejtpërdrejta duhet të jenë të shkurta, të qarta, të kuptueshme, të krijojnë relacione një pyetje një fakt që ndërlidhet me çështjen e caktuar

Pyetjet e drejtpërdrejta në hetuesi, kanë për qëllim që prokurori të krijojë një opinion më të përafërt, duke nxjerrë në shesh faktet kryesore të çështjes, të cilat me provat që e përcjellin, me ekzaminimet të cilat kryhen,

---

<sup>35</sup> Kush, çka, kur, ku, pse, si, me kënd, me çka, tregoje, shpjego, etj.



çështja penale të ndriçohet dhe të zbardhet gjatë procedurës. Teknikat e përdorura nga ana e prokurorit, te pyetjet e drejtpërdrejta tregojnë përgatitjen e prokurorit si dhe aftësitë profesionale, për të hetuar një çështje penale.

Prokurori gjatë punës duhet të konkretizojë pyetjen, dhe mos të krijojë huti gjatë punës të pandehurit, dëshmitari, i dëmtuari, apo eksperti, sepse po që se nuk paraqet qartësi, prish atmosferën e punës dhe dëmton procesin hetimor<sup>36</sup>.

Teknika e marrjes në pyetje në mënyrë të drejtpërdrejtë nëse zbatohet duke u respektuar dispozitat ligjore, siç janë garantimi i të drejtave të pandehurit<sup>37</sup>, i të dëmtuarit<sup>38</sup>, dëshmitarëve<sup>39</sup>, atëherë me siguri se respektohet dinjiteti i palëve në procedurë.

**4.2.2. Marrja në pyetje e të pandehurit në mënyrë të tërthortë (cross examination)**

Përpos marrjes në pyetje të pandehurit në mënyrë të drejtpërdrejtë ekziston edhe mënyra e tërthortë, e paraparë me dispozitat ligjore. Prokurori publik duhet të ketë parasysh që gjatë marrjes në pyetje tu përmbahet autorizimeve të cilat i ka, sepse duhet të ketë parasysh, që personi i propozuar që të dëgjohet, është i propozuar nga palët tjera<sup>40</sup>.

Kjo nuk do të thotë që kjo formë e marrjes në pyetje kërkon profesionalizëm të mirë nga profesionistët sepse duhet të ruhet dinjiteti i palës që dëgjohet. Funksonimi gjatë marrjes në pyetje duhet të jetë pa trysni, pa provokime nga asnjëra palë dhe duke respektuar palën, e cila merret në pyetje. Nxjerrja e fakteve, që me një pyetje të arrihet te i njëjti apo te qëllimi i caktuar, zgjedhur pyetjet që do të parashtrihen për nxjerrjen e fakteve. Gjithnjë duhet të jetë në ndërdije të palëve se respektimi i ndërsjellë është obligim ligjor sipas dispozitave pozitive.

Qëllimi i marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë, është deklarata e dhënë me fitimin e radhës, nga ana e subjektit në procedurë ta hedhë atë çka deklaroj më parë. Kjo vjen në shprehje sepse tendenca e palës është që të shmangët nga deklarata e vërtetë për të paraqitur rastin si e din.

<sup>36</sup> Kemberly A. Mur, Jackf. Nevin, Matthew W. Willlams, Debora Cunningham Foshee, Ndërtimi i shkathtësive gjyqësore, faqe 6.

<sup>37</sup> Neni 231, KPPK.

<sup>38</sup> Neni 79, 80, 81, KPPK.

<sup>39</sup> Neni 159 -164, KPPK.

<sup>40</sup> Neni 262 i Komentuarit të Kodit të Procedurës Penale të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Sa u përket pyetjeve të tërthorta, kjo mundësi u lejohet palëve në procedurë, gjatë hetimeve, ashtu edhe gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në kuadër të autorizimeve dhe në respektim të dispozitave ligjore.

## 5. Vlerësimi i provave të grumbulluara

Çështja penale e cila është filluar për tu hetuar, përcillet me grumbullimin e provave qofshin ato personale siç janë marrja e deklaratës së të pandehurit, e të dëmtuarit, dëshmitarëve, e ekspertëve, si dhe e atyre materiale, siç janë provat e gjetura në vendin e ngjarjes, kryerja e ekzaminimeve të ndryshme të kërkuara. Zakonisht provat materiale e fuqizojnë provën personale nga se me sendet e gjetura si dhe me ekzaminimet e kryera gjatë hetimeve është më lehtë për prokurorin. Pretendohet që provat të ndërlidhen në mes vet për formulim më të drejtë, për çështjen e cila është duke u hetuar.

Gjendja faktike paraqet strumbullarin e hetimit të një rasti penal gjatë zhvillimit të hetimeve, me të vetmin qëllim që akti akuzues i cili do të ngritët, të ketë mbështetjen në faktet e vërtetuara, me provat e nxjerra në bazë të KPP-së.

Me respektim të dispozitave ligjore, paraqesim tërësi faktesh të bazuara në ligj, Kushtetutë të vendit si dhe me aktet dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare të cilat aplikohen.<sup>41</sup> Nisur nga kjo rrethanë, duhet vlerësuar çdo provë të nxjerrë mirë, për të fituar një bazë të qëndrueshme për nxjerrjen e vendimit gjyqësor.

Provat e grumbulluara gjatë hetimeve nxirren nga ana e prokurorit i cili është i obliguar sipas autorizimeve që i ka, por mund të bëhet nxjerrja e provave edhe me propozimin e palëve të tjera të interesuara. Palë të interesuara për nxjerrjen e provave të tjera, të ndërlidhura me çështjen penale, janë gjykatësi i procedurës paraprake, mbrojtësi i të pandehurit, i pandehuri, si dhe të interesuarit e tjerë që marrin pjesë në çështjen që procedohet. Lidhur me këtë vjen në shprehje aksioma” *mos e dëmto personin e pafajshëm, derisa përpiqesh ta gjesh fajtorin*”.

Pas ngritjes së aktit akuzues, nuk do të thotë që shteret mundësia e paraqitjes së propozimeve për nxjerrjen e provave të tjera. Kjo mund të

---

<sup>41</sup> Grubiša, Mladen, Činjenično Stanje u Krivičnom Postupku, fq. 4.

bëhet gjatë mbajtje së shqyrtimit gjyqësor, deri në paraqitjen e fjalës përfundimtare nga ana e prokurorit, e garantuar me dispozitat ligjore.

## 6. Roli i prokurorit publik në fazën e akuzimit

Faza e akuzimit paraqet nën fazën e tretë procedurale, të fazës së hetimit, kur prokurori publik, vlerëson provat e mbledhura para se të vendosë për ngritjen e aktit akuzues. Për veprimet e ndërmarra gjatë hetimeve, prokurori publik zbaton parimet të cilat e përcjellin punën e tij si dhe i koordinon aktivitetet e veta me subjektet e tjera në procedurë, gjykatës, polici e tij. Roli i prokurorit publik dallohet nga ai i subjekteve të tjera, por në natyrën juridike të tij vërehet si institucion shtetëror dhe si palë e barabartë me palët e tjera në shqyrtimin gjyqësor.

Vlerësimi i provave të nxjerra, i atyre materiale dhe personale, kanë lidhshmëri të pashkëputur në mes vete për karakterizimin e çështjes penale. Kjo nënkupton që provat që kanë relacione të ngushta në mes vete, fitojnë fuqizim më të madh reflekton pozitivisht gjatë prezantimit të tyre për përfaqësim të aktit akuzues në shqyrtimin gjyqësor.

Provat personale dhe materiale dhe personale, gjatë grumbullimit duhet të nxirren përshtatshmërisht me dispozitat ligjore, në të kundërtën shpallen prova të papranueshme, që nuk mund të shërbejnë matej në procedurë.

Shikuar rolin e prokurorit në ngritjen e aktit akuzues, është me rëndësi që gjatë punës, duhet të ketë parasysh kompetencën qoftë atë lëndore ose territoriale, që vlen edhe për gjykatë.. Në kuadër të kompetencës reale, prokurori publik varësisht prej veprës penale të kryer ka të drejtë të ngritë: propozim akuzë ose aktakuzë<sup>42</sup>. Ndaj kryerësit të veprës penale, varësisht prej llojit të saj shqipton masën e diversitetit, ngrit propozimin për shqiptimin e masës edukative ose propozimin për shqiptimin e dënimit. Te personat me paaftësi mendore të kufizuar, prokurori publik bën propozimin për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm psikiatrik, mbështetur në dispozitat ligjore të KPPK-së, si dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 34/2004.

---

<sup>42</sup> Rasti penal Hp nr 230/09, kallëzimi penal i Policisë së Kosovës, sektori regjional për luftimin e narkotikëve nr 2009-XP5-37 të 27 10 2009, ndaj të dyshuarve N Z dhe I B. që të gjithë nga Prizreni, për shkak të dyshimit se të njëjtit kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par 2 lidhur me par 2 të KPK-së, është nxjerrë aktvendimi për fillimin e hetimeve, janë vlerësuar provat e grumbulluara, të cilat kanë dhënë bazë zë mjaftueshme për të ngritur aktakuzën PP nr 230/09, 28 12 2009.

## 7. Hetimi i veprave penale ndaj kryesve të mitur

Për të filluar hetimin e një çështje penale, pasi që prokuroria njoftohet nga ana e policisë se ka ndodhur një krim, i jep udhëzimet e duhura në kuadër të kompetencave që i ka. Kjo nënkupton, që prej momentit kur prokurori merr informatën nga ana e policisë, se është kryer një veprë penale, duhet të vepron në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me KPPK të cilat nuk guxon ti tejkalon. Komunikimi me gjykatësin e procedurës paraprake duhet të jetë i vazhdueshëm duke u bazuar në dispozitat ligjore. Nxjerrja e provave në këtë fazë, konsiston në atë që kallëzimi penal i cili paraqitet në prokurori, mbështetet në provat e nxjerra në dispozitat ligjore<sup>43</sup>.

Udhëzohet policia që ta përmbledhë rastin, me të gjitha provat e duhura, kurse duhet pasur kujdes të posaçëm, ndaj të miturit sa i përket kohës së ndalimit që nuk mund të jetë më i gjatë se 24 orë. Trajtimi i të miturit të ndaluar sipas aktvendimit të policisë, duhet të jetë në kuptim të ligjit sepse i njëjti nuk duhet të qëndroj me kryerësit e rritur të veprave penale.

Me të pranuar të kallëzimit penal, lënda i dërgohet prokurorit publik i cili vlerësohet, kurse nëse ekziston prokurori i caktuar që punon me kryerësit e mitur të veprave penale, atëherë kallëzimi penal i dërgohet atij. Duke pasur parasysh që në Kosovë numri i prokurorëve është i vogël<sup>44</sup>, me punë për të mitur janë të ngarkuar të gjithë prokurorët. Për punë profesionale, është e preferuar që prokuroritë të kenë prokurorë të specializuar për punë me të mitur, si dhe gjykatat për punë me të mitur të kenë gjykatës të specializuar.

---

<sup>43</sup> Revista “E drejta ” për çështjen juridike dhe shoqërore, e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, nr 1-4/2009, Çollaku, Hashim, fq 19, “Autorizimet e Prokurorit Publik në Procedurën Penale

<sup>44</sup> Numri i prokurorëve në raport me numrin e banorëve Po qe se bëhet një krahasim i numrit të prokurorëve në Kosovë me numrin e prokurorëve të vendeve nga rajoni, raporti qëndron si në vijim: në Kosovë raporti për 100.000 banorë qëndron 3.7 prokuror, në B e H, raporti për 100.000 banorë qëndron 7.3 prokuror, në Slloveni raporti për 100.000 banorë qëndron 9.0 prokurorë, në Kroaci raporti për 100.000 banorë qëndron 13.0 prokurorë, në Mal të Zi raporti për 100.000 banorë qëndron 13.4 prokurorë (Burimi: raporti për programet – korrik 2009, faqe 89, në adresën në internet: <http://www.eulexkosovo.eu/news/docs/programmereport/EULEX-PROGRAMME-REPORT-July-2009.new-AL.pdf> (vërejtje, numri i prokurorëve tani është rritur, e cila mund të vërtetohet me shënimet përkatëse nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokuroria e shtetit)

Prokurori publik në procedurën përgatitore për të mitur vepron me kujdes të duhur ,kurse nëse natyra e lëndës është me paraburgim, i mituri duhet të dërgohet në qendrën emergjente të spitalit rajonal, për t’u marrë mendimi se a mund ta përballojë paraburgimin në pikëpamje psikike dhe fizike<sup>45</sup>. Raporti mjekësor do të shërbejë edhe në gjykatë, për veprim të mëtutjeshëm po që se do të caktohet masa e paraburgimit, si masë për sigurimin e prezencës së të miturit. Paraburgimi i caktuar nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë për veprat penale sipas kompetencës.

Prej atij momenti, i qaset hetimit të çështjes penale, duke filluar punën për nxjerrjen dhe grumbullimin e provave të nevojshme, duke i zbatuar dispozitat pozitive ligjore nga KPPK, në kuptim të nenit 41 të KDM, njoftohet organi i kujdestarisë pranë Qendrës për Punë Sociale, Shërbimi Sprovues në kuptim të nenit 8 të KDM, për ta punuar anketën sociale.

Sipas LPP-së, procedura përgatitore për të mitur është filluar me kërkesën e prokurorit publik për zhvillimin e procedurës përgatitore, ndërsa aktvendimin për fillimin e procedurës përgatitore e ka nxjerrë gjyqtari për të mitur i cili edhe ka organizuar punën rreth grumbullimit të provave të nevojshme<sup>46</sup>.

Të miturit si kryes të veprave penale të llojeve të ndryshme<sup>47</sup>, kanë pjesëmarrje bukur të mirë në kriminalitetin e përgjithshëm. Shikuar në këtë drejtim pjesëmarrja e kryesve të mitur në kryerjen e veprave penale, sa i përket veprave penale të vjedhjeve kanë kryer 3.500, prej të cilave shikuar në mënyrën statistikore 1.757 janë vepra penale të vjedhje, kurse 1.873 janë

---

<sup>45</sup> Neni 45 i KDM.

<sup>46</sup> Neni 470, LPP.

<sup>47</sup> Veprat penale të cilat i karakterizojnë kryesit e mitur janë vepra penale kundër jetës dhe trupit, kapitulli XXV (vepra penale e vrasjes – neni 146 i KPK-së, vepra penale e vrasjes së rëndë – 147 i KPK-së, vepra penale lëndimi i lehtë trupor - neni 153 i KPK-së, vepra penale lëndimi i rëndë trupor – neni 154 i KPK-së, vepra penale pjesëmarrja në rrahje – neni 155 i KPK-së, veprat penale kundër integritetit seksual kapitulli XIX (vepra penale dhunimit – neni 193 i KPK-së, vepra penale keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime mendore a emocionale ose me paafësi mendore – neni 197 i KPK-së, keqpërdorimi seksual i personave nën moshën 16 gjashtëmbëdhjetë vjet – neni 198 i KPK-së, e tjerë), veprat penale kundër shëndetit publik kapitulli XXI (vepra penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike – neni 229 i KPK-së, veprat penale kundër ekonomisë – kapitulli XXII (vepra penale falsifikimi i parasë – neni 244 i KPK-së), veprat penale kundër pasurisë, kapitulli XXII (vepra penale e vjedhjes së rëndë – neni 252 i KPK-së), vepra penale e grabitjes – 255 i KPK-së.

vepra penale vjedhje të rënda. Derisa jemi te kryerja e veprave penale, duhet shtuar kujdes i posaçëm kryesve të mitur, sepse të njëjtit paraqiten edhe si kryes të veprave penale të mbajtjes pa leje të armëve të zjarra<sup>48</sup>.

Nga ana e prokurorit publik pas pranimit të kallëzimit penal, vlerësimi te të njëjtit, dhe ardhjes në përfundim se në rastin konkret kryesit e mitur për veprën penale të kryer, mund t'i shqiptohet dënimi me burgim deri në 3 vite ose dënimi me gjobë, atëherë është detyrë e prokurorit publik që mund të fillojë punën për shqiptimin e masës së diversitetit, si dhe llojit të saj. Kjo varet nga vlerësimi i rastit.

### ***7.1 Procedura përgatitore për të mitur***

Procedura përgatitore ndaj të miturit, fillon si një procedurë specifike, ashtu që prokurori publik, gjatë zhvillimit të procedurës, e mbështet punën në disa parime themelore. Parimet të cilat e udhëheqin prokurorin publik gjatë punës, janë ato të përgjithshmet, por duhet pasur parasysh që gjatë zhvillimit të procedurës përgatitore për të mitur duhet të zhvillohet procedurë e ndarë nga të rriturit, që duhet të veprojë me urgjencë të posaçme gjatë zhvillimit të procedurës përgatitore për mbledhjen e provave të kërkuara. Është me rëndësi në këtë lloj procedure, se parimi i publicitetit nuk vjen në shprehje sikurse në procedurën penale për të rritur.

Gjatë zhvillimit të procedurës përgatitore, i mituri duhet të ketë mbrojtës – avokat menjëherë me të paraqitur para prokurorit publik, e mundësisht kjo mundësi duhet t'i ofrohet edhe derisa të jetë në polici<sup>49</sup>. Duhet të njoftohet kryesi i mitur, mbrojtësi i tij si dhe të gjitha palët tjera të interesuara, për rrjedhat gjatë grumbullimit të provave që kanë të bëjnë me çështjen penale, sepse përveç prokurorit publik mund të ngritin propozime për prova të reja edhe palët e tjera.

Prokurori publik, duhet pasur kujdes që gjatë zhvillimit të procedurës përgatitore konkretisht kur ta e merr në pyetje të miturin, të respektojë dinjitetin e tij, të vërtetojë datën e lindjes, duke siguruar certifikatën e lindjes, si dhe të respektoj të drejtat e tjera ligjore..

---

<sup>48</sup> Veprat penale kundër rendit publik dhe veprimeve juridike – kapitulli XXVIII, vepra penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 të KPK-së. Është me rëndësi se kryesve të mitur sipas të dhënave statistikore të Policisë së Kosovës, iu janë konfiskuar 230 armë të zjarra.

<sup>49</sup> Neni 43, KDM, parasheh që i mituri të ketë mbrojtës prej fillimit të procedurës përgatitore, kjo ka qenë e paraparë edhe me nenin 455 par 1 të Ligjit të Procedurës Penale të përparshëm.

I mituri nuk duhet që të merret në pyetje më shumë se dy herë, nga se çdo marrje në pyetje shkakton ngarkesë për të miturin. Gjatë marrjes në pyetje të miturit duhet plotësuar këto kushte:

- që të jetë prezentë përfaqësuesi i tij ligjor – prindi;
- në se nuk ka prind, të jetë prezent prindi adoptues, ose kujdestari i caktuar për të mituri nga ana e Qendrës për punë sociale,
- varësisht se në çfarë faze të zhvillimit gjendet procedura përgatitore, prokurori publik duhet të jetë i kujdesshëm që të miturit t'i caktojë mbrojtës,
- që t'i respektojë të gjitha të drejtat e garantuara që i takojnë në kuptim të nenit 231 të KPPK-së, kur gjendet para prokurorit për të dhënë deklaratën, po që se është intervistuar në polici në kuptim të nenit 214 të KPPK-së si dhe para gjykatësit për të mitur.

Hap më i avancuar sipas KDM janë masat e diversiteti<sup>50</sup>, që për qëllim kanë ri integrimin sa më të shpejtë të të miturit në rrjedhat e përgjithshme shoqërore. Sa u përket llojeve të masave të diversitetit<sup>51</sup>, janë të parapara në kod, ashtu që gjatë punës prokurori ose gjykatësi respektojnë procedurën përkatëse.

Procedura përgatitore për të mitur fillohet, me ndjekjen penale nga ana e prokurorit publik për veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare, kurse për veprat penale që ndiqen sipas propozimit të të dëmtuarit apo sipas aktpadisë private vetëm nëse iniciativa është paraqitur me kohë dhe prokurori publik pajtohet ta ushtrojë ndjekjen<sup>52</sup>. Gjatë punës nëse pushohet procedura përgatitore ndaj të miturit, njoftohen të gjitha palët e parapara sipas dispozitave ligjore.

Varësisht nga natyra e lëndës, prokurori publik përcaktohet për ndonjërin nga masat për sigurimin e prezencës së të paraqiturit të mitur të parapara me ligj<sup>53</sup>. Varësisht prej masës për të cilën përcaktohet, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e KPPK-së, sikurse kundër kryerësve të rritur të veprave penale.

## Përfundimi

---

<sup>50</sup> Neni 16 KDM (sipas LPMK, neni 13).

<sup>51</sup> Neni 18 KDM.

<sup>52</sup> Neni 54, KPPK.

<sup>53</sup> Neni 268, KPPK.

Për të zhvilluar procedurë sa më të drejtë në një çështje penale, duhet patur parasysh, që të fillohen hetimet. Fillimi i hetimeve nënkupton që ndaj të miturit të nxjerrët aktvendimi për fillimin e procedurës përgatitore. Me nxjerrjen e aktvendimit nga ana e prokurorit fitohet kushti ligjor për fillimin e hetimeve, me të vetmin qëllim që të grumbullohen provat e duhura, për vërtetimin e gjendjes faktike. Qëllimi i hetimeve, është me rëndësi që prokurori publik gjatë punës, duhet të vlerëson provat e nxjerra para se të vendos për ngritjen e aktit akuzues përkatës. Lidhur me këtë dallojmë disa faza të procedurës penale juridike.

Pasi që procedura penale – juridike sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës kalon në tri faza, faza e zhvillimit të hetimeve, faza e përfaqësimit të aktit akuzues në shqyrtimin gjyqësor dhe faza e veprimit sipas mjeteve juridike, në fazën e parë që ndërlihet, me fazën e hetimeve ku dallohen tri nën faza:

- faza e procedurës parapenale, që konsiston në ndërmarrjen e veprimeve të kërkuara për mbledhjen e informacioneve rreth zbardhjes dhe ndriçimit të çështjes penale të caktuar,
- faza e zhvillimit të hetimeve, që konsiston me nxjerrjen e aktvendimit për fillimin e hetimeve në kuptim të dispozitës përkatëse ligjore<sup>54</sup>, dhe
- faza e grumbullimit të provave të kërkuara, si të atyre personale po ashtu edhe atyre materiale, të cilat pas vlerësimit, japin bazën e mjaftueshme për ngritjen e aktit akuzues përkatës.

Hetimet fillojnë me nxjerrjen e aktvendimit për fillimin e hetimeve, që paraqet bazën për fillimin e punës për grumbullimin e provave dhe identifikimin e çështjes penale, kurse ndaj kryerësve të mitur me nxjerrjen e aktvendimit për fillimin e procedurës përgatitore.

Në këtë drejtim shikuar procedurën penale në fazën e hetimeve, paraqet prokurorin publik me autorizime konkrete në ndjekjen penale, sipas dispozitave të KPPK- së. Përndryshe, respektimi i të drejtave të njeriut është çështje me rëndësi nga se të njëjtat janë të garantuara me Kushtetutë, si dhe ligje të tjera, si dhe aktet dhe instrumente të tjera ndërkombëtare.

Kjo nxitë prokurorin publik, gjykatësin, si dhe palët e tjera që të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara të njeriut, sikurse janë:

---

<sup>54</sup> Neni 220 i KPPK-së.



- të drejtën për jetë,
- të drejtën në identitet,
- të drejtën dhe lirinë e shprehjes në çdo lloj procedure,
- të drejtën në mbrojtje dhe mbrojtës,
- të mos keqpërdoret dhe abuzohet gjatë zhvillimeve procedurale,
- të respektohet interesi dhe dinjiteti i personit që hetohet,
- të ketë të drejtën e pushimit dhe shfrytëzimin e kohës së lirë,
- të ketë të drejtën që të luftojë çdo formë të eksploatimit apo diskriminimit,
- të ketë të drejtën që mos të privohet prej lirie në mënyrë të kundërligjshme dhe të gëzon mbrojtjen ligjore etj.

Shikuar sipas dispozitave ligjore pozitive, hetimet zhvillohen nga ana e prokurorit, këtë kompetencë e ka edhe për kryerësit e mitur të veprave penale. Prokurori publik duhet që gjatë hetimeve ti nxjerrë provat e duhura në kuptim të dispozitave ligjore, që provat të jenë të nxjerra si e parasheh ligji me qëllim që provat të jenë të pranueshme, që ekspertizat e kërkuar të bëhen sipas procedurave të parapara, që të respektohen parimet procedurale, etj. Ndaj kryerësve të mitur duhet respektuar dispozitat përkatëse në atë mënyrë që kur ka mundësi gjatë procedurës, të shqiptohen masa të diversitetit nga ana e prokurorëve dhe e gjykatave, dënime alternative të parapara sipas KDM.



*Ma. Sc. Hashim Çollaku*

## **The Commencement, Purpose and Implementation of Investigation**

### *Summary*

In order to conduct a procedure which is as right as possible in a criminal matter, first consideration should be paid to commencement of investigations. Commencement of investigations implies rendering of a ruling for commencement of the preparatory procedure against a juvenile by the Prosecutor, by which the legal condition for commencement of investigations is met, with the sole purpose of collecting of necessary evidence, in order to ascertain the factual state. In connection to the purposes of investigation, it is of paramount importance that the Public Prosecutor in course of his work evaluates the evidences extracted, prior to filing the respective indictment. In connection to this, there are several criminal and judicial procedure phases.

Once the criminal- judicial procedure, pursuant to Criminal Procedure Code of Kosovo undergoes the three phases – the phase of investigations, the phase of representing the indicting act during the court hearing and the phase of acting upon the judicial tools,- within the first phase, namely the investigation phase – here are notably three sub-phases:

- the pre-criminal procedure phase, consisting of undertaking the requested actions in regard to collected information concerning illumination and elucidation of a specific criminal matter;

- the phase of conducting investigations, consisting of rendering of ruling for commencement of investigations, pursuant to respective legal provision, and the indicting act;

- the phase of collection of required evidences, both personal and material ones which, upon being evaluated, would offer sufficient ground for filling the respective indicting act.

Investigations commence with rendering of the ruling for commencement of investigations, which represents grounds for commencement of work in collection of evidences and identification of the criminal matter, while in concern to the juvenile offenders, with rendering of ruling for commencement of the preparatory procedure.

In the course of conduct of the investigations, public prosecutor collects the necessary evidences, hears the suspect, witnesses, experts, as well as undertakes all actions upon the legal authorizations, until the completion of the investigation. During the phase of investigations, other parties, as defined by the legal provisions, the court included, may file requests for extraction of new evidences that are considered to tribute to illumination of the case.

In this respect, considering the criminal procedure in the investigative phase, the public prosecutor is presented with his specific authorizations in the criminal prosecution, in accordance with the provisions of CPCK. Otherwise, respecting of the human rights is an important issue, as they are guaranteed by the Constitution and other laws, as well as other international acts and instruments. This way, the public prosecutor; the judge as well as other parties must respect the basic guaranteed human rights and freedoms, such as:

- The right to life,
- The right to identity,
- The right and freedom of expression in any proceeding,
- The right to defense and defense attorney,
- Not to be abused throughout the proceedings,
- To have the interest and dignity of the person being investigated respected,
- To be entitled to pause and use of a free time,
- To be entitled to fight any form of exploitation or discrimination,
- To be entitled not to be deprived of his liberty in non-legal manners and to enjoy legal protection, etc.

Considering the positive legal aspects, investigations are conducted by the prosecutor, who has this competency also in regard to juvenile perpetrators of criminal offences. The Public Prosecutor during the course of investigations should excerpt the necessary evidences, in a sense of legal provisions, that the evidences should be obtained in accordance with the law, so that they will be admissible, that the expertise required should be conducted upon the procedures foreseen, that the procedural principles should be respected, etc.

Against the juvenile perpetrators, the respective provisions should be respected in such manners that, whenever possible during the procedure, the measure of diversity should be rendered by prosecutors or judges, and alternative measures as foreseen by JJC (Juvenile Justice Code).

*Mr.sc. Xhevdet HALILI, Doktorant*

## LEGJISLACIONI DHE METODAT E TORTURËS

### Vështrime hyrëse

Tortura është një lloj i veprës penale e cila parashihet me ligjet si në nivel vendi po ashtu ky lloj i veprës penale parashihet edhe me akte dhe konventa të shumta ndërkombëtare.

Duke marrë parasysh rrethanat nëpër të cilat ka kaluar Kosova, dhe torturat të cilat i ka pësuar populli i saj, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, konsiderojmë se nuk është trajtuar mjaftueshëm kjo fushë nga ana e shkrimeve publicistike dhe profesionale, andaj edhe pikërisht për këtë arsye i qasemi kësaj teme në këtë kontekst.

Në kuadër të këtij punimi do të trajtohet tortura si vepër penale, aspekti i legjislacionit në kuadër të kësaj fushe, pastaj do të trajtohen në mënyrë të detajuar llojet e metodave të torturës, e në kuadër të tyre edhe mjetet të cilat përdoren për të realizuar torturën si një akt tejet i neveritshëm dhe një vepër penale tejet e rëndë.

Në fund të këtij punimi do të nxjerrim disa përfundime me rëndësi për këtë lloj të veprës penale, e cila pa dyshim lë pasoja të mëdha edhe pas kryerjes së saj te personat ndaj të cilëve është ushtruar ajo.

Shpresojmë se punimi sado pak do të ofrojë njohuri për studentët të cilëve u nevojitet literaturë nga kjo fushë me qëllim të zgjerimit dhe freskimit të njohurive të tyre, si dhe zyratrët që merren me mbojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në përgjithësi.

## 1.) Legjislacioni vendorë dhe ndërkombëtar për torturën

Shprehja “torturë” do të thotë shkaktimi i qëllimshëm i dhembjes apo i vuajtjes së rëndë fizike apo mendore mbi një person, i cili është i ndaluar ose është nën kontrollin e kryerësit, me përjashtim të rasteve kur tortura nuk përfshinë dhembjen dhe vuajtjen që rezulton vetë nga sanksionet e ligjshme, karakteristike ose aksidentale për to.

Veprimi i shkaktuar në mënyrë sistematike, i paramenduar ose i shthurrur që është mbijetuar nga vepra e një ose me shumë personaave të urdhëruar nga ana e autoriteteve duke përdorur forcën për marrjen dhe pranimin e informatave, ose për ndonjë arsye tjetër.”<sup>1</sup>

Të vetëdijshëm se legjislacioni mbi veprën penale të torturës është i shpërndarë në ligje të ndryshme dhe jo i kodifikuar, do të bëjmë përpjekje maksimale që shumicën e neneve që flasin për këtë lloj të veprës penale ta paraqesim në këtë punim.

### 1.a) Tortura sipas legjislacionit vendor

Në kuadër të legjislacionit vendorë për çështjet të torturës do të trajtojmë këto akte vendore:

*1.a.1) Kushtetuta e Republikës së Kosovës*

*1.a.2) Kodi Penal i Kosovës (KPK)*

*1.a.3) Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)*

#### 1.a.1) Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh se “Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit e trajtimit mizor, çnjerëzor a poshtërues”.<sup>2</sup> Pra, me anë të Kushtetutës së vendit parashihet në mënyrë decitive ndalimi i ushtrimit të torturës.

Ky formulim është në përputhje të plotë me të gjitha aktet dhe konventat ndërkombëtare, të cilat shprehimisht e ndalojnë përdorimin e torturës si metodë për nxjerrjen e informatave apo pranimin e deklaratave të caktuara.

<sup>1</sup> World Medical Association, Tokyo Declaration, 1975.

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 27.

### 1.a.2) Kodi Penal i Kosovës (KPK)

Po ashtu, në Kodin Penal të Kosovës vepra penale e torturës parashihet në disa paragrafe dhe shtrohet në këtë mënyrë, siç do të paraqesim në vijim, në paragrafin (1) të nenit 165 thuhet: *“Përsoni zyrtar ose personi i cili vepron me qëllim të shtytjes ose me pëlqim ose pranim të përsonit zyrtar, i cili kryen aktin e torturës, dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vite.”*

Ndërsa në paragrafin (2) të po të njetit nen të Kodit Penal të Kosovës parashihet se: *“Akti i torturës do të thotë kryerja ose mos kryerja e një akti me anë të të cilit me qëllim shaktohet dhembja e rëndë ose vuajtja qoftë fizike ose mendore e përsonit me qëllim të marrjes së informacionit a deklaratës nga përsoni i tillë ose nga përsoni i tretë e cila ka për qëllim dënimin e personit të tillë për një vepër të cilën ai person ose përsoni i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer apo për frikësimin a detyrimin e personit ose të personit të tretë.”*<sup>3</sup>

Tortura është e drejtuar në shkatërrimin e individualitetit në një karakter të thyer, e përdorur për të trembur anëtarët e tjerë të komunitetit, për shak se qëllimi themelor i torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit është një ndarje e opozitës individuale për pushtetin shtetëror.

Kjo është arsya pse në ditët sotme tortura është instrumenti më i fuqishëm i pushtetit kundër demokracisë.<sup>4</sup>

Një çështje tjetër me rëndësi është se akti i torturës nuk nënkupton doshmërisht përfshirjen e cilit do akt ose mungesën e tij, që rrjedh vetëm nga aktet e pa-shmangshme apo karakteristike të sanksioneve të ligjshme.

### 1.a.3) Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK)

Kur jemi te Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, ky kod në mënyrë më të detajuar ka paraparë disa nene dhe shumë paragrafe të cilat kanë të bëjnë pikërisht me parandalimin e përdorimit të torturës gjatë privimit të personave nga liria, apo gjatë vuajtjes së dënimeve të tyre të shqiptuara nga

<sup>3</sup> Kodi Penal i Kosovës, Neni 165, paragrafi 1.2.

<sup>4</sup> Dr.StevanLiliq, BiljanaKoaveqeviq Vuco, *Torture-Instrument against Democracy*, Beograd, 2001, page 22.

organet shtetërore. Mirëpo, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës në përgjithësi e konsideron ankesën e të burgosurit si mjet juridik.<sup>5</sup>

Po ashtu, në nenin 212, paragrafi (6), të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës parashihet se: *"Personi i arrestuar ka të drejtën e ankimit (ndaj paraburgimit) pranë gjyqtarit në procedurën paraprake"*. Po ashtu, edhe në nenin 235 parashihet se: *"Nëse marrja në pyetje e të pandehurit është zbatuar me shkelje të dispozitave nga neni 234 paragrafi 2 i këtij kodi, deklaratimet e të pandehurit janë të pa pranueshme"*. Po ashtu, edhe në dispozita tjera, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës ka paraparë dispozita ligjore, ku në mënyrë indirekte dhe në disa raste edhe direkte ndalohej përdorimi i torturës si mjet për nxjerrjen e informatave nga ana e zyrtarëve shtetëror.

Përsoni i paraburgosur duhet të trajtohet në mënyrë humane dhe duhet mbrojtur shëndetin e tij fizik dhe psikik. Ndërsa në paragrafin (2) të nenit 288 thuhet se: *"Ndaj të paraburgosurit mund zbatohen vetëm ato kufizime që janë të nevojshme për të penguar ikjen ose komunikimet që do të mund të ishin të dëmshme për zbatimin efektiv të procedurës."*<sup>6</sup>

Në disa dispozita të tjera të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës në mënyrë taksative parashihet se *"Personaliteti dhe dinjiteti i të burgosurve nuk guxon të fyhet gjatë mbajtjes në paraburgim."* Po ashtu, në Kod thuhet se: *"Gjatë çdo intervistimi apo marrje në pyetje ndalohej që"*:

- *Liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet nepërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit;*
- *I pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj;*
- *Të premtohet ndonjë përfitim i papapapar me ligj; dhe*
- *Të dobësohet kujtesa e të pandehurit ose aftësia e tij për të kuptuar.*

Ndalesat nga paragrafi (1) i nenit 288 zbatohen, pavarësisht nga pëlqimi i personit të intervistuar ose të marrur në pyetje.

---

<sup>5</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Neni 206 dhe 297.

<sup>6</sup> Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 288, paragrafi 1 dhe 2.



Kur intervistimi ose marrja në pyetje është zbatuar në kundërshtim me paragrafin (1) të këtij neni, atëherë procesverbali i intervistimit ose marrjes së tillë në pyetje është i pa pranueshëm.”<sup>7</sup>

Të gjitha këto pragrafe janë formuluar me qëllim të parandalimit të shkaktimit të veprës penale të torturës në vendin tone, andaj ligjvënësi me rastin e përpilimit të ligjeve ka qenë i kujdesshëm në formulimin e neneve dhe paragrafeve për parandalimin e veprës penale të torturës apo që ato dëshmi të nxjerrura të mos mundin të përdoren në procedurën penale në asnjë mënyrë, panvarësisht rrethanave të paraqitura gjatë vijimit të procedurës.

Procedurë e njejtë zbatohet edhe për dëshmitë, të dhënat e policisë mbi arrestimin dhe paraburgimin, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave të arrestuar, raportet mjekësore në rastet e abuzimit fizik.<sup>8</sup>

Pra, asnjëra nga provat materiale të cekura më lartë nuk mundet të merren si dëshmi në procedurën penale nëse ato si të tilla janë marrur në kundërshtim me kodin e procedurës penale të Kosovës.

Si shembull kur tentohet që duke përdorur metoda të caktuara me anë të cilave do të ndikohet në Lirinë e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij qoftë përmes keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit.

Por ka edhe raste të tjera, si kur i pandehuri kanoset me masë të ndaluara me ligj, apo i premtohet ndonjë përfitim i paparapar me ligj dhe i cili si i tillë është i ndaluar, dhe kur tentohet që ti dobësohet kujtesa të pandehurit me qëllim që ai të mos jete në dijeni se qafër veprimi është duke bërë.

Të gjitha këto prova apo dëshmi, të cilat gjatë marrjes së tyre janë përdorur metodat e sipërpërmednura, janë të papranueshme dhe si të tilla nuk mundin asesi të përdoren në procedurën penale e cila zhvillohet ndaj personit të dyshuar se ka kryer veprë të caktuar penale, sepse informatat janë nxjerrur duke u shkelur dispozitat ligjore procedurale.

Legjislacioni penal i Kosovës, në mënyrë të përgjithshme ka paraparë në shumë dispozita ligjore ndalimin e përdorimit të torturës si veprë penale, si shembull mund të cekin dëshmitë apo të dhënat e policisë mbi arrestimin dhe

---

<sup>7</sup> Po aty, Neni 155, paragrafi 1.

<sup>8</sup> Po aty, paragrafi 3.

paraburgimin, deklaratat e dëshmitarëve dhe personave te arrestuar, për të cilat nuk ka dispozita konkrete ligjore.

## 1.b) Tortura sipas legjislacionit ndërkombëtar

Në kuadër të legjislacionit ndërkombëtar për qështjet të torturës kesaj radhe do të trajtojmë këto akte dhe konvenat ndërkombëtare:

- 1.b.1) Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut;*
- 1.b.2) Konventa Evropiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese;*
- 1.b.3) Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;*
- 1.b.4) Konventat e Gjenevës (1949);*
- 1.b.5) Legjislacioni i Shqipërisë mbi veprën penale të torturës.*

### 1.b.1) Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Po ashtu, edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut parasheh se *“Kundër askujt nuk mundë të përdoren torturat çnjerëzore ose poshtëruese.”*<sup>9</sup>

Pra, me anë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, decidivisht ndalohet përdorimi i torturave ndaj personave për çfardo qëllimi qoftë ai.

Shprehimisht dhe ne mënyrë decitive ndalohet përdorimi i saj për marrjen e informatave dhe pranimin e çfarëdo deklarate.

### 1.b.2) Konventa Evropiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese

Me anë të kësaj konvente *“krijohet një komitet evropian për parandalimin e torturës ose trajtimeve çnjerëzorë ose poshtëruese, ku me anë të vizitave komiteti shqyrton trajtimin e personave të privuar nga liria, dukes synuar në rastë se nevojitet. Forcimin e mbrojtjes së tyre kundër torturës.”*<sup>10</sup>

Shtetet antare të Këshillit të Europës, duke i pasur parasysh dispozitat e Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, specifikisht nenin 3, ku thuhet se *“askush nuk mund ti nënshtrohet torturës as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”*.

<sup>9</sup> Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ,6 nëntor 1990, Strasbourg, Neni 3.

<sup>10</sup> Konventa Evropiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, Neni 1, Këshilli i Evropës, Strasburg, hyrë në fuqi më 16.11.1987.

Duke konkluduar se se personat të cilët janë viktimat të shkeljeve të këtij neni do të mbrohen nga mekanizmi i cili do të krijohet nga Konventa Europiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

Bindja se mbrojtja e personave të privuar nga liria, kundër torturës dhe dënimeve a trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese mund të forcohet nga një mekanizëm jo gjyqësor, me karakter parandalues dhe i bazuar në vizita.

### 1.b.3) Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Një trajtim dhe rëndësi të konsiderueshme viktimave të torturës ia kushton edhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), ku specifikisht flet tek procedura penale për viktimave të torturave apo të torturuarëve.

Në procedurën penale, *a) Viktimat mundë ta kenë statusin juridik të “dëmtuarit”, apo “pales së dëmtuar”. b) Në praktikën gjyqësore kjo përfshinë edhe anëtarët e familjes së viktimës.* Statusi i “pales së dëmtuar” është i ndërlidhur me procedurën penale dhe për këtë arsye dhe për dallim nga definicioni i Kombeve të Bashkuara nuk përfshin personat të cilët kanë përjetuar krime me ç’rast kryerësi (nuk) është identifikuar, kapur, ndjekur penalisht apo dënuar.

Po ashtu edhe me diaspora akte tjera rregullohet kjo fushë, ku shkelja e të drejtës së personit të paraburgosur që të trajtohet në mënyrë njerëzore dhe respekt për dinitetin e tij apo të saj.<sup>11</sup>

Të gjitha këto akte dhe konventa të rëndësishme kanë për synim që diniteti i njeriut të cilit, i është privuar liria të respektohet dhe të trajtohet në përputhje me parimin e trajtimit human.

### 1.b.4) Konventat e Gjenevës (1949)

Rëndësi tejet të madhe për ta vënë në pah edhe më shumë rëndësinë e veprës penal të torturës, ka përcaktimi i konventës së Gjenevës së 12 gushtit 1949, në lidhje me krimet e luftës ku ato parashohin edhe ndalimin e torturave dhe

---

<sup>11</sup> Marrveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile, (MNDPC) Neni 10 pika (1) po ashtu e parasheh edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (KEDNj) neni 3, si dhe Kodi i Procedures Penale të Kosovës, (KPPK) neni 288.

trajtimin jo human të personave të cilët mbahen gjatë zhvillimit të akativiteteve luftarake ndërmjet shteteve apo vendeve të caktuara.

Për shembull në kuadër të këtyre konventave parashihet në paragrafin (1) Kush do që shkel rëndë konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dënohet më së paku pesë vite burgim ose me burgim afatgjatë.<sup>12</sup> Kjo çështje më së shumti ka të bëjë me sanksionet penale të cilat parashihen për shkelësit e këtyre konventave .

Ndërsa po të njejtat konventat në mënyrë taksative parashohin veprimet të cilat ndërlihen me veprat penale të tortures si: (2) *“Shkelja e rëndë e konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 do të thot një a më shumë prej veprimeve vijuese të kryera gjat kohës së luftës apo konfliktit të armatosur, si : a) Tortura ose trajtimi çnjerzor, duke përfshirë eksperimentet biologjike ; dhe b) Shaktimi i qëllimshëm i vuajtjeve të mëdha ose i dëmtimeve të rënda trupore apo shëndetësore.”*<sup>13</sup>

Mbi bazën e këtyre formulimeve të Konventave të Gjenevës (1949), mund të konkludojmë se vepra penale e tortures si dhe veprimet e saj degraduese dhe poshtruese janë të një rëndësie të madhe për tu studiuar dhe trajtuar ngase parashihen edhe me aktet tjera të rëndësishme dhe të aplikushme në të gjitha vendet e botës.

### **1.b.5) Legjislacioni i Shqipërisë mbi veprën penale të torturës**

Po ashtu edhe legjislacioni i Shqipërisë parasheh se ndalimi dhe veçimi i përkohëshëm i personave që dyshohen që kanë kryer vepër penale, ka edhe karakter edukativ dhe parandalues, por të dënuarve dhe të paraburgosurve nuk mund tu mohohen disa të drejta, ndryshe veçimi i tyre do të kishte karakter hakmarrës.<sup>14</sup>

Profesori i njohur i së drejtës penale Ismet Salihu, po ashtu potencon se Kodi penal i Kosovës është hartuar në frymën e parimeve ndërkombëtare

<sup>12</sup> Konventa e Gjenevës, 12 gushtit 1949,

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Njazi Jaho, *Legjislacioni Penitenciar i Republikës së Shqipëris në Vështim të Dokumenteve Ndërkombëtare, Tiranë 2002, faqe 12.*

për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në përgjithësi dhe të drejtat e viktimës në veçanti të percaktuara me konventa ndërkombëtare.<sup>15</sup>

Andaj konsiderojmë se me të drejtë profesori nxjerr një konstatim të tillë, mbase po thuaj se të gjitha aktet ligjore të nxjerruar pas vitit 1999 në Kosovë, së paku ligjëvënësi është munduar që të mos jenë në kundërshtim me aktet ndërkombëtare.

## 2.) Metodat e torturës

Kur flitet për metodat e torturës apo të shkaktimit të vuajtjeve të personave që janë në fazën e parë të procedurave penale apo të atyre që gjenden në faza tjera, qoftë të procedurave penale apo që gjenden në vuajtje të dënimeve apo sanksioneve penale duhet gjithnjë të bazohemi në rastet praktike se qfarë lloj torture pordorin përgjegjësit e organeve apo të institucioneve përkatëse ndaj atyre që ushtrojnë torturën.

Po ashtu në një raport të Avokatit të Popullit në Kosovë potencohet se “Në disa prej rasteve të pohimit për keqëtrajttime dhe për shkaktime të lëndimeve trupore ndaj qytetarëve,” avokati i popullit kishte kërkuar nga gjykata dhe prokurorit kompetente, njoftime lidhur me veprimet e këtyre institucioneve për shqyrtimin e kallëzimeve penale ndaj pjeshtarëve të policisë së Kosovës. Si edhe në raste tjera edhe në këto aspekte ka zvarritje të procedurave gjyqësore.<sup>16</sup>

Po ashtu edhe nga organizata të ndryshme që merren me të drejtat e njeriut dhe me parandalimin e ushtrimit të torturave theksohet se tortura si vepër penal është tejet e vështirë të dokumentohet edhe nëse ekziston.

Njëri ndër avokatët, i cili punon në Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës në Prishtinë. Ai thotë për Deutch Welle (DW), se kjo organizatë joqeveritare ka kontakte intensive me strukturat e rendit dhe të sigurisë në Kosovë, me institucionin e Avokatit të Popullit dhe me shoqata që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Ai e përshkruan të

---

<sup>15</sup> Dr.sc. Ismet Salihu, *Legjislacioni Penal i Kosovës Lidhur me Parandalimin dhe Sansionimin e Torturës dhe Mbrojtjen e Viktimave të Torturës*, Revista “Studime Juridike në Kosovë” Vëllimi 7-8, 2005/1, faqe 7, botuar nga KLC-ja.

<sup>16</sup> Raporti i Nëntë Vjetor i Avokatit të Popullit, Rrepublica e Kosovës 2008-2009, drejtuar Kuvendit të Rrepublicës së Kosovës, Prishtinë 2010, faqe 27.

vështirë evidentimin e ushtrimit të dhunës e torturës ndaj personave që gjenden në stacionet e policisë, në paraburgim a në burg. *“Nuk mund të themi se nuk ekziston, por është e vështirë të dokumentohet. Ne jemi në dijeni se çështjet e torturës janë paksa komplekse, pasi duhet të kemi pohim të informatës nga zyrtarët policorë dhe tendenca e pranimi si të tilla”*. Po ashtu ai potencon se çdo sinjalizim dhe dyshim iu përcillet autoriteteve zyrtare të drejtësisë e të punëve të brendshme. *“Qëllimi ynë është që trajtimi i personave që ndalohen nga policia, që ndodhen në paraburgim ose vuajnë dënimin në burg të bëhet sipas ligjit, duke respektuar Konventën Europiane të të drejtave të njeriut, si dhe çdo akt tjetër ndërkombëtar. Ne kemi organizuar shpesh fushata ndërgjegjësuëse, për përmirësimin e kushteve dhe mirëtrajtimin ndaj njerëzve që ju privohet liria”*.<sup>17</sup>

Por sa i përket metodave të torturës është tejet e vështirë të nxjerrim një konkluzion se cilat metoda përdoren tani, apo në një periudhë të caktuar kohore, sepse metodat e torturës me kalimin e kohës edhe ato po avancohen, nëse mundemi të shprehemi ashtu dhe po ndyshohen, por neve do të potecojmë disa nga metodat të cilat përdoren më së shpeshti në praktikë.

Në përgjithësi kemi dy lloje apo metoda të torturave dhe ato janë:

*Metoda e torturës fizike*

*Metoda e torturës psikologjike*

## **2.a. Metodatat e torturës fizike**

Metodat e torturës fizike janë të atilla që kanë për qëllim që ta dëmtojnë dhe shkatërrojnë shëndetin fizik të personit ,me qëllim të nxjerrjes së informacioneve apo pranimi të ndonjë deklarate nga ana e zyrtarëve shtetërorë apo personave që janë nën kontrollin e tyre.

Franc Kafka në një gjykim i cili zvillohet tha “kjo është e gjitha që ndodhë, ne jemi po edhe të ishim mjaft të aftë, por koprrac për vet faktin se autoritetet e larta të cilave ne u shërbejmë, para se ata të urdhërojnë

<sup>17</sup> [www.dw-world.de](http://www.dw-world.de). Konferenca me titull “Gjendja e burgjeve në Ballkan”, Tiranë, Shqipëri, nga 21-24.12.2009. (qasur më 15.06.2011).

arrestimin e një rasti të till siq është ky duhet të jenë mjaft mire të informua për arsyjen e arrestimit dhe qëllimin e burgosjes së personit “<sup>18</sup>

Janë të ndryshme dhe të shumta, llojet e metodave të torturës fizike si :

2.a.1) *Rrahja sistematike (fallanga) ;*

2.a.2) *Tortura e mbytjes;*

2.a.3) *Djegia;*

2.a.4) *Gjymtimi (prerje, këputje);*

2.a.5) *Tortura elektrike (pikana);*

2.a.6) *Tortura dentare;*

2.a.7) *Tortura farmakologjike;*

2.a.8) *Tortura seksuale;*

2.a.9) *Varja palestineze.*

### **2.a.1) Rrahja sistematike (fallanga)**

Gjatë tërë kohës viktimat rrahet me shkopinjë, shufra ose tela në shputat e këmbëve. Një mënyrë tjetër e rrahjes sistematike, kur viktimat rrahet përnjeherë në të dy veshët, në vendet e frakturave të mëparshme ose në bark. <sup>19</sup> Kjo lloj rrahjeje është zbatuar sidomos te grate shtatëzëna, që sa më parë të provokohej aborti. Po ashtu edhe fore e kësaj metode është edhe kur gjatë tërë kohës viktimat torturohet me shkopinjë gome, shufra hekuri ose tela në shputat e këmbëve etj.

### **2.a.2) Tortura e mbytjes (nëndetsja)**

Ndryshe njihet edhe si forma e nëndetsës. Koka e viktimës zhytej në ujë të ndotur me jashtëqitje, urin dhe të tjera ndyrësira, derisa të fillonte mbytja, ose deri sa reflekse fizike të shkaktojnë thithjen e ujit të ndotur. <sup>20</sup> Kjo metode e

<sup>18</sup> Frederick Quinn, *Human Rights and You*, Warsaw, Poland, 1999, faqe 14.

<sup>19</sup> [www.agimi.poetiforum.com](http://www.agimi.poetiforum.com); Dr. Sabile Keqmezi-Basha, *Trajtimi i të burgosurve politik shqiptarë në burgjet jugosllave*, (qasur me 26 prill 2011).

<sup>20</sup> Loren Jacobsen and Peter Vesti, *Torture Survivors-a new group of patients*, Denmark, 1992, page 16.



torturës është konsideruar si një ndër metodat më nëveritëse dhe përqmuse për të torturuarin, andaj edhe pa dyshim është shumë poshtuese, dhe ka për qëllim cënimin e integritetit të personit ndaj të cilit ushtrohet me qëllim të nxjerrjes së informacioneve apo marrjes së ndonjë deklarate apo pranimi të saj pa qenë e tija fare.

### **2.a.3) Djegia**

Bëhet me anë të cigars, apo me hekur të nxehtë. Egzistonte edhe një lloj tjetër, që quhet “pjekja”, kur i burgosuri vishej me një skarë hekuri që me anë të rrymës elektrike fillonte nxehej gradualisht.<sup>21</sup> Këto metoda të torturës janë tejet të vrazhta dhe të rënda dhe shkaktojnë pasoja të mëdha si fizike ashtu edhe psikike dhe trauma të vazhdueshme që percjellin personalitetin ndaj të cilit janë ushtruar.

### **2.a.4) Gjymtimi (prerja, këputja)**

Si torture mundë të kishte disa forma. Të tilla ishin shkulja e fkokëve ose e mjekrrës, heqja e thonjëve, prerja e pjesëve të ndryshme të trupit, si e veshëve ose e gjuhës, etj.<sup>22</sup> Këto forma të kësaj metode janë përdorur shumë shpesh ndaj të burgosurve shqiptarë në Kosovë nga ana e sigurimit shtetrorë serbë dhe nda ana e policisë hetuese të kontrolluar nga serbët, në të cilën fatëkeqsisht ka pasur edhe shqiptarë të cilët kanë ushtruar tortura të tilla ndaj vllazërve tonë.

Por anë tjetër e kësaj është se numri i shqiptarëve që kanë marrë pjesë në tortura si pjesëtar të policisë dhe sigurimit shtetëror serbë nuk ka qenë edhe aq i madh, por e meta e saj është se një pjeë e tyre ende gjenden nëpër vende kyçe dhe ushtrojnë pozita me rëndësi, pa i vrarë fare ndërgjegjja.

---

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Po aty.

### 2.a.5) Tortura elektrike (pikana)

Ishte një nga llojet e torturave më të dhembëshme dhe viktimat shpesh here kafshonte gjuhën ,pjesët e mbrendëshme të faqeve dhe buzët .Elektrodat vendoseshin në pjesët më të ndryshme të trupit ,si: në veshë,gjuhë,mish të dhëmbëve ,mollëza të gishtrinjëve,organe gjenitale etj.<sup>23</sup> Pra ky lloj i metodës së torturës ishte një nga llojet e torturave më të tmerrshme e cila është përdorur ndaj personave ndaj të cilve është ushtruar tortura edhe në Kosovë sidomos gjat viteve '80 dhe '90 ndaj të burgosurëve politik.

### 2.a.6) Tortura Dentare

Thyeshin dhëmbët me goditje ose dhëmbët e shëndoshë thyeshin ose hiqeshin duke përdorur në mënyr jo funksionale instrumentet dentare.<sup>24</sup> Kjo formë e shkakimit të dhembjeve në pjesë të njeshme siq është goja ,dhëmbët duke mos përdorur fare mjetet e nevojshme për nxjerrjen e dhëmbëve pa anestezi dhe pa mjete të sterilezuara me qëllim që të torturohet personi dhe ti shkaktohen dhimbje të mëdha ,ngase dhëmbët janë të ndërlidhura drejt për drejt me sistemin nervor duke i shkakuar pos pasojave fizike dhe pasoja psikike ,Gjithashtu në raste kur përdoren mjete jo funksionale dhe të pastertilizuara dhe mjete jo adekuate shkaktohen edhe infeksione tjera me pasoja të pa parashikueshme për viktimën.

### 2.a.7) Tortura farmakologjike

Torturuesi e detyronte viktimën të gëlltiste tableta ose i jepnin atij injeksione, shpesh here të rrëzikshme për shëndetin e tyre.<sup>25</sup> Në disa raste iu jepnin edhe medikamente të rrëzikshme ose lëndë të panjohura, me qëllim të shkakimit të frikës si formë e torturës psikike .

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> [www.agimi.poetiforum.com](http://www.agimi.poetiforum.com); Dr. Sabile Keqmezi-Basha, Trajtimi i të burgosurve politik shqiptarë në burgjet jugosllave, (qasur me 26 prill 2011).

<sup>25</sup> Loren Jacobsen and Peter Vesti, Torture Survivors-a new group of patients, Denmark, 1992, page 17.

### 2.a.8) Tortura seksuale

Është ushtrimi i dhunës së drejpërdrejt në organet gjenitale, goditje ose tortura elektrike në këto organe. Qëllimi i përdorimit të kësaj metode të torturës është që të dëmtohet përkohësisht apo edhe përgjithmonë aftësi e personit për të pasur aktivitete seksuale apo ka raste që përdoret kjo metodë edhe vetëm për të ngjallur frikë tek personi se do tia dëmtoj organet gjenitale.<sup>26</sup>

Qëllimi i përdorimit të torturave seksuale është degradimi dhe thyerja e identitetit seksual të personit si dhe shkaktimi i frikës se personi më kurrë nuk do të jetë seksualisht i aftë.

Format e torturimit seksual më të shpeshta janë: rrahje në kokë (trup), lëndime në organet seksuale, zhveshje dhe ekscitim seksual para masës, sakatimi i organit seksual.

### 2.a.9) Varja palestineze

Ishte një formë torture kur viktima mbahje me krahët prapa për orë ose ditë të tëra.

Shpeshë here ndodhë që kësaj torture t'i shtonin edhe torturen elektrike (elektro -shokun), në pjesët e ndryshme të trupit.<sup>27</sup> Kjo metodë e torturës kishte për qëllim që ta lodhte të torturuarin dhe që ai mandej të jepte informatat apo të dhënat për të cilat ndaj tij ushtrohej kjo formë e tortures. Pra mbi bazën e definimit apo përkufizimit të kësaj metode shohim se me një far mënyre kjo metod mundë të konsiderohet edhe metoda e kombinuar, mbase përdoren edhe pjes të metodave tjera të torturave fizike.

---

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> Po aty.

## 2.b. Metodat e torturës psikologjike

Po thuaj se është tejet e rëndë dhe e pa përballueshme tortura fizike, por me gjith atë ajo nuk mund të krahasohet në aspektin e shkakimit të pasojave me torturen psikologjike.

Metodat e torturës psikologjike janë ato që e shkatërrojnë drejt për se drejti personalitetin e viktimës.<sup>28</sup> Pra ato kanë për qëllim që të shkatërrojnë personalitetin e personit ndaj të cilit ushtrohen ato, pra qëllimi i përdorimit të këtyre torturave është shkatërrimi i psikikës së personit me qëllim që ai të pranoj që ti merret ndonjë deklaratë apo të pranojë ndonjë veprim që nuk e ka kryer fare.

Janë të ndauardurshme dhe të shumëllojta metodat e torturave psikologjike sin ë vijim:

- 2.b.1) Privimi ose rraskapitja;*
- 2.b.2) Kërcënimet;*
- 2.b.3) Frika(fobia);*
- 2.b.4) Prania e të tjerëve gjatë torturimit;*
- 2.b.5) Poshtimi dhe tortura seksuale.*

### 2.b.1) Privimi ose rraskapitja

Kjo metodë e torturës ka për qëllim që i torturuari ta shkatërroj privimin nga ndijimet shqisore siq janë: drita, tinguj, gjumi apo edhe nga kontaktet me njerz. Këto metoda shpesh janë të kombinuara. Izolimi mundë të bëhet me një qeli shumë të vogël, 1.5x2 metra, e cila mundet me qenë pa dritë fare apo me shumë dritë. Në shumë raste viktimës i mbulohet koka dhe e ushqejnë në kohë të ndryshme gjatë njëzet e katër orëve, me qëllim që viktimës ti humbas konceptimi i kohës. Zakonisht viktimës nuk i jepet mundësia fare për t'u pastruar, për të kryer nevojat fiziologjike, po ashtu nuk i jepet kurrfare mundësie dhe të gjitha nevojat kryhen në qeli. Pra vetëm disa ditë pa gjumë thyejnë rezistencën e viktimës, kurse mungesa e

---

<sup>28</sup> *Loren Jacobsen and Peter Vesti, Torture Survivors a new group of patients, Denmark, 1992, page 19.*

kontaktit me pjesën tjetër të botës , e bënë të pa shpresë, të dëshpruar e me depresion , ka raste kur disa nga viktimat edhe kalojnë në halucinacione.<sup>29</sup>

Privimi (izolimi) si metodë ka dëshmuar, se është një prej metodave efikase të torturës për të “thyer”një qenje njerëzore. Mbi bazën e përvojës shihet se në shumë burgje, izolimi është shpesh një armë e mirë për të reduktuar pafuqinë sociale të individëve, duke i lënë ata të vetëm me vetën e tyre për periudha kohore më të gjata. Izolimi, si metodë psikologjike e torturës është një faktor i stresit ekstrem për individin, dhe në shumë raste ka dëshmuar, se është shkak i sulmeve të panikut dhe fobive të ndryshme. Simptomet kryesore të izolimit janë: dashuri e skajshme për qenjet e tjera të gjalla, duke i menduar edhe objektet e pa jetë, si të gjalla, dhe halucinacione tjera.

## 2.b.2) Kërcënimet

Kjo metod e tortures psikologjike ka për qëllim që ti kërcënoj viktimat në mënyrë të vazhdueshme me tortura, vrasje, plagosje, po ashtu u thonë viktimave të torturës se familjet dhe miqtë dhe të afërmit dhe të dashurit e tyre do të torturohen dhe rrahen, duke qenë ata vet aty të pranishëm.<sup>30</sup>

Ka edhe kërcënime në individ me një prag të ulët e dhimbjeje, kërcënim për të shkaktuar dhimbje, është i pa durueshëm, ndonjë her më pak i durueshëm dhe ka efektin e dhimbjes.

Torturuesi mundohet për ta parë strategjin efektive të torturës, tek i torturuari, sipas shumë studimeve të studiuesve të kësaj fushe, personat zyrtar të cilët ushtrojnë torturën kanë për qëllim që ta shofin psikologjin më të thellë të viktimës së torturës në mënyrë që të shohin efektin e kërcënimit si metodë psikologjike dhe shkaktimin e frikës së saj më të thellë, dhe për të zbuluar prapen përtej të ciliës dhimbje, viktimat nuk mund të rezistojnë tut

---

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> Po aty.

### 2.b.3) Frika (fobia)

Kjo metodë e torturës psikologjike përdoret me qëllim që të thyej mendjen e viktimës për të pranuar ndonjë deklarat apo ndonjë vepër të cilën fare nuk e ka bër, apo për të nxjerrur ndonjë informacion me rëndësi për ato të cilat ushtrojnë torturën.<sup>31</sup>

Mënyra se si ushtrohet kjo torture është e atillë që shfrytëzohen informacionet nga vet i torturuari mbi dobësit apo fobit që ai ka, apo nga përsoneat e tjerë.

Disa njerëz kanë një fobi të tillë për marimangat: në këtë rastë mundë të lihen për orë të tëra me një dhomë plot me marimanga, vetëm që të merren në pyetje, dhe personat që kanë fobi marimangat janë të trishtuar dhe do të fillojnë të flasin apo të japin informacione mbi atë se qfarë kërkohet nga ata.

Po ashtu kjo metodë përsëritet disa herë dhe viktimat nga frika e kthimit në atë dhomë, apo në atë gjendej qafre ka ndjerë do të jenë më të qetë dhe do të përgjigjen pyetjeve të parashtruara nga ana e torturuesve.

### 2.b.4) Prania e të tjerëve gjatë torturimit

Kjo metodë e torturës psikologjike ka për qëllim që të fus frikën dhe ndjenjën e trishtimit tek ata persona që janë prezent deri sa ushtrohet tortura ndaj viktimave tjera.

Me një far forme është tendencë e të tërhequrit vrejte se edhe ato nëse nuk bashkpunojnë në dhënjën e informacioneve do të përjetojnë të njejtin fatë.

Nuk mundë të përshkruhen ndjenjat e një njeriu kur e detyrojnë të jetë prezent gjatë torturimit të të dashurëve të tij apo të sajë. Shpesh njerëzit torturohen deri në vdekje, ndërsa të burgosurit e tjerë janë të detyruar ti shikojnë, pa mundur të bëjnë asgjë që ta ndalojnë atë gjendje. Viktimat që kanë pasur një përvoj të tillë, tregojnë se ende kujtojnë çdo sekond të asaj ngjarjeje, dhe se për ta jeta po thuhet se kishte ndaluar ecuri dhe se ate po

---

<sup>31</sup> Po aty.

thuj se nuk ishin në dijonin e së eksiztuarit. Në ato momente ato më mire kishin preferuar të vdesin se sa të përjetonin të tilla ngjarje.<sup>32</sup>

Ishte një metodë shumë nënçmuese, dhe fyese për personalitetin e viktimës. Gjatë ushtrimit të kësaj metode ka raste të shpeshta ku zbatimi i saj bëhet në mënyr kolektive, kur në një dhomë i futnin shumë persona dhe i rrahin në mënyr të panderprerë deri sa ata të alivanosen para të tjerëve.

Mënyra se si është zbatuar kjo metodë në Kosovë nga ana e pushtetit serbë, paraqitet më së miri në një shkrim të Prof.Dr.Sabile Keqmezi-Basha, ku ajo thotë “Shpesh ndodhë që, ashtu të rrahurit i ekspozonin para të tjerëve, ose para anëtarve të familjes (rasti me N.N.).<sup>33</sup> Sipas shumë deklaratave që kanë dhënë ish-të izoluarit, shumica e tyre pohojnë se janë rrahur e janë keqëtrajtuar para shokëve të vet. Qëllimi i torturuesit dihej, pra ishte që ta përkulte dhe t’ia thyente dinjitetin njerëzor të burgosurit.<sup>34</sup>

## 2.b.5) Poshtrimi dhe tortura seksuale

Kjo metod e torturës psikologjike ka për qëllim që të shkaktoj një goditje të rëndë ndaj personalitetit të njëriut e që është poshtrimi. Këto viktime të cilat i nënshtrohen kësaj torture janë të detyruar të kryejn akte poshtëruese, duke thënë gjëra poshtëruese, të tallen duke kënduar për njerzit e tyre të dashurë apo të afërmë të tyre, në formë nënçmuese dhe tejet poshtëruese.

Torturuesi qeshë dhe tallet me viktimat që qajnë, urinon mbi to, i detyron ta hanë jashtëqitjen e tyre. Nuk ka dyshim se poshtrimi është një element shumë irëndë i cili zbaohet me anë të torturës seksuale, tek burrat goditet aftësia e tyre për të qenë burra ,ndërsa grate sulmohen si objekte seksuale.<sup>35</sup>

---

<sup>32</sup> Po aty.

<sup>33</sup> Ky rast është i potencuar edhe me emër dhe mbiemër në punimin e autorës Dr. Sabile Keqmezi-Basha me titull: *Trajtimi i të burgosurve politik shqiptarë në burgjet jugosllave*

<sup>34</sup> Dr. Sabile Keqmezi-Basha, *Trajtimi i të burgosurve politik shqiptarë në burgjet jugosllave* (qasur me 26 prill 2011).

<sup>35</sup> Loren Jacobsen and Peter Vesti, *Torture Survivors a new group of patients*, Denmark, 1992, page 20.

Që të dy llojet apo metodat e torturave kanë për qëllim nxjerrjen apo pranimin e informatave të caktuar ndaj të torturuarëve nga ana e personave zyrtar, kjo bëhetë siomos ndaj atyre që janë privuar nga liria apo janë në vuajtje të dëmieve të caktuara apo sanksioneve penale të cilat janë shqiptuar ndaj tyre në procedurë të rregullt ligjore.

### ***Përfundimet***

- *Legjislacioni penal i Kosovës, në mënyrë të përgjithësuar ka paraparë në shumë dispozita ligjore ndalimin e përdorimit të torturës si vepër penale, por këto dispozita nuk janë të koncentruara apo kodifikuara në një ligj apo kod penal ose procedural, por si të tilla ato gjenden në disa ligje dhe në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale. Natyra e kësaj vepre penale e predisponon një gjë të tillë, por ne konsiderojmë se do të ishte e dobishme sikurse palëve të inetrësuar t'u ofrohet një përmbledhje e dispozitave nga kjo fushë.*
- *Dispozitat ligjore ndërkombëtare mbi veprën penale të torturës po ashtu janë të parapara në disa akte dhe konventa ndërkombëtare mjaft të rëndësishme, si në akte të nxjerra nga institucionet e rangut evropiane apo edhe nga institucionet e caktuara të Kombeve të Bashkuara. Është shume e vëndiente se ka mjaft dokumnete dhe akte që ndalojnë përdorimin e torturës si mjet për nxjerrjen e informatave.*
- *Të vetëdijshëm se me këtë punim është e pamundur të përmbliiden të gjitha metodat e torturës, pasi që ato janë të ndryshme dhe të shumta. Andaj, për sa i përket metodave të torturës është tejet e vështirë të nxjerrim një përfundim se cilat metoda përdoren tani, e cilat jo, apo cilat do të përdoren në të ardhemen, sepse metodat e torturës me kalimin e kohës edhe ato po avancohen, po ndyshohen, dhe po përsosen, e cila gjë, po e bën më të vështirë mundësinë e hetimit dhe zbulimit të kryerësve të kësaj vepre penale.*
- *Metodat e torturës fizike janë të atilla që kanë për qëllim që ta dëmtojnë dhe shkatërrojnë shëndetin fizik të personit, me qëllim të nxjerrjes së informacioneve apo pranimi të ndonjë deklarate nga ana e zyrtarëve*



*shitetërorë apo personave që janë nën kontrollin e tyre. Ky lloj i torturave është mjaft i pranishëm në ditët e sotme, por ka qenë shumë më shumë i pranishëm dhe i zbtuar në të kaluarën në përgjithësi.*

- *Metoda e torturës psikologjike, kanë për qëllim që të shkatërrojnë personalitetin e personit ndaj të cilit ushtrohen ato, pra qëllimi i përdorimit të këtyre torturave është shkatërrimi i psikikës së personit me qëllim që ai të pranojë që t'i merret ndonjë deklaratë apo të pranojë ndonjë veprim që nuk e ka kryer fare. Me anë të kësaj metode synohet të nxirren të dhëna të cilat personi i caktuar nuk dëshiron t'i japë me vullnetin e tij të lirë apo të pranohen gjëra të cilat fare nuk kanë të bëjnë me të. Kjo metodë është shumë më e pranishme në kohën e tanishme dhe është metodë shumë perfide për nxjerrjen e informacioneve apo pranimin e tyre nga personat ndaj të cilëve ushtrohet kjo.*
- *Që të dy llojet apo metodat e torturave kanë për qëllim nxjerrjen apo pranimin e informatave të caktuara ndaj të torturuarve nga ana e personave zyrtar, kjo bëhet sidmos ndaj atyre që janë privuar nga liria apo janë në vuajtje të dënimeve të shqiptuara apo sanksioneve penale të cilat janë shqiptuar ndaj tyre në procedurë të rregullt ligjore. Këtë vepër penal munden ta kryejnë vetëm personat zyrtarë pranë institucioneve ku ata punojnë, duke tejkaluar kompetencat e tyre për mbajtjen e personave të privuar nga liria apo mbikëqyrjen e personave që janë në vuajtje të dënimeve apo sanksioneve penale.*

*Mr.sc. Xhevdet HALILI*

## **THE LEGISLATION AND METHODS OF TORTURE**

### *Summary*

Torture is the kind of criminal act which is punished by law both at the domestic level and internationally through numerous international conventions.

This paper argues that, notwithstanding the problems facing Kosovo, in particular during the last two decades, where torture has been widespread, this has not been addressed sufficiently by the academic and professional communities.

This paper offers a comprehensive overview of domestic and international legislation against torture. It also observes its meaning and methods involved to implement torture, one of the most heinous acts human beings.

At the end of the paper, we draw a number of conclusions about this type of criminal act, which has major consequences and impact well after it has been committed. Such conclusions and recommendations aim at a better implementation of relevant legislation against torture.





## **Kontribute** Contributios



Mr. sc. Lavdim Krasniqi

## PAVARËSIA GJYQËSORE

### Përmbledhje

Pavarësia gjyqësore është njëra nga vlerat më të çmueshme të një shoqërie demokratike. Për ta shprehur kuptimin e vërtetë, pavarësinë gjyqësore mund ta ndihmojnë vetëm disa parime bazë të cilat janë edhe përmbajtje kryesore e sajë.

Parimi i ndarjes së pushteteve i cili doli si doktrinë përfundimtare pas shumë përpjekjeve revolucionare kundër centralizimit të pushtetit, ishte fillimi i formimit të termit pavarësi gjyqësore. Ndërsa, derisa pavarësia gjyqësore siguron sundimin e ligjit, këtë të fundit e bën të mundur vetëm gjykimi i paanshëm dhe i drejtë.

Këto parime bazë (ndarja e pushteteve, sundimi i ligjit dhe paanshmëria) janë përmbajtja kryesore e këtij punimi. Paraqitja e trajtimit ndërkombëtarë të këtyre parimeve dhe pasqyrimi i bazës kushtetuese dhe ligjore vendore është fokusi kryesor gjatë përpunimit të këtyre parimeve.

Termat e theksuar me këtë rast si: pavarësia gjyqësore, pavarësia e gjyqtarëve, gjykimi i drejtë dhe i paanshëm, si dhe sundimi i ligjit, njihen si parimet më të rëndësishme të një demokracie kushtetuese. Një vëmendje e posaçme në këtë punim i është kushtuar pavarësisë gjyqësore në Kosovës, sfidave dhe zhvillimeve lidhur me strukturën institucionale përgjegjëse për ta siguruar këtë pavarësi si dhe bazës kushtetuese dhe ligjore vendore e cila ka përcaktuar pavarësinë ligjore në kuptimin formal.

Sundimi i ligjit si bazë e respektimit të lirive dhe sigurimin e barazisë për të gjithë qytetarët, gjithashtu është trajtuar duke pasur parasysh perspektivën e menaxhimit ndërkombëtarë institucional, por edhe krijimin e strukturës ligjore e cila nuk mbeti pa u shoqëruar me sfida të llojit të veçantë.

Edhe paanshmëria gjyqësore si njëri nga parimet e pavarësisë gjyqësore është trajtuar gjithashtu në frymën e një garancie e cila siguron besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor të një vendi.

Përfundimisht shpreh bindjen se trajtimi i nocionit “pavarësi gjyqësore” dhe parimeve kyçe të saj në kuadër të këtij punimi është vetëm një përpjekje fillestare për të tërhequr vëmendjen e atyre që janë pjesë e kulturës juridike të Kosovës.

## I. PAVARËSIA GJYQËSORE

### A. *Parimet kryesore të pavarësisë gjyqësore*

Tri janë arsyet kryesore të cilat e shpjegojnë rëndësinë e pavarësisë gjyqësore. E para është doktrina e ndarjes së pushteteve e cila kërkon që gjyqësia të jetë e pavarur nga degët e zgjedhura të qeverisjes (kuvendi, presidenti, qeveria). E dyta, sundimi i ligjit kërkon pavarësi gjyqësore. E treta, në mënyrë që gjyqtarët të janë në shërbim të drejtësisë ata duhet të jenë të paanshëm dhe të drejtë me rastin e vendosjes së rasteve.

Çka është në të vërtetë “pavarësia gjyqësore”? Ndonëse definimi i pavarësisë së gjyqësorit nuk është shprehimisht i përcaktuar me legjislacion, në teorinë juridike mbizotëron definimi se pavarësia gjyqësore përfshin gjykimin e drejtë, të mbështetur në ligj, të paanshëm dhe të ndershëm, të motivuar nga zotimi ndaj drejtësisë dhe shprehja e drejtësisë në ligj. Për të realizuar këtë standard kushtetues, gjyqtarët duhet të jenë të lirë për të vendosur çështjet faktike pa u ndikuar nga frika e shpagimit qoftë psikologjik, financiar apo rrezikimit të vendit të punës apo familjes. Megjithatë nuk është e qartë se si gjyqtarët ose gjykatat mund të jenë të pavarur në qoftë se ndonjë nga këta faktorë nuk janë të ngulitur fort në sistemin ligjor ku ata veprojnë. Një faktor tjetër është se vendimet gjyqësore nuk duhet të përmbysen apo të mohohen në mënyrë arbitrare. Këta faktorë kritik për pavarësinë gjyqësore janë të domosdoshëm për gjykatat që të funksionojnë në mënyrë efektive.

Me këtë rast mund të shtrohen këto pyetje: si ndikojnë këta faktorë kritik që të kemi një sistem të demokracisë kushtetuese? A është kontrolli gjyqësor një kompromis për pavarësinë gjyqësore? Cilat lloje të kontrollit gjyqësor janë të lejueshme? Përgjigja në këto pyetje varet krejtësisht nga fakti se çfarë çmimi kanë vlerat e demokracisë kushtetuese të një vendi. Për shembull, në një demokraci kushtetuese llogaridhënia vërtetë çmohet shumë, sepse demokracia është e bazuar në pajtimin e të qeverisurve dhe pa

llogaridhënie, nuk mund të ketë pajtim. E kundërta ndodhë me vendet ku demokracia shprehet vetëm në deklarime formale e nuk jeton në realitet. Si pasojë, pavarësia gjyqësore dhe llogaridhënia gjyqësore duket se tërhiqen në drejtime të kundërta.

A ka ndonjë mënyrë për të shmangur këtë situatë? Një baraspeshim në mes të këtyre dy vlerave të rëndësishme është më se i nevojshëm. Por çfarë lloj baraspeshimi është i përshtatshëm? Vlerat e pavarësisë dhe llogaridhënies gjyqësore ekzistojnë në një spektër ku njëri ekstrem përfaqëson pavarësinë e plotë, ndërsa tjetri llogaridhënien e plotë. Kjo situatë do të duhej të zgjidhej me vendosjen e një sistemi gjyqësor ku gjyqtarët janë të pavarur në marrjen e vendimeve, por llogaridhënës për rastet dhe mënyrat e përcaktuara me ligj. Për të siguruar pavarësinë dhe llogaridhënien, shumica e shteteve me demokraci funksionale kushtetuese kanë themeluar institucione të veçanta të cilat administrojnë sistemin gjyqësorë duke filluar nga rekrutimi, arsimimi ligjor, disiplinimi, llogaridhënia dhe shkarkimi i gjyqtarëve.

Shtete të ndryshme trajtojnë pavarësinë e gjyqësorit në mënyra të ndryshme, ndërtojnë struktura të ndryshme të sistemit gjyqësorë, ose zgjedhin gjyqtarët në mënyra të ndryshme. Në kuadër të kësaj sigurie, shumëçka fillon me kriteret dhe mënyrën e rekrutimit të gjyqtarëve. Një mënyrë tjetër për të promovuar pavarësinë e gjyqësorit është emërimi i përjetshëm i gjyqtarëve ose emërimi i tyre për një kohë sa më të gjatë.<sup>1</sup> Ky fakt, në mënyrë ideale i liron gjyqtarët që të vendosin rastet dhe të marrin vendime në bazë të ligjit. Ky diskrecion gjyqësor do të mbisundojë, edhe në qoftë se vendimet e gjyqtarëve janë politikisht të papëlqyeshme ose të kundërshtueshme nga interesa të fuqishme. Zyrtarët e gjyqësorit duhet të bëjnë sakrifica për të ruajtur pavarësinë e gjyqësorit dhe për të mbështetur parimet kushtetuese.

Në disa vende, aftësia e gjyqësorit për të kontrolluar legjislativin dhe ekzekutivin është rritur nga fuqia e shqyrtimit gjyqësor<sup>2</sup>. Kjo fuqi mund të përdoret, për shembull, kur gjyqësori kupton se ligjvënësit janë duke rrezikuar të drejtat kushtetuese të tilla si të drejtat e të akuzuarit.

---

<sup>1</sup> Shih për shembull neni 105.1 i Kushtetutës së Kosovës.

<sup>2</sup> Shih për shembull section 2 i Kushtetutës së SHBA-ve.



**B. Rregullativa ndërkombëtare ligjore**

Sipas Kartës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), popujt e botës pohojnë vendosmërinë e tyre për të krijuar kushtet nën të cilat mund të mbahet drejtësia për të arritur bashkëpunimin ndërkombëtar në promovimin e respektit për të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale pa asnjë diskriminim.<sup>3</sup> Ndërsa, Deklarata Universale e OKB-së për të Drejtat Njeriut mishëron në mënyrë të veçantë parimet e barazisë para ligjit, prezumimin e pafajësisë dhe të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe publik nga një gjykatë kompetente, e pavarur, e paanshme dhe e caktuar me ligj.<sup>4</sup>

Ushtrimi i të drejtave ekonomike dhe kulturore si dhe të drejtave civile dhe politike garantohet me konventa ndërkombëtare. Ndër to është Konventa mbi të Drejtat Civile dhe Politike e cila garanton të drejtën për t'u gjykuar pa vonesë të tepruar. Ndër të drejtat e shpallura me këtë konventë janë ato që kanë të bëjnë me “garancitë procedurale në gjyqet civile dhe penale”<sup>5</sup>. Sipas këtyre të drejtave “të gjithë njerëzit janë të barabartë para gjykatës. Në përcaktimin e çdo akuze penale, ose të drejtave dhe detyrimeve në një padi, të gjithë kanë të drejtë për një proces gjyqësor të drejtë dhe publik të zhvilluar nga një gjykatë kompetente, e pavarur e paanshme dhe e themeluar me ligj”. Një ligj mjaft i rëndësishëm ndërkombëtarë i cili përcakton dhe mbron pavarësinë dhe paanshmërinë gjyqësore është Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.<sup>6</sup> Sipas nenit 6 të kësaj Konvente “çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj”. Duhet theksuar se sipas neni 53 të Kushtetutës së Kosovës, çështjet që kanë të bëjnë me përvojën jurisprudenciale të Strasburgut janë kushtetutshmërisht të detyrueshme në Kosovë.

Kongresi i Shtatë i Kombeve të Bashkuara, i zhvilluar me temë “Parandalimi i Krimit dhe Trajtimi i Shkelësve”, i bëri thirrje Komisionit për Parandalimin dhe Kontrollin e Krimit që në mesin e prioritetëve të tij të përfshijë udhëzimet lidhur me pavarësinë, mënyrën e përzgjedhjes,

---

<sup>3</sup> Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, miratuar në San Francisko më 1945  
faqe 2.

<sup>4</sup> Neni 10 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

<sup>5</sup> Neni 14.1 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

<sup>6</sup> Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

trajnimin profesional dhe statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>7</sup>. Një shembull adekuat i një mekanizmi për të ruajtur pavarësinë e gjyqësorit përmbahet në Kushtetutën e SHBA-ve e cila vendos një sistem të ndarjes dhe balancimit e pushtetit. Kjo Kushtetutë<sup>8</sup> në mes tjerash përcakton se "gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe gjykatave më të ulëta, do të mbajnë zyrat e tyre dhe në të njëjtën kohë do të kompensohen për shërbimet e tyre, shpërblim i cili nuk do të zvogëlohet gjatë vazhdimësisë së tyre në detyrë.

Në pothuaj se të gjitha vendet me demokraci kushtetuese, sot ekzistojnë mekanizma të cilët jo vetëm që parashohin formalisht, por edhe krijojnë kushte për respektimin e parimeve të ndarjes së pushteteve, gjyqësorit të pavarur, të paanshëm dhe sundimit të ligjit. Këto parime kanë fituar përkushtimin ndërkombëtarë nëse jo për diçka tjetër, së paku për t'i bërë ballë globalizimit ndërkombëtarë në të gjitha format e jetës dhe komunikimit të njerëzve.

## II. NDARJA E PUSHTETEVE

Shqyrtimet teorike të konceptit të ndarjes së pushteteve fillojnë zë zënë vend gjatë periudhës mesjetare nga figura kulminante të mendimit politik dhe filozofik si mendimtarit politik francez Baron de Montesquieu dhe anglezi John Locke. Megjithatë, gjurmët e ndarjes aktuale të pushteteve në degë të ndryshme të qeverisjes mund të gjinden qysh në Greqinë e lashtë. Ky term më vonë hyri në përdorim të gjerë nga ana e Republikës Romake, si pjesë e kushtetutës origjinale e Republikës Romake.

Mbi bazë të kësaj ideje edhe hartuesit e Kushtetutës amerikane vendosën të bazojnë sistemin e qeverisjes së tri degëve të veçanta: ekzekutiv, gjyqësor, dhe legjislativ. Të tre këto pushtete apo degë të qeverisjes dallojnë nga njëra tjetra, kanë kontrole dhe janë të ekuilibruara në njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë, asnjëra degë nuk mund të fitojë pushtetin absolut apo abuzojnë me pushtetin e dhënë.

Doktrina e ndarjes së pushteteve është një nga elementet thelbësore të sundimit të ligjit, sepse pa një ndarje të duhur të kompetencave sundimi i ligjit do të vihej në rrezik apo do të ishte i pamundur.

---

<sup>7</sup> Këto udhëzime u miratuan me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në nëntor 1985 me të cilën vendosën "Parimet Themelore mbi Pavarësinë e Gjyqësorit".

<sup>8</sup> Neni III, Seksioni 1 i Kushtetutës së SHBA-ve.

Sipas modelit të ndarjes së pushteteve, shteti është i ndarë në disa degë, ku secila ka kompetenca të veçanta dhe të pavarura në mënyrë që asnjëra prej tyre të mos ketë fuqi më shumë se tjetra. Ndarja normale e degëve të pushtetit është në atë ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor.

Mënyra se si janë zgjedhur, si janë financuar, cilat kompetenca i kanë si dhe cili është niveli i kontrollit të ndërsjellë, determinon edhe nivelin e ndarjes së pushteteve.

Kushtetuta e Kosovës<sup>9</sup> në kuadër të dispozitave themelore të saj e ka akceptuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancit në mes tyre duke e ngritur këtë në parim fundamental kushtetues. Në Kosovë pushtetin legjislativ e ushtron Kuvendi, pushtetin ekzekutiv e ushtron qeveria, ndërsa pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat. Kuvendi është institucion ligjvënës i zgjedhur drejtpërdrejtë nga populli<sup>10</sup>. Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv duke zbatuar ligjet dhe aktet e miratuara nga Kuvendi si dhe nxjerr vendime dhe ushtron kompetenca të caktuara me Kushtetutë dhe me ligj<sup>11</sup>. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat si autoritete të pavarura, të cilat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.

### III. SUNDIMI I LIGJIT

Sundimi i ligjit është një bazament për liritë dhe rendin tonë juridik i cili siguron barazinë për të gjithë qytetarët. Sundimi i ligjit na mundëson që ne të organizojmë jetën, të planifikojmë të ardhmen, dhe të zgjidhim mosmarrëveshjet në mënyrë racionale. Si një mekanizëm i rëndësishëm për sigurimin e ligjshmërisë dhe pavarësisë së gjyqësorit, sundimi i ligjit siguron zbatimin e vendimeve qeveritare të mbështetura në rregullativën ligjore, përfshirë Kushtetutën. Termi “sundim i ligjit” ka filluar të përdoret qysh në shekullin e XVII, mirëpo është popullarizuar në shekullin e XIX nga juristi britanik A.V Dicey. Koncepti “sundim i ligjit” ishte i njohur edhe për filozofët e lashtë si Aristoteli<sup>12</sup>, i cili shkroi “Ligji duhet të qeverisë”. Sundimi i ligjit nënkupton faktin se që çdo qytetar i nënshtrohet ligjit dhe të gjithë janë të barabartë para tij. Kjo qëndron në kontrast me idenë se

---

<sup>9</sup> Neni 4 i Kushtetutës së Kosovës.

<sup>10</sup> Kapitulli IV neni 63 i Kushtetutës së Kosovës.

<sup>11</sup> Kapitulli VI neni 92 i Kushtetutës së Kosovës.

<sup>12</sup> Aristoteli, Politika 3.16.

sunduesi është mbi ligjin. Të gjitha shoqëritë demokratike në botë sot kanë vendosur sundimin e ligjit jo vetëm si prioritet parësor, por përpiqen intensivisht për të promovuar atë qoftë përmes strukturës ligjore, qoftë përmes procesit të vendimmarrjes institucionale.

Një element kyç i sundimit të ligjit është parimi se zgjidhja e mosmarrëveshjeve duhet të bëhet në përputhje me ligjin dhe me asgjë tjetër, pos ligjit. Nëse gjyqtarët largohen nga zbatimi i ligjit për shkak të pikëpamjeve personale morale apo politike, atëherë vihet në rrezik ligjshmëria gjyqësore. Nëse gjykimi i mosmarrëveshjeve ndikohet nga presione të jashtme politike, atëherë bëhet i pamundur kontrolli i ushtrimit të pushtetit gjyqësor pa ndërhyrjen e degëve politike të qeverisë (kuvendit dhe qeverisë).

Parimi i sundimit të ligjit është gjerësisht i përcaktuar me legjislacionin kosovar. Theksi në termin “sundim i ligjit” vihet për qëllime të ndryshme. Përkundër faktit se institucionet përgjegjëse të pushtetit në Kosovë kanë përcaktuar si prioritet “sundimin e ligjit”, vënia në jetë e këtij parimi ka hasur në sfida mjaft komplekse. Tejkalmi i këtyre sfidave nuk do të mund të arrihet vetëm me strategji dhe deklarime formale, por thjesht me zbatimin real të strukturës aktuale ligjore.

Baza për sigurimin e sundimit të ligjit, në pikëpamje formale ekziston në vet strukturën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila ka themeluar të gjithë mekanizmat e duhur për këtë qëllim. Neni 7 i Kushtetutës së Kosovës përcakton sundimin e ligjit si një nga vlerat kushtetuese të detyrueshme për zbatim nga ana e organeve dhe autoriteteve shtetërore. Për më tepër, Kushtetuta ka ngarkuar gjykatat me autoritetin e sigurimit të sundimit të së drejtës, duke i garantuar secilit (që në këtë rast nënkupton personat fizik dhe juridik) të drejtën për të ju drejtuar gjykatave me mjete të rregullta dhe të jashtëzakonshme<sup>13</sup>. Në vijim të kësaj, i pazëvendësueshëm është edhe roli i Gjykatës Kushtetuese si autoritet përfundimtarë për interpretimin e Kushtetutës dhe vlerësimin e ligjshmërisë në Republikën e Kosovës.

Megjithatë, duke qenë se fjala është për një nocion të gjerë dhe kompleks, sfidat për implementimin e parimit të sundimit të ligjit mund të jenë të shumta. Së pari, perceptuar nga këndvështrimi historik, nga viti 1999 kur u vendos misioni ndërkombëtar (që shënon themelimin dhe menaxhimin e

---

<sup>13</sup> Për më tepër shih nenin 102.5 të Kushtetutës së Kosovës.

institucioneve përgjegjëse për sundimin e ligjit nga autoritetet ndërkombëtare) në Kosovë ka pasur një zhvillim të hovshëm legal dhe institucional në fushën e sundimit të ligjit. Megjithatë krijimi i strukturës ligjore është përcjellë shpesh herë me mos harmonizim adekuat të ligjeve dhe me një përzierje të rregullativës ligjore e cila në disa fusha ka krijuar konfuzion dhe vështirësi për jetësim. Një nga mangësitë që shoqëruan procesin e sigurimit të sundimit të ligjit ishte edhe fakti i investimeve jo të mjaftueshme në ngritjen e kapaciteteve sidomos në sistemin gjyqësor të Kosovës. Vetëm pas vitit 2005/2006 kanë filluar të vërehen disa lëvizje pozitive në drejtim të reformimit të sistemit gjyqësor si përgjegjësi kryesor për të garantuar sundimin e ligjit. Këto zhvillime pozitive u shfaqën edhe më intensivisht pas vitit 2008, kur reformat filluan të prekin të gjitha aspektet e sistemit gjyqësor. Ato reforma u përqendruan sidomos në aspektin kadrovik<sup>14</sup>, legjislativ<sup>15</sup>, financiar<sup>16</sup> dhe ristrukturimin e tërësishëm të gjykatave dhe prokurorive<sup>17</sup>. Zhvillimet aktuale në sistemin gjyqësor tregojnë se viti 2012 do të shënojë të gjitha përpjekjet për ta përgatitur zbatimin e strukturës së re ligjore të sistemit gjyqësor, ndërsa përkrahja e kësaj reforme nga dy pushtetet tjera (legjislativ dhe ekzekutiv) nëse nuk do të jetë më e theksuar të paktën duhet të mbahet larg ndikimeve në sistemin gjyqësor dhe pavarësinë e tij.

#### IV. PAVARËSIA GJYQËSORE

Shumica e vendeve evropiane, përfshirë Kosovën, kanë përcaktuar pavarësinë e gjyqësorit në aktet ligjore më të larta të tyre. Para së gjithash, kushtetuta është dokumenti i cili në shumicën e vendeve, parasheh pavarësinë e gjyqësorit dhe duke qenë një dokument vështirë për t'u ndryshuar, konsiderohet se siguron një stabilitet të këtij parimi. Përveç kësaj, kushtetutat e shumicës së vendeve parandalojnë krijimin e gjykatave *ad hoc*, të cilat mbajtësit e caktuar të pushtetit mund ti përdorin në përpjekjet e tyre për të mbrojtur interesat e veta.

---

<sup>14</sup> Emërimet dhe ngritjen profesionale për mes arsimimit fillestar dhe të vazhdueshëm ligjorë të gjyqtarëve dhe

prokurorëve dhe kandidatëve për këto pozita.

<sup>15</sup> Nxjerrjen e ligjeve bazë për sistemin gjyqësor e prokurorial; Ligji për Gjykatat, Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

<sup>16</sup> Është shënuar një përmirësim i pozitës financiare të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

<sup>17</sup> Duke filluar nga janari i vitit 2013 Kosova do të ketë strukture të re të gjykatave dhe prokurorive.

Në parimet themelore të Magna Carta të Gjyqtarëve, pavarësia e gjyqësorit dhe gjyqtarëve është përcaktuar edhe nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE), më 19 nëntor 2010. KKGJE gjithashtu rekomandon që pavarësia të sigurohet "nga rregullat kombëtare të nivelit më të lartë". Një pozicion i pavarur i gjyqtarëve përfshinë në vete aspekte të shumta, duke filluar nga, mënyra e emërimit të gjyqtarëve, kohëzgjatja e funksionit gjyqësor, rregullat strikte për transferimin dhe disiplinimin e gjyqtarëve, mënyrat për shkarkimin e gjyqtarëve, imuniteti dhe pavarësia financiare e gjyqtarëve e kështu me radhë.

### **A. *Pavarësia Gjyqësore në Kosovë***

Ndarja e pushteteve si kriter bazë për të siguruar një sistem gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës<sup>18</sup>. Ndër vlerat kryesore të sistemit kushtetues të Kosovës është krijimi i një bazë solide për të promovuar një sistem gjyqësor të pavarur, të ushtruar nga gjykatat. Kjo bazë është shprehur sidomos në kapitullin e VII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës<sup>19</sup> ku parashihen parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësorë. Këto parime përcaktojnë unitetin, pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësorë, sigurojnë qasje të barabartë në gjykata, ndërsa pushtetin gjyqësorë e determinojnë si apolitik. Në të njëjtin kapitull është e përcaktuar se gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm. Pavarësia e gjykatave është e përcaktuar edhe në Ligjin për Gjykatat<sup>20</sup> i cili përcakton se gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike.

Një segment kyç i cili garanton pavarësinë e sistemit gjyqësorë është themelimi i një strukture institucionale të pavarur e cila e menaxhon sistemin gjyqësorë. Ndërsa instalimi i një sistemi të rekrutimit të gjyqtarëve i cili garanton një proces profesional, transparent dhe i ndërtuar mbi kritere të qarta ligjore siguron gjyqtarë të tillë të cilët si vlerë primare e kanë pavarësinë dhe paanshmërinë.

---

<sup>18</sup> Neni 3 dhe 4 i Kushtetutës së Kosovës.

<sup>19</sup> Neni 102 i Kushtetutës së Kosovës.

<sup>20</sup> Neni 3 i Ligjit për Gjykatat.

Lidhur me strukturën e institucioneve është pozitiv fakti që Kushtetuta e Kosovës përcakton se sigurimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe profesionalizmit të sistemit gjyqësorë e bënë Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Ky këshill është përgjegjës për rekrutimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim në pozitën e gjyqtarit. Edhe pse ky rekrutim shtrihet deri tek procesi i propozimit për emërim tek Presidenti i vendit, prapë mund të thuhet se është bërë një avancim i nivelit të pavarësisë së sistemit gjyqësor. Kjo pavarësi do të mund të kufizohej më tepër nëse dekretimin përfundimtarë do ta bënte kuvendi (organi legjislativ) apo qeveria. Njëra nga kritikrat që sot drejtohet në drejtim të eliminimit të të gjitha formave të ndikimit ka të bëjë me zgjidhjen e bërë në Kushtetutën e Kosovës, sipas të cilës 8 (tetë) nga 13 anëtarët e Këshillit Gjyqësor i zgjedhin deputetët e Kuvendit.<sup>21</sup> Edhe pse nga 8 anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi 5 duhet të jenë nga radhët e gjyqtarëve, vet fakti i zgjedhjes nga deputetët e kuvendit të një numri kaq të madh të anëtarëve mund të krijoj përshtypjen e mundësisë për kufizimin e pavarësisë gjyqësore. Megjithatë zgjidhja e bërë në kushtetutë arsyetohet me vendosjen e sistemit të kontrollit dhe balancit të pushteteve, një mënyrë e zgjidhjes së kësaj çështjeje do të ishte sistemi sipas të cilit të gjithë anëtarët e Këshillit Gjyqësor do të zgjedheshin nga radhët e gjyqësorit. Apo zgjidhja tjetër e cila do të mbështeste parimin e kontrollit dhe balancit të pushteteve do të ishte zgjedhja nga kuvendi e një numri më të vogël (për shembull 3 anëtarëve) të Këshillit Gjyqësor.

Procesit i rekrutimit të gjyqtarëve në Kosovë është një histori në vete. Sistemi gjyqësor i Kosovës ka kaluar nëpër disa etapa të cilat së fundi kanë shënuar të arritura pozitive. Mbi bazën e një strukturë ligjore të miratuar nga misioni i administratës ndërkombëtare (UNMIK) në vitin 2000 u bënë emërimet e para. Në atë periudhë kriteret për emërim si gjyqtarë ishin kryesisht ato që ishin pjesë e traditës juridike të kohës së para vitit 2000. Çështjet e rekrutimit, vlerësimit, disiplinimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve ishin nën autoritetin e Departamentit të Drejtësisë, të misionit të UNMIK-ut.

Një ndryshim i theksuar në përcaktimin e kriterëve të avancuara për rekrutim të gjyqtarëve u shënuar për herë të parë me hyrjen në fuqi të Rregullores 2005/52 me të cilën u themelua Këshilli Gjyqësor e Prokurorial i Kosovës. Me këtë rregullore përveç faktit se si autoritet administrues i gjyqësorit u caktua Këshilli Gjyqësor e Prokurorial, në të njëjtën kohë u përcaktuan edhe kriteret për emërim të gjyqtarëve të cilat dallonin nga ato të

---

<sup>21</sup> Neni 108 paragrafi 6 (2), (3) dhe (4) i Kushtetutës së Kosovës.

mëparshmet. Një risi në këtë drejtim paraqet kriteri i kalimit të provimit për gjyqtarë dhe kalimi i programeve përkatëse për arsimim ligjor.

Për ta përmbushur këtë objektiv, Kuvendi i Kosovës si institucion vendor ligjdhënës, në shkurt 2006 miratoi Ligjin për Themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës<sup>22</sup>. Sipas këtij ligji Instituti Gjyqësor i Kosovës, përveç tjerash ka për mandat organizimin e provimit për gjyqtarë dhe organizimin e programit të veçantë për arsimim ligjorë i cili do të përgatiste gjyqtarët dhe prokurorët e rinj. Këto zhvillime ligjore mundësuan themelimin e një mënyre të re të rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Aktualisht më shumë se 1/3 e gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistemin gjyqësor të Kosovës janë rekrutuar përmes këtij sistemi.

Duke marrë parasysh normativën kushtetuese dhe ligjore në fuqi në Kosovë, mund të konkludojmë se sistemi gjyqësor i Kosovës ka të siguruar pavarësinë formale duke filluar nga procesi i rekrutimit, administrimit, vlerësimit, arsimimit ligjor, llogaridhënies, disiplinimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve. Pyetje në vete paraqet fakti se sa ndihen dhe veprojnë si të pavarur gjyqtarët në praktikë.

## V. PAANSHMËRIA GJYQËSORE

Paanshmëria është njëri ndër postulatet më qenësore të sistemit gjyqësorë. Nëse një vend dëshiron të vendosë sundimin e ligjit, duhet që vërtetë të promovojë dhe sigurojë vlerat e paanshmërisë. Kjo nuk përfshin vetëm paanshmërinë formale, por edhe ruajtjen e një gjendjeje të paanshmërisë. Paanshmëria e sistemit gjyqësorë është një garanci e cila siguron besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor të një vendi. Në praktikë, paanshmëria gjyqësore realizohet nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, duke përfshirë edhe ndarjen me short të lëndëve për vendosje nga gjyqtarët si dhe rregullat për përjashtimin e gjyqtarit. Rregullat për caktimin e rasteve duhet të përcaktohen paraprakisht, përndryshe mund të ketë presione nga palët që një rast të zgjidhet nga një gjyqtar të cilin ata e njohin apo i cili ka zgjidhur raste të ngjashme në një mënyrë të ngjashme. Në kohët e fundit Këshilli Gjyqësor i Kosovës është duke punuar për vendosjen e sistemit të regjistrimit elektronik të rasteve. Kjo reformë do të ndikonte dukshëm në rritjen e besimit të publikut në ndarjen e duhur të rasteve.

---

<sup>22</sup> Ligji nr. 02/L-25.



Një mënyrë tjetër e mbrojtjes së paanshmërisë gjyqësore është uniteti dhe harmonizimi i praktikës gjyqësore, e cila, në Kosovë, bie nën përgjegjësinë e Gjykatës Supreme. Nëse gjykatat marrin vendime shumë të ndryshme për raste të cilat për nga natyra e tyre janë të ngjashme padyshim se në publik krijohet përshtypja e një gjykate apo gjyqtari të korruptuar.

Është e njohur se gjyqtarët janë njerëz dhe pjesë të jetës normale. Megjithatë gjyqtarët i nënshtrohen një sërë kufizimesh gjatë kohës së lirë të tyre. Përveç sjelljeve të pahijshme, kufizimet përfshijnë edhe kërkesat të cilat në Kosovë janë miratuar në Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Gjyqtarëve, duke siguruar që një gjyqtar nuk mund të pranojë ndonjë punë apo punësim që mund të komprometoj pozitën e tij ose mund ta vejë në pyetje paanshmërinë e tij, gjë e cila nuk ndodh edhe për profesionet tjera.

Një aspekt me rëndësi i cila ka ndikim të madh në paanshmërinë e gjyqtarit dhe jo më pak edhe në reputacionin e sistemit gjyqësorë, është edhe çështja e palejueshmërisë së tij për tu anëtarësuar në ndonjë parti politike, apo për të ushtruar ndonjë pozicion apo veprimtari politike. Ekzistojnë edhe kufizime të tjera të cilave iu nënshtrohen gjyqtarët me qëllim të ruajtjes së vlerave të parimit të paanshmërisë.

Paanshmëria si parim i sistemit gjyqësor është pjesë e strukturës ligjore edhe në Kosovë. Kjo vlerë, përkatësisht paanshmëria e pushtetit gjyqësor dhe veprimi i gjyqtarëve si të paanshëm është përcaktuar në Kushtetutë<sup>23</sup> dhe në Ligjin për Gjykatat<sup>24</sup>. Paanshmëria gjyqësore, sidomos koncepti i paanshmërisë së gjyqtarëve është rregulluar edhe me Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Gjyqtarëve. Megjithëse trajtimi i këtij parimi në këtë pjesë nuk pretendohet të jetë i nivelit detal, mund të përfundojmë duke theksuar se përcaktimi i paanshmërisë gjyqësore në aktet më të rëndësishme ligjore dhe kodin e etikës për gjyqtarë nuk garanton edhe realizimin adekuat dhe te duhur të këtij parimi në praktikë. Sigurisht se sfidat për jetësimin e parimit të paanshmërisë së gjyqtarëve mund të jenë rezultat i shumë faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm, të natyrës juridike apo strukturore. Megjithatë një gjë është e sigurt se baza e jetësimit të paanshmërisë gjyqësore duhet të kultivohet fillimisht në vet gjyqësorin e Kosovës, proces ky i cili me siguri se do të kishte efekte pozitive në ngritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor të Kosovës.

<sup>23</sup> Neni 102 paragrafi 2 dhe 4 i Kushtetutës së Kosovës.

<sup>24</sup> Neni 3 i Ligjit për Gjykatat i Kosovës.

**Mr. sc. Lavdim Krasniqi**

## **Judicial Independence**

### *Summary*

Judicial independence is one of the most precious values of a democratic society. Only few basic principals can express the sense of true judicial independence.

The principle of separation of powers, which emerges as a final doctrine, after many revolutionary attempts against centralization of power, marks the beginning of the formation of judicial independence. As long as the judicial independence insures the rule of law, the presence of the fair and impartial trial is unavoidable.

These basic principles (separation of powers, rule of law, and impartiality) form the main content of this output.

The terms highlighted in this case as judicial independence, judges' independence, fair and impartial trial, and the rule of law, are all recognized as the most important principles of constitutional democracy. However, a special attention is paid to the formal terms of judicial independence in Kosovo, challenges and developments concerning the institutional structure responsible for ensuring the independence of local legal and constitutional grounds that are important for legal independence.

The rule of law as the main ground for the respect of freedoms which ensures equality for all citizens is also addressed, considering the perspective of international institutional management, which also establishes a legal framework associated with specific challenges.

Judicial impartiality as one of the principles of judicial independence is also addressed in the context of the certainty which ensures public trust in the judicial system of a country.

Finally, the usage of the notion of “judicial independence” and its key principles in the context is only an initial attempt to attract the attention of those who are part of Kosovo's legal culture.

**Ma.sc. Arben Agushi**

## **MARRËDHËNIET JURIDIKE PRONËSORE TË BASHKËSHORTËVE, TË BASHKËSHORTËVE JASHTËMARTESORË DHE TË ANËTARËVE TË BASHKËSISË FAMILJARE**

### **Hyrje**

Objekt i shqyrtimit në këtë punim është pronësia e përbashkët e bashkëshortëve martesorë, jashtëmartesorë dhe anëtarëve të bashkësisë familjare e cila krijohet si rrjedhojë e jetës dhe kontributit të përbashkët dhe si të tilla kanë një përmbajtje të veçantë në krahasim me marrëdhëniet pronësore juridike në të drejtën sendore. Për këtë arsye këto marrëdhënie pronësore juridike janë studiuar nga e drejta familjare dhe si të tilla janë rregulluar me ligje të veçanta, si me Ligjin për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare<sup>1</sup> dhe tani, së fundi, me Ligjin për Familjen të Kosovës<sup>2</sup>.

Ligji për Familjen i Kosovës, marrëdhëniet pronësore të bashkëshortëve martesor, jashtëmartesor dhe anëtarëve të bashkësisë familjare i ka rregulluar ngjashëm si Ligji mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare të Kosovës, me ndryshime të pakta, si rrjedhojë e demokratizimit të bashkësisë martesore, jashtëmartesore dhe bashkësisë familjare.

Meqë pronësia e përbashkët e bashkëshortëve martesorë, jashtëmartesorë dhe anëtarëve të tjerë të familjes përmban disa veçori dalluese nga pronësia individuale – vetjake, për këtë arsye në këtë punim është bërë përpjekje që të shqyrtohen këto çështje në pajtim me të arriturat shkencore dhe legjislationin kosovar.

---

<sup>1</sup> Ligjin mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare të Kosovës (GZ e KSAK nr.10/84, date 28 mars 1984)

<sup>2</sup> Ligji për Familjen i Kosovës nr. 2004/32 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datë 20.01.2006, ndërsa ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit nga PSSP-ja me datë 16.02.2006.

## I. Marrëdhëniet juridike pronësore të bashkëshortëve

Në bashkësi martesore, burri me gruan bashkërisht krijojnë të mira materiale për plotësimin e nevojave të veta ekzistenciale<sup>3</sup>. Me regjimin pasuror martesor kuptojmë tërësinë e normave juridike që rregullojnë në njërën anë marrëdhëniet pronësore në mes bashkëshortëve dhe në anën tjetër marrëdhëniet pronësore të bashkëshortëve me personat e tjerë<sup>4</sup>.

Varësisht nga përkatësia e pronësisë në të drejtën martesore janë rregulluar disa regjime pronësore të bashkëshortëve: a) regjimi juridik i pasurisë së veçantë; b) regjimi juridik i pasurisë së përbashkët; dhe c) regjimi juridik i pasurisë së përzier<sup>5</sup>. Secili regjim pasuror ka specifikat e veta, të cilat do të trajtohen në vazhdim të punimit.

### a) Regjimi juridik i pasurisë së veçantë

Pasuria e veçantë, në literaturën juridike quhet edhe pronësi vetjake, pronësi e ndarë ose separatiste<sup>6</sup>. Sipas nenit 46, para. 1, të Ligjit për Familjen i Kosovës, pasuria vetjake është ajo pasuri të cilën e ka bashkëshorti në kohën e lidhjes së martesës, e cila edhe pas lidhjes së martesës mbetet pasuri e tij e veçantë – vetjake.

Gjithashtu, pasuria e veçantë është edhe pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës e fituar përmes trashëgimit, dhurimit apo ndonjë forme tjetër ligjore të fitimit të pasurisë<sup>7</sup>.

Dispozitat e nenit 46 të LFK-së e rregullojnë në mënyrë plotësisht identike çështjen e kuptimit të pronësisë së veçantë. Po kështu me të njëjtën dispozitë ligjore në para. 5 është paraparë që secili bashkëshort në mënyrë të pavarur e administron dhe e posedon pasurinë në pronësi të veçantë gjatë

---

<sup>3</sup>Prof. Dr. Hamdi Podvorica, E drejta Familjare (botim i IV me ndryshime dhe plotesime, Prishtinë 2011, faqe. 243.

<sup>4</sup> Prof. Dr. Abdulla Aliu & Mr. sc. Haxhi Gashi, E drejta Familjare Prishtinë 2007. faqe. 138.

<sup>5</sup> Prof. Dr. Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare (botim i IV me ndryshime dhe plotesime), Prishtinë 2011, faqe. 243.

<sup>6</sup> Dr. Vojislav Bakić i Dr. Milan Popović Enciklopedia Imovinskog prava I prava udruzenog rada, tom prvi – Bracni imovinski rezim, Beograd 1978 faqe 156; Dr. Mihajlo Mitiq, Porodicno pravo u SFRJ, Beograd, 1980, faqe 196; Dr. Marko Mlladinović, Porodicno pravo, knjiga II, Beograd, 1981, faqe 642; Valentina Zaqe, Marrëdhëniet Martesore sipas Legjislacionit Shqiptar, Tiranë, 1999, faqe 104.

<sup>7</sup> Prof. Dr. Abdulla Aliu & Mr. sc. Haxhi Gashi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007, faqe 138.

gjithë kohës së martesës. Kjo do të thotë se bashkëshorti pasurin e veçantë mund të disponoi lirisht brenda autorizimeve pronësore të parapara me dispozitat e neni 18 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore<sup>8</sup>.

Edhe pasuria e fituar me lojëra fati paraqet pasuri në pronësi të veçantë, nëse njëri bashkëshort ka deponuar në këtë lojë fati pasurin e veçantë.

Pasuria e fituar gjatë martesës por jo me punë të përbashkët të bashkëshortëve, si frytet nga toka, bagëtia, qiraja nga sendet e luajtshme dhe të paluajtshme që rrjedhin nga pasuria e veçantë, konsiderohen si pronësi e veçantë. Po ashtu edhe kamatat nga kursimet në pronësi të veçantë e përbëjnë masën e pasurisë në pronësi të veçantë.

Në masën e pasurisë në pronësi të veçantë të bashkëshortit hynë dhe sendet për përdorim personal të njërit bashkëshort, sendet për veshmbathje, ora e dorës, unazat, vathet, mjetet për higjienën etj. Me kërkesën e bashkëshortit, me rastin e pjesëtimit dhe të ndarjes së pronësisë së përbashkët, këto sende do të veçohen nga pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe nuk do të llogariten në pronësi të përbashkët të bashkëshortëve.

Mirëpo, nëse vlera e këtyre sendeve është jo proporcionale, shumë më e madhe, në krahasim me vlerën e përgjithshme të pasurisë së përbashkët, do të bëhet pjesëtimi dhe i atyre sendeve, përveç nëse bashkëshorti të cilit këto pjesë duhet t'i takojnë nuk ia siguron bashkëshorti tjetër pagimin përkatës në para apo vlerën përkatëse ose të përafërt ose nuk ia cedon - bartë bashkëshortit tjetër sipas pëlqimit të tij sendet e tjera me vlerë përkatëse ose të përafërt. Për këto kompensime qëllimi kërkohet të miratohet nga të dy bashkëshortët<sup>9</sup>.

Para se të pjesëtohet dhe të ndahet pasuria e përbashkët, duhet të bëhet kërkesa e bashkëshortit që me rastin e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët, që sendet në shfrytëzim personal të veçohen nga masa e pasurisë së përbashkët. Sendet në shfrytëzim personal janë sendet që shërbejnë ekskluzivisht për përdorim personal të njërit bashkëshort dhe vlera e këtyre sendeve të mos jetë jo proporcionale në krahasim me vlerën e përgjithshme të pronësisë së përbashkët apo në krahasim me vlerën e sendeve që i shërbejnë për përdorim personal bashkëshortit tjetër.

Në pronësinë e veçantë hynë të gjitha të drejtat sendore dhe të drejtat e detyrimeve të fituara ekskluzivisht me punën e secilit bashkëshort jo vetëm pas ndërprerjes së përhershme të bashkësisë martesore por dhe me

---

<sup>8</sup> Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, neni 18.

<sup>9</sup> Ligji për Familje i Kosovës, neni 90, para. 3.

rastin e ndërprerjes së përkohshme të bashkësisë martesore<sup>10</sup>. Kur bashkëshortët kanë jetuar një kohë të gjatë ndaras për shkak të marrëdhënies së punës apo për shkak të specializimit në botën e jashtme me marrëveshje ose për shkak të mosmarrëveshjeve, bile vetëm me vullnetin e njërit bashkëshortë e kundër vullnetit të bashkëshortit tjetër, për shkak të mjekimit të gjatë në spital etj. Pra, pasurinë që e ka fituar atje, me punë vetjake, konsiderohet si pronësi e përbashkët. Pronësia e veçantë paraqet krejt ajo pasuri që nuk hynë në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve, e cila nuk është fituar me punë të përbashkët.

Lidhur me shpërblimet dhe përfitimet tjera të bashkëshortit nga krijimtaria shkencore, artistike dhe letrare në teorinë e të drejtës pronësore – martesore ekzistojnë dy mendime:

- Sipas mendimit të parë, këto përfitime materiale honorarët autoriale duhet të hynë në pronësi të veçantë, ngase paraqesin rezultat të punës së autorit ose për shkak se puna e autorit paraqet kontribut shumë më të madh (jo proporcional) në krahasim me kontributin e bashkëshortit tjetër.

- Sipas mendimit të dytë, këto përfitime materiale paraqesin pasuri të përbashkët kur janë të fituara gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore, sepse puna e bashkëshortit nuk mund të përjashtohet si kontribut indirekt i bashkëshortit tjetër kur ky me ndihmën e tij, i mundëson bashkëshortit tjetër që t'i përkushtohet në mënyrë të qet punës shkencore, letrare, artistike dhe të arrij rezultate me vlera të larta profesionale. Mendimi i dytë është mbisundues kur është fjala për regjimin e pasurisë së veçantë<sup>11</sup>. Ligji për Familjen i Kosovës në nenin 46 par. 4 përmban një dispozitë të tillë lidhur me punën intelektuale, një prodhim arti konsiderohet pasuri e ndarë e bashkëshortit/ës që e ka krijuar pasurinë e veçantë.

Secili bashkëshort veç e veç në mënyrë të pavarur administrojë dhe disponojnë me pasurinë e tyre të veçantë. Kjo do të thotë se secili bashkëshorte nuk është i detyruar të kërkoj pëlqimin e bashkëshortit tjetër për të poseduar, përdorë dhe për të disponuar me pasurinë e veçantë deri në kufirin e mos keqpërdorimit të këtyre autorizimeve pronësore në bashkëshortin tjetër dhe nëse këto autorizime pronësore nuk janë në kundërshtim me ligjin dhe të drejtat tjera pronësore të bashkëshortit tjetër. Po ashtu bashkëshorti mund të administroj dhe të disponoj me pasurinë në

---

<sup>10</sup> Jelisaveta Gajovic, Zakon o braku I porodicnim odnosima sa objasnjenjima I sudskom praksom, Beograd 1995, faqe 138.

<sup>11</sup> Dr. Marko Mlladinoviq, Porodicino pravo, knjiga II, Beograd 1981, faqe 645; Dr. Mihajlo Mitiq, Porodicino pravo u SFRJ, Beograd 1980, faqe 188.

pronësi të veçantë edhe kundër mendimit të bashkëshortit tjetër, por jo edhe në dëm të pasurisë së përbashkët e as asaj të veçantë të bashkëshortit tjetër.

Mundësia tjetër është që njëri bashkëshort ta autorizoj bashkëshortin tjetër për administrimin ose disponimin me pronësinë e tij, si çdo person tjetër që të lidh të gjitha kontratat tjera të parapara në të drejtën kontraktuese.

### **b) Regjimi juridik i pronësisë së përbashkët**

Me Ligjin për Familjen i Kosovës, parashihet se pasuria e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë neni 47, para. 1 i LFK-së.

Nga ky përcaktim ligjor i kuptimit të pasurisë së përbashkët bashkëshortore rrjedh se për ekzistimin e saj duhen të plotësohen dy kushte: 1. Ekzistimi i bashkësisë martesore dhe 2. Puna e bashkëshortëve martesore<sup>12</sup>. Kur pasuria nuk është fituar me punën e të dy bashkëshortëve, por vetëm me punën e njërit bashkëshort ose nuk është fituar gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë martesore, ajo nuk paraqet pasuri të përbashkët, por paraqet pasuri të veçantë për të cilën kemi folur më parë.

Në teori nga pikëpamja e të drejtave të bashkëshortëve nuk ka rëndësi fitimi i së drejtës së pronësisë, megjithatë puna e bashkëshortëve ndahet në punë të përbashkët, në punë të ndarë, punë direkte, dhe punë indirekte të bashkëshortëve<sup>13</sup>.

Kjo ndarje ka vetëm rëndësinë e tregimit të formave të punës dhe mundet të paraqesë ndihmë me rastin e caktimit të kontributit të secilit bashkëshort në fitimin e pasurisë së përbashkët.

Puna e përbashkët e bashkëshortëve martesore ekziston kur të dy punojnë në të njëjtën punë apo faza të së njëjtës punë dhe në këtë mënyrë fitojnë të drejtat pasurore. Kështu, ekziston puna e përbashkët kur bashkëshortët punojnë në të njëjtën punë si: tregtar në të njëjtin dyqan, rrobaqepës, avokat e daktilografist në të njëjtën zyre, arsimtar në të njëjtën shkollë, etj.

Punë e ndarë ekziston kur një bashkëshort është në marrëdhënie të punës, ndërsa bashkëshorti tjetër nuk është në marrëdhënie pune, por i

---

<sup>12</sup> Prof. Dr. Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare (botimi IV, me ndryshime dhe plotësime), Prishtinë, 2011, faqe 246.

<sup>13</sup> Dr. Mihajlo Mitiq, Porodicio pravo, Beograd, 1980, faqe 189; Dr. Marko Mladenović, Porodicio pravo, knjiga II, Beograd, 1981, faqe 649.



kryejnë punët e shtëpisë, kur janë të profesioneve të ndryshme, si mjek e inxhinier dhe punojnë punë të ndryshme sipas profesionit, por gjithashtu dhe kur janë të njëjtit profesion e nuk punojnë bashkë shembull: bashkëshortja në gjykatë si gjykatëse, ndërsa burri si avokat.

Puna drejtpërdrejtë ekziston kur bashkëshortët me punën e tyre bashkë fitojnë: pagën nga marrëdhënia e punës, pagesat në kryerjen e shërbimeve të ndryshme: si avokat, mjek, taksist, floktar, etj.

Puna jo direkte ekziston kur mungon kontributi i drejtpërdrejt, sepse për punën e kryer nuk merret kurrfarë shpërblimi por kontributi qëndron në mundësimin e bashkëshortit tjetër, që me punë të drejtpërdrejt të fitoj të drejta, shembull: ndihma e bashkëshortit gjatë krijimit të veprës shkencore apo artistike. Kështu, puna e bashkëshortit, por dhe ndihma e njërit bashkëshort që i jep bashkëshorti tjetër, kujdesi për fëmijët, kryerja e punëve shtëpiake, ruajtja e pasurisë dhe secila formë tjetër e punës dhe e bashkëpunimit në administrimin dhe ruajtjen e pasurisë së përbashkët.

LFK-ja, në nenin 47, pika 4, ka paraparë se bashkëshortët janë pronar të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marr vesh.

Fakti se ekziston martesë nuk do të thotë se gjithmonë dy bashkëshortët jetojnë bashkë. Por, edhe në rastet kur ata nuk jetojnë bashkë, për shkak të punës, studimeve apo specializimit të njërit bashkëshortë për një kohë të gjatë në botën e jashtme, kur ekziston lidhja e tyre emocionale dhe kur njeri bashkëshort indirekt ka dhënë kontributin e vet për fitimin e pasurisë së përbashkët në ruajtje dhe edukim të fëmijëve të përbashkët ruajtje të pasurisë së përbashkët etj, edhe kjo pasuri e fituar është e përbashkët.

Në teori dhe në praktik qëndron mendimi se ekziston bashkësia martesore dhe pasuria e fituar edhe në atë kohë paraqet pasuri të përbashkët<sup>14</sup>. Jam i mendimit se edhe kur nuk ekziston lidhja emocionale e bashkëshortëve, por ekziston kontributi indirekt i njërit bashkëshort për fitimin e pasurisë, ajo pasuri paraqet pasuri të përbashkët të bashkëshortëve.

Po ashtu, edhe kur është bërë blerja e një objekti të luajtshëm apo të paluajtshëm (banesa, shtëpia për banim, automobil), në emër të njërit bashkëshort, para se të lidhet martesë e pagesa është bërë nga pasuria e përbashkët e bashkëshortëve gjatë martesës ose nga të ardhurat nga puna e

---

<sup>14</sup> Dr. Mihajlo Mitiq, Porodico pravo, Beograd, 1980, faqe 190; Dr. Marko Mladenović, Porodico pravo, knjiga II, Beograd, 1981, faqe 648.

përbashkët e bashkëshortëve, ai objekt duhet të jetë pasuri e përbashkët e bashkëshortëve<sup>15</sup>.

Me nenin 47, para. 2, të LFK-së është paraparë se pasurinë e përbashkët e përbejnë të gjitha të drejtat sendore dhe të drejtat e detyrimeve, duke përfshirë po ashtu të hyrat nga pasuria e veçantë që janë fituar me punën e përbashkët.

Nga të drejtat sendore objekt i pasurisë së përbashkët hyjnë; e drejta e pronësisë së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, e drejta e servituteve sendore, e drejta e pengut në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme (hipoteka), prona e etazh – pronësi kati,<sup>16</sup> si dhe frytet nga pasuria e përbashkët sikurse janë: prodhimet bujqësore, drithërat, kashta, sana, shtimi i bagëtisë, prodhimet pyjore, etj.

Në të drejtën e detyrimeve hyjnë të gjitha kërkesat: qiraja nga sendet e përbashkëta, shpërblimi për fitimin e humbur, kamatat në kursimet e afatizuara, shpërblimi i dëmit nga pasuria e përbashkët, renta, shpërblimi i dëmit për fitimin e humbur, etj<sup>17</sup>.

Pasuri të përbashkët të bashkëshortëve paraqesin të gjitha të drejtat sendore dhe të drejtat e detyrimeve në pjesë të pa përcaktuara të bashkëshortëve të cilat rregullohen me norma të natyrës urdhëruese në të drejtën familjare.

Bashkëshortet nuk i dinë hiset në pasurinë e përbashkët, derisa të mos bëhet pjesëtimi i saj, ata janë titullar i të gjitha të drejtave në pjesët e pa pjesëtuar të sendeve dhe të drejtave të detyrimeve me shuma të pa përcaktuara të kërkesave.

Kjo do të thotë se ata nuk i dinë pjesën numerike dhe cilat sende të caktuara ose të drejtave të tjera sendore u takojnë, sikurse është rasti te bashkëpronësia (codominium), kur dihet pjesa e secilit bashkëpronarë për shembull: 1/2, 1/3, 1/4 apo 2/3 etj., ose e shprehur me përqindje 20%, 30%, ku secili nga bashkëpronarët mund që sendin ta marrin në posedim dhe ta shfrytëzojnë në proporcion me pjesën e tij. Pra, bashkëpronari mund të lidhë kontratë për shitblerjen e pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme me pjesën e vetë numerike pa pëlqimin e bashkëpronarit tjetër, kjo në pajtim me dispozitat e nenit 52, para. 1, të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera

<sup>15</sup> Dr. Vojislav Bakiq & Dr. Milan Popović, Enciklopedia Imovinskog prava i prava udruzenog rada, tom prvi – Bracni imovinski rezim, Beograd, 1978, faqe 119.

<sup>16</sup> Prof. Dr. Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare (botimi IV me ndryshime dhe plotesime), Prishtinë, 2011, faqe 247.

<sup>17</sup> Po aty, faqe 247.

Sendore<sup>18</sup>, kurse te pronësia e përbashkët këtë autorizim pronësor nuk e kanë pjesëmarrësit – titullarët e kësaj pasurie të përbashkët, kjo në pajtim me dispozitat e nenit 77, para. 3, të LPDTS.

Për arsye se nuk dihet vlera e hiseve në pasuri të përbashkët LFK – ja parasheh rregulla sa i përket administrimit dhe disponimit me pasuri të përbashkët, bashkëshortët nuk mundin të disponojnë veç e veç, por vetëm bashkërisht, si një tërësi të përbashkët<sup>19</sup>.

Kjo do të thotë se në rast të mohimit apo shkeljes së ndonjë të drejte nga pasuria e përbashkët bashkëshortët duhet të paraqesin bashkërisht padi ose të paditen si bashkëndërgjyqës unik (neni 269, para. 1) i Ligjit për Procedurën Kontestimore<sup>20</sup>.

Kështu sipas LFK-së të drejtat e bashkëshortëve në pasurin e përbashkët të paluajtshme regjistrohen në regjistrat publik të pasurisë së paluajtshme, në emrin e të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët në pjesë të papërcaktuara (neni 50, para. 1) i LFK-së.

Në këtë rast konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të dy bashkëshortëve edhe kur në regjistrat publik të pasurive të paluajtshme është regjistruar vetëm emri i njërit bashkëshort (neni 50, para. 2) i LFK-së.

### **c) Regjimi juridik i pasurisë së përzier**

Regjimi juridik i përzier përfshinë elemente të regjimit të pasurisë së veçantë, por edhe të pasurisë së përbashkët.

Me reformat e reja barazia e bashkëshortëve vihet në planë të parë, me çka synohet realizimi i barabartë i të drejtave të burrit me gruan lidhur me administrimin dhe dipsonimin e pronësisë në mënyrë të barabartë.

Tani nuk flitet për të drejtën e burrit sa i përket administrimit dhe dipsonimit të pronësisë, por për të drejtën e barabartë të qiftit bashkëshortorë<sup>21</sup>.

Me rregullativën ligjore të disa vendeve me kontratë bashkëshortët vetëm mund të zgjedhin njërin prej regjimeve pasurore martesore, nëse nuk e lidhin kontratën atëherë aplikohet regjimi pasurore ligjorë<sup>22</sup>. Regjimin

---

<sup>18</sup> Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, neni 52, para. 1.

<sup>19</sup> Ligji për Familje i Kosovës nenin 47.

<sup>20</sup> Ligji për Procedurën Kontestimore i Republikës së Kosovës i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në nenin 269, pika 1.

<sup>21</sup> Prof.Dr.Hamdi Podvorica, E drejta Familjare (botim i IV me ndryshime dhe plotesime), Prishtinë, 2011, faqe 244.

<sup>22</sup> Po aty.

pasuror ligjor e karakterizojnë normat juridike urdhëruese me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore mes bashkëshortëve.

Me marrëveshje bashkëshortët nuk mund t'i rregullojnë marrëdhëniet ndryshe nga si parashihet me norma ligjore. Ligji për familje i Kosovës legjitimon dy regjime pasurore martesore: regjimi ligjor dhe kontraktues. Po kështu edhe Kodi i familjes i Shqipëris ka paraparë regjimin ligjor pasuror martesor se më adekuat e më të përshtatshëm për bashkëshortët. Edhe Ligji për familje i Maqedonisë parashih regjimin ligjor pasuror martesor. Pasuria e çiftit bashkëshortor mund të jetë e veçantë dhe e përbashkët ( neni 203 i LFM-së).

## **II. Administrimi dhe disponimi i pasurisë së përbashkët**

Sipas nenit 49 të LFK-së, bashkëshortët martesor bashkërisht dhe me marrëveshje e administrojnë dhe disponojnë pasurin e përbashkët. Bashkëshortët mund të kontraktojnë që administrimin dhe disponimin e pasurisë së përbashkët në tërësi ose në pjesët e saj ta bëjë njëri prej tyre. Kontrata mund të kufizohet edhe vetëm në administrim ose në disponim. Kur nuk është kontraktuar ndryshe, administrimi përfshin dhe disponimin në kuadrin e veprimtarisë së rregullt (neni 51 i LFK-së, pika 2). Kontrata mund të përfshij të gjitha punët e administrimit të rregullt ose punë të veçanta të caktuara, për këtë nuk është parashikuar forma e shkruar, andaj lirisht mund të konkludohet se këtu është fjala për kontratë jo formale<sup>23</sup>.

Në rast të mosmarrëveshjeve të bashkëshortëve rreth administrimit, me kërkesën e njërit, vendimin e jep gjykata komunale në procedurën kontestimore.

Administrimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve përfshinë marrjen e masave e të veprimeve të zakonshme për përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë së përbashkët, shembull: pagesa e tatimit, pagesa e qirasë mbledhja e fryteve<sup>24</sup>.

Disponimi i pasurisë së përbashkët përfshinë marrjen e masave dhe të veprimeve të cilat bëhet tjetërsimi dhe ngarkimi i pasurisë së përbashkët

---

<sup>23</sup> Dr. Mihajlo Mitiq, Porodicno pravo, Beograd.1980.faqe.192, Dr.Marko Mlladenoviq, Porodicno pravo, knjiga II, Beograd, 1981, faqe 653.

<sup>24</sup> Prof. Dr. Abdulla Aliu & Mr. sc. Haxhi Gashi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007, faqe 142 – 143.

shembull: shitja e shtëpisë, vënia e hipotekës mbi tokën ose shtëpinë e përbashkët, etj<sup>25</sup>.

Kur disponimin e bën njëri bashkëshort, në teorinë e së drejtës familjare dhe martesore ekziston mendimi se në këtë rast ekziston prezumimi i pëlqimit të bashkëshortit tjetër për tjetërsim dhe veprimi juridik është i plotfuqishëm<sup>26</sup>.

Kështu, edhe sipas një qëndrimi të Gjykatës Supreme të Kosovës: “Pasuria e fituar në martesë me punën e bashkëshortëve është pasuri e përbashkët. Kur njëri nga bashkëshortët, gjatë kohës së martesës dhe të bashkësisë së jetesës disponon pasurin e përbashkët me veprim juridik, ndërsa tjetri bashkëshort e din për një disponim të tillë dhe nuk e kundërshton, madje dhe për dhjet vjet nga dita e tjetërsimit të pasurisë së përbashkët, do të merrte se me sjelljen e tij të tillë, pëlqimin e ka dhënë edhe bashkëshorti për tjetërsimin e pasurisë së përbashkët, prandaj pas zgjedhjes së martesës ai bashkëshort nuk mund ta godas në mënyrë të vlefshme veprimin juridik të bashkëshortit tjetër për arsye se ai bashkëshort nuk ka qene i autorizuar për lidhjen e veprimit juridik” (Ac. nr. 95/73)<sup>27</sup>.

Megjithatë, supozojmë se është i drejt mendimi në teori se kur bashkëshorti nuk ka ditur se bashkëshorti tjetër e ka tjetërsuar pasurinë e përbashkët apo ndonjë të drejt nga pasuria e përbashkët dhe për këtë arsye nuk ka mundur ta kundërshtoj atë, atëherë konsiderohet se veprimi i tillë është nul. Për arsye se një veprim i tillë nuk prodhon efekt juridik. Në këtë rast barra e të provuarit se ai nuk ka ditur për tjetërsimin e pasurisë sa i përket këtij bashkëshorti.

Bashkëshortët mund të lidhin ndërmjet tyre të gjitha kontratat të themelojnë të drejtat dhe detyrimet, sipas ligjit ata nuk mund të lidhin ato kontrata të cilat e ndryshojnë regjimi pasuror martesor i përcaktuar me ligj, si dhe kontratat me të cilat që më parë heqin dorë nga të drejtat që u takojnë sipas ligjit. Shembull: në ushqimin ligjor në pjesën e pasurisë së përbashkët etj.

### III. Pjesëtimi i Pasurisë së Përbashkët

Bashkëshortët në çdo kohë mund të bëjnë me marrëveshje pjesëtimin e pasurisë së përbashkët (neni 53, para. 1 i LFK-së). Gjithashtu,

---

<sup>25</sup> Po aty, faqe 143.

<sup>26</sup> Dr. Mihajlo Mitiq, Porodicno pravo, Beograd, 1980, faqe 193.

<sup>27</sup> Mr. Svetislav Vukovic, Komentar Zakona o braku I porodicnim odnosima, pravo izdanje, Beograd, 2000, faqe 248.

kanë të drejtë të kërkojnë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose të bashkëshortit të shpallur i vdekur dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve, nëse kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet nga pasuria e pjesëtuar e atij bashkëshorti (neni 56, para. 2) i LFK-së.

Pjesëtimin e pasurisë së përbashkët, bashkëshortët martesorë mund ta bëjnë me marrëveshje por edhe me vendim gjyqësor<sup>28</sup>.

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet kur bashkëshortët caktojnë ose kërkojnë të caktohen pjesët e tyre në pasuri të përbashkët dhe kështu bëhen pronarë në pjesë të caktuar (neni 53, para. 2 i LFK-së).

Në rast se nuk arrihet marrëveshja, sa është pjesa e secilit bashkëshortë në pasurin e përbashkët caktohet sipas kontributit të tij duke i çmuar të gjitha rrethanat. Me këtë rast do të merren parasysh jo vetëm të ardhurat personale dhe hyrjet tjera të secilit bashkëshortë, por edhe ndihma e njërit bashkëshort dhënë bashkëshortit tjetër, kujdesi për fëmijët udhëheqja e punëve të shtëpisë, kujdesi dhe ruajtje e pasurisë dhe secila formë tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, ruajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët (neni 54 para. 1 i LFK-së).

Në rast të kontestit për pjesën e bashkëshortëve vendos gjykata kompetente (neni 54, para. 2 i LFK-së) dhe at kur nuk ekziston kontesti ndërmjet bashkëshortëve lidhur me pasurin e përbashkët, me propozimin e njërit apo të dy bashkëshortëve mund të bëhet pjesëtimi i pasurisë së përbashkët në gjykatën komunale në procedurë jokontestimore në pajtim me dispozitat e nenit 197 të LPJ-së<sup>29</sup>, kurse kur ekziston kontesti ndërmjet bashkëshortëve, njëri apo tjetri bashkëshort me padi mund të filloj procedurën kontestimore në gjykatën komunale kur është bërë zgjidhja e martesës me aktgjykim të formës së prerë nga gjykata e qarkut e cila nuk ka gjykuar lidhur me pjesëtimin e pasurisë së përbashkët.

Pjesa e pasurisë së bashkëshortëve përcaktohet duke përdorur kritere të njëjta në të gjitha sendet dhe të drejtat të cilat e përbëjnë pasurin e përbashkët, sipas gjendjes faktike, përkatësisht të drejtave në momentin e pushimit të bashkësisë martesore dhe sipas kontributit të tërësishëm gjatë vazhdimit të bashkësisë martesore (neni 55 lidhur me nenin 54, para. 1, të LFK-së).

---

<sup>28</sup>Prof. Dr. Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare (botimi i IV me ndryshime dhe plotësime), Prishtinë, 2011, faqe 250.

<sup>29</sup> Ligji Për Procedurën Jokontestimore i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 20 nëntor 2008, neni 197.

Nga parimi i pjesëtimit të njëjtë në të gjitha sendet dhe të drejtat që e përbëjnë pasurin e përbashkët, ligji parasheh këto përjashtime:

- Sipas përjashtimit të parë pjesa më e madhe e pasurisë së bashkëshortit në një send apo në të drejtën e caktuar, mund të përcaktohet nga gjykata vetëm nëse ai send ose e drejt ekonomikisht është e pavarur në krahasim me sendet dhe të drejtat tjera në pasurin e përbashkët dhe bashkëshorti përfitimin e atij sendi apo të drejtën ka marr pjesë në të hyrat nga pasuria e tij e veçantë (neni 55, para. 2 i LFK-së);

- Sipas përjashtimit të dytë bashkëshorti, i cili pas pushimit të bashkësisë martesore, përmes investimeve rrit vlerën e sendeve të pasurisë së përbashkët, ka të drejtën të kërkoj nga bashkëshorti tjetër kompensimin nëse investimet kanë qenë të domosdoshme dhe të dobishme. Kompensimi do të jetë në proporcion në pjesën e tij në atë send (neni 55, para. 3 i LFK-së);

- Sipas përjashtimit të tretë bashkëshorti tjetër mund të lirohet nga detyrimi i tillë nëse pranon pjesën më të madhe të pjesës së atij sendi në proporcion me investimet e bëra (neni 55, para. 4 i LFK-së).

#### **IV. Marrëdhëniet juridike pasurore të bashkëshortëve jashtëmartesorë**

Ligji për Familjen i Kosovës, marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve jashtëmartesorë i ka rregulluar me dispozita ligjore.

Me LFK-në është paraparë se pasuria e fituar përmes punës së përbashkët të burrit dhe të gruas në marrëdhëniet jashtëmartesore (partneritetit pa bashkëjetesë) konsiderohet pasuri e tyre e përbashkët (neni 58, para. 1)<sup>30</sup>, dhe për marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve jashtëmartesorë zbatohen me analogji dispozitat përpjesëtimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve për të cilën u bë fjalë më parë.

Duhet thënë se këto marrëdhënie deri vonë nuk kanë qenë fare të rregulluara me rregullativën ligjore.

Nga ky aspekt, ka munguar mbrojtja ligjore e marrëdhënieve pasurore të bashkëshortëve jashtëmartesorë. Në kundërshtim me parimin e barazisë, pabarazisë është bërë pjesë përbërëse e përditshmërisë së jetës së përbashkët jashtëmartesore sidomos në pjesët

---

<sup>30</sup> Ligji për Familjen i Kosovës, neni 58.

rurale e të pazhvilluara të vendit, ku gruaja është eksploatuar në mënyrë të egër<sup>31</sup>.

Mirëpo në praktikën gjyqësore shfaqet mendimi se mbrojtjen e tillë ligjore mund ta gëzoj vetëm bashkësia jashtëmartesore e themeluar në mënyrë ligjore, do të thotë që në momentin e themelimit të saj ku nuk kanë ekzistuar pengesat e as ndalesat martesore dhe që ajo ka zgjatur një kohë të gjatë<sup>32</sup>.

Meqenëse ligji nuk ka përcaktuar asnjë afat minimal, ku do të konsiderohej se një bashkësi jashtëmartesore ka zgjatur një kohë të gjatë, ku në këtë rast duhet shfrytëzuar standardet juridike dhe pastaj i mbetet gjykatës që të vlerësojë rastin konkret se kur është plotësuar ky kusht<sup>33</sup>.

Ligji për Familje i Kosovës në dispozitën e nenit 39 nuk e bënë dallimin ndërmjet bashkësisë faktike dhe bashkësisë jashtëmartesore. Në pajtim me këtë dispozitë ligjore bashkësia faktike apo (bashkësia jashtëmartesore) konsiderohen si marrëdhënie faktike midis burrit dhe gruas të cilët bashkëjetojnë në çifte e karakterizuar me jetë të përbashkët e cilësuar me karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie. Këtë bashkësi faktike apo jashtëmartesore ligji e barazon me bashkësinë martesore nga aspekti i realizimit të drejtave dhe detyrimeve për kujdesën, mbështetje financiare reciproke, dhe të drejta pronësore ashtu sikurse është paraparë me ligj.

Ligjdhënësi në dispozitat e para. 3 të nenit të cituar më lart jep sqarim vetëm lidhur me efektin juridik të bashkësisë faktike në krahasim me bashkësinë martesore duke precizuar se bashkësia faktike nuk jep efektin e saj juridik ndërmjet bashkëshortëve jashtëmartesorë nëse në kohën e themelimit të saj kanë ekzistuar pengesa martesore: martesa ekzistuese, gjinia e gjakut deri në shkallën e ndaluar me ligj, gjinia e adaptimit, sëmundje psikike dhe paaftësia për të gjykuar, përveç nëse ndonjëra nga këto pengesa ka pushuar në ndërkohë, gjithashtu në dispozitat e nenit 40 të FLK-së janë dhënë sqarime plotësuese lidhur me atë se kur mund të konsiderohet se personat jetojnë në bashkësi faktike (bashkësi jashtëmartesore) ku është paraparë se do të plotësohen këto kushte: 1. kanë të drejt të martohen, por nuk kanë lidh martesë ligjore dhe 2. kanë bashkëjetuar haptazi sikur një qift bashkëshort. Kurse me dispozitat e nenit 41 është prapa se në bashkësi faktike (bashkësi jashtëmartesore) bashkëshortët detyrohen ndaj njëri tjetrit për respekt të njëjtë, me

<sup>31</sup> Prof. Dr. Hamdi Podvorica E Drejta Familjare (Botimi i IV me ndryshime dhe plotësime), Prishtinë, 2011, faqe 252.

<sup>32</sup> Po aty, faqe 252.

<sup>33</sup> Po aty.



mirëkuptim të dyanshëm dhe ndihmë sikur në bazë të martesës ligjore. Prandaj, LFK nuk bën dallim ndërmjet bashkësisë faktike dhe bashkësisë jashtëmartesore, kurse mbi bazën e përmbajtjes së dispozitave të cekura në dispozitat e nenit 58 është rregulluar pasuria e fituar me punë të përbashkët të burrit dhe të gruas me marrëdhënie jashtëmartesore dhe regjimi juridik i ndarjes apo pjesëtimit të kësaj pasurie.

## **V. Marrëdhëniet juridike pasurore të anëtarëve të bashkësisë familjare**

Në vendin tonë, lloji dominues i familjes është familja e gjerë e cila përbëhet prej pjesëtarëve të disa brezave. Jo rrallë në familje jetojnë, punojnë, administrojnë dhe disponojnë pasurinë e përbashkët: prindërit, fëmijët me bashkëshorten e tyre dhe nipërit.

Familjet me tri e më shumë breza më së shpeshti gjendet në rajonet rurale, por nuk bëjnë përjashtim as nëpër qytete. Për shkak të shumësisë së subjekteve dhe specifikave të këtyre marrëdhënieve, edhe ligji këto marrëdhënieve i ka rregulluar në mënyrë të veçantë.

Kur në bashkësi familjare me bashkëshortët, përkatësisht me bashkëshortët jashtëmartesorë jetojnë fëmijët e tyre dhe personat e tjerë në gjini, të cilët punojnë në pasurinë bujqësore ose bashkërisht ushtrojnë veprimtari të tjera ose në ndonjë mënyrë tjetër punojnë bashkërisht, pasuri e fituar gjatë kohëzgjatjes së asaj bashkësie është pasuri e përbashkët e të gjithë anëtarëve të cilët kanë marrë pjesë në fitimin e saj (neni 272 i LFK-së).

Është e logjikshme që me ligj nuk është caktuar ndonjë minimum i moshës për të fituar statusin e pronarit të pasurisë së përbashkët sepse kjo është një çështje faktike. Edhe personat e moshës më të re se pesëmbëdhjetë vjeç mund të kontribuojnë me fitimin e pasurisë së përbashkët si: në bujqësi, hoteleri, zejtari etj (neni 273, para. 2 i LFK-së).

Të drejtat e anëtarëve të bashkësisë familjare në sendet e paluajtshme që janë pasuri e tyre e përbashkët regjistrohen në regjistrat publik për vërtetimin e pronësisë në emër të gjithë anëtarëve të bashkësisë familjare të cilët me punën e tyre kanë marrë pjesë me fitimin e pjesëve të pacaktuara (neni 274, para. 1 i LFK-së).

Nëse në ato regjistra është regjistruar si pronar një anëtarë i bashkësisë familjare, konsiderohet se është pronar personi që është

regjistruar derisa sipas propozimit të anëtarëve të tjerë të bashkësisë familjare, në regjistrat publik për evidencat e pasurive të paluajtshme, nuk bëhet regjistrimi i së drejtës së pronësisë së përbashkët (para. 2 i po të njëjtit nen).

Pasurinë e përbashkët anëtarët e bashkësisë familjare e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht dhe me marrëveshje të ndërsjellë (neni 273, para. 1 i LFK-së).

Kontratën me të cilën anëtari i bashkësisë familjare, që si pronarë është regjistruar në regjistrat publik për evidencën e pasurive të paluajtshme, e bënë tjetërsimin ose ngarkimin e pasurisë së paluajtshme të fituar në bashkësi familjare, anëtarët e tjerë të bashkësisë familjare mund ta godasin vetëm nëse në kohën e lidhjes së kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtshme ka qenë e regjistruar pasuria e përbashkët ose në kohën e lidhjes së kontratës personin e tretë me të cilën është lidhur kontrata në mënyrë të padyshimtë e kanë vënë në dijeni se është fjala për objektin e pasurisë së përbashkët (neni 274, para. 3 i LFK-së). Me fjalë të tjera mundë të bëhet goditja e kontratës vetëm kur personi i tretë ka qenë me keqbesim. Kur bëhet tjetërsimi i pa autorizuar i sendit të luajtshëm në pasurin e përbashkët anëtarët mund ta atakojnë atë vetëm nëse marrësi ka qenë me keqbesim (para. 4 i po të njëjtit nen).

Anëtarët e bashkësisë familjare me kontratë mund të rregullojnë marrëdhëniet reciproke pasurore. Kontrata duhet të jetë e formuluar në mënyrë të shkruar, të përfshij të gjithë anëtarët e bashkësisë familjare dhe të vërtetohet në gjykatë<sup>34</sup>.

Nëse në lidhjen e kontratës marrin pjesë anëtarët e mitur, gjykata para se ta bëjë vërtetimin e kontratës do të kërkojë mendimin e organit të kujdestarisë (neni 276, para. 4 i LFK-së).

---

<sup>34</sup> Prof. Dr. Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare (botimi i IV me ndryshime dhe plotësime), Prishtinë, 2011, faqe 254.

## PËRFUNDIM

I. Nga shqyrtimet e paraqitura më lartë lidhur me marrëdhëniet juridike pronësore të bashkëshortëve, të bashkëshortëve jashtëmartesorë dhe të anëtarëve të bashkësisë familjare, vijmë në përfundim se teoria, legjislacioni dhe praktika gjyqësore këtyre marrëdhënieve pronësore juridike i janë qasur në pajtim me përmbajtjen e tyre, sidomos duke marrë parasysh veçoritë apo karakteristikat e këtyre marrëdhënieve për nga mënyra e krijimit të pasurisë së përbashkët, duke e marrë si kriter kontributin e pjesëmarrësve gjatë bashkësisë martesore, jashtëmartesore dhe anëtarëve tjerë të bashkësisë familjare.

II. Hulumtimet tona kanë treguar se rregullimi i marrëdhënieve të këtilla pronësore juridike në periudhën transitore në Republikën e Kosovës kanë pësuar ndryshime të ndjeshme në aspektin e rregullativës ligjore. Ndryshimet e mëdha shoqërore dhe ekonomike janë shoqëruar me paraqitjen e marrëdhënieve të reja edhe në familjen kosovare, andaj rregullimi me norma ligjore e këtyre marrëdhënieve të reja është shtruar si nevojë e këtyre rrethanave të ndryshuara. Ligji për Familjen i Kosovës, i cili tani është në fuqi, sjell risi të shumta në rregullimin e marrëdhënieve pronësore juridike të bashkëshortëve, bashkëshortëve jashtëmartesorë dhe të anëtarëve të bashkësisë familjare, të cilat jemi përpjekur t'i vëmë në pah gjatë trajtimit të punimit.

III. Së fundi, punimi ka për qëllim të japë një kontribut sado modest në sqarimin e disa dilemave që ekzistojnë edhe në teori edhe në praktikë lidhur me këto institucione pronësore të rëndësishme juridike, si dhe të njoftohen lexuesit edhe me disa qëndrime të praktikës gjyqësore.